

**NDRYSHIMI I KLIMËS
DHE SFIDA E SHQIPËRISË DREJT EVROPËS
NË KËNDVËSHTRIMIN E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE**

Jonka Ceka

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin Juridik, me profil të Drejtë Ndërkombëtare Publike,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Numri i fjalëve: 78525

Tiranë, mars 2015

Shënime mbi të drejtën e kopjimit dhe të drejtat e pronësisë intelektuale:

(1) E drejta e kopjimit të tekstit të këtij disertacioni i mbetet Autorit. Kopjet (nëpërmjet çdo mënyre) si të plota, ashtu dhe të pjesshme, mund të bëhen vetëm sipas udhëzimeve të dhëna nga Autori dhe të depozituara në bibliotekën e Universitetit Evropian të Tiranës. Kjo faqe duhet të jetë pjesë e çdolloj kopjeje të realizuar. Kopje të tjera (nëpërmjet çdolloj mënyre) të kopjeve të bëra në përputhje me këto udhëzime, nuk mund të bëhen pa marrë lejen me shkrim të Autorit.

(2) Pronësia e të drejtave intelektuale që mund të përshkruhen në këtë disertacion i takojnë Universitetit Evropian të Tiranës, subjekt i një marrëveshjeje paraprake me kontraktuesin dhe nuk mund t'i jepen për përdorim palëve të treta pa lejen me shkrim të Universitetit, e cila do të përshkruajë termat dhe kushtet e një marrëveshjeje të tillë.

(3) Për qëllime bibliografike dhe reference, ky disertacion duhet të referohet si vijon:
Ceka, J. 2014. *Ndryshimi klimës dhe sfida e Shqipërisë drejt Evropës, në këndvështrimin e së drejtës ndërkombëtare*. Disertacion doktore, Fakulteti Juridik, Universiteti Evropian i Tiranës, Tiranë.

Deklarata e autorësisë:

- (1) Ky disertacion është plotësisht origjinal si nga përmbajtja, ashtu dhe nga struktura. Asnjë pjesë e punimit në këtë disertacion nuk është dorëzuar në kuadër të ndonjë aplikimi për gradë tjetër shkencore në këtë universitet apo në ndonjë institucion tjetër mësimdhënieje.
- (2) Ky disertacion nuk përmban materiale të shkuara ose publikuara më parë nga ndonjë person tjetër, me përjashtim të rastit kur është referuar në mënyrën e duhur me referencë bibliografike.

Jonka Ceka

Falenderime

Autorja i është mirënjohëse profesor Ksenofon Krisafit, që u bë ftuesi dhe nxitësi për të kryer doktoraturën në UET dhe që në rolin e mentorit të mençur dhe të dijshtëm, me këshillat e tij, lehtësoi zgjidhjen e shumë dilemave kërkimore.

Autorja pati fatin të përfitojë nga asistencë teknike e financiare e Agjencisë së Mjedisit të Suedisë, një vendi avangardë në çështjet e mjedisit, asistencë e cila dha frutet e saj në disertacion.

Së fundi, ishte falë mbështetjes së pakursyer të bashkëshortit Arian Veizaj, që procesi i gjatë e sfidues i doktoraturës u bë më i lehtë.

Jonka Ceka

PËRMBAJTJA

TABELA DHE FIGURA	ix
LISTA ME SHKURTIME	xii
FJALORTH	xiii
PËRMBLEDHJE.....	xiv
ABSTRACT	xiv
HYRJE	16
Qëllimi i studimit dhe objektivat	18
Hipoteza dhe pyetjet kërkimore	19
Fusha e studimit	21
Cilat janë burimet e së drejtës së mjedisit?	21
Lindja dhe zhvillimi i të drejtës së mjedisit	22
E drejta për klimën në të drejtën e mjedisit.....	23
Tendencat e zhvillimit të së drejtës së mjedisit.....	25
Rëndësia e studimit.....	27
Vlera e shtuar e kërkimit.....	27
Shtrimi i problemit.....	28
Pohime paraprake	29
PJESA I - ZHVILLIMET POLITIKE DHE JURIDIKE GLOBALE	30
NË KUADËR TË NDRYSHIMIT TË KLIMËS – PËRMBLEDHJE LITERATURE	30
Ngrohja globale ose ndryshimi i klimës	30
Ndikimet e ndryshimit të klimës.....	33
Ndryshimi i klimës si çështje sigurie	39
Përgjigjja ndërkombëtare ndaj ndryshimit të klimës	43
Kuadri ligjor për ndryshimin e klimës	46
Protokolli i Kiotos	53

Përgjigja e BE ndaj ndryshimit të klimës	55
Bashkimi Evropian për ndryshimin e klimës si çështje e sigurisë ndërkombëtare	60
Legjislacioni mjedisor i BE lidhur me Protokollin e Kiotos	65
Çështjet kryesore mjedisore që ndërlidhen me ndryshimin e klimës dhe përgjigja institucionale ndaj tyre	68
Toka.....	68
Energjia	71
Transporti	75
Industria.....	77
Konteksti ligjor dhe politik i mjedisit në nivel rajonal lidhur me ndryshimin e klimës	80
Mesdheu	80
Ndikimet e ndryshimit të klimës në sigurinë e Mesdheut dhe qasja evropiane	82
Ballkani Perëndimor- Politikat e ndryshimeve klimatike dhe perspektivat në kuadër të angazhimeve ndaj KKKBNK dhe anëtarësimit në EU	92
Metodologjia.....	100
Planifikimi i kërkimit	101
Strategjia e kërkimit	102
Metodat specifike për t’iu përgjigjur pyetjeve kërkimore.....	103
Përmbledhje e metodave dhe kufizime të metodologjisë së përdorur	104
PJESA II - ÇËSHTJA E NDRYSHIMIT TË KLIMËS PËR SHQIPËRINË,.....	108
SI NJË PREJ SFIDAVE PËR INTEGRIMIN.....	108
NË BASHKËSINË EVROPIANE - ANALIZË	108
Shqipëria	108
Një përmbledhje e shkurtër e natyrës dhe ekonomisë së vendit.....	108
Sektori i mjedisit	113
Elementët e zhvillimit që ndikojnë në gjendjen e mjedisit parë në aspektin juridik.....	118

Kuadri ligjor dhe institucional i mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri në perspektivën e anëtarësimit në BE	122
E drejta e brendshme e mjedisit	122
Procesi i politikave dhe legjislacionit mjedisor nën dritën e integritit evropian	129
Vlerësimet e raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë lidhur me ndryshimin e klimës	136
Legjislacioni horizontal i mjedisit dhe shkalla e përafrimit të tij.....	141
Legjislacioni në fushën e energjisë dhe industrisë	148
Legjislacioni në fushën e pylltarisë lidhur me ndryshimin e klimës.....	155
Gjendja e mjedisit dhe kuadri ligjor lidhur me ngrohjen globale	157
Legjislacioni për ajrin, klimën dhe konteksti i politikave për ndryshimet klimatike.....	159
Komunikimet Kombëtare për KKKBNK.....	170
Dokumenti i politikave të financimit të karbonit	172
Analiza FDMK	174
PJESA III - DETYRIMET LIGJORE KLIMATIKE TË SHQIPËRISË NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË BE, PLUS DY RASTE STUDIMI - ANALIZË	177
Kërkesat e negociatave për zgjerim të BE-së – ndryshimet klimatike	177
Detyrimet e Shqipërisë për ndryshimet klimatike në kuadër të anëtarësimit në BE	183
Mekanizmat e financimit të karbonit dhe lidhja e tyre me procesin e anëtarësimit në BE	185
Rast studimi 1 - Përmirësimi i legjislacionit për taksën e karbonit në Shqipëri.....	189
Hyrje.....	189
Taksa e karbonit dhe zbatimi i saj	190
Taksa e karbonit krahasuar me tregtinë e emetimeve (cap-and-trade).....	192
Ndryshimi i klimës dhe taksa e karbonit në Evropë.....	194
Taksa e karbonit në Shqipëri	196
Nevoja për përafrim të mëtejshëm të legjislacionit të taksës së karbonit	198

Analiza e produkteve të energjisë që importohen në Shqipëri	200
Përfundime	203
Rast studimi 2 - Politikat për pakësimin e karbonit nëpërmjet pylltarisë – nevoja për ndryshime.....	205
Hyrje.....	205
Programet REDD	206
Mënyrat e aplikimit të mekanizmave REDD	208
Shpërndarja e stimujve financiare	209
Mekanizmat financiarë me bazë tregu.....	211
Politika Evropiane e REDD+	212
Zbatimi i REDD+	214
Programi REDD+ për Shqipërinë.....	215
Masat që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e klimës në sektorin pyjor	219
Përfundime	230
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	231
Konkluzione të përgjithshme	233
Konkluzione specifike	242
Lista e referencave.....	249
Literaturë.....	249
Burime parësore	252
Burime juridike	255
Burime nga Interneti	259
Shtojca 1	261
Gazet serrë që vijnë nga veprimtari njerëzore dhe emetimet e të cilëve kufizohen nga Protokollin e Kiotos:.....	261
Shtojca 2.....	262
Acquis të BE-së për energjinë me rëndësi për përafrimin para-aderues.....	262

Shtojca 3	264
Lista e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mjedisit,	264
të miratuara në Shqipëri, gjatë periudhës 2005-2012,	264
Shtojca 4	270
Lista e vendeve pjesë e Shtojcës 1 në KKKBNK	270

TABELA DHE FIGURA

Figura 1: Skemë - si shkaktohet ngrohja globale nga gazet serrë	31
Figura 2: Ndikimet e ngrohjes globale	35
Figura 3: Aspekti i sigurisë së ndryshimit të klimës	41
Figura 4: Burimet e gazeve serrë në Evropë, sipas sektorëve të ekonomisë.....	59
Tabela 1: Iniciativat për dizajnin dhe etiketimin ekologjik.....	67
Tabela 2: Iniciativat për sektorët me energji intensive, tregjet e energjisë dhe prodhimin.....	67
Tabela 3: Transporti dhe sektorët e tjerë jo-tregtarë	67
Figura 5: Emetimet e gazeve serrë sipas sektorit dhe mënyrës së transportit në BE	76
Figura 6: Hartë e Pellgut të Mesdheut.....	80
Figura 7: Metodatat në funksion të objektivit kërkimor	102
Figura 8: Harta e Shqipërisë.....	109
Figura 9: Pishë e dëmtuar nga erozioni i bregut dhe kripa e ujit.....	112
Tabela 4: Treguesit mjedisorë për dukurinë e ndryshimeve klimatike	118
Tabela 5: Përmbledhje e vlerësimeve në raportet e progresit të KE gjatë 2010-2013	139
Tabela 6: Legjislacioni horizontal shqiptar dhe shkalla e përafrimit të tij.....	142
Tabela 7: Shkalla e përafrimit të legjislacionit horizontal mjedisor evropian	145
Tabela 8: Shkalla e përputhjes së legjislacionit shqiptar të energjisë me atë të BE-së	149
Tabela 9: Shkalla e përafrimit të legjislacionit evropian për ndotjen industriale.....	152
Tabela 10: Shkalla e përafrimit të legjislacionit bazë të pyjeve me atë të BE-së.....	156
Figura 10: Prova të rritjes së nivelit të detit në plazhin e Golemit, maj 2008.....	159
Tabela 11: Legjislacioni i ajrit dhe shkalla e përafrimit të tij	161
Tabela 12: Shkalla e përafrimit me legjislacionin evropian për ajrin	162
Tabela 13: Shkalla e përafrimit me legjislacionin evropian për klimën.....	165

Figura 11: Emetimet e gazeve serrë (në Gg CO ₂ eq) sipas të dy skenarëve.....	171
Tabela 14: Analiza FDMK e legjislacionit dhe politikave për ndryshimin e klimës	175
Tabela 15: Krerët Tariforë të KTNK të produkteve të energjisë të taksuara në Direktivën 2003/96/EC, por që mungojnë në ligjin shqiptar	198
Tabela 16: Importi sipas KTNK të produkteve të energjisë gjatë viteve 2010, 2011, 2012 ..	200
Figura 12: Sasia e 2701 dhe totalit të produkteve të energjisë gjatë viteve në ton	201
Figura 13: Sasia e 2709 dhe 2711, matur në mijë litra gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012.....	202
Figura 14: Përqindja e totalit të KTNK për sasi të ton, në vitin 2012	202
Figura 15: Aktivitetet e sugjeruara për ndërtimin e kapacitetit.....	223
Figura 16: Aktivitetet kërkimore të sugjeruara për mbrojtjen e klimës në sektorin e pyjeve	225
Tabela 17: Matrica FDMK për rastin e studimit 2	229

LISTA ME SHKURTIME

GEF	Enti global mjedisor (Global Environmental Outlook)		
GjED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë		
IPCC	Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimin e Klimës		
KE	Komisioni Evropian		
KiE	Këshilli i Evropës		
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës		
KTNK	Kreu Tarifor i Nomenklaturës së Kombinuar		
LCP	Procese me karbon të pakët		
LNP	Lëndët e Ngurta në Pezulli		
MENA	Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut		
MIE	Ministria e Integritimit Evropian		
MM	Ministria e Mjedisit		
MZhP	Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër		
NAPA	Programi i Veprimit Kombëtar të Përshatjes		
NATO	Organizata e Traktatit Verior-Atlantik		
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë		
OECD	Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit		
OJF	Organizata Jo-fitimprurëse		
OJQ	Organizata Jo-qeveritare		
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm		
PE	Parlamenti Evropian		
PKZ-MSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit		
PM10	Pjesëza pluhuri me dimatër më pak se 10 mikron		
REC	Zyra Rajonale Mjedisore		
REDD	Reduktimi i Emetimeve nga Shpyllëzimi dhe Degradimi		
RENA	Rrjeti Mjedisor Rajonal për Aderim		
SEC	Standardet Evropiane të Cilësisë		
SIP	Sistemi i Integruar i Planifikimit		
SKE	Strategjia Kombëtare e Energjisë		

FJALORTH

FDMK: teknikë e strukturuar planifikimi e përdorur për të vlerësuar **Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë** dhe **Kërcënimet** në një projekt ose në një ndërmarrje biznesi

kapacitet përshtatës: aftësia e një sistemi për t'iu përshtatur ndryshimit të klimës me dëme të lehta, për të përfituar nga mundësitë, ose për të bashkëvepruar me pasojat

legjislacion horizontal mjedisor: pjesë legjislacioni mjedisor, i cili në dallim nga legjislacioni që mbulon mediat mjedisore të tilla si uji, ajri apo toka, ka karakter procedural dhe siguron metoda e mekanizma që kanë për qëllim përmirësimin e vendimmarrjes, zhvillimin dhe zbatimin e ligjit

ndryshim i klimës: Çdo ndryshim i klimës në kohë, si për shkaqe natyrore, ashtu dhe si rezultat i veprimtarisë së njeriut (sipas përkufizimit të IPCC)

zhvillim i qëndrueshëm: zhvillim që plotëson nevojat e të tashmes, pa ndikuar në aftësinë e brezave të ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre (sipas përkufizimit në raportin *Brundtland*)

PËRMBLEDHJE

i disertacionit të doktoraturës: “Ndryshimi i klimës dhe sfida e Shqipërisë drejt Evropës, në këndvështrimin e së drejtës ndërkombëtare”, nga Jonka Ceka.

Kërkimi në këtë disertacion zhvillohet në fushën e së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, ndërsa tematika është ‘ngrohja globale’ ose ‘ndryshimi i klimës’, e cila paraqet sot një ndër çështjet me rëndësi në agjendën ndërkombëtare. Kjo është një çështje globale jo thjesht mjedisore, por dhe politike, ekonomike, sociale e sigurie. Shqipëria, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe të ravijëzimit të profilit të saj si shtet demokratik në arenën ndërkombëtare, është e udhës të ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente një sërë masash ligjore, institucionale e politike, edhe në fushën e ndryshimit të klimës.

Mbështetur në aspektin teorik të kërimit, çështja e ndryshimit të klimës trajtohet në këndvështrimin politik, gjeopolitik, sociologjik dhe mjedisor. Qëllimi i përgjithshëm i studimit është analizimi i gjendjes, identifikimi i mangësive dhe shqyrtimi i mundësive në kuadrin ligjor e politik shqiptar të ndryshimit të klimës, në këndvështrimin e proceseve integruese të vendit tonë në BE. Ky qëllim i përgjithshëm realizohet duke vlerësuar situatën edhe nëpërmjet analizës FDMK, e cila lehtëson shfaqjen e një panorame të procesit të politikave të ndryshimit të klimës në Shqipëri, dhe mbi këtë bazë, bëhen prognoza e nxirren detyra për të ardhmen. Bazuar në aspektin empirik të kërimit, vendosen objektiva që kanë të bëjnë me analizimin e kontekstit ndërkombëtar dhe rajonal të ndryshimit të klimës, evidentimin e rolit të BE-së në këtë çështje, kërkesat e saj ndaj vendeve anëtare e në proces aderimi, si Shqipëria. Mbi këtë bazë vijohet me objektivat për pasqyrimin e plotë të kuadrit ligjor, politik e institucional shqiptar për ndryshimin e klimës, të shkallës së përafrimit me *acquis*-në e BE-së, të shqyrtimit të mundësive për aplikimin e skemave inovative evropiane me ndikim pozitiv për ekonominë, mjedisin dhe pozitën politike të Shqipërisë.

Kërkimi mbështetet në hipotezën se kuadri ligjor dhe institucional në Shqipëri është i paplotë për t’u përgjigjur një çështjeje globale sikurse është ndryshimi i klimës dhe sfidave që ajo paraqet, se ka nevojë për përmirësime të ndjeshme me qëllim që t’u përgjigjet kërkesave të aderimit në BE, përfshirë kapacitet teknike, administrative, monitoruese e raportuese, si dhe informimin, ndërgjegjësimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes së publikut. Rëndësia e kërimit lidhet ngushtë me qëllimin e studimit, objektivat, hipotezën dhe grupet shënjestër të tij. Kërkimi del me përfundime dhe rekomandime që mendohet t’u vlejnjë ligjvënësve, politikbërësve dhe administratorëve të mjedisit në vend. Ai jep kontribut konkret nëpërmjet rasteve studimore në fushën e përafrimit të legjislationit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor e institucional për ndryshimin e klimës. Rrjedhimisht, jepen disa rekomandime specifike, të cilat kanë të bëjnë me konsiderimin e përfshirjes në kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar të mekanizmave me bazë tregu, sigurimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në tregjet e karbonit, ndërmarrjen e masave legjislative e politikave pyjore, që konsiderohen me ndikim pozitiv për çështjen e ndryshimit të klimës.

Fjalë kyçe: ndryshimi i klimës, Protokollin e Kiotos, mekanizmi i zhvillimit të pastër, programet REDD për pylltarinë, taksat e karbonit, përafrimi i legjislationit, siguria, integrimi evropian.

ABSTRACT

of doctoral dissertation: "Climate change and Albania challenge toward Europe, in view of international law" by Jonka Ceka.

Research in dissertation takes place in the field of international environmental law, while subject is 'global warming' or 'climate change', constituting one of the important issues of today's international agenda. Climate change is a global issue, having not just environmental, but also political, economic, social and security implications. During the process of joining the European Union, as well as of outlining its profile as a democratic state in the international arena, Albania needs to consistently take a set of coherent legislative, institutional and political measures, in the field of climate change.

Focusing on theoretical research, the issue of climate change has been addressed in the political, geopolitical, sociological and environmental perspective. The overall goal of the study is to analyze the situation, identify the gaps, and review the opportunities in legal and institutional framework of Albanian climate change policy, in view of its process toward the European integration. The attainment of this general objective is assisted by SWOT technique, which facilitates the assesment of the situation of climate change policy in Albania. Following the empirical research, goals are set dealing with the analysis of international and regional context of climate change, highlighting the EU role on this issue, as well as its demands toward states already member and in accession process, such as Albania. On this basis, it is pursued with the objective of displaying a full picture of the Albanian legal, institutional and political framework of climate change and the degree of its alignment with the EU acquis, as well as the exploration of the possibility for application of the European innovative schemes having positive impact on the economic, environmental and political situation in Albania.

Research is based on the assumption that legal and institutional framework in Albania is incomplete to respond to a global issue such as climate change and the challenges it poses, that needs improvements in order to comply to the requirements for EU accession, improvements that include technical, administrative, monitoring and reporting capacity, as well as provision of information and public participation.

The importance of research is closely related to the purpose of the study, objectives, hypothesis, and its target groups. Research comes out with conclusions and recommendations that are meant to be applicable by legislators, policymakers and environmental managers in the country. Dissertation strives to give specific contribution through case studies in the field of approximation of legislation and improvement of the legal and institutional framework for climate change. Consequently, there are drawn some specific recommendations in relation to the inclusion of market-based mechanisms in the Albanian legal and institutional framework, the ensurance of country's participation in carbon markets, as well as the adoption of forest legislative measures and policies that are considered to have positive impact to climate change mitigation.

Keywords: climate change, Kyoto Protocol, clean development mechanism, REDD programs for forestry, carbon tax, approximation of legislation, security, European integration.

HYRJE

Kërkimi, objekt i këtij disertacioni doktoral, zhvillohet në fushën e të drejtës së mjedisit, e cila është një disiplinë e së drejtës ndërkombëtare (të drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtave të njeriut). Mjedisi është pjesë e jetës sonë të përditshme, ndaj ndërgjegjësimi kundrejt tij është jetik. Çështja e mjedisit gradualisht po merr përparësi në Shqipëri, por në raport me vendet e rajonit dhe më gjerë, jemi ende prapa. Arritje janë shënuar në krijimin e institucioneve qeveritare dhe kuadrin ligjor përkatës, fusha në të cilat ka ende punë për të bërë. Ndërsa zbatimi i ligjit, veprimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor në tërësi, kanë shumë nevoja për përmirësim.

Shqipëria është vend aspirant për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ndaj edhe në këtë kuadër, i paraqiten shumë sfida, ndër të tjera edhe në aspektin ligjor, institucional dhe politik të mjedisit. Nga Shqipëria në fushën e mjedisit pritet, si në të gjithë fushat e tjera të jetës në vend, të arrihen standarde ligjore, administrative e sociale, të cilat nënkuptojnë përafrim legjislativ, ngritje kapacitetesh, përmirësim i vendimmarrjes politike në mbrojtje dhe dobi të mjedisit, ndërgjegjësim dhe pjesëmarrje e publikut në vendimmarrje.

Bazuar në rëndësinë e çështjes së mjedisit në tërësi dhe implikimeve të saj për procesin e integritetit të vendit tonë në Bashkësinë Evropiane, trajtimi i një teme nga fusha e mjedisit tingëllon e kohës dhe pritet të paraqesë interes për ligjvënësit, politik-bërësit, aktivistët e mjedisit, akademikët dhe studentët e drejtësisë.

Ngrohja globale ose ndryshimi i klimës është sot një ndër çështjet me rëndësi në agjendën ndërkombëtare. Kjo është një çështje globale jo thjesht mjedisore, por dhe politike, ekonomike, sociale, sigurie, etj. Vendet e zhvilluara të botës, prej 20 vjetësh po merren seriozisht me çështjen e ndryshimit të klimës, e cila kërkon angazhim të madh politik dhe vendimmarrje që i kapërcen kufijtë e shteteve. Ndryshimi i klimës është trajtuar dhe trajtohet nga një organizatë ndërqeveritare si Kombet e Bashkuara, ndërsa në nivel evropian nga institucionet e BE-së, duke zënë vend si një ndër çështjet e rëndësishme në agjendën mjedisore evropiane.

Shqipëria është palë e Protokollit të Kiotos kundër ndryshimit klimatik që prej vitit 2004, pra zyrtarisht e ka adaptuar këtë politikë globale. BE-ja, përveçse palë e këtij protokolli, ka ndërmarrë angazhimet e saj shumë ambicioze për të lehtësuar ndryshimin e klimës. Andaj, një vend si Shqipëria që aspron të bëhet pjesë e familjes evropiane duhet të ndërmarrë një sërë masash ligjore, institucionale e politike, edhe në këtë fushë, jo vetëm deri në momentin e marrjes së statusit të vendit kandidat dhe anëtarësimit, po edhe pas kësaj ngjarjeje, për të arritur standardet e kërkuara.

Çështja e ndryshimit të klimës merr rëndësi të veçantë për Shqipërinë, edhe për faktin se është vend mesdhetar dhe si i tillë i ndjen dukshëm pasojat direkte dhe indirekte të këtij ndryshimi. Në këtë suazë, Shqipëria është e përfshirë në forume politike të rajonit, ku është angazhuar të japë kontributin e saj. Angazhimet politike të Shqipërisë përbëjnë një premtim dhe sfidë, ndaj Shqipëria, së pari klasa politike shqiptare, duhet të angazhohet fort, me qëllim lartësimin e imazhit rajonal e ndërkombëtar të vendit.

Tashmë dihet pa asnjë dyshim se shkak kryesor i ndryshimit të klimës është aktiviteti njerëzor. Edhe ata që deri pak vite më parë nuk ishin të bindur se njerëzit kishin ndikim mbi klimën, tani pranojnë se provat shkencore ekzistojnë që kjo po ndodh. Dëshmi për këtë janë ngrohja e temperaturave të ajrit, shkrirja në nivel të gjerë e dëborës dhe akujve, nivelet në rritje të deteve. Këto ndryshime paraqesin rrezik për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social e politik, si dhe shkaktojnë vuajtje njerëzore. Ndryshimet klimatike po sjellin fatkeqësi natyrore, mungesa ushqimore dhe zhvendosje të popullatave, ndikime që priten të intensifikohen. Përveç kësaj, ndryshimet klimatike priten të përforcojnë në masë të konsiderueshme kërcënimet tashmë ekzistuese, në pikën ku ata mund të shkaktojnë paqëndrueshmëri social-politike e konflikte të dhunshme.

Ekziston një ndryshim i madh në aftësinë e vendeve për t'u përballur dhe për t'u përshtatur me ndikimet negative të ndryshimit të klimës; vendet e zhvilluara kanë shanse t'ia dalin me mekanizma, edhe pse të kushtueshëm për t'u përballur me këta ndikime, përfshirë lëvizjen e popullsisë nga zonat e rrezikut, përshtatjen e bujqësisë dhe industrisë, si dhe mjetet e tjera të përgjithshme për të minimizuar sfidat e shkaktuara nga ndryshimi i klimës ndaj shoqërisë, ekonomisë dhe sistemit politik. Ndërsa vendet që tashmë përballen me varfërinë, jostabilitetin social dhe politik, do të jenë shumë më të ndjeshme ndaj pasojave negative të ndryshimeve klimatike, sepse nga njëra anë ata nuk posedojnë shumë mjete për të luftuar ndikimin e

ndryshimeve klimatike dhe nga ana tjetër ata tashmë vuajnë nga një shumëllojshmëri kërcënimesh që priten të përkeqësohen nga ndryshimet klimatike, duke përfshirë thatësitat, degradimin e tokës, shkretëtirëzimin, sëmundjet, etj.

Në raportin e fundit të UNEP-it, Këndvështrimi Global Mjedisor¹, theksohet se ndryshimet klimatike do të kenë ndikim të rëndësishëm dhe afatgjatë në zhvillimin dhe mirëqenien e njeriut dhe se këto do të pengojnë përpjekjet për të përmbushur nevojat themelore të zhvillimit, të tilla si ato të identifikuar në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Sipas raportit të UNDP-së mbi zhvillimin njerëzor:

“ka një dritare mundësie për të shmangur ndikimet më të dëmshme të ndryshimeve klimatike, por dritarja është e mbyllur: bota ka më pak se një dekadë për të ndryshuar kursin. Veprimet që do të ndërmerren ose nuk do të ndërmerren në vitet e ardhshme, do të ketë një ndikim të thellë në rrjedhën e ardhshme të zhvillimit njerëzor. Botës nuk i mungojnë as burimet financiare, as kapacitetet teknologjike për të vepruar. Ajo që mungon është një ndjenjë e interesit kolektiv dhe mbi të gjitha solidaritetit njerëzor.”²

Qëllimi i studimit dhe objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i studimit është analizimi i gjendjes, identifikimi i mangësive e shqyrtimi i mundësive, në politikat dhe legjislacionin e Shqipërisë, lidhur me ndryshimin e klimës, në këndvështrimin e proceseve integruese të vendit tonë në BE. Ky qëllim i përgjithshëm realizohet duke vlerësuar situatën nëpërmjet analizës FDMK (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet), e cila është një teknikë e përshtatshme për të realizuar një panoramë të procesit dhe politikave të ndryshimit të klimës në Shqipëri dhe mbi këtë bazë, për të dhënë një prognozë për të ardhmen.

Ky studim mëton të japë një kontribut në një fushë të re për Shqipërinë dhe relativisht të re në botën e zhvilluar, atë të mjedisit, trajtuar në aspektin e së drejtës ndërkombëtare të mjedisit. Trajtimi i një çështjeje globale mjedisore të ofron mundësinë ta kapësh problemin gjerë, por edhe ta ngushtosh deri në nivel kombëtar, duke shfrytëzuar kështu një përvojë të stërmadhe dhe shumë të vlefshme, por duke e përqendruar fokusin maksimalisht drejt qëllimit të përgjithshëm.

¹ <http://www.unep.org/geo/geo5.asp>

² <http://hdr.undp.org/en/content/human-development-report-20078>

Pavarësisht nga risia dhe veçantia, kjo tematikë mund të gëzojë një audiencë të gjerë duke përmendur ligj-vënësit, politik-bërësit, akademikët, mësimdhënësit dhe studentët e fushës, si dhe shoqërinë civile. Po kështu, pavarësisht faktit se trajtohet një çështje globale mjedisore, synohen të evidentohen mangësi dhe të meta në adresimin zyrtar të të gjithë spektrit relevant të nënçështjeve mjedisore ose jo, por që kontribuojnë në të tërën. Ndaj ky studim pritet të japë rekomandime të vlefshme për mundësi dhe veprime konkrete nga ana e zyrtarëve shqiptarë që u takojnë disiplinave të ndryshme vendimmarrëse.

Duke pasur parasysh *aspektin empirik* të këtij kërkimi, objektivat e tij janë si më poshtë:

1. Analizimi i kontekstit ndërkombëtar dhe rajonal të ndryshimit të klimës; ndikimet e ndryshimit të klimës tek njeriu (parë gjerësisht) dhe në çështjet e sigurisë; përgjigjja ndërkombëtare ndaj ndryshimit të klimës, konventat, forumet, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal;
2. Evidentimi i rolit të BE-së në çështjen e ndryshimit të klimës; legjislacioni, *acquis communautaire*, projektet e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim, kërkesat ndaj vendeve anëtare dhe në proces aderimi, si Shqipëria;
3. Pasqyrimi i plotë i gjendjes së kuadrit ligjor, politik dhe institucional shqiptar për ndryshimin e klimës; angazhimet ndërkombëtare, realizimi i objektivave kombëtare, shkalla e përafrimit me *acquis*-në e BE-së, mundësi për aplikimin e skemave inovative evropiane me ndikim pozitiv për ekonominë, mjedisin dhe gjeopolitikën shqiptare.

Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Kërkimi mbështetet në *hipotezën* se kuadri ligjor dhe institucional në Shqipëri është i paplotë për t'iu përgjigjur një çështjeje globale, sikurse është ndryshimi i klimës dhe sfidave që ajo paraqet, se ka nevojë për përmirësime të ndjeshme me qëllim që t'iu përgjigjet kërkesave të aderimit në Bashkimin Evropian e respektimit të detyrimeve që ka Shqipëria për shkak të anëtarësisë në aktet ndërkombëtare të kësaj fushe, përmirësime që të përfshijnë kapacitet teknike, administrative, monitoruese e raportuese, si dhe informimin, ndërjegjësimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes së publikut.

Në përputhje me qëllimin dhe objektivat e përcaktuar më lart, formulohen pyetjet kërkimore si vijon:

Pyetja kërkimore 1: Ç'po ndodh me ndryshimin e klimës sot në Botë dhe cilat janë ndikimet e tij? Kjo pyetje kontribuon në përmbushjen e objektivit nr. 1. Kjo pyetje, duke pasur rëndësi parashtruese, merr përgjigje qysh në pjesën e parë të temës.

Pyetja kërkimore 2: Cila është përgjigjja institucionale ndaj ndryshimit të klimës në nivel global, rajonal dhe evropian? Një veprim sjell një kundërveprim. Në këtë kuptim ndryshimi i klimës ka marrë një përgjigje institucionale nëpërmjet forumeve ndërkombëtare, përgjigje e cila vlen të shtjellohet në përmbushje të qëllimeve të objektivit nr. 1

Pyetja kërkimore 3: Cilat janë angazhimet e BE-së në fushën e ndryshimit të klimës dhe cilat janë kërkesat për vendet anëtare e në proces anëtarësimi? Kjo pyetje kontribuon në përmbushjen e objektivit 2. Rëndësia e kësaj pyetjeje qëndron në faktin se Shqipëria synon anëtarësimin në BE, kohë në të cilën duhet të ketë ndërtuar një kuadër ligjor dhe institucional të plotë dhe të ketë ndërmarrë objektiva konkrete për t'u realizuar, ndër të tjera edhe në fushën e klimës.

Pyetja kërkimore 4: Cilat janë detyrat që i dalin vendit tonë në përgjigjen ndaj ndryshimit të klimës, bazuar në situatën brenda vendit, angazhimet e saj në rajon, perspektivat e anëtarësimin në BE dhe me qëllim përmirësimin e imazhit dhe pozitës ndërkombëtare? Kjo pyetje kontribuon në përmbushjen e objektivit nr. 3. Të përgjigjurit e kësaj pyetjeje përbën thelbin e vetë kërkimit.

Pyetja kërkimore 5: Cilat janë mangësitë dhe mundësitë e vendit tonë lidhur me adaptimin e instrumenteve evropiane të asistencës tekniko-financiare, me qëllim përmirësimin e situatës mjedisore dhe financiare në vend, në kuadër të respektimit të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmbushjes së angazhimeve për lehtësimin e ndryshimit të klimës? Kjo pyetje gjithashtu kontribuon në përmbushjen e objektivit nr. 3. Rëndësia e trajtimit të kësaj çështjeje qëndron në faktin se BE-ja është kontribuuesi më i madh në botë nëpërmjet programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim, ndaj është e udhës dhe e pritshme që Shqipëria të përfitojë nga kjo asistencë edhe në lëmin e ndryshimit të klimës.

Në vijim, trajtimi i hipotezës dhe pyetjeve kërkimore të këtij punimi, do të bëhet duke u përpjekur për t'i inkuadruar ato maksimalisht brenda kontekstit të së drejtës së mjedisit dhe duke pasur parasysh parimet e normat themelore të së drejtës ndërkombëtare, legjislacionin e

BE-së, veçanërisht direktivat e aktet që lidhen me objektin e këtij punimi, si dhe legjislacionin shqiptar përkatës. Për këtë arsye, më poshtë jepet një informacion i përgjithshëm për të drejtën e mjedisit, historikun dhe evoluimin e saj, duke mos harruar atë pjesë të saj që lidhet drejtpërdrejt me objektin e këtij punimi – të drejtën e klimës.

Fusha e studimit

E drejta e mjedisit, e veçuar prej kohësh nga korpusi qendror in parimeve dhe normave themelore të së drejtës ndërkombëtare, përbën një grup të rëndësishëm të tyre, i cili rregullon marrëdhëniet e shumta e të shumëllojshme të individëve, komuniteteve, shteteve e organizatave ndërkombëtare, ndërmjet tyre ose me njëri-tjetrin, në fushën e menaxhimit e mbrojtjes së mjedisit. Në tërësinë e tyre, këto norma e parime kanë formuar atë që quhet e drejta e mjedisit.

E drejta e mjedisit është një term përmbledhës për traktatet, statutet, rregulloret ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar, të cilat kanë për qëllim të rregullojnë ndërveprimin midis njeriut dhe mjedisit natyror, në mënyrë të tillë që të lehtësohen pasojat e aktivitetit njerëzor në të (Lazarus 2004).

Cilat janë burimet e së drejtës së mjedisit?

Marrëveshjet mjedisore ndërkombëtare janë në përgjithësi traktate (konventa, marrëveshje, protokolle, etj) shumëpalëshe ose dypalëshe. Shumica e këtyre marrëveshjeve kanë të bëjnë me çështje specifike mjedisore. Megjithatë, ka edhe disa traktate të përgjithshme, që me një ose dy klauzola u referohen çështjeve të mjedisit, por këto janë më të rralla. Protokollet janë marrëveshje plotësuese të ndërtuara mbi bazën e një traktati fillestar, që kanë rezultuar veçanërisht të dobishme në fushën e mjedisit dhe që mund të shërbejnë për të azhurnuar rregullisht njohuritë shkencore që qëndrojnë në sfond të marrëveshjeve (Lazarus 2004). Protokollin e njohur më gjerësisht i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit është Protokollin e Kiotos, i cili pasoi Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK).

Lindja dhe zhvillimi i të drejtës së mjedisit

Rregullat e para juridike për çështjet e mjedisit janë shumë të vjetra; ato janë pjesë e rregullave juridike të shoqërisë romake dhe janë zbatuar më vonë edhe në Mesjetë në Evropë. Megjithatë, arrihen të identifikohen struktura të hershme juridike, që sot mund të bien në metrikën e ligjit mjedisor, koncepti i të drejtës së mjedisit, si një organ i veçantë dhe i dallueshëm i së drejtës, i takon shekullit të 20^{të}. Njohja e faktit se mjedisi natyror është i brishtë dhe ka nevojë për mbrojtje të veçantë ligjore, përkthimi i kësaj njohjeje në struktura ligjore, si dhe zhvillimi i këtyre strukturave në një organ më të madh, atë të së drejtës mjedisore, ka ndodhur në vitet '60 (Lazarus 2004). Në këtë kohë, rritja e interesit publik për ndikimin e aktivitetit industrial tek burimet natyrore e shëndeti i njeriut, sikurse dhe shfaqja e ambientalizmit si lëvizje politike e suksesi i saj, çuan në formësimin e një organi të madh të së drejtës, për një periudhë relativisht të shkurtër kohore (*Ibid.*). Qysh nga fundi i shekullit të 20^{të}, e drejta mjedisore është konsoliduar si element i tablosë juridike në të gjitha vendet e zhvilluara të botës, në shumë nga ato në zhvillim, si dhe në atë më të madhen – tablonë e së drejtës ndërkombëtare.

Në vitet '60, çështjet e mjedisit filluan të dilnin në pah në disa vende. Si kundërpërgjigje, edhe numri i marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe filloi të rritej. Kështu, u negociuan konventat lidhur me ndërhyrjen dhe përgjegjësinë civile për rastet e ndotjes nga nafta, për kontrollin e ndotjes nga nafta të Detit të Veriut, si dhe Konventa Afrikane për ruajtjen e natyrës dhe burimeve natyrore.

E drejta ndërkombëtare mjedisore moderne, sipas D'Amato dhe Engel (1997), daton rreth vitit 1972, vit kur u mbledh Konferenca e Stokholmit e Kombeve të Bashkuara për mjedisin njerëzor dhe kur u themelua Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisit (UNEP). Gjatë kësaj kohe, pati disa zhvillime juridike të rëndësishme, si negociimi i Konventës mbi tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara, Konventës së Londrës për dampingun e oqeanëve, Konventës për trashëgiminë botërore dhe Konventës së parë të UNEP-it për detet rajonale.

Që nga viti 1970, janë përgatitur qindra instrumente ndërkombëtare mjedisore, dypalësh dhe shumëpalësh (detyrues dhe jodetyrues). Shtrirja e marrëveshjeve ndërkombëtare është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme, nga marrëveshjet për ndotjen ndërkufitare, tek

marrëveshjet globale për ndotjen; nga mbrojtja e specieve të caktuara, tek mbrojtja e ekosistemeve; nga marrëveshjet që zbatohen vetëm në kufijtë kombëtarë, në ato që frenojnë përdorimin e burimeve dhe kontrollojnë aktivitetet brenda kufijve kombëtarë, të tilla si lidhur me trashëgiminë botërore dhe zonat biologjikisht të ndryshme (*Ibid.*). Detyrimi i palëve në këto marrëveshje është bërë gjithashtu më i qartë, duke kaluar nga kryerja e kërkimeve dhe monitorimi për parandalimin e pakësimit të ndotjes, në përcaktimin e niveleve të caktuara të ndotësve.

Qysh atëherë, instrumentet juridikë ndërkombëtare që merren me mjedisin, kanë ardhur duke u shtuar dhe janë përqendruar në zhvillimin e mënyrave të reja për negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me to, në mënyrë të veçantë me dispozitat e tyre financiare, administrative e monitoruese. E drejta ndërkombëtare e mjedisit, që prej viteve '90 po i jep ritmin bashkëpunimit ndërkombëtar të komunitetit për zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare (D'Amato dhe Engel 1997).

Tipar dallues i marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe të negociuara në fund të viteve 1980 dhe 1990, është se ndryshe nga të mëparshmet, ato përmbajnë një gamë të gjerë normash trajtimi të diferencuar në dobi të vendeve në zhvillim. Këto norma ua përshtatin angazhimet kapaciteteve dhe sigurojnë mbështetje financiare, teknologjike e teknike, duke i bërë këto marrëveshje me interes për vendet në zhvillim (French dhe Rajamani 2013). Arkitektura e diferencimit, e materializuar në këto marrëveshje, ka shpënë në realizimin e marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe me të vërtetë universale, të tilla si Konventa e Vjenës dhe Protokollit i Montrealit për pakësimin e ozonit, si dhe Konventat e Rios mbi ndryshimin e klimës, diversitetin biologjik dhe shkretëtirëzimin. Por, edhe midis këtyre marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe të gjeneratës së re, është regjimi i ndryshimit të klimës që dallon për natyrën dhe masën e trajtimit të diferencuar që ai përmban në favor të vendeve në zhvillim. Kjo ndodh në mënyrë të veçantë me detyrimet qendrore, sikurse është fakti se disa shtete kanë objektiva të pakësimit të gazeve serrë, ndërsa të tjerë jo.

E drejta për klimën në të drejtën e mjedisit

Masa e trajtimit të diferencuar në regjimin e ndryshimit të klimës, ka qenë objekt diskutimi përgjatë viteve. Si rezultat, që prej vitit 2007, negociatat për ndryshimet klimatike, në kuadër

të Protokollit të Kiotos, edhe pse në përgjithësi kanë përparuar ngadalë, kanë shënuar ndryshime të rëndësishme në lidhje me trajtimin e diferencuar (French dhe Rajamani 2013). Një analizë e kujdeshme e vendimeve të Konferencës së Palëve (COP) në kuadër të KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos, të tilla si Plani i Veprimit Bali (2007), e deri tek Platforma Durban (2011), nxjerr në pah një ndryshim të dukshëm, nga trajtimi i diferencuar në dobi të vendeve në zhvillim, në drejtim të simetrisë së kërkesave ligjore të vendosura mbi vendet. Tendenca është që detyrimet lehtësuese në kuadër të ndryshimit të klimës, të përcaktohen dhe zgjidhen në shkallë kombëtare, me fleksibilitet edhe më të madh se më parë, sa i takon mjeteve për të përmbushur këto detyrime. Kjo do të thotë respektim më i madh i rrethanave kombëtare, pra një rol më i kufizuar i së drejtës ndërkombëtare dhe një shtrirje më e madhe e pushtetit sovran (Ibid.), ndryshime që mund të ushtrojnë ndikim edhe mbi zhvillimet në fusha të tjera të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.

Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për analizimin e problemeve mjedisore globale në terma afatgjatë, vendimet e politikës së jashtme, të cilat herët janë motivuar nisur nga interesat kombëtarë, marrin një tjetër dimension. Në këto raste, qëllimi është një dhe i përbashkët: mirëmbajtja e sistemeve mjedisore në botë. Lidhur me këtë, vendet kanë filluar ta njohin nevojën për të koordinuar interesat e tyre afatgjata, ç'ka duket në përparimet e shpejta të bashkëpunimit ndërkombëtar, të shprehura në të drejtën ndërkombëtare të mjedisit.

Në disa instrumente juridikë ndërkombëtare, shtetet janë marrë vesh që të kufizojnë 'soveranitetin operacional' dhe të vazhdojnë të mbajnë 'soveranitetin formal kombëtar', si p.sh. në konventat për pakësimin e ozonit dhe dërgesat ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme. Ndërkohë, në instrumente të tjerë, shtetet e kanë forcuar sovranitetin e tyre operativ, duke u fokusuar në planet e veprimet kombëtare dhe përhapjen e këtyre dokumenteve tek palët e tjera të marrëveshjeve (D'Amato dhe Engel 1997). KKKBNK dhe Konventa mbi Diversitetin Biologjik e ilustrojnë këtë fakt.

Në të drejtën ndërkombëtare, ekziston një tezë, se e drejta mjedisore është bërë e gjitha 'e drejtë për klimën' dhe se kjo e fundit ka tentuar të frenojë çështjet e tjera të shumta të së drejtës mjedisore. Sipas kësaj teze, diskutimi për ndryshimin e klimës, ka tentuar të dominojë agjendat mjedisore globale dhe kombëtare, duke u justifikuar me pak veprim konkret (Hilson 2013).

Një përgjigje ndaj kësaj teze është se veprimi për ndryshimin e klimës prodhon në mënyrë të pashmangshme përfitime të shumta për çështjet e tjera mjedisore. Profili i lartë politik i çështjes së ndryshimit të klimës, veçse mund të ndihmojë dhe jo të pengojë progresin e një game të gjerë çështjesh mjedisore, sikurse është p.sh. ndotja e ajrit. Pra, sipas Hilson (2013), mund të argumentohet se në vend që të thuhet se e drejta e mjedisit po bën gjithçka për të drejtën e klimës, politika e klimës është në fakt shumë e rëndësishme për të drejtën e mjedisit.

Të gjitha tezat për klimën, përfshirë edhe ato përjashtuese, kanë argumentuar mbi bazën e standardeve dhe normave për marrëdhënien midis të drejtës dhe politikës së klimës nga njëra anë, dhe të drejtës së mjedisit, nga ana tjetër. Në këtë kërkim shihet se e drejta e mjedisit dhe e drejta e klimës ngjajnë me njëra-tjetrën në terma politik, ç'ka lidhet me natyrën e problemit të paraqitur, por edhe me metodat rregullatore e qeverisëse të miratuara për ta zgjidhur atë problem.

E drejta e klimës së BE-së, krahasuar me të drejtën mjedisore të mëparshme të saj, mbështetet më shumë në teknikat e 'qeverisjes së re', të tilla si instrumentet ekonomike. 'Qeverisja e re' në BE, ka sjellë një ndryshim në qasje, nga stili i vjetër i 'metodës komunitare', e cila mbështetej në direktiva dhe rregullore të detyrueshme, drejt përdorimit më të madh të metodave të tjera, të ligjit 'të butë', që gjenden kryesisht në të drejtën shoqërore të BE-së. Si formë qeverisjeje të re mund të konsiderohet p.sh. mekanizmi EU-ETS, i cili si zgjidhje instrumentale novatore, i largohet stilit të vjetër të së drejtës mjedisore evropiane, që gjithmonë mbështetej në instrumentet rregullatore 'komandë-dhe-kontroll'.

Tendencat e zhvillimit të së drejtës së mjedisit

Parimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit (parimet mjedisore) luajnë një rol të rëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare të mjedisit, rol që pritet të vijojë. Forma e sanksionimit të tyre në marrëveshjet ndërkombëtare është e larmishme. Sidoqoftë, për vetë natyrën e kësaj dege të së drejtës, parimet mjedisore gjejnë shprehjen e tyre më të madhe në pjesën e së drejtës së butë – "soft law" (Muharremaj 2014). Në tërësi, procesi i formulimit të instrumenteve juridike jodetyruese, ose të drejtës së butë, pritet të ecë më shpejt se negociimi i konventave formale ndërkombëtare mjedisore. Përvoja e dy dekadave të fundit ka treguar se kur instrumenti është jodetyrues, marrëveshja është më e lehtë për t'u arritur.

Roli i rëndësishëm i parimeve mjedisore në të drejtën bashkëkohore, duket edhe në faktin se ato kanë marrë formën e parimeve ligjore, duke u bërë pjesë e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare (si GJED).

Në kuadër të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, vëmendja ka të ngjarë të përqendrohet tek shqetësimet mjedisore në fund të ciklit të prodhimit industrial, me qëllim parandalimin e ndotjes, minimizimin e degradimit mjedisor dhe përdorimin e burimeve në mënyrë më eficiente (Hilson 2013). Nëse do të ndodhë kështu, e drejta ndërkombëtare e mjedisit do ta pasqyrojë këtë prirje, duke u mbështetur në standardet dhe procedurat për parandalimin e ndotjes dhe minimizimin e degradimit të mjedisit.

Edhe gjatë kësaj dekade, pritet të vijojë unifikimi i mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik (*Ibid.*). Një mënyrë bashkëveprimi është nëpërmjet fushës së tregtisë, pasi ekzistojnë praktika tregtare që ndikojnë në ruajtjen e mjedisit, sikurse ekzistojnë praktika për mbrojtjen e mjedisit që ndikojnë në tregti. Për këtë arsye, nevojitet një këndvështrim që u jep të dyjave çështjeve legjitimitet të ngjashëm, duke i trajtuar si elementë të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjithashtu, pritet të ketë një rritje të rëndësishme të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe të së drejtës së publikut për qasje në informacionin përkatës. Sistemi institucional ndërkombëtar, me të cilin lidhen instrumentet juridike mjedisore, pritet të vijojë të bëhet më divers, duke përfshirë një numër gjithnjë e më të madh organizatash jo-qeveritare. Nga ana e tyre, ato pritet të zgjerojnë ndikimin e tyre në proceset e negociatave, zbatimit dhe pajtueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të mjedisit (*Ibid.*).

Ndërsa vendet e ndryshme ndajnë një bashkësi interesash për ruajtjen e integritetit të planetit tonë, ekzistojnë dallime të mëdha në pozicionet e tyre sa i takon ndarjes së barabartë të pengesave dhe përfitimeve në rrugën e arritjes së këtij misioni. Nisur edhe nga ky fakt, shtetet mund të mos bien dakord nëse prioriteti është kënaqja e nevojave të menjëhershme për të zbutur varfërinë dhe degradimin lokal mjedisor, apo e atyre më afatgjata për të mbrojtur integritetin e biosferës. Ndaj, ekziston rreziku i shfaqjes e intensifikimit të këtyre mosmarrëveshjeve ndër grupe komunitetesh vendore ose me gjerë, ndërkohë që vendet

përpiqen të arrijnë një konsensus për atë që konsiderohet e drejtë, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Rëndësia e studimit

Rëndësia e studimit lidhet ngushtë me qëllimin e studimit, objektivat, pyetjet kërkimore dhe grupet shënjestër të tij.

E drejta e mjedisit është një fushë që mund të konsiderohet pak e lëvruar në vendin tonë, ndërkohë që Evropa e qytetëruar ku ne synojmë të bëjmë pjesë, e ka në qendër të vëmendjes. Studimet në këtë fushë janë një vlerë e shtuar për lëvizjen mjedisore. Ato janë një apel më shumë për t'i dhënë çështjes së mjedisit vendin që meriton.

Studimi mendohet të dalë me përfundime dhe rekomandime që u vlejnë administratorëve të mjedisit dhe politik-bërësve në vend. Por, ky studim synon ta tejkalojë pragmatizmin që nxitet nga kërkesat politike të kohës. Ai i drejtohet një audience të gjerë, që përfshin edhe profesionistët e fushës dhe mjedisorët/ juristët e rinj.

Vlera e shtuar e kërkimit

Bazuar në të dhënat e literaturës së mbledhur e të shfrytëzuar për këtë kërkim dhe të përmbledhur në pjesën e parë të temës, ky kërkim pritet të sjellë vlerë të shtuar në këto aspekte:

- Fusha kërkimore paraqet një risi në fondin e studimeve në Shqipëri;
- Ndonëse këndvështrimi i problemit është juridiko-ndërkombëtar, një ndërthurje disiplinash dhe konceptesh nga shkencat politike dhe mjedisore, e rrisin shkallën e interesit dhe erudicionit në këtë kërkim;
- Analiza e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e ndryshimit të klimës në Shqipëri bëhet e thellë, duke kryqëzuar të dhënat dhe informacionet për të rritur shkallën e objektivitetit, por dhe e gjerë, në mënyrë që t'u hapet panorama ligjvënësve dhe politikë-bërësve;
- Kërkimi nuk mbetet në nivelin e konstatimit, por synon të japë kontribut konkret nëpërmjet rasteve studimore në fushën e përafrimit të legjislacionit dhe përmirësimit të kuadrit

ligjor dhe institucional në fushën e ndryshimit të klimës, gjithnjë duke pasur si objektiv përvojën e përparuar evropiane.

Shtrimi i problemit

Ndryshimi i klimës (ose ngrohja globale) është një ndër çështjet më të rëndësishme mjedisore sot në botë. Kjo dukuri është shkaktuar gradualisht në 250 vjetët e fundit si pasojë e revolucionit industrial. Faktorët që e shkaktojnë dhe pasojat e saj, janë një mori problemesh mjedisore më vete që trajtohen si të tilla si në aspektin teorik, ashtu dhe ligjor dhe janë pjesë e disiplinës së mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Por këndvështrimi në këtë kërkim është ligjor dhe politik publik, si kundrejt ndryshimit të klimës, ashtu dhe shkaqeve dhe pasojave të këtij ndryshimi.

Ngrohja globale shkaktohet më së shumti nga vendet e zhvilluara (industrializuara), por dëmet e saj i vuajnë të gjithë, por më së shumti vendet e varfra ose në zhvillim. Aty ku ekosistemet janë më të brishtë dhe kushtet klimatike më të pamëshueshme, edhe ndikimet e ndryshimit të klimës amplifikohen më shumë. Marrja e masave për lehtësimin dhe menaxhimin e pasojave të katastrofave të mundshme mjedisore me dëme të pallogaritshme materiale dhe njerëzore është një imperativë. Shqipëria, për vetë pozitën gjeografike (Mesdhe, Evropë), pritet të japë kontributin e saj në këtë çështje. Nga ana tjetër, pozita politike e vendit, synimi për t'u bërë vend anëtar me të drejta të plota në BE, i bën veprimet për klimën, pjesë të angazhimeve politike të vendit. Dhe ky nuk është thjesht një angazhim formal; një organizëm si BE nuk mund të funksionojë normalisht, nëse pjesë të tij kanë mangësi. Anëtarësimi i Shqipërisë në BE është vetëm fillimi i sfidës, ecja me hapin e shumicës është sfida e vërtetë.

Një kuadër i tërë ligjor, institucional dhe politik duhet përshtatur për krijuar kornizën e duhur për veprime konkrete për klimën. Pjesë e punës është kryer në këto vitet e fundit, por sikurse raporti i fundit i BE-së kumton, “në çështjen e ngrohjes së klimës, Shqipëria nuk ka bërë progres në tërësi dhe kapacitetet institucionale mbeten shumë të dobëta”.

Analizimi i situatës brenda vendit, krahasimi me përvojën komunitare dhe më gjerë, do të sjellin në formulimin e përfundimeve që mund të kenë aplikueshmëri për politik-bërësit dhe administratorët publikë.

Pohime paraprake

Kërkimi bazohet në disa pohime paraprake të cilat priten të justifikohen gjatë shtjellimit dhe analizimit të çështjeve konkrete:

Pohimi 1: Ndryshimi i klimës është një çështje globale me rëndësi dhe kërcënim për sigurinë e njeriut.

Pohimi 2: Shqipëria, për shkak të pozitës gjeografike është vend që ndikohet ndjeshëm nga ndryshimi i klimës dhe ka nevojë të marrë masa për lehtësimin dhe mbrojtjen kundrejt tij.

Pohimi 3: Një kuadër i përmirësuar ligjor e institucional dhe politika të përshtatshme për të parandaluar ndryshimin e klimës, për të lehtësuar pasojat dhe për t'u mbrojtur nga ndikimet e saj, përbëjnë një premisë pozitive për zhvillimin e qëndrueshëm në vend dhe për pozitën politike ndërkombëtare e rajonale të Shqipërisë.

Metodat dhe metodologjia e kërkimit dhe kufizimet e saj

Për metodat dhe metodologjinë e kërkimit, si dhe kufizimet e saj flitet hollësisht në një pjesë të dedikuar për këtë qëllim, që gjendet në fund të pjesës së parë.

Burimet e referimit

Ky studim mbështetet në burime literature parësore, dytësore, vendase dhe të huaja, me profil shkencor (libra, artikuj shkencorë), politik/ institucional (plane, programe, strategji, raporte), ligjor (konventat ndërkombëtare, direktivat dhe rregulloret evropiane, aktet ligjore e nënligjore shqiptare në fushën e mjedisit), sociologjik, statistikor (OECD, UN, REC, institucionet zyrtare shqiptare, etj.). Janë shfrytëzuar edhe burime nga interneti, kryesisht të marra nga faqet zyrtare të organizmave ndërkombëtare, të cilat për lehtësi paraqitjeje do të referohen në fund të faqes, përveçse do të inventarizohen edhe tek burimet e referimit. Stili i citimit dhe referencave do të jetë Harvard.

PJESA I

ZHVILLIMET POLITIKE DHE JURIDIKE GLOBALE NË KUADËR TË NDRYSHIMIT TË KLIMËS – PËRMBLEDHJE LITERATURE

Ngrohja globale ose ndryshimi i klimës

Aktivitetet njerëzore nëpër botë kanë ndryshuar klimën e Tokës, ndryshim që ka sjellë ndikime të rëndësishme në ekosistemet dhe shoqërinë njerëzore. Në veçanti përdorimi i burimeve fosile, pylltaria dhe bujqësia, po shkaktojnë sasi në rritje të gazeve serrë dhe gaze të tjerë që po ndryshojnë shumë mbulesën bimore të Tokës. ‘Gazet me efekt serrë’ ose ‘gazet serrë’ quhen kështu pasi e mbajnë nxehtësinë e diellit brenda Atmosferës, në të njëjtën mënyrë që bën dhe serra brenda saj (Commission Europeene 2010). Ndër gazet serrë më të rëndësishmi është dioksidi i karbonit (CO₂), rritja e përqendrimit të të cilit në atmosferë mendohet se ka qenë ndikimi më i madh njerëzor dhe natyror i 250 vjetëve të fundit (UN-Sigma XI Expert Group, 2007). Ky ndikim është shkaktuar nga djegia e karburanteve fosile (qymyr, naftë e gaz) dhe shpyllëzimet. Sipas IEA (International Energy Agency), emetimet e CO₂ janë duke u rritur me rreth 1,5 për qind në vit. Për pasojë parashikohet që emetimet të rriten nga 28.8 Gt në vitin 2007, në 40.2 Gt në vitin 2030 (IEA 2010).

Qysh nga fillimi i Revolucionit Industrial rreth dy shekuj më parë, përqendrimi i gazeve serrë, gazeve të tjerë dhe aerosolëve³ ka ardhur në rritje. Këta gaze kanë qenë faktori kryesor i rritjes së temperaturës sipërfaqësore të Tokës dhe i ndryshimeve të tjera. Sipas Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC)⁴, i cili sjell së bashku me qindra ekspertë shkencorë të ndryshimit të klimës nga e gjithë bota, temperatura mesatare globale është rritur pothuajse 0,8°C që në gjysmën e dytë të shekullit të 19^{të}, me rritjen më të madhe të ndodhur në shekullin e 20^{të} dhe në veçanti pas vitit 1970. IPCC është më shumë se 90% e sigurt se aktivitetet njerëzore që nga viti 1750 kanë pasur një efekt neto të ngrohjes së atmosferës. Midis viteve 1980 dhe 2007 temperatura globale mesatare vjetore u rrit me një ritëm mesatar prej 0.054°C

³ Aerosol - sistem koloidal i grimcave të ngurta apo të lëngshme në ajër.

⁴ Marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/clima/>, shkarkuar në korrik 2012.

në vit. Dekada e parë e shekullit të 21^{të} ishte më e ngrohta që nga koha kur të dhënat mund të konsiderohen të besueshme (viti 1880).




Figura 1: Skemë - si shkaktohet ngrohja globale nga gazet serrë
Burimi: Department of Ecology of State of Washington, nxjerrë nga Interneti në shkurt 2012,
Në <http://www.ecy.wa.gov/climatechange/whatis.htm>

Nga ana tjetër, oqeanet po absorbojnë rreth një të tretën e emetimeve të CO₂ nga aktivitetet njerëzore, duke ndryshuar kiminë e oqeanëve dhe duke rritur nivelin e deteve. Akullnajat po shkrihen gradualisht, si përgjigje e rritjes së temperaturave duke kontribuar në rritjen e nivelit të detrave. Projektionet për rritjen mesatare të nivelit të detit, sipas IPCC-së, gjatë shekullit të 21^{të} janë me 18-59 cm. Referuar studimeve të kryera, midis 2003-2008, është vërejtur një rritje mesatare e nivelit të detit nga 1.6 mm/vit midis 1961 dhe 2003, në 2.5 mm/vit (IPCC 2007d). Në varësi të nivelit të arritur të stabilizimit të emetimeve të gazeve serrë dhe rritjes së temperaturës mesatare globale mes 2°C dhe 4°C, sipas IPCC, niveli global i detit nga epoka para-industriale deri në atë të ekspansionit termik mund të rritet ndërmjet 0.4 dhe 2.4 metra. Po kështu, edhe pyjet e toka po reagojnë ndaj rritjes së përqendrimeve të CO₂ dhe temperaturave. Këto ndryshime nuk janë uniforme dhe variojnë në varësi të rajoneve dhe stinës.

Nëse do vazhdohet me një shtim të këtyre substancave në atmosferë dhe oqeanë, sikurse dhe me ndryshimet në mënyrat e shfrytëzimit të tokës, do të shkaktohen ndikime të paqarta por potencialisht të rrezikshme dhe të kushtueshme mbi klimën dhe oqeanet nëpër Botë. Skenarët

afatgjatë të ngrohjes globale marrin në konsideratë një sërë faktorësh si p.sh. rritjen e popullsisë, zhvillimin teknologjik dhe zhvillimin ekonomik. Si të tillë, këta skenarë kanë një masë të madhe pasigurie, pasiguri që rritet sa më larg projektohet. Në këtë pasiguri duket se ndikojnë sa paqartësia për nivelin e emetimeve në të ardhmen, aq dhe përgjigjja që sistemi i klimës jep ndaj ndryshimeve.

Pavarësisht nga kjo, analiza nga grupe që kanë marrë në konsideratë si paqartësitë ekonomike, ashtu edhe ato shkencore, kanë arritur në konkluzionin se nëse nuk ndërmerret asnjë masë për të pakësuar shtimin e emetimeve, rritja mesatare e temperaturës mesatare globale gjatë shekullit të 21^{të} do të jetë rreth 5°C. Për të krijuar një ide më të qartë për këtë nivel rritjeje, kalimi nga thellësitë e epokës së fundit të akullnajave (rreth 21,000 vjet më parë), në klimën e sotme ka sjellë një rritje temperature nga 3.9°C deri më 7.2°C.

Për të parandaluar pasojat më të rënda të ndryshimit të klimës, prova shkencore tregon se bota ka nevojë për të kufizuar ngrohjen globale në jo më shumë se 2°C mbi temperaturën e para-industriale. Për të qëndruar brenda këtij tavani, duhet të ndalet tendenca në rritje e shkarkimeve të gazeve serrë para vitit 2020, të paktën të përgjysmohen emetimet globale nga mesi i këtij shekulli dhe pas kësaj të vazhdojë ndërprerja e tyre⁵.

Sidoqoftë, edhe një pakësim drastik i emisioneve sot nuk do të ndalte domosdoshmërisht ndryshimet e shkaktuara tashmë në klimë. Kështu edhe nëse përqendrimet do të stabilizoheshin duke filluar nga 2009, temperatura mesatare globale do të vijonte të ngrihej gradualisht nga 0.5-2°C deri në fund të shekullit. Ndërsa nëse emetimet e CO₂ do të vijonin me këtë ritëm, temperatura globale mesatare e sipërfaqes do të rritej me 0.2-0.4°C për dekadë gjatë shekullit të 21^{të}. Në këto kushte, viti 2100 do ta gjente Tokën me një temperaturë 3-5°C më të lartë sesa përpara industrializimit (UN-Sigma XI Expert Group 2007).

Ndërsa, sipas IPCC (2007d), lidhur me tendencat e ardhshme, në fund të shekullit të 21^{të}, rritja mesatare vjetore e temperaturave ka të ngjarë të jetë midis 2.2°C dhe 5.1°C për 2080-2099, krahasuar me 1980-1999. Mundësia e rritjes së temperaturave nga 3 deri me 4°C është vlerësuar me 50 për qind. Rritja e temperaturës sipërfaqësore pritet të ndryshojë nga një rajon të tjetrin (në rajonet Sub-Sahariane ajo mund edhe të jetë edhe 4°C në verë; nga ana tjetër, në brigjet veriore, rritja ka gjasa të jetë më e dukshme në dimër, me rreth 3°C).

⁵ Marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/clima/>, shkarkuar në korrik 2012.

Ndikimet e ndryshimit të klimës

Ndryshimi i klimës në kontekstin njerëzor është një çështje tepër e rëndësishme dhe një sfidë e shekullit të 21^{te}, në kuptimin se ajo mund të shkaktojë ndikim jo vetëm në mjedis, por edhe në ekonomi dhe shoqëri, direkt, apo indirekt nëpërmjet mjedisit.

Sikurse thamë më lart, nëse nuk ndërmerren veprime për të pakësuar emetimet e gazeve serrë, rritja mesatare e temperaturave gjatë shekullit të 21^{te} do të jetë rreth 5°C. Ndërsa, nëse do vazhdohet me një shtim të këtyre substancave në atmosferë dhe oqeanë, sikurse dhe me ndryshimet në mënyrat e shfrytëzimit të tokës, do të shkaktohen ndikime të paqarta por potencialisht të rrezikshme dhe të kushtueshme mbi klimën dhe oqeanet nëpër botë. Ka një konsensus të gjerë mes klimatologjistëve se një rritje globale e temperaturave në 2°C është pothuajse e sigurt, deri 4°C është e mundur dhe deri në 6°C nuk mund të përjashtohet, nëse biznesi vazhdon me tendencat e zakonshme.

Ndryshimet në dukje modeste të temperaturave gjatë shekullit të 20^{te}, janë shoqëruar me incidencë të rritur të përmytjeve dhe thatësirave, posaçërisht pas vitit 1970. Po kështu, gjatë shekullit të 21^{te} ndryshimi i klimës pritet të sjellë rritje të frekuencave dhe intensitetit të motit ekstrem, rritje të nivelit të detrave dhe aciditetit të oqeanëve, zhvendosje të bimësisë dhe humbje të specieve të ndjeshme (UN-Sigma XI Expert Group, 2007).

Sipas raportit përmbledhës së IPCC (2007a):

“Ndryshimi i klimës pritet të rrisë ndryshimet rajonale në burimet dhe pasuritë natyrore të Evropës. Ndikimet negative do të përfshijnë rritjen e rrezikut të përmytjeve të papritura të tokave, përmytjet më të shpeshta bregdetare dhe erozioni në rritje (për shkak të situatave të stuhisë dhe nivelit të rritur të detit). [...] Deri më 2080, disa milionë më shumë njerëz se sot, janë projektuar të përjetojnë përmytje çdo vit për shkak të rritjes së nivelit të detit. Njerëzit e prekur do të jenë më të shumtë aty ku popullsia janë më të dendura ...”.

Ndryshimi i klimës do të sillte ndryshime në modelet rajonale dhe sezonalë të temperaturave, rënien e reshjeve dhe ndryshime në frekuencën e episodeve të tilla si shtrëngatat, thatësirat, përmytjet, ngricat, etj. Disa efekte të ndryshimit të klimës, si shkrirja e akujve, rritja e nivelit të detrave dhe rritja e aciditetit të oqeanëve, priten të shpalosen më gradualisht. Në disa raste, ndërveprimet midis efekteve mund t'i amplifikojnë ato në mënyra të papritura. Një tjetër faktor ndërlikues është se efektet e ndryshimit të klimës do të shoqërojnë zhvillimet

ekonomike, demografike dhe mjedisore, që do të ndikojnë nga ana e tyre shumë veprimtari që ndikohen nga ndryshimi i klimës dhe që në shumë raste do të ndërveprojnë me efektet e ndryshimit të klimës në mënyra që janë veçanërisht të vështira për t'u parashikuar.

Ndryshimet e klimës mendohet të sjellin temperatura më të larta veçanërisht në brendësi të kontinenteve. Ngrohja do të sjellë spostime të stinëve nëpër botë, me gjasa për dimra më të shkurtër dhe më të butë, me më pak ditë të ftohta, me më pak ditë me ngrica dhe me gjasa për verëra më të gjata dhe më të ngrohta, me më shumë ditë të nxehta dhe më tepër valë të nxehti. Një botë më e nxehtë është më e pritshme të jetë dhe një botë më e lagësht. Ndryshime rajonale janë gjithashtu të mundshme, në të cilat një rajon më i lagësht aktualisht mund të bëhet më i thatë dhe anasjelltas. Ky model parashikon që në një botë më të ngrohtë dhe më të lagësht, shumë rajone do të përjetojnë rreziqe më të mëdha nga thatësitat dhe përmbytjet.

Kërkuesit gjithashtu parashikojnë se ngrohja globale në shekullin e 21^{të} mund të sjellë një rritje të masës dhe intensitetit të cikloneve tropikalë, duke rritur nga ana e tyre temperaturën sipërfaqësore dhe të ujërave ku formohen këto stuhi. Këta ciklone tropikalë shkaktojnë dëme ekonomike që vlerësohen në miliarda dollarë në vit.

Ngrohja do të rrisë gradualisht nivelin e detrave për shumë shekuj edhe pasi përqendrimet e gazeve serrë janë stabilizuar. Vetëm ngrohja e oqeanëve pritet të rrisë nivelin e deteve me 5.6 cm deri më 8.3 cm për gradë C (Shackleton 2009). Rritja e nivelit të deteve do të shkaktojë valëzim progresiv dhe erozion të vijës bregdetare.



Figura 2: Ndikimet e ngrohjes globale

Burimi: NASA, marrë nga Interneti në korrik 2012, në <http://climate.nasa.gov/effects/>

Sikurse përmendëm, oqeanet absorbojnë një pjesë të CO₂ nga aktivitetet njerëzore, duke i bërë oqeanet më acidë gjatë shekullit të 21^{të}, çka paraqet një rrezik serioz për ekosistemet e tyre. Ndryshimi i klimës do të sjellë spostime edhe në llojin e bimëve dhe kafshëve që popullojnë zona të caktuara. Këto spostime mjedisore kanë gjasa të ndikojnë ekosistemet e pamenaxhueshme, bujqësinë, peshkimin dhe pylltarinë. Përqendrimi i gazeve serrë, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe në klimë kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme ekosistemet në botë. Spostimet në zonat klimatike kanë gjasa që të ndikojnë më tej ekosistemet. Ekosistemet e pamenaxhuara, në veçanti ato në rajonet me biodiversitet të pasur, janë veçanërisht të rrezikuara. Pra ngrohja globale konsiderohet si një ndër faktorët që shkaktojnë rrezikun e zhdukjes së specieve në Tokë. Edhe faktorët e tjerë të njohur, në shumë raste ndërveprojnë madje me efekt akumulativ duke rrezikuar biodiversitetin.

Edhe bujqësia pritet të ndikohet negativisht nga ngrohja globale, veçanërisht nga ndryshimi i rënies së shirave, si në aspektin e thatësirave, ashtu dhe të përmytjeve. Ndryshimet në temperatura do të sjellin një ndryshim të shpërndarjes së llojeve të pyjeve, të cilat nga ana e tyre mund të ushtrojnë ndikimin e tyre në klimat rajonale dhe faunën. Peshkimi do të ndikohet në mënyrë të ngjashme; speciet e ndryshme në një rajon të caktuar do të pësojnë një zhvendosje gjeografike. Më të dëmtuara priten të jenë speciet e ujërave të ftohta si salmoni.

Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë edhe industri të ndryshme, ose infrastruktura si ato të furnizimit më ujë. Kjo e fundit është më tepër e lidhur me ndryshimin e modeleve të reshjeve,

sikurse është sasia më e paktë e borës. Për më tepër, ndryshimet në reshje dhe temperatura çojnë në ndryshime të disponueshmërisë së ujit që është projektuar, sipas Brauch (2006), të ulet nga 10 në 30 për qind në disa rajone të thatë në gjerësitë e mesme gjeografike dhe tropikët, për shkak të pakësimit të reshjeve dhe normave më të larta të evapo-transpirimit. Ekziston gjithashtu një besim i madh se shumë zona gjysmë të thata (p.sh., pellgu i Mesdheut, perëndimi i Shteteve të Bashkuara, Afrika Jugore dhe Brazili Veri-Lindor) do të pësojnë një pakësim të burimeve ujore për shkak të ndryshimit të klimës. Zonat e prekura nga thatësira janë parashikuar të rriten në shtrirje, me potencialin për ndikime negative ndaj sektorëve të ndryshëm, si p.sh., bujqësia, furnizimi me ujë, prodhimi i energjisë dhe të shëndeti. Nga pikëpamja rajonale, është projektuar një rritje e madhe e kërkesës për ujitje si rezultat i ndryshimeve të klimës.

Ndryshimi i klimës është global, afatgjatë dhe në përshpejtim. Ai do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në sistemet shoqërore, ekonomike dhe mjedisore, si dhe në ndërveprimet e tyre, dhe në këtë mënyrë në sigurinë njerëzore duke përfshirë ushqimin, ujin dhe shëndetin. KKKBNK e sheh ndryshimin e klimës “si një problem kompleks që ndonëse mjedisor nga natyra, ka pasoja në të gjithë sferat e ekzistencës në planetin tonë. ... duke përfshirë varfërinë, zhvillimin ekonomik, rritjen e popullsisë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve.”

Një ndër shqetësimet kryesore të ngrohjes globale është ndikimi në shëndetin e njeriut. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ndryshimi i klimës është një ndër rreziqet globale dhe me shkallë të gjerë për shëndetin e njeriut. Risku i sëmundshmërisë pritet të rritet me ndryshimet klimatike, po kështu dhe vdekshmëria për disa aspekte të shëndetit të njeriut, të lidhura me ndjeshmërinë ndaj klimës.

Ndërsa ngrohja globale zhvillohet, efektet e saj fillestare do të intensifikohen dhe të reja do të bëhen të dukshme. Shumë sëmundje të përhapura të njeriut janë të lidhura me luhatjet klimatike, që nga stresi i ngrohjes, vdekshmëria kardiovaskulare dhe sëmundjet e frymëmarrjes për shkak të valëve të të nxehtit, deri tek transmetimi i ndryshuar i sëmundjeve infektive dhe kequshqyerja e lidhur me pakësimin e prodhimit të kulturave. Sipas (Paz *et al.* 2010), ndikimet e ardhshme të ndryshimit të klimës ka të ngjarë të ndikojnë në gjendjen shëndetësore të miliona njerëzve në mbarë botën nëpërmjet:

- morbiditetit dhe mortalitetit të rritur si pasojë e ekspozimit ndaj të ngrohtit apo të ftohtit ekstrem, sidomos në njerëzit e moshuar dhe me histori sëmundjesh
- rritjes së sëmundjeve infektive, sidomos ato që transmetohen nga organizma që janë të ndjeshme ndaj rritjes së temperaturës (si mushkonjat dhe këpushat)
- rritjes së kequshqyerjes dhe rreziku i lidhur me këtë i sëmundjeve infektive dhe rrugëve të frymëmarrjes, me implikime për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve
- shtimit të vdekjeve, sëmundjeve dhe lëndimeve për shkak të ngjarjeve më të shpeshta dhe intensive të motit ekstrem (përmbytjet, furtuna, thatësira)
- shtimit të sëmundjeve diarreike dhe sëmundjeve të tjera të lidhura me ushqimin dhe ujin
- rritjes së frekuencës së sëmundjeve kardio-respiratore për shkak të përqendrimeve më të larta të nivelit të ndotjes së ajrit pranë tokës (ozoni, NO_x, CO, etj) që kanë të bëjnë direkt me ngrohjen përmes reaksioneve kimike dhe indirekt me aktivitetin në rritje të zjarreve spontane
- shpërndarjes gjeografike të ndryshuar të bimëve dhe vektorëve që mbartin sëmundje (p.sh. brejtësve, mushkonjave, këpushave, etj.) dhe sëmundjeve të lidhura me ta (p.sh. malaria, encefaliti, ethja tropikale, etj);

Vlerësimi i kostove ekonomike i impaktit të ndryshimit të klimës në sektorë si bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe infrastruktura, llogaritet relativisht lehtë. Megjithatë, me zhvillimin e pritshëm ekonomik në botë dhe në veçanti të sektorëve që nuk ndikohen nga klima, mendohet që ndikimi të jetë më pak dramatik sesa po të ndodhte sot. Zbutja dhe përshtatja ndaj efekteve të saj rajonale ka të bëjë me të kuptuarit e ndërveprimeve komplekse midis proceseve demografike, klimatike, mjedisore, ekonomike, shëndetësore, politike, institucionale, sociale dhe teknologjike (Paz *et al.* 2010).

Në mënyrë relative, dëmet e shkaktuar ndaj ekonomisë nuk priten të jenë katastrofike. Dëmet mund të jenë të tillë, që të dëmtojnë rëndë standardin e jetesës, sikurse të bëhen shkak për instabilitet politik të gjerë, duke sjellë pasojë për sigurinë në botë. Më të prekura nga kushte shumëfishe klimatike mund të jenë rajone si Azia, Afrika dhe Lindja e Largët. Ekspertët në tërësi bien dakord se vendet e varfra, pranë Ekuadorit dhe pranë zonave të shkretuara ka gjasa të vuajnë më të shumtën e pasojave të ndryshimit të klimës.

Tajfuni Hajan (i njohur në Filippine si tajfuni Yolanda), ishte një tajfun jashtëzakonisht i fuqishëm që shkatërroi pjesë të Azisë Juglindore, veçanërisht Filipinet, në fillim të nëntorit 2013. Ky tajfun vdekjeprurës shkaktoi të paktën 5235 të vdekur, vetëm në Filippine. Hajani është edhe stuhia më e madhe e regjistruar në afërsi të tokës dhe tajfuni i katërt më i fuqishëm i regjistruar ndonjëherë në aspektin e shpejtësisë së erës.

Si liderët politikë, ashtu dhe klimatologët e kanë lidhur tajfunin Hajan me çështjen e ndryshimit të klimës⁶. Gjatë COP 2013 të KKKBNK (e cila u mbajt rastësisht njëkohësisht me ngjarjen e tajfunit Hajan), kryenegociatori i delegacionit filipinez, në shenjë proteste për ngjarjen dhe solidarizimi me popullin e tij, shpalli grevën e urisë, nën ovacionet mbështetëse të pjesëmarrësve në takim. Së bashku me të, filluan grevën e urisë edhe disa delegatë të tjerë, si dhe gjashtëdhjetë njerëz nga Rrjeti i Veprimit të Klimës, një grup ombrellë e organizatave jo-qeveritare mjedisore.

Por tajfuni Hajan, nuk është i vetmi që ka goditur Azinë Juglindore, as edhe Filipinet. Më poshtë jepen të dhëna për dhjetë tajfunet më të kushtueshëm për Filipinet, me kostot të shprehura në milion dollarë amerikanë⁷:

	Emri	Viti	USD (milion)
1	Bofa (Pablo)	2012	1040
2	Parma (Pepeng)	2009	608
3	Hajan (Yolanda)	2013	512
4	Nesat (Pedring)	2011	333
5	Fengshen (Frank)	2008	301
6	Kecana (Ondoi)	2009	244
7	Megi (Juan)	2010	255
8	Mike (Ruping)	1990	241
9	Angela (Rosing)	1995	241
10	Flo (Kadiang)	1993	195

Politikat që u përgjigjen ndryshimeve klimatike mbartin një element të fortë të menaxhimit të riskut. Ato u përgjigjen qasjes së shoqërisë që synon të reduktojë riskun e impakteve më të rënda të ndryshimeve të klimës (që janë me probabilitet të ulët, por me ndikim të madh). Pasiguritë që shoqërojnë skenarët klimatikë (paqartësia rreth lidhjes midis emetimeve dhe ndryshimit të klimës) reflektohen edhe në politika që përdorin mekanizma fleksibël.

⁶ Marrë nga: http://en.wikipedia.org/wiki/Typhoon_Haiyan#Impact, më mars 2014

⁷ *Ibid.*

Institucionet ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale, në shumë kuptime janë të papërgatitura t'u përgjigjen pasojave të katastrofave të shkaktuara nga moti. Në këtë kuadër kërkuesit dhe politik-bërësit japin alarmin që shoqëria në tërësi duhet të përmirësojë mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të ketë gati strategji për t'iu përgjigjur kushteve klimatike të së ardhmes, që priten të jenë krejt të ndryshme nga ato të sotmet (UN-Sigma XI Expert Group 2007).

Puna për të pakësuar efektin e ndryshimit të klimës dhe lehtësuar pasojat e ngrohjes globale mund të bëhet në disa drejtime, më kryesoret prej të cilave janë:

- Përmirësimi i eficiencës së sektorit të energjisë;
- Përdorimi i biokaburanteve;
- Përmirësimi i praktikave të përdorimit të tokës;
- Ruajtja e pyjeve dhe ripyllëzimi;
- Reduktimi i emisioneve të gazeve serrë;
- Forcimi i institucioneve dhe ngritja e kapaciteteve për t'iu përgjigjur ndryshimeve të klimës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Zhvillimi i teknologjive dhe politikave që lehtësojnë pasojat e katastrofave.

Ndryshimi i klimës si çështje sigurie

Ndryshimi i klimës do të ketë pasoja fizike dhe njerëzore ose shoqërore të shumta, direkte dhe indirekte që paraqesin rreziqe dhe shqetësime të shumta të sigurisë. Kështu, njerëzimi, shoqëria dhe biznesi ndërkombëtar, si dhe bashkësia e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, pritet të ballafaqohen me sfida të reja për mirëqenien e tyre dhe mbijetesën, që mund të jenë më të rënda se çdo kërcënim që bota ka përjetuar gjatë pesë shekujve të fundit dhe sidomos që nga dy luftërat botërore dhe pandemitë gjatë shekullit të 20^{të}. Hulumtimet nga IPCC (2007d) nuk ka lënë asnjë dyshim se gjatë shekullit të 21^{të} njerëzimi do të përballet me shumë sfida të reja të sigurisë mjedisore që mund të paraqesin probleme themelore të reja për mbijetesën e individëve, për shtetet dhe aktorët e politikave globale.

Ndërsa në shekullin e 20^{të} dhe sidomos që nga viti 1945, "dilema e sigurisë" së shteteve ka mbizotëruar në analizat e marrëdhënieve ndërkombëtare, që nga fundi i Luftës së Ftohtë, kjo perspektivë sigurie me shtetin në qendër, ka ndryshuar për shkak të një zgjerimi (nga siguri

ushtarake dhe politike, në ekonomike, shoqërore dhe të mjedisit), thellimi (nga siguri kombëtare dhe ndërkombëtare, në njerëzore, të gjinisë dhe sigurisë globale) dhe sektorizimi (nga siguri energjie, uji, ushqimi, në shëndeti dhe klime) të konceptit të sigurisë (Brauch 2010).

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, dilema e luftës nuk është kapërcyer as në nivel global, as rajonal për vendet MENA (Lindja e Mesme e Afrika Veriore), madje garat e armatimeve janë intensifikuar në pjesë të tjera të botës, si p.sh., midis Iranit dhe shteteve të Gjirit Persik dhe midis Izraelit dhe fqinjëve të tij arabë. Ndërkohë ka dalë një "dilemë e re mbijetese" e përqendruar tek njeriu, që ka ndikuar seriozisht një pjesë të njerëzimit që jeton në varfëri, veçanërisht në Jug (Ibid.).

Ndryshimi i klimës do të ndikojë në vendet e dhe njerëzit në Jug më seriozisht, për shkak të një numri më të lartë të rreziqeve të rënda dhe intensive, një shkallë të lartë ndjeshmërie sociale, që rezulton nga varfëria dhe mungesa e burimeve për masa përshtatjeje dhe zbutëse, sikurse dhe një kapacitet i pamjaftueshëm i shtetit për zbatim.

Këto sfida të reja të sigurisë së mjedisit që po përballon njerëzimi në shekullin e 21^{të}, nuk mund të zgjidhen nga strategji, politika dhe masa sigurie tradicionale dhe të bazuara tek fuqia. Ato kërkojnë një zhvendosje nga një koncept i njëanshëm i sigurisë kombëtare, tek një qasje bashkëpunuese dhe shumëpalëshe e sigurisë.

Rreziqet dhe shqetësimet e reja të sigurisë globale jo-ushtarake në Antropocenë⁸, dhe konceptet e sigurisë së ripercptuar, tashmë kanë rezultuar në një Agjendë të re "të butë" të sigurisë globale, rajonale, ndërkombëtare dhe kombëtare. Ndryshimet e trefishta kontekstuale, me a) fundin e Luftës së Ftohtë; b) globalizimin dhe c) sfidat e reja të sigurisë në zhvillim në Antropocenë, kërkojnë që paqja ndërkombëtare dhe politika e sigurisë të ndryshojnë rrënjësisht (Brauch 2010).

Që nga viti 2000, ndryshimi i klimës është trajtuar gjithnjë e më shumë nga politikbërësit dhe analistët si një rrezik dhe shqetësim, që u paraqitet çështjeve të shumta të sigurisë njerëzore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndryshimi i klimës filloi të diskutohej intensivisht si çështje

⁸ Epoka gjeologjike e tanishme (pas Revolucionit Industrial), gjatë së cilës njeriu ka filluar të ushtrojë ndikim të madh tek mjedisi.

ndërkombëtare, kombëtare, njerëzore dhe e sigurisë së mjedisit, duke pranuar se paraqet shumë kërcënime, sfida, dobësi dhe rreziqe për një sërë elementësh të sigurisë sektoriale të tilla si uji, toka, shëndeti dhe ushqimi.

Figura 3: Aspekti i sigurisë së ndryshimit të klimës



Burimi: Royal United Services Institute, marrë më korrik 2012 në <http://rusi.org/events/ref:E48481B8ED91EC/>

Në vitin 2007, pati disa zhvillime të cilat shënuan një pikë kthese në çështjen e ndryshimeve klimatike; u publikua raporti i katërt i vlerësimit të IPCC, u zhvillua debati i parë për këtë çështje në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si dhe iu dha çmimi Nobel për Paqen IPCC-së dhe Al Gore (Brauch 2010). Në qershor të vitit 2009, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, për herë të parë miratoi një rezolutë jo-detyruese mbi ndryshimin e klimës si një problem ndërkombëtar i sigurisë, e cila u kërkonte Shteteve të tjera Anëtare ta adresonin këtë çështje dhe t'i kërkonin Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të paraqiste një raport mbi të.

Ndërsa debati i politikës evropiane në Suedi, në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, dhe në Bashkimin Evropian i drejtohet ndryshimit të klimës kryesisht si një çështje ndërkombëtare e sigurisë, debati i politikës amerikane që nga viti 2004, por më veçanërisht që nga viti 2007, u përqendrua në ndryshimin e klimës si një çështje të sigurisë kombëtare, në mënyrë të veçantë në kërcënimin që do të prodhojë për sigurinë kombëtare të SHBA dhe si do të ndikojë ushtrinë dhe operacionet e saj. Ndryshimi i klimës është analizuar nga një perspektivë e sigurisë së njeriut nga ana e Programit të Ndryshimit Global Mjedisor dhe Sigurisë Njerëzore (GECHS)

dhe është adresuar gjatë presidencës greke të Rrjetit të Sigurisë Njerëzore (2007-2008), si dhe nga Miqtë e Sigurisë Njerëzore në OKB (Brauch 2010).

Bazuar në një raport mbi Rrezikun për Sigurinë të Ndryshimit të Klimës, të Këshillit gjerman për Ndryshimet Klimatike (WBGU), që u botua në Samitin e G-8, qeveria gjermane propozoi një letër strategjike të BE mbi impaktet në siguri të ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, WBGU argumentoi se ndryshimi i klimës mund të shkaktojë konflikte kombëtare e ndërkombëtare, dhe të intensifikojë probleme tashmë të vështira për t'u menaxhuar, si dështimi i shtetit, shturja e rendit social dhe rritja e dhunës. WBGU-ja identifikoi katër shkaqe konflikti në përballjen e mjedisit dhe shoqërisë, dinamika e të cilave mund të çojë në destabilizim social dhe dhunë: a) degradimi i burimeve të ujërave të ëmbla shkaktuar nga klima; b) rënia e prodhimit të ushqimit e shkaktuar nga klima; c) rritja e stuhive dhe përmytjeve të shkaktuara nga klima; d) migrimi i shkaktuar nga kushtet mjedisore. WBGU-ja identifikoi disa pika të nxehta rajonale në: Afrikën e Veriut, Afrikën Jugore, Azinë Qendrore, Indi, Pakistan dhe Bangladesh, Kinë, Karaibe dhe Gjirin e Meksikës, si dhe në rajonin e Andeve dhe Amazonës (WBGU 2008).

WBGU-ja formuloi gjashtë kërcënime kryesore për sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar, që do të lindin në qoftë se zbutja e ndryshimit të klimës “dështon”: 1) rritje e mundshme e numrit të shteteve të dobët dhe të brishtë si rezultat i ndryshimit të klimës; 2) rreziqe për zhvillimin ekonomik global; 3) rreziqe të rritjes së konflikteve ndërkombëtare në vendet shkaktoare të ndryshimeve klimatike dhe atyre më të prekura; 4) rrezik për të drejtat e njeriut dhe legjitimitetin e vendeve të industrializuara si aktorë të qeverisjes globale; 5) shkaktim dhe intensifikim i migrimit; dhe 6) ezaurim i politikave klasike të sigurisë (WBGU 2008).

Nëse këto konflikte apo kriza sociale do të ndodhin, varet nga rritja mesatare e ‘temperaturës’ botërore deri në fund të këtij shekulli. Kështu, në këndvështrimin e WBGU, në qoftë se politika e klimës është e suksesshme në kufizimin e rritjes së temperaturës mesatare globale të sipërfaqes në jo më shumë se 2°C në krahasim me vlerat para-industriale, kërcënimi i shkaktuar nga klima për sigurinë ndërkombëtare mund të konsiderohet i menaxhueshëm. Por, nëse përpjekja për zbutje dështon, rreziqet e sigurisë të nxitur nga klima do të fillojnë të manifestohen në rajone të ndryshme të botës rreth viteve 2025-2040. Sfida kryesore është të ndërmerren veprime të tilla politike për klimën, brenda 10-15 viteve të ardhshme, në mënyrë

që të shmangen ndikimet social-ekonomike dhe implikimet për sigurinë ndërkombëtare, të cilat në të kundërt mund të intensifikohen në dekadat e ardhshme.

Tre nga shkaqet e mësipërme të konfliktit janë me shumë ndikim në rajonin Euro-Mesdhetar: a) degradimi i burimeve të ujërave të ëmbla i nxitur nga klima; b) rënia e prodhimit të ushqimit e nxitur nga klima, dhe c) migrimi i nxitur nga shkaqet mjedisore. Ndërsa shtimi i stuhive dhe përmytjeve i nxitur nga klima, ka prekur shumë vendet e Mesdheut Perëndimor dhe Lindor, sidomos gjatë vjeshtës dhe dimrit (Brauch 2010).

Përgjigjja ndërkombëtare ndaj ndryshimit të klimës

Veprimet e para ndërkombëtare për klimën datojnë më 1979, vit kur u mbledh Konferenca e Parë Botërore për Klimën. Në vitin 1988, u krijua Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet e Klimës (IPCC). Ky i fundit dhe Konferenca e Dytë Botërore për Klimën, më 1990, rekomanduan masat e mundshme për përshtatje dhe lehtësim, si dhe u shprehën për nevojën e një traktati global për ndryshimin e klimës. Këtë e bënë duke u mbështetur në skenarët e së ardhmes, bazuar në analizën shkencore të fakteve.

Ndryshimi i klimës përcaktohet nga IPCC si një problem me karakteristika unike që përfshin ndërveprime midis proceseve mjedisore, politike, ekonomike, sociale dhe teknologjike (IPCC 2007c). Në dokumentin që po i referohemi, argumentohet se efektshmëria e zbutjes së ndryshimit të klimës mund të rritet nëse politikat e klimës integrohen me objektivat e politikave të tjera kombëtare dhe sektoriale.

Në vitin 1992, shumë vende u bënë pjesë e një traktati ndërkombëtar, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), e cila hyri në fuqi më 1994. Qëllimi i kësaj konvente ishte të vendosej bashkërisht sesi do veprohej kundër rritjes së temperaturave mesatare globale dhe çdolloj ndikimi negativ të mundshëm të saj.

Në vitin 1995, vendet pjesëtare të KKKBNK, shpallën negociatat për të forcuar përgjigjen globale ndaj ndryshimit të klimës, të cilat u finalizuan më 1997 me Protokollin e Kiotos (i cili hyri në fuqi më 2005).

Të dyja këto marrëveshje ndërkombëtare përcaktojnë rolin drejtues që duhet të kenë vendet e industrializuara në luftën kundër ndryshimeve klimatike, për sa kohë që ata janë përgjegjës

për pjesën më të madhe të emetimeve, sikurse disponojnë edhe burimet më të mëdha financiare (*Ibid.*). Vendet e industrializuara kanë një detyrim nën KKKBNK për të ndihmuar vendet me të ardhura më të ulëta, nëpërmjet financimit të strategjive për zbutjen dhe përshtatjen, të nevojshme për të reduktuar emetimet dhe mbrojtur popullsitë në rrezik. Vendet me të ardhura më të ulëta që veprojnë vetëm, nuk e kanë gjendjen financiare për të mbrojtur plotësisht popullatat e tyre nga ndikimet klimatike. Financimet për këtë arsye janë të rëndësishme për të ndihmuar këto vende në luftën kundër ndryshimit të klimës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të popujve të tyre. Zhvillimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse financiare është gjithashtu i nevojshëm për të parandaluar dëmtimin social dhe mjedisor dhe maksimizuar pjesëmarrjen, transparencën, përgjegjshmërinë, barazinë dhe mbrojtjen e të drejtave (CIEL 2011)⁹.

Organizata e Kombeve të Bashkuara jep kontributin e saj për mjedisin në përgjithësi, nëpërmjet UNEP-it (Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara), i cili u themelua në vitin 1972, pas Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor në Stokholm, Suedi. UNEP-i koordinon zhvillimin e konsensusit për politikat mjedisore të bashkësisë ndërkombëtare, duke pasur si synim zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit global. Ishte pikërisht UNEP-i, që së bashku me Organizatën Meteorologjike Botërore themeluan Panelin Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC)¹⁰. UNEP-i është gjithashtu një ndër agjencitë zbatuese të GEF-it (shih më poshtë) dhe Fondit Shumëpalësh për zbatimin e Protokollit të Montrealit.

Në Evropë, UNEP-i përfaqësohet nga Zyra Rajonale me seli në Gjenevë, në të cilën bën pjesë dhe Shqipëria, përmes zyrës së saj ndërlidhëse në Vjenë. Qëllimi kryesor i Zyrës Rajonale për Evropën është të sigurojë ofrimin e programeve të UNEP-it në rajon dhe të nxisë përfshirjen e çështjeve mjedisore në planet kombëtare të zhvillimit¹¹. Kjo zyrë synon gjithashtu të nxisë dhe forcojë bashkëpunimin rajonal, në përgjigje të prioriteteve të identifikuar nga qeveritë kombëtare dhe organizatat e ndryshme rajonale.

⁹ Climate change and human rights, marrë nga http://www.ciel.org/Publications/CC_HRE_23May11.pdf, shkarkuar në mars 2012

¹⁰ <http://www.unep.org/climatechange/>

¹¹ Marrë në: <http://www.un.org.al/subindex.php?faq=details&id=23>, shkarkuar në mars 2012

Përveç Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që është organizata ndërkombëtare kryesore që merret me çështjen e ndryshimit të klimës, ka edhe organizata të tjera të cilat japin kontributin e tyre në këtë fushë. Për këtë, do flitet shkurtimisht më poshtë.

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) është një organizatë ndërkombëtare që u themelua zyrtarisht më 1961, me hyrjen në fuqi të konventës për themelimin e saj. Sot, OECD ka 34 vende anëtare nga e gjithë bota, të cilët mbledhen të identifikojnë probleme, t'i analizojnë ato dhe të ndërmarrin politika për t'i zgjidhur. Së shpejti ajo pritet të zgjerohet në 40 anëtarë, të cilët llogaritet se realizojnë 80% të tregtisë dhe investimeve botërore. OECD-ja ka zhvilluar ndër vite vlerësime të politikave sektoriale, përmbledhje të politikave kombëtare dhe analiza të instrumenteve të politikave ekonomike. Instrumentet ekonomikë dhe financiarë, efienca e energjisë në vendet me ekonomi në tranzicion, politikat e transportit dhe bujqësisë, janë disa nga çështjet që lidhen me ngrohjen globale dhe që ka trajtuar kjo organizatë.

Banka Botërore (BB) mbajti për ca kohë përgjegjësinë e menaxhimit të Fondit të Teknologjisë së Pastër, që kishte si qëllim primar bërjen e energjisë së rinovueshme, të konkurrueshme në kosto me energjinë nga qymyri. BB ka ndërmarrë edhe Iniciativën e Ajrit të Pastër që ka pasur për qëllim të nxiste mënyrat inovative (si p.sh mjetet elektrike të transportit) për të përmirësuar cilësinë e ajrit në qytete të rajoneve të caktuara të botës, nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe përvojave. Puna e BB për të zhvilluar një strategji mbi problemet mjedisore dhe ndryshimin e klimës kanë qenë objekt kritikash në disa aspekte që kanë pasur të bëjnë kryesisht me investimet në mbarë botën që BB ka bërë për termocentralet me qymyr, si emetues të mëdhenj të gazeve serrë dhe me huadhëniet shumë të ulëta për të mbështetur sektorin mjedisor. Pas Konferencës së Kopenhagenit më 2009, edhe përgjegjësia e menaxhimit të Fondit të Teknologjisë së Pastër për ndryshimin e klimës rreshti, pasi ndërkohë BB vijonte të financonte termocentralet me qymyr.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e trajton ngrohjen globale si një ndër rreziqet globale mjedisore me shkallë të gjerë, së bashku me disa çështje të tjera si: pakësimi i ozonit stratosferik, humbja e biodiversitetit, furnizimi me ujë, degradimi i tokës, etj. Një ndër sfidat e OBSH-së është të mbrojë shëndetin nga ndikimi mjedisor. Ajo e realizon këtë duke krijuar lidhjen e programeve mjedisore me ato shëndetësore, duke siguruar ekspertizë shëndetësore

në KKKBNK dhe UNBDD, si dhe duke këshilluar sektorin e shëndetit për t'iu përgjigjur siç duhet risqeve shëndetësore të shkaktuara nga ndryshimi mjedisor në shkallë të gjerë.

Global Environmental Facility (GEF), themeluar më 1991, është një organizatë financiare, e cila u siguron hua vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion për projekte që kanë lidhje me ndryshimin e klimës, biodiversitetin, degradimin e tokës, ujërat ndërkombëtare, e kështu me radhë. GEF-i bashkon 182 vende anëtare, në partneritet me institucionet ndërkombëtare, organizatat jo-qeveritare dhe sektorin privat për të trajtuar çështjet globale të mjedisit. Ky partneritet përfshin UNDP, UNEP, UNFAO, BB, BERZH, etj. GEF-i është sot financuesi më i madh i projekteve për të përmirësuar mjedisin global, duke dhënë 9.2 miliard \$ dhe bashkëfinancuar 40 miliard \$ nëpër 2700 projekte në më shumë se 165 vende në zhvillim dhe ekonomi në tranzicion.

Në vitin 2010, Palët e KKKBNK themeluan një fond të ri (Fondi i Gjellbër i Klimës), dhe ranë dakord ndër të tjera, të zhvillonin mekanizma për të siguruar që masat mbrojtëse sociale dhe mjedisore të zbatoheshin për fondin. Institucionet e përfshira në financimin e aktiviteteve të lidhura me ndryshimet klimatike, të tilla si GEF, BB dhe Fondi i Përshtatjes, janë angazhuar të ndjekin politika dhe procedura që respektojnë të drejtat e njohura ndërkombëtarisht, të sigurojnë procese transparente dhe lejojnë mundësi kuptimplotë për pjesëmarrjen e publikut (CIEL 2011).

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), ndonëse një organizatë ushtarake, përfshin në strukturën e saj një pjesë me funksione jo-ushtarake që kanë lidhje me sigurinë. Për qëllime të këtij studimi, vlen të përmendet Komiteti Shkencor për Paqen dhe Sigurinë, i ngritur më 2006. Efektet e degradimit mjedisor janë për NATO-n, të një rëndësie të madhe nga pikëpamja e paqes, stabilitetit dhe sigurisë. Për NATO-n, ndryshimi i klimës dhe çështjet që lidhen me të, mund të ndikojnë negativisht ekonominë, stabilitetin, rendin publik, sigurinë e ushqimit, migrimin dhe sigurinë e kufijve (NATO 1999).

Kuadri ligjor për ndryshimin e klimës

Sikurse përmenden edhe më lart, KKKBNK (1992) dhe Protokollin e Kiotos (1997) janë instrumentet kryesorë ligjorë ndërkombëtarë në fushën e politikave ndaj ndryshimit të klimës

dhe ngrohjes globale. Qëllimi kryesor i KKKBNK është stabilizimi i përqendrimit të gazeve serrë në atmosferë në një nivel të tillë që do të parandalonte ndikimin e rrezikshëm njerëzor ndaj sistemit klimatik. Palët në Konventë, duhet të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe duhet të angazhohen për të mbrojtur sistemin klimatik nga ndikimi njerëzor, duke integruar masa dhe politika në programet e tyre zhvillimore (UNFCCC 1992).

Ideja e stabilizimit të emetimeve të gazeve serrë është përforcuar më tej me Protokollin e Kiotos (1997). Ky protokoll përcakton objektiva të detyrueshëm juridikisht kundrejt 37 vendeve të industrializuara, me qëllim pakësimin e emetimeve nga ana e tyre të gjashtë gazeve serrë me një masë mesatare prej 5 për qind deri në vitin 2012 (për informacion për gazet serrë, shih Shtojcën 1). Ky protokoll nuk është ratifikuar nga ShBA, pavarësisht se ata dhe Kina kontribuojnë për gati gjysmën e emetimeve të gazeve serrë në botë (Commission Europeene 2010). Periudha e angazhimit të parë të këtij Protokollit përfundoi më 2012. Shqipëria ka miratuar ligjin për aderimin në Protokollin e Kiotos, në vitin 2004.

Protokollin e Kiotos jep udhëzime për masat dhe politikat që palët duhet të ndërmarrin për të pakësuar emetimet me qëllim përmbushjen e angazhimit për zhvillim të qëndrueshëm. Këto udhëzime përfshijnë ndër të tjera rritjen e eficiencës së energjisë, nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme dhe pakësimin e emetimeve të gazeve serrë. Pavarësisht se Protokollin e Kiotos i detyron ligjërisht vendet e zhvilluara të realizojnë objektivat për reduktimin e emetimeve, ai është i orientuar drejt ngritjes së mekanizmave që ndihmojnë si vendet e zhvilluara, ashtu dhe ato në zhvillim të arrijnë në një mënyrë kost-efektive objektivat e tyre nën protokoll. Protokollin vendosi mekanizma me bazë tregu, të tilla si Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (MZHP) dhe Zbatimi i Përbashkët, për të lejuar vendet e zhvilluara të përmbushin detyrimet e tyre sipas traktatit, duke investuar në vendet në zhvillim.

Po kështu, edhe nën KKKBNK, vendet pjesëmarrëse, janë zotuar të marrin masa kryesisht nëpërmjet përshtatjes së programeve kombëtare për lehtësimin e ndryshimit të klimës, për zhvillimin e inventarit për bilancin 'prodhim ndaj largim' gazesh serrë dhe raportimin e tij, për bashkëpunimin shkencor dhe teknik, si dhe për garantimin e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së publikut. Procesi i negociatave të KKKBNK përqendrohet në zhvillimin e një vizioni të përbashkët të veprimit bashkëpunues afatgjatë për të shmangur ndërhyrjet e rrezikshme në sistemin e klimës. Nga ana tjetër, vizioni i përbashkët mbështetet nga veprimi nën secilën nga

katër shtyllat themelore: zbutja, përshtatja, financimi dhe transferimi i teknologjisë (CIEL 2011).

KKKBNK dhe Protokollin e Kiotos u kërkojnë vendeve që të reduktojnë emetimet e tyre të gazeve serrë duke përdorur strategji zbutëse të ndryshme. Politikat e përshtatjes synojnë të rrisin kapacitetin e shoqërive dhe të ekosistemeve të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Për shkak të natyrës së sistemit klimatik dhe ndikimeve afatgjata të përqendrimeve të rritura të gazeve serrë, ndryshimi i klimës do të vazhdojë për disa dekada, dhe për këtë arsye strategjitë e përshtatjes janë të rëndësishme për të mbrojtur popullatën në nevojë.

Përshtatja ndaj ndryshimit të klimës nën KKKBNK menaxhohet nga tre instrumente: Programi i Punës Nairobi, program që nisi më 2005 me qëllimin për të ndihmuar palët (shtetet) të kuptonin brishtësinë e tyre ndaj ndikimeve të klimës dhe të qartësonin nevojën e tyre për përshtatje; Trupi Ndihmës për Zbatimin që këshillon Konferencën e Palëve (COP) - organizmi më i lartë i KKKBNK në zbatimin e masave zbutëse dhe përshtatëse; dhe Programi i Veprimeve për Përshtatjen Kombëtare (NAPA), i cili siguron informacion për të vlerësuar dhe renditur nevojat më imediate për përshtatje të vendeve më pak të zhvilluara (Pilifosova, 2000). Programi i Punës Nairobi synoi të përmbushte dy objektiva: të ndihmonte vendet të kuptonin ndikimet dhe përshtatjen, si dhe të ndihmonte vendet në marrjen e masave përshtatëse ndaj ndryshimit të klimës, duke marrë në konsideratë realitetet e tyre social-ekonomike. Rregullat e detajuara për zbatimin e Protokollit u miratuan në COP 7 në Marakesh, Marok, më 2001 dhe janë quajtur "Marrëveshjet e Marakeshit".

Një zhvillim më i vonët është Plani i Veprimit Bali (2007), i cili perceptoi një mënyrë inovative për të siguruar burime financiare, transferim teknologjik dhe investime. Ky plan parashikoi qartë angazhimet shtesë për reduktimin e emetimeve të vendeve të industrializuara dhe prezantoi konceptin e veprimeve parandaluese të përshtatshme në shkallë kombëtare nga vendet në zhvillim, të cilat duhet të mbështeten nga ana teknologjike, financiare dhe e ngritjes së kapaciteteve.

Plani i Veprimit Bali prezantoi Mekanizmin e Zhvillimit të Pastër për të mbledhur fonde për masat përshtatëse. Nëpërmjet Programit të Veprimit Kombëtar të Përshtatjes (NAPA), që është një mjet raportimi për vendet më pak të zhvilluara, zgjidhen fushat prioritare për veprim.

KKKBNK po lehtëson në masë të madhe studimet në nivel vendi mbi nevojat për përshtatje, të cilat financohen nga GEF nëpërmjet katër fondeve të Konventës. Sipas dokumentit NAPA¹², publikuar nga KKKBNK më 2011, sektorët më të financuar deri në fund të këtij viti janë:

- Siguria e ushqimit
- Zonat bregdetare dhe ekosistemet detare
- Menaxhimi i katastrofave
- Energjia
- Shëndeti
- Infrastruktura
- Ngritja e kapaciteteve dhe arsimi

Shqipëria nuk është në listën e vendeve të financuara në kuadër të NAPA-s.

Kombet e Bashkuara rinisën negociimet në vitin 2007, për çështjen e ndryshimeve klimatike, të cilat patën qëllim finalizimin e një kuadri botëror me rastin e Konferencës së Kopenhagenit, të dhjetorit 2009. Konferenca e Kopenhagenit (COP 15) për klimën, e cila prodhoi një deklaratë politike jo-detyruese që nuk përmban objektiva detyrues për pakësimin e emetimeve, por ua lë ato vendeve të zhvilluara, për t'i përfshirë në shtojcën e marrëveshjes. Ndërsa vendet në zhvillim duhet të komunikojnë veprimet e tyre lehtësuese çdo dy vjet, masë që ishte një hap i parë kundrejt një regjimi të përgjithshëm për pakësimin e emetimeve në vendet në zhvillim. Konferenca nuk arriti sukses në përparimin e negociatave, por doli me Marrëveshjen e Kopenhagenit, që është një dokument politik i mbështetur nga 140 vende anëtare të OKB (Commission Europeene 2010). Rrjedhojat e Konferencës qenë në tërësi zhgënjyese për Komisionin Evropian, Këshillin dhe Parlamentin e Evropës, kryesisht për shkak të profilit të ulët që liderët evropianë u detyruan të mbajnë dhe për shkak të ndikimeve të dobëta që kjo konferencë pritej të kishte mbi legjislacion evropian. Një marrëveshje sinjifikante në Kopenhagen do të mund të sillte një rishikim të paketës së energjisë dhe ndryshimit të klimës së BE-së. Sidoqoftë, shumë politikëbërës në BE u orvatën të shohin aspektet pozitive të marrëveshjes së Kopenhagenit. Në të shprehet qartë vullneti politik për të

¹² Marrë në:

http://unfccc.int/cooperation_support/least_developed_countries_portal/napa_priorities_database/ite

pakësuar emetimet e karbonit dhe për t'iu përgjigjur ndryshimit të klimës në terma afatshkurtër dhe afatgjatë¹³.

Përgjigja kryesore ndaj ndryshimit të klimës është pakësimi i emetimeve. Në vitin 2010, palët pjesëmarrëse ranë dakord se emetimet duhet të pakësohen në mënyrë të tillë që rritja e temperaturave globale të jetë nën 2°C (UNFCCC 2011). Edhe Marrëveshja e Kopenhagenit jep orientime politike të rëndësishme për të bërë të mundur këtë objektiv, në funksion të të cilit 75 vende të zhvilluara ose në zhvillim kanë komunikuar veprimet që do të ndërmarrin për të pakësuar emetimet e tyre (*Ibid.*). Kjo marrëveshje fton gjithashtu vendet e zhvilluara të japin ndihmë financiare të konsiderueshme, për vendet në zhvillim, në mënyrë që ata të luftojnë ndryshimin klimatik. Rreth 30 miliard USD janë vënë në dispozicion për periudhën 2010-2012 dhe 100 miliard të tjera deri më 2020, nëse vendet në zhvillim marrin masa domethënëse dhe transparente për pakësimin e emetimeve të tyre (*Ibid.*).

Në dhjetor 2010, në përfundim të Konferencës së Klimës së OKB-së në Kankun të Meksikës (COP 16), u arrit një marrëveshje, e cila përfaqëson një hap të rëndësishëm në rrugën drejt ndërtimit të një kornize gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për veprimin ndaj klimës për periudhën pas vitit 2012¹⁴. Palët e KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos miratuan në Kankun një sërë vendimesh të njohura kolektivisht si Marrëveshjet Kankun, të cilat përfshijnë ndër të tjera referenca ndaj disa të drejtave të njeriut. Kështu lidhja midis ndryshimit të klimës dhe të drejtave të njeriut pasqyrohet në këtë mënyrë (CIEL 2011):

“Duke vënë në dukje rezolutën 10/4 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve Bashkuara mbi 'të drejtat e njeriut dhe ndryshimin e klimës', i cili njuh se efektet negative të ndryshimit të klimës kanë një gamë pasojash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ushtrimin efektiv të të drejtave të njeriut dhe se efektet e ndryshimeve klimatike do të ndjehen më akute nga ata segmente të popullatës që tashmë janë të prekshme për shkak të gjinisë, moshës, gjeografisë, statusit indigjen ose minoritar dhe paaftësisë.”

Gjuha e së drejtës në njërin nga vendimet e Kankunit është një hap i parë i rëndësishëm drejt krijimit të mbrojtjes të së drejtave të njeriut në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

ms/4583.php, në prill 2012

¹³ Marrë nga: <http://www.denmark.dk/en/menu/Climate-Energy/COP15-Copenhagen-2009/cop15.htm>, në korrik 2012

¹⁴ Marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/clima/>, shkarkuar në korrik 2012

Në konferencën e 17-të klimës së OKB-së që u mbajt në Durban të Afrikës së Jugut, në fund të vitit 2011, u ra dakord që të nisej një proces i ri negociues që do t'i hapte rrugën një protokollit të ri (apo marrëveshjeje) brenda 2015-ës dhe që do të gjejë zbatim brenda vitit 2020, duke mbuluar të gjitha vendet. Ndërkohë, u ra dakord që të vijojë periudha e dytë e angazhimit nën Protokollin e Kiotos, duke nisur nga janari 2013. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, 37 vendet e zhvilluara do të vijojnë angazhimet e tyre për reduktimin e shkarkimeve të tyre të karbonit me 5% në nivelin e vitit 1990, edhe për pesë vjet të tjerë¹⁵.

Marrëveshja e Durbanit pati rëndësi pasi rregullat, mekanizmat dhe tregjet e Protokollit të Kiotos, mbetën të gjitha në veprim si mjete efektive për zbatimin e veprimit global për klimën. Qeveritë e 194 vendeve pjesëmarrëse ranë dakord të zbatojnë një paketë të plotë veprimesh për të mbështetur vendet në zhvillim, paketë që është miratuar më 2010-ën në Kankun. Paketa e veprimeve e njohur si 'Platforma e Durbanit' përfshin Fondin e Gjelbër të Klimës, i cili mundëson 100 miliard USD çdo vit në dispozicion të vendeve në zhvillim, deri në vitin 2020. Përveç këtyre rrjedhobjave, 'Paketa Durban' solli përparim në disa elementë të tjerë të rëndësishëm të Marrëveshjes Kankun, të tillë si ngritja e një qendre për teknologjinë dhe rrjetin e klimës, modalitetet për mekanizmin e rishikimit për të vlerësuar përparimin global të procesit të lehtësimit dhe marrëveshjen mbi anëtarësimin në Komitetin e Përshtatjes.

Në COP 15, COP 16 dhe COP 17, Shqipëria, si palë në KKKBNK dhe Protokollin e saj të Kiotos, ka mbështetur qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe komunitetit ndërkombëtar për të zbutur ndryshimet klimatike (SNM 2013-2020).

Për KKKBNK dhe 197 palët anëtare të Konventës, një nga dilemat e mëdha ka qenë se çdo ndodhë pas 2012-ës. Vlefshmëria kohore e detyrimeve të palëve nën Protokollin e Kiotos u mor në shqyrtim në sesionin e 18-të të Konferencës së Palëve nën KKKBNK, që u zhvillua në fund të vitit 2012, në Doha të Katarit (së bashku me sesionin e 8-të të Mbledhjes së Palëve nën Protokollin e Kiotos), në të cilin u arrit një marrëveshje për të zgjatur jetën e Protokollit të Kiotos deri në vitin 2020 dhe u vendos se një pasues i Protokollit do të zhvillohet duke u nisur nga viti 2015 dhe që do të zbatohet deri në vitin 2020.

¹⁵ Marrë nga <http://www.willstegerfoundation.org/climate-news/item/1388-cop17-final-outcome> shkarkuar në prill 2012

Formulimi i miratuar nga Konferenca përfshiu për herë të parë konceptin e "humbjes dhe dëmtimit", një marrëveshje në parim se vendet e pasura mund të jenë financiarisht përgjegjës ndaj kombeve e tjerë në rast se dështojnë të reduktojnë emetimet e karbonit. Konferenca ka prodhuar një paketë dokumentesh të titulluar Porta Klimatike e Dohas, e cila përmban:

- Një zgjatje tetë vjeçare të Protokollit të Kiotos deri në vitin 2020, të kufizuar në fushëveprim për vetëm 15% të emetimeve globale të dioksidit të karbonit për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së Kanadasë, Japonisë, Rusisë, Bjellorusisë, Ukrainës, Zelandës së Re dhe Shteteve të Bashkuara dhe për shkak të faktit se vendet në zhvillim si Kina (emetuesi më i madh në botë), India dhe Brazili nuk janë subjekt i ndonjë zvogëlimi të emetimeve sipas Protokollit të Kiotos;
- Formulimin e 'humbjes' dhe 'dëmit', të formalizuar për herë të parë në dokumentet e konferencës;
- Përparimin (ndonëse të pakët) drejt financimit të Fondit të Gjellbër të Klimës.

Konferenca COP 19, e cila u mbajt më nëntor 2013, në Varshavë, Poloni, shtroi rrugën për qeveritë për të punuar mbi projekt-tekstin e një marrëveshjeje të re universale klimatike, që është një hap thelbësor për të arritur një marrëveshje përfundimtare në Paris, në vitin 2015. Në kontekstin e 2015-ës, vendet vendosën të fillojnë ose të intensifikojnë përgatitjet e brendshme për kontributet e tyre kombëtare për atë marrëveshje, e cila pritet të hyjë në fuqi në vitin 2020. Vendet ranë gjithashtu dakord të mbyllin hendekun e ambicieve të para-2020-ës, duke intensifikuar punën teknike, rritur mundësitë për ndarjen e informacionit dhe shtuar angazhimin për dialogje ministrore¹⁶.

Përveç kësaj, qeveritë u shprehën më qartë për mobilizimin e financave për të mbështetur veprimet e vendeve në zhvillim për të pakësuar emetimet dhe për t'u përshtatur me ndryshimin e klimës. Kjo përfshin kërkesën që vendet e zhvilluara të përgatisin parashtesat dyvjeçare të strategjive të tyre të përditësuara dhe qasjet për shkallëzim të financave midis viteve 2014 dhe 2020. Pati gjithashtu njoftime konkrete të kontributeve të ardhshme të financave publike për të mbështetur zhvillimin e veprimeve kombëtare për klimën, nga vende si Norvegjia, Britania e Madhe, BE-ja, SHBA-ja, Republika e Koresë, Japonia, Suedia,

¹⁶ Marrë nga <http://www.cop19.gov.pl/latest-news/>, në nëntor 2013.

Gjermania dhe Finlanda. Ndërkohë, Bordi i Fondit të Gjelbër të Klimës do të fillojë procesin e mobilizimit të fondeve dhe vendeve të zhvilluara u është kërkuar kontribut i qenësishëm dhe i shpejtë para COP 20-ës, për të mundësuar një vënie në lëvizje sa më efektive.

Konferenca e Varshavës vendosi gjithashtu të krijojë një mekanizëm ndërkombëtar për të siguruar një mbrojtje më të mirë popullatat më të rrezikuara, kundrejt humbjeve dhe dëmit të shkaktuar nga ngjarjet ekstreme të motit dhe për ngadalësimin e ngjarjeve të tilla si rritja e nivelit të detit. Marrëveshja e COP 19-ës përfshiu një grup të rëndësishëm të vendimeve mbi mënyrat për të ndihmuar vendet në zhvillim për të reduktuar emetimet e gazeve nga shpyllëzimet dhe degradimi i pyjeve, të cilat përbëjnë rreth një të pestën e të gjitha emetimeve të gjeneruara nga njeriu. Marrëveshja për REDD+ është mbështetur nga premtime për financime prej 280 milion dollarë nga SHBA, Norvegjia dhe Britania e Madhe. Ky instrument për ruajtjen e pyjeve dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre me qëllim stabilizimin e klimës, u emërua Korniza Varshavë për REDD. Vendet e zhvilluara, përfshirë Austrinë, Belgjikën, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Norvegjinë, Suedinë dhe Zvicrën kanë paguar ose kanë premtuar të paguajnë mbi 100 milion dollarë për Fondin e Përshtatjes, i cili tashmë ka filluar të financojë projektet kombëtare. Qeveritë përfunduan punën për Qendrën dhe Rrjetin e Teknologjisë së Klimës dhe në mënyrë që të mund t'u përgjigjet menjëherë kërkesave nga vendet në zhvillim për këshillë dhe ndihmë në transferimin e teknologjisë.

Në kuadrin juridiko-ndërkombëtar, Protokollin e Kiotos veçohet si marrëveshja themelore e politikave globale për ndryshimin klimatik. Si i tillë, meriton të shqyrtohet veças dhe më me hollësi.

Protokollin e Kiotos

Protokollin e Kiotos është një gur kilometrik në mbrojtjen ndërkombëtare të mjedisit. Ai detyroi ligjërisht vendet e zhvilluara të arrijnë pakësim të emetimeve të gazeve serrë. Kjo është realizuar nëpërmjet futjes të mekanizmave të tregut. Ndryshe nga qasja tradicionale sipas së cilës firmat penalizohen nëse thyejnë normat mjedisore, Protokollin e Kiotos krijoi një mekanizëm ku firmat janë të interesuara të reduktojnë emetimet e tyre në mënyrë që të përfitojnë. Sipas Protokollit, palët duhet (*individualisht ose së bashku*) të reduktojnë emetimet

e gazeve serrë me të paktën 5% nën nivelin e 1990-ës, përgjatë periudhës (së parë) të angazhimit 2008-2012 (Kyoto Protocol, 1997). Vendet e zhvilluara, thuhet shprehimisht, duhet të marrin rol drejtues teksa i adresohen ndryshimit të klimës.

Bazuar në termat *individualisht* ose *së bashku*, Protokollin krijoi tri mekanizma fleksibël: 'tregtia e emetimeve' (si një model individual) dhe 'zbatimi i përbashkët' e 'mekanizmi i zhvillimit të pastër' (si projekte të përbashkëta). Ndërsa vendet e zhvilluara (që kanë limit të përcaktuar emetimesh) mund të marrin pjesë në projektet e përbashkëta, vendet në zhvillim mund të marrin pjesë vetëm në mekanizmin e zhvillimit të pastër. Qëllimi i këtyre tre mekanizmave është që, ndërsa krijojnë një mundësi për pakësim të emetimeve të gazeve serrë, të maksimizojnë kost-efektivitetin e masave për lehtësimin e ndryshimit të klimës. Protokollin i Kiotos krijoi njësi për të matur sasisë e CO₂, e shprehur në ton, njësi të cilat emërtohen në bazë të mekanizmit fleksibël ku përdoren dhe janë të konvertueshme midis tyre. Këto njësi mund të tregtohen në 'tregtinë e emetimeve'.

Ekonomitë e vendeve që nuk bëjnë pjesë në Shtojcën 1 të Protokollit, nuk kanë kufizime në shkarkimin e gazeve serrë. Sidoqoftë, ato nxiten të zhvillojnë projekte për reduktimin e shkarkimeve të këtyre gazeve, duke prodhuar të ashtuquajturat "kredite karboni" ose "kuota karboni" (në varësi të projektit ose sektorit), që më pas mund të shiten tek blerësit që bëjnë pjesë në Shtojcën 1 (shih shtojcën 3 të temës), duke mbështetur në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm (DRFKSh, 2009). Kuotat e përfuara të karbonit mund t'u shiten blerësve të Shtojcës 1, duke inkurajuar zhvillim të qëndrueshëm dhe duke siguruar burime joshëse të të ardhurave për vendet që nuk bëjnë pjesë në Shtojcën 1. Veç kësaj, mekanizmat fleksibël i lejojnë vendet e Shtojcës 1 me industri efikase, me shkarkime të ulëta të gazeve serrë dhe me standarde të larta për mjedisin, të blejnë kuota karboni në tregun botëror, në vend që të ulin shkarkimet e gazeve serrë brenda vendit.

Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (MZhP) synon të ndihmojë vendet në zhvillim të arrijnë një zhvillim të qëndrueshëm në kuadër të ndryshimit të klimës, ndërkohë që vendet e përparuara e kanë më të lehtë të arrijnë objektivat e tyre. Ky mekanizëm mundëson vendet e përparuara të rrisin limitin e tyre të CO₂ (duke gjeneruar kredite karboni nga financimi i projekteve në vendet në zhvillim që çojnë në pakësim të emetimeve), të cilin vendet e industrializuara mund ta përdorin për të kompensuar emetimet e tyre. Futja e MZhP pa objektiva detyrues është me

përfitim për vendet në zhvillim dhe e bën atraktive pjesëmarrjen në mbrojtjen mjedisore të orientuar ndaj biznesit. Entitete publike dhe private mund të marrin pjesë në projektet e MZhP, por përgjegjësinë për detyrimet ndaj Protokollit gjithsesi i mban Shteti.

Projektet MZhP mund të përfshijnë zhvendosjen e komuniteteve dhe ndikime të tjera tek njeriu. Mohimi i pëlqimit të lirë dhe paraprak nga indigjenët dhe komunitete të tjera lokale, mund të përkeqësojë më tej këto efekte kundrejt të drejtave të tyre, tokave dhe territoreve. Prandaj, dimensionet e të drejtave të njeriut në masa të tilla lehtësuese janë një aspekt për t'u konsideruar me kujdes në hartimin e politikave dhe projekteve (CIEL 2011). Modalitetet dhe procedurat e tanishme të MZhP përmbajnë disa mjete që ndihmojnë në promovimin e një qasjeje me bazë të drejtat, të tilla si përfshirja e vlerësimeve mjedisore dhe hapësirave për pjesëmarrjen e publikut. Megjithatë, MZhP ende nuk e ka miratuar plotësisht një qasje të bazuar tek të drejtat, për të siguruar që operacionet e saj kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë respektimin për të drejtat e njeriut (*Ibid.*).

Konferenca e Kopenhagenit (shih më lart), për ndryshimin e klimës, e mbledhur në dhjetor 2009, e cila ka qenë një nga evenimentet me pjesëmarrjen më të madhe mbarëbotërore të organizuar ndonjëherë, çoi përpara negociatat për infrastrukturën e nevojshme për një bashkëpunim global efektiv për ndryshimin e klimës. Këto përparime përfshinë përmirësime në MZhP të protokollit të Kiotos.

Përgjigja e BE ndaj ndryshimit të klimës

Lufta kundër ndryshimit të klimës është një prioritet i lartë i BE-së. BE-ja ka një strategji për të luftuar ndryshimin e klimës, në kuadër të së cilës ka zhvilluar politika dhe po përgatit propozime të reja për t'ia drejtuar Parlamentit Evropian dhe vendeve anëtare. Po kështu, BE-ja është duke zhvilluar një strategji për t'iu përshtatur ndikimeve të ndryshimeve klimatike që nuk mund të parandalohen.

Shërbimet e Komisionit Evropian vijojnë të eksplorojnë mundësitë për përgatitjen e propozimeve për të ardhmen. Komisioni Evropian ka ndërmarrë shumë nisma lidhur me klimën që nga viti 1991, kur ai lëshoi strategjinë e parë të Komunitetit për të kufizuar emetimet e dioksidit të karbonit dhe për të përmirësuar eficiencën e energjisë, të tilla si një direktivë për të promovuar prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme,

angazhimet vullnetare nga prodhuesit e makinave për të reduktuar emetimet e CO₂ me 25 për qind dhe propozimet mbi tatimin e produkteve të energjisë.

Nismat që ka marrë BE për të ulur emetimet e saj klimatike përfshijnë¹⁷:

- përmirësimin e vazhdueshëm të eficiencës të energjisë në një rrjet të gjerë të pajisjeve dhe aparateve shtëpiake;
- vendosjen e detyrimeve për rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si era, dielli, uji dhe biomasa, si dhe të lëndëve djegëse të rinovueshme të transportit, të tilla si biokarburantet;
- mbështetjen e zhvillimit të teknologjive që realizojnë e kapjen e karbonit dhe magazinimin e tij (CCS), duke kufizuar sasinë e CO₂ të emetuar nga stacionet e energjisë dhe impiante të tjera të mëdha;
- miratimin e një game të gjerë të politikave dhe masave qysh me fillimin e Programit Evropian kundër Ndryshimeve Klimatike, në vitin 2000, duke përfshirë sistemin e tregtisë të emetimeve (*emission trading system*), i cili (sikurse është shpjeguar më lart) është mjet kyç i BE-së për të reduktuar emetimet e gazit nga industria kost-efektive;
- zhvillimin e një strategjie të përshtatjes, gjithëpërfshirëse të BE-së, që forcon rezistencën e Evropës ndaj ndryshimit të klimës.

Bashkimi Evropian ka qenë prej kohësh një forcë shtytëse në negociatat ndërkombëtare që çuan në finalizimin e traktatit të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) i vitit 1992 dhe Protokollit të Kiotos, i vitit 1997.

Protokollit i Kiotos u kërkonte 15 vendeve anëtarë të BE në atë kohë (BE-15) të ulnin emetimet e tyre së bashku, gjatë periudhës 2008-2012 (periudha e parë e angazhimit), me 8 për qind nën nivelet e vitit 1990. Monitorimi i emetimeve dhe parashikimet tregojnë se BE-15 e ka tejkaluar objektivin në masën 12.2%¹⁸.

Por, le të shohim rrugën që ka përshkuar BE-ja në realizimin e objektivit të saj. Më 2008, BE-ja ishte përgjegjëse për 11-12 % të emetimeve globale të gazeve serrë, ndërsa përbënte 8% të popullsisë së botës (EEA 2010). Emetimet vjetore të gazeve serrë në BE në vitin 2008 ishin në

¹⁷ *Ibid.*

¹⁸ Marrë më: http://ec.europa.eu/clima/policies/g-gas/index_en.htm, shkarkuar më 19 nëntor 2013

nivelet 10 ton CO₂-ekuivalent për person. Në terma krahasimorë, BE-ja ishte në vend të tretë pas Kinës dhe ShBA-së.

Sipas EEA (2010), midis viteve 1990 dhe 2007, emetimet për njësi të GDP ranë në BE-27 me më shumë se një të tretën. Ndërsa, emetimet e gazeve serrë në vitin 2010 ishin 15.5% më e ulët sesa në vitin 1990, ndërkohë që GDP e tyre në total ishte 41% më e lartë¹⁹.

Sidoqoftë, theksohet se këto vlera emetimi përfaqësojnë vetëm çfarë është emetuar brenda territorit të BE-së, përlllogaritur sipas udhëzimeve të miratuara ndërkombëtarisht nën KKKBNK. Kontributi i Evropës ndaj emetimeve globale mund të ishte më i madh nëse do të merreshin parasysh importet Evropiane të mallrave të shërbimeve, me 'karbon të mbartur'.

Tendencat e emetimeve në BE midis viteve 1990 dhe 2008 janë dominuar nga dy emetuesit më të mëdhenj: Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, të cilët kanë meritën për pakësimin e më shumë se gjysmës së totalit të emetimeve. Projektme nga Komisioni Evropian tregojnë se emetimet në BE në vitin 2020 do të jenë 14% më poshtë sesa nivelet e 1990-ës. Ndërsa, nëse do zbatohet plotësisht paketa për klimën dhe energjinë, BE-ja pritet ta arrijë objektivin për pakësim me 20% (EEA 2010).

Megjithatë, është e qartë se veprimi si nga Shtetet Anëtare, ashtu dhe nga Komuniteti Evropian duhet të forcohet në mënyrë që BE të ketë sukses në pakësimin e emetimeve të saj të gazit siç kërkohet nga protokollin e Kiotos²⁰.

Dhjetë nga dymbëdhjetë vendet të cilat më pas u bashkuan me BE në 2004 dhe 2007 kanë gjithashtu angazhimet e tyre ndaj Kiotos, në bazë të të cilave atyre u kërkohet individualisht të reduktojnë emetimet e tyre me 6 ose 8%. Këto shtete anëtare janë gjithashtu në rrugë të mbarë për të përmbushur objektivat e tyre.

BE-ja ka programin e saj për ndryshimin e Klimës - *European Climate Change Program* (ECCP), i cili mbështetet në Programin e Veprimit Mjedisor dhe Strategjinë e BE-së për Zhvillim të Qëndrueshëm (European Commission 2001a dhe 2001b). Ky program u shpall në përgjigje të Protokollit të Kiotos, në vitin 2000, (Programi i Parë - ECCP I, vitet 2000-2004). Qëllimi kryesor i ECCP I ishte identifikimi dhe zhvillimi i elementëve të nevojshëm të

¹⁹ Marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/clima/>, shkarkuar më 9 korrik 2012

strategjisë evropiane në përgjigje të Protokollit të Kiotos. Faza e dytë e ECCP I (2002-2003) e përqendroi vëmendjen tek bujqësia dhe pylltaria, në kontekstin “*sink*”. Gjithashtu u zhvilluan më tej veprime konkrete për çështje të identifikuar që në fazën e parë të ECCP I, lidhur me potencialin për pakësim të emetimeve dhe kost-efektivitetin e tyre (European Commission 2000a).

Programi i dytë Evropian për Ndryshimin e Klimës (ECCP II) filloi në vitin 2005. Sikundër ECCP-ja e parë, ai ishte një program që përfshinte grupe të tilla interesi si Shtetet Anëtare, industrinë, OJQ-të dhe akademikët. Grupet e punës, pjesë e këtij programi do të trajtonin çështje si: kapja e CO₂ dhe ruajtja gjeologjike, ndikimi i ndryshimit të klimës dhe përshtatja, aviacioni, CO₂ dhe e makinat²¹.

Sipas Cerda dhe Labandeira (2010), ECCP II u parapri nga Komunikimi “*Të fitosh betejën ndaj ndryshimit të klimës*”. Ky program shpalli iniciativa në pesë fusha:

- Rishikimin e EU ETS
- Politikat në aviacion
- Politikat në sektorin e makinave
- Eksplorimi i mundësive për kapjen e karbonit
- Iniciativat për përshtatje

Bashkimi Evropian duke qenë prej kohësh i angazhuar në përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar ndryshimin e klimës, ndjeu detyrimin për t’u bërë shembull, përmes një politikë-bërjeje të fuqishme në shtëpi. Pavarësisht se nuk ka ndonjë legjislacion kuadër në nivel Bashkimi Evropian në fushën e bashkëpunimit për zhvillim ndërkombëtar në fushën në fjalë, ka pjesëmarrje aktive të KE-së dhe Shteteve Anëtare në bashkëpunimin për zhvillim ndërkombëtar (Kulauzov 2007). Gjithashtu në BE, në nivel të shteteve anëtare ekzistojnë strategji dypalëshe dhe shumëpalëshe të zhvillimit të asistencës zyrtare, të cilat luajnë rol të rëndësishëm, të tillë si Programi për Zhvillimin e Veprimit të Mesdheut.

Në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim ndërkombëtar, në vitin 2004, KE ngriti një strukturë plani dhe veprimi për ndryshimin e klimës dhe bashkëpunimin për zhvillim (Plani i veprimit i BE që shoqëron strategjinë e BE-së për ndryshimin e klimës në kontekstin e bashkëpunimit

²⁰ *Ibid.*

për zhvillim). Qëllimi kryesor i strategjisë dhe planit të veprimit ishte të ndihmonte vendet anëtare të arrinin sfidat e vendosura nga ndryshimi i klimës, veçanërisht në vështrimin e KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos. Strategjia identifikon disa prioritete të cilat përkthehen në veprime, si vijon: a) ngritja e profilit të politikave kundër ndryshimit të klimës; b) mbështetje për përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës dhe zhvillimit të kapaciteteve; c) mbështetje për pakësimin e gazeve serrë.

Më 2007, liderët evropianë miratuan një qasje të integruar ndaj politikave të klimës dhe të energjisë dhe u zotuan ta transformonin ekonominë e Evropës në atë të një efience të lartë energjie dhe me prodhim të ulët karboni. Vendet anëtare u zotuan gjithashtu të pakësonin emetimet e tyre së bashku, me të paktën 20% të niveleve të vitit 1990, brenda vitit 2020. Për të zbatuar këtë premtim, po zbatohet një paketë legjislacioni detyrues. Ky plan përfshin mënyrat sesi do të ndahen kostot, si dhe parashikon koncesione ndaj industrisë së rëndë dhe vendeve të Evropës Lindore, ekonomia e të cilave pritet të ndikohet nga detyrimi për pakësim i gazeve serrë²².




Figura 4: Burimet e gazeve serrë në Evropë, sipas sektorëve të ekonomisë,
Burimi: Eurostat. Marrë në korrik 2012, në http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index

BE-ja ka ofruar gjithashtu të rrisë pakësimin e emetimeve të saj në 30 për qind deri në vitin 2020, me kusht që vendet e tjera të mëdha emetuese në botën e zhvilluar dhe në zhvillim të angazhohen për të bërë pjesën e tyre, në bazë të një marrëveshjeje për të ardhmen e klimës

²¹ Ibid.

globale. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2013, pasi përfundoi periudha e parë e angazhimit për Protokollin të Kiotos.

Komisioni Evropian dhe Shtetet Anëtare po zbatojnë Planin e Veprimit së bashku dhe në një linjë me programet e tyre të zhvillimit. Komisioni do të përqendrohet në *zbatimin* e planit të veprimit të BE për ndryshimin e klimës dhe zhvillimin. Por edhe *përshtatja* ndaj ndikimeve negative të ndryshimit të klimës, veçanërisht nga ana e vendeve më pak të zhvilluara, do të jetë në qendër të vëmendjes së tij. Hapi i parë kundrejt një strategjie përshtatjeje për të pakësuar brishtësinë ndaj ndikimit të ndryshimit të klimës, në nivel evropian, ka qenë letra e bardhë e BE-së mbi përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës (e vitit 2009). Përveç kuadrit për ndryshimin e klimës, BE-ja ka ngritur edhe instrumente të tjerë që u adresohen çështjeve mjedisore, duke realizuar integrimin sektorial të tij, të tilla si: Programi i 6-të i veprimit mjedisor, Procesi i Kardifit dhe Strategjia e Lisbonës.

Ndryshimi i klimës është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet njerëzimi. Bashkimi Evropian është duke punuar për të promovuar një përgjegjësi globale ambicioze ndaj ndryshimeve klimatike, përmes OKB-së, forumeve të tjera ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet marrëdhënieve të saj bilaterale me vendet e treta, si të zhvilluara, ashtu dhe në zhvillim. Si ofruesja më e madhe në botë e ndihmës zyrtare për zhvillim, përgjegjëse për pothuajse 60 për qind të kësaj ndihme globale në vitin 2010, BE-ja është kontribuuesi më i madh i financimeve për klimën, që ndihmojnë vendet në zhvillim të përshtaten me ndryshimin e klimës dhe zhvillojnë një rrugë të emetimeve të ulëta²³.

Bashkimi Evropian për ndryshimin e klimës si çështje e sigurisë ndërkombëtare

Me fillimin e shekullit të ri, ndryshimi i klimës është adresuar gjithnjë e më shumë nga politikbërësit dhe analistët si një rrezik dhe shqetësim. Si i tillë, ndryshimi i klimës ka vijuar të diskutohet intensivisht si çështje ndërkombëtare, kombëtare dhe e sigurisë, duke theksuar kërcënimet e shumta që kjo çështje paraqet për konceptet e sigurisë të sektorëve të ndryshëm jetikë për njeriun.

²² Marrë nga <http://www.ens-newswire.com/ens/dec2008/2008-12-12-02.asp>, shkarkuar më 17 korrik 2012

²³ Marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/clima/>, shkarkuar më 9 korrik 2012.

Në vitin 2007, krahas zhvillimeve të tjera në Botë, që janë përmendur më lart, u botua gjatë G-7-s dhe Presidencës gjermane të BE-së, raporti i WBGU (Këshillit Gjerman Konsultativ për Ndryshimet Klimatike) mbi rrezikun e sigurisë së Ndryshimeve Klimatike, (WBGU 2008). Në qershor të po atij viti, Presidenca gjermane e BE-së, i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe Përfaqësuesit të Lartë të Punëve të Jashtme, Javier Solanës, dhe Komisionit Evropian, të përgatisnin një letër të përbashkët mbi ndryshimet klimatike dhe sigurinë ndërkombëtare, e cila u dorëzua në mars 2008. Në këtë raport, ku flitet mbi lidhjen e mundshme ndërmjet ndryshimit të klimës dhe sigurisë, ndryshimi i klimës shihet si një shumëzues kërcënimesh që përkeqëson tensionet dhe paqëndrueshmërinë, kryesisht të shteteve dhe rajoneve që janë tashmë të brishta dhe të prirura ndaj konflikteve.

Këto kërcënime përfshijnë "rreziqe politike dhe të sigurisë që ndikojnë drejtpërdrejt interesat evropiane"²⁴. Raporti më tej pohon se "në përputhje me konceptin e sigurisë njerëzore, është e qartë se shumë çështje që lidhen me ndikimin e ndryshimeve klimatike në sigurinë ndërkombëtare janë të ndërlidhura dhe kërkojnë përgjigje gjithëpërfshirëse të politikave." Ai fokusohet në ndikimin e ndryshimeve klimatike në sigurinë ndërkombëtare dhe konsideron ndikimin e këtyre pasojave të sigurisë ndërkombëtare në sigurinë e vetë Evropës. Në raport konstatohet se është në interes të vetë Evropës t'i adresohet implikimeve të sigurisë të ndryshimit të klimës me një sërë masash, në nivel BE-je, në nivel të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe duke u mbështetur reciprokisht.

Çështja e ndikimit të ndryshimeve klimatike në sigurinë globale, u bë pjesë edhe e letrës zbatuese të Strategjisë së Evropiane të Sigurisë, të dhjetorit të vitit 2009. Po në vitin 2009, Komisioni Evropian nisi një proces udhërrëfyes për të analizuar lidhjet midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë ndërkombëtare me më shumë detaje. Letra e BE-së rendit shtatë kërcënimet më të mëdha të sigurisë ndërkombëtare që vijnë nga ndryshimi i klimës, ndër të cilat mund të citojmë: konflikti mbi burimet, dëmi ekonomik dhe rreziku për qytetet bregdetare dhe infrastrukturat kritike, migracioni për shkak të mjedisit, tensioni për furnizimin me energji dhe presioni mbi qeverisjen ndërkombëtare. Aty jepen disa shembuj gjeografikë ku këto kërcënime mund të materializohen: a) Afrika, b) Lindja e Mesme; c) Azia Jugore; d) Azia Qendrore; e) Amerika Latine dhe Karaibet, dhe f) Arktiku.

²⁴ Climate Change and International Security, Paper from the High Representative and the European Commission to the European Council, 2008, shkarkuar në maj 2012 nga: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/reports/99387.pdf

Bazuar në këtë analizë, politika e BE-së arriti në përfundimin se roli aktiv i BE-së në negociatat ndërkombëtare për ndryshimet klimatike është jetik dhe duhet të vazhdojë. BE-ja ka ndërmarrë rol përparimtar në negociatat ndërkombëtare, me vendimet e saj largpamëse lidhur me politikat e brendshme për klimën dhe energjinë. Rekomandimet e letrës zbatuese u propozuan të plotësohen me studime të mëtejshme dhe të ndiqen nga plane veprimi koherente, me qëllim që t'u adresohen dimensioneve të ndryshme të çështjeve specifike, për të trajtuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në sigurinë ndërkombëtare në një mënyrë të kuptueshme dhe efektive. Në fund, u arrit në konkluzionin se shqyrtimi i ardhshëm i zbatimit të Strategjisë Evropiane të Sigurisë duhet të marrë parasysh dimensionin e sigurisë të ndryshimit të klimës (Brauch, 2010).

Raporti mbi ndryshimet klimatike dhe sigurinë ndërkombëtare jep edhe rekomandime për veprime të mundshme në funksion të përgjigjes të hershme ndaj fatkeqësive dhe konflikteve që mund të përfshijnë rritjen e kapaciteteve në nivel BE-je dhe të shteteve anëtare të BE-së për analiza, kërkime, monitorime dhe paralajmërim të hershëm, në përgjigje të rreziqeve të sigurisë që vijnë nga ndryshimi i klimës. Po kështu, sugjerohet një komisionim i mëtejshëm i punës për të parë, rajon pas rajoni, më me hollësi, se cilat kanë të ngjarë të jenë implikimet e sigurisë dhe si ata do të ndikojnë në interesat e BE-së²⁵. Në nivelin ndërkombëtar, BE-ja duhet të përdorë rolin e saj udhëheqës për të promovuar sigurinë e klimës globale, i cili mund të bëhet një shembull pozitiv për përmirësimin dhe reformimin e qeverisjes globale. Midis veprimeve të mundshme në raport renditen:

- rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar për zbulimin dhe monitorimin e kërcënimeve të sigurisë në lidhje me ndryshimet klimatike, dhe për gatishmërinë, parandalimin, apo zbutjen e pasojave të tyre;
- përqendrimi i vëmendjes në rreziqet e sigurisë që kanë të bëjnë me ndryshimin e klimës në arenën shumëpalëshe, në veçanti në kuadër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, G-8, si dhe organet e specializuara të OKB-së;
- nxitja e zhvillimit të skenarëve rajonale të sigurisë për nivele të ndryshme të ndryshimit të klimës dhe implikimet e tyre për sigurinë ndërkombëtare;

²⁵ Climate Change and International Security, Paper from the High Representative and the European Commission to the European Council, 2008, shkarkuar nga: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/reports/99387.pdf, 14 maj 2012

- duke marrë parasysh stresin migrator shtesë të shkaktuar nga mjedisi, zhvillimi i mëtejshëm i një politike migratore evropiane, në bashkëpunim me të gjitha organet relevante ndërkombëtare.

Raporti bën thirrje për ringjallje dhe forcim të bashkëpunimit të BE-së dhe instrumenteve të dialogut politik, duke i dhënë më shumë vëmendje ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi sigurinë. Kjo mund të çojë në prioritarizim më të madh dhe mbështetje të zgjeruar për zbatimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës, menaxhimin më të mirë të burimeve natyrore, dhe bashkëpunimin ndërkufitar mjedisor në ujë dhe tokë, si dhe forcimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e krizës.

Nga sa më lart, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë debatin konceptual dhe politik të dhënies së ndryshimit të klimës aspektin e sigurisë, ndërsa Këshilli Evropian është bërë një aktor i madh në përkthimin e mesazheve shkencore të këtij aspekti në propozime konkrete politike që do të çojnë në veprime në vitet që vijnë.

Në veçanti, Britania e Madhe dhe Gjermania janë bërë promotorë të aspektit të sigurisë që ka lidhje me ndryshimin e klimës. Kështu, sekretari i jashtëm britanik David Miliband dhe ministri i jashtëm gjerman Frank-Walter Steinmeier argumentuan në një artikull të përbashkët më 13 mars 2008²⁶, se ndryshimi i klimës "kërcënon prosperitetin tonë dhe mirëqenien, jo vetëm në Evropë, por më gjerë. Për më tepër, ai do të riformulojë gjeopolitikën e botës në të cilën jetojmë, me pasoja të rëndësishme për paqen dhe sigurinë." Ata u bënë iniciatorë të tri nismave kryesore brenda BE-së dhe globalisht, që kanë të bëjnë me intensifikimin e përpjekjeve për të përballuar rreziqet e reja të sigurisë të shkaktuara nga ndryshimi i klimës, përgjigjen ndaj një numri në rritje fatkeqësive globale natyrore, të tilla si stuhitë, përmbytjet, dhe në ardhmen thatësira, si dhe marrjen parasysh të faktit se si ndryshimi klimatik do të ndikojë kontekstin strategjik të politikave evropiane të marrëdhënieve më jashtë dhe të sigurisë në vitet që vijnë.

Edhe më parë, në Strategjinë Evropiane të Sigurimit të BE-së – “Një Evropë e sigurt në një botë më të mirë”, miratuar në dhjetor 2003, pa përmendur termin ‘ndryshim klime’, kanë qenë identifikuar tashmë implikimet e sigurisë të ndryshimit të klimës. Pesë vjet më vonë kjo

çështje mori prioritete të reja. Fatkeqësitë natyrore, degradimi mjedisor dhe konkurrenca për burime kanë përkeqësuar konfliktet, sidomos në situata të varfërisë dhe rritjes së popullsisë, me pasoja humanitare, shëndetësore, politike dhe sigurie, si dhe migrim më të madh. Ndryshimi i klimës mund të çojë në mosmarrëveshje mbi rrugët tregtare, zonat detare dhe burimet e pashfrytëzuara. BE-ja ka punuar shumë për parandalimin e konfliktit dhe menaxhimin e krizës, por në raportin e Solanës, të dhjetorit 2008²⁷ theksohet se duhet të përmirësohen aftësitë për analiza dhe paralajmërim të hershëm. Që ta arrijë këtë, BE-ja duhet të përshpejtojë punën e saj me shumicën e vendeve në rrezik, duke nisur nga forcimi i aftësisë së tyre për të bashkëpunuar. Po kështu në raportin e Solanës, bashkëpunimi ndërkombëtar, me OKB dhe organizatat rajonale, konsiderohet të jetë thelbësor.

Komisioni Evropian, ka kryer një studim të sondazheve të realizuar mbi implikimet rajonale të sigurisë nga ndryshimi i klimës, si pjesë e procesit udhërrëfyes të BE-së mbi ndryshimin e klimës dhe sigurinë ndërkombëtare, i cili përmbledh rekomandimet e shumta në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit, kërkimet e mëtejshme, dialogun midis palëve të interesuara, rritjen e kapaciteteve, prioritetet e politikave, rajonet prioritare dhe zhvillimin e sistemit ndërkombëtar, dhe ai sugjeron hulumtim shtesë në Azinë Jug-lindore, Oqeanin Indian dhe shtetet e Ishujve të Paqësorit në Azinë jug-perëndimore dhe Amerikën e Mesme (Brauch, 2010). Disa skenarë rajonalë të fokusuar në nën-rajonet e Amerikës Qendrore, në Azisë Jugperëndimore dhe Juglindore, si dhe në rajonin indian të Paqësorit janë të përfunduar deri në dhjetor 2009. Megjithatë, sipas studimit mendohet se rajoni që do të preket më shumë gjatë këtij shekulli nga ndikimet fizike dhe shoqërore të ndryshimeve klimatike dhe se ka shumë të ngjarë gjithashtu të paraqesë rreziqe dhe shqetësime të sigurisë, do të jetë rajoni i Mesdheut dhe më në veçanti vendet MENA (Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore). Tek politikat e BE-së për aspektin e sigurisë të ndryshimit të klimës në rajonin e Mesdheut, do të përqendrohem në kapitullin e Mesdheut.

²⁶ “Europe has to face up to the security policy impact of climate change” – joint contribution by Frank-Walter Steinmeier and David Miliband, 2008, shkarkuar më 14 maj 2012 në <http://www.auswaertiges-amt.de/EN/Infoservice/Presse/Interview/2008/080313-klimasicherheit.html>

²⁷ “Climate Change and Security: Follow-up recommendations” by EUHR Solana, 2008, shkarkuar më 14 maj 2012 në http://www.europa-eu-un.org/articles/en/article_8382_en.htm

Legjislacioni mjedisor i BE lidhur me Protokollin e Kiotos

Ndonëse BE-ja është përgjegjëse vetëm për më pak se 12% të emetimit global të gazeve serrë, ajo është zotuar të marrë rol udhëheqës në këtë fushë të mbrojtjes së mjedisit. Sipas Soros-it (2008), arsyeja prapa kësaj ambicieje është se roli politik që Evropa ka mbajtur tradicionalisht në skenën politike botërore, është dobësuar vitet e fundit. Në kushtet e krizës së sotme financiare, investimi ‘i gjelbër’ mund të bëhet promotor i të ardhmes së biznesit në Evropë. Ndërsa iniciativat në fushën e mbrojtjes së mjedisit, mund ta ndihmojnë BE-në të krijojnë avantazh teknik dhe teknologjik, krahasuar me organizma të tjerë politikë. Në këtë kuadër, angazhimet ndërkombëtare për pakësimin e karbonit, janë ndër më kryesoret për të.

Protokolli i Kiotos është aprovuar me Vendimin e Këshillit Evropian 2002/358/EC, më 25 prill 2002. Ndërsa angazhimi mesatar i Kiotos ishte për pakësim 5%, 15 vendet anëtare të BE-së u zotuan t’i pakësonin emetimet e CO₂ me 8%. Sot ky angazhim përfshin edhe 12 vende të reja anëtare të BE (Malta dhe Qiproja nuk kanë objektiva kundrejt Protokollit të Kiotos).

Vendimi 2002/358 përmban të ashtuquajturën ‘marrëveshje për ndarje të barrës’, e cila do të thotë se Vendet Anëtare *së bashku* duhet të arrijnë objektivin prej 8%. Pra disa vende anëtare lejohen t’i rrisin emetimet, ndërsa të tjera t’i ulin ato. Arritja e objektivit të Kiotos do të bëhet duke ndërmarrë veprime dhe përgjegjësi të përbashkëta. Për këtë qëllim u krijua Skema e Tregtisë së Emetimeve (shih më lart).

Ndryshimi i klimës nuk është trajtuar drejtpërdrejt si çështje në Traktatin e themelimit BE-së. Baza ligjore e përdorur për ndryshimin e klimës varet nga natyra e masës. Kur bëhet fjalë për bujqësinë, zbatohet Neni 37, për tregtinë, Neni 133, etj., (Kramer, 2003).

Në vitin 2003, bazuar në planin strategjik të ECCP, Këshilli miratoi Direktivën që mundësonte krijimin e skemës së tregtisë së karbonit për mbarë BE-në, në nivel firme (Direktiva 2003/87/EC - EU ETS). Ky është instrumenti më i rëndësishëm për BE-në kundrejt objektivit madhor të Kiotos që është pakësimi i ngrohjes klimatike. Direktiva EU ETS bazohet ligjërisht në Nenin 175 të Traktatit të BE-së. Zbatimi i kësaj direktive filloi më 1 janar 2005 dhe periudha e zbatimit ndahet në dy pjesë: periudha e parë - 1 janar 2005-31 dhjetor 2007 dhe periudha e dytë - 1 janar 2008-31 dhjetor 2012. Periudha e tretë e EU ETS është më e gjatë

(2013-2020). Direktiva përcakton një skemë për tregtimin e lejes së emetimeve të gazeve serrë brenda BE-së, me qëllim nxitjen e pakësimit të tyre në një mënyrë eficiente dhe efektive.

Një direktivë nga natyra është i ashtuquajtur ‘ligj i butë’, duke përcaktuar qëllimet që BE-ja synon të realizojë, por duke lënë edhe një lloj lirie për vendet anëtare për të gjetur mënyrat dhe rrugët sesi t’i zbatojë këto qëllime në legjislacionin kombëtar. Ndërsa përdorimi i një rregulloreje si instrument ligjor në fushën e emetimeve, do të krijonte më shumë siguri dhe do të kishte zbatueshmëri të menjëhershme, pa nevojën e ndonjë akti nga ana e Vendeve Anëtare, arsyeja e një zgjedhjeje të tillë, qëndron në veçantitë e sistemeve juridike kombëtare dhe në nevojën e ruajtjes së parimit të subsidiaritetit. Në këtë mënyrë, Vendet Anëtare kanë bërë zgjidhjet e tyre në legjislacionin kombëtar, në mënyrë të veçantë për çështjen e ‘lejimeve’ (allowances) – autorizimit për të emetuar sasi të caktuar të CO₂. Ekzistojnë disa mundësi për të përcaktuar natyrën juridike të ‘lejimeve’. Ata mund të trajtohen si mallra, instrumente financiare, autorizim administrativ, ose siguri (Bourbon-Seclet 2008). Ndërkaq, Direktiva mbi Tregun e Instrumenteve Financiarë, rendit edhe lejimet e emetimeve si instrumente financiarë (2004/39/EC).

Në Direktivën 2003/87/EC-EU ETS parashtrohet synimi i Komunitetit për të reduktuar emetimet e gazeve serrë në masën 8% deri më 2012 dhe rreth 70% në terma afatgjatë, krahasuar me nivelet e vitit 1990. Vlera prej 70% shpreh një ambicie shumë të madhe, si dhe faktin se BE-ja e konsideron si serioze çështjen e ngrohjes globale. Kjo ambicie, ndonëse në preambul, u sugjeron Vendeve Anëtare një zbatim të Direktivës nën dritën e arritjes së objektivit afatgjatë.

Direktiva mbulon rreth 12 mijë instalime (firma/ kompani që emetojnë gaze serrë) dhe nuk mbulon të gjithë burimet e emetimeve apo të gjithë gazet serrë. Periudha e parë mbulon vetëm CO₂, ndërsa duke nisur me periudhën e dytë, fillon e zgjerohet gama e gazeve serrë. Gjithashtu Direktiva mbulon katër sektorë prodhues: 1. Sektori i energjisë; 2. Sektori i përpunimit të mineraleve; 3. Sektori i prodhimit të metaleve; dhe 4. Sektori i prodhimit të letres. Ndërkaq, Neni 30, lejon zgjerimin e linjës së aktiviteteve të mbuluara.

Më lart u fol për programet e BE-së për ndryshimet klimatike (ECCP). Sipas Cerda E. dhe X. Labandeira (2010), ECCP I dhe II u ndoqën nga një sërë direktivash, vendimesh dhe rregulloresh. Disa prej tyre lidheshin drejtpërdrejt me emetimet e gazeve serrë, ndërsa të tjera

ishin më të orientuara drejt sektorëve, apo dizajnit dhe etiketimit ekologjik që kishte të bënte me produkte specifike. Në tabelat më poshtë bëhet një përmbledhje e akteve juridike të BE-së lidhur me gazet serrë [Burimi Cerda E. dhe X. Labandeira (2010), me modifikime].

Tabela 1: Iniciativat për dizajnin dhe etiketimin ekologjik

Direktiva për dizajnimin ekologjik të produkteve të energjisë	Direktiva 2209/125/EC
Direktiva për eficiencën e energjisë në përdorim dhe shërbimet energjetike	Direktiva 2006/32/EC
Direktiva e etiketimit	Direktiva 2003/66/EC
Direktiva e ndërtimit	Direktiva 2002/91/EC

Tabela 2: Iniciativat për sektorët me energji intensive, tregjet e energjisë dhe prodhimin e energjisë

Vendimi për sektorët e ekspozuar ndaj rrjedhjes së karbonit	Direktiva 2010/2/EU
Direktiva e rishikuar EU ETS	Direktiva 2009/29/EU
Direktiva për burimet e energjisë së rinovueshme	Direktiva 2009/28/EC
Direktiva IPPC	Direktiva 2008/1/EC
Direktiva mbi akumulimin gjeologjik të CO ₂	Direktiva 2009/31/EC
Direktiva e gazit F	Direktiva 2006/842/EC
Direktiva e bashkëgjenerimit	Direktiva 2004/8/EC
Direktiva EU ETS	Direktiva 2003/87/EC
Direktiva e taksimit të energjisë	Direktiva 2003/96/EC
Direktivave e impianteve të mëdha me djegie	Direktiva 2001/80/EC
Direktiva mbi tavanet e emetimeve kombëtare	Direktiva 2001/81/EC
Direktiva kuadër e ujit	Direktiva 2000/60/EC

Tabela 3: Transporti dhe sektorët e tjerë jo-tregtarë

Vendimi për ndarjen e përpjekjeve për gazet serrë	Vendimi 406/2009/EC
Direktiva për cilësinë e karburantit	Direktiva 2009/30/EC
Rregullorja për CO ₂ nga makinat	Rregullorja Nr 443/2009
Aviacioni	Direktiva 2008/101/EC
Implementimi i shtojcës VI të Konventës MARPOL	Amendimet të 2008, rishikimi i shtojcës VI
Rregullorja EURO 5 dhe 6	Rregullorja Nr 715/2007
Direktiva për mjetet motorike	Direktiva 2006/40/EC
Direktiva për biokarburantët	Direktiva 2003/30/EC
Direktiva për lendfillet	Direktiva 99/31/EC

Çështjet kryesore mjedisore që ndërlidhen me ndryshimin e klimës dhe përgjigja institucionale ndaj tyre

Toka

Toka është një burim jetik për ekosistemet, duke luajtur një rol thelbësor në shërbime të tilla si pastrimi i ujit dhe prodhimi i ushqimit. Ajo ka gjithashtu një potencial të madh për të larguar nga atmosfera gazet që ndikojnë në ndryshimin e klimës.

Degradimi i tokës i cili nënkupton pakësim ose humbje të produktivitetit të tokave të thata, është i lidhur ngushtë me ndryshimin e klimës. Thatësira është një dukuri që lidhet me shkretëtirëzimin, ndërsa i fundit vjen nga ndryshimet natyrore të klimës, por është rënduar gjithashtu nga faktori njerëzor (ngrohja globale). Sipas Atlasit të Botës të vitit 1997 (UNEP), rreth 50% e sipërfaqes totale të tokës bie në kategorinë e tokës së thatë. UNCCD, Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin, e sheh shkretëtirëzimin si një kërcënim ndaj sigurisë njerëzore. Sipas Kofi Ananit (ish Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara): “thatësitat dhe shkretëtirëzimi kërcënojnë jetesën e mbi 1 miliard njerëzve në më shumë se 110 vende nëpër botë”²⁸

Fillimisht, shkretëtirëzimi u pranua si një problem madhor ekonomik, social dhe mjedisor, ndaj të cilit u adaptua një plan veprimi për ta luftuar atë (1977). Çështja e shkretëtirëzimit u ngrit fillimisht si çështje kombëtare dhe rajonale dhe gradualisht u zhvillua në formën e një konvente botërore. Qysh nga 1992, procesi i Rios (Samiti Botëror i Rio de Zhaneiros) solli ekzistencën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin (UNCCD). Kjo konventë u adaptua më 1994 dhe hyri në fuqi më 1996. Aktualisht, pjesë e konventës janë 190 vende dhe Komuniteti Evropian.

Ndryshe nga ndryshimi i klimës për shkak të ndikimit njerëzor që është një dukuri që nisi me Revolucionin Industrial, shkretëtirëzimi është një dukuri me histori të vjetër. Përsa i takon shtrirjes gjeografike, shkretëtirëzimi vepron në nënrajone dhe rajone gjeografike. Një rajon i tillë është rajoni i Mesdheut.

²⁸ Marrë nga

http://www.cyen.org/innovaeditor/assets/Interlinkages_between_drought,_desertification_and_water.pdf,
më 12 gusht 2012

Ekziston mundësia teorike që shkretëtirëzimi në një vend të ndikojë modelet klimatike rajonale (Kulauzov, 2007). Ndikime të tjera jo të drejtpërdrejta të shkretëtirëzimit janë problemet sociale, ekonomike dhe politike që ai sjell në një vend dhe në rajon. Tokat e thata kanë produktivitet më të ulët dhe si të tilla janë një faktor i varfërisë. Problemet ekonomike nëpër tokat e thata shkaktojnë flukse refugjatësh nëpër vendet fqinjë apo të rajonit, të cilat sjellin probleme politike, sociale dhe të sigurisë.

Ndryshimi i klimës dhe shkretëtirëzimi kanë një dimension sigurie që lidhet me sigurinë e bujqësisë dhe ushqimit, menaxhimin e ujërave, migrimin ndërkombëtar, sigurinë e kufijve dhe krizat e konfliktet (*Ibid.*). Këto probleme të shkaktuara direkt dhe indirekt nga ndryshimi i klimës në rajonin ku Shqipëria bën pjesë, mund të trajtohen nëpërmjet asistencës që vende të zhvilluara u japin vendeve në zhvillim, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim.

Politikat e BE-së për tokën

Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA) së bashku me Qendrën e Përbashkët të Kërkimeve të Komisionit Evropian ka përgatitur më 2012 një raport gjithëpërfshirës shkencor lidhur me gjendjen e tokës në Evropë, duke theksuar nevojën për të mbrojtur dhe për të ruajtur tokën në një mënyrë të koordinuar në të gjithë Bashkimin Evropian²⁹.

Sipas EEA (2010), Agjencia Evropiane e Mjedisit ka raportuar në vlerësimin e saj tematik se tokat e Evropës janë subjekt i erozionit dhe rrëshqitjeve të dheut, të cilat kanë pasoja të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore. Kështu, erozioni i tokës nga uji prek rreth 16% të sipërfaqes së tokës në Evropë. Kjo ndodh kryesisht si rezultat i menaxhimit të dobët të tokës dhe praktikave të tilla si shpyllëzimit, aktivitetet ndërtimore dhe zjarret pyjore.

Një nga kërcënimet më të mëdha për ndryshimin e klimës në Evropë, të lidhura me tokën, përveç thatësisë janë shpyllëzimet. Shpyllëzimi është përgjegjës për rreth një të katërtën e shkarkimeve të gazeve serrë, pasi sikurse dihet, pyjet e shëndetshëm kanë kapacitet të largojnë

²⁹ Marrë nga <http://www.eea.europa.eu/highlights/soil-protection-critical-to-safeguard>, më 17 korrik 2012

dioksidin e karbonit nga atmosfera, duke lehtësuar ndryshimin e klimës, si dhe duke ndikuar në ciklet e ujit dhe efektin pasqyrues të sipërfaqes së tokës.

Në kuadër të Programit të Ndryshimeve Klimatike Evropiane (ECCP), në vitin 2002, ka pasur një Grup Punues për pyjet, i cili ka prodhuar një raport që përshkruan masat më të mundshme për të rritur kontributin e pyjeve në lehtësimin e ndryshimit të klimës. Gjatë fazës e dytë të ECCP II, pritet të fillojnë këto veprime lidhur me pyjet³⁰.

BE-ja është duke kanalizuar përpjekjet e tij për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës në mbarë botën, para së gjithash duke nxitur dialogun dhe ndihmën dypalëshe për bashkëpunimin për zhvillim përmes UNCCD. Në këtë mënyrë, BE-ja vlerëson rëndësinë e UNCCD për zbutjen e varfërisë dhe arritjen e objektivave të Kombeve të Bashkuara për zhvillim gjatë Mijëvjeçarit. Komuniteti Evropian ka kontribuar në zbatimin e UNCCD në Azi, Amerikën Latine dhe Karaibe, në Evropën qendrore dhe lindore, në rajonin e Mesdheut dhe Lindjes së Mesme, në aspektin e mobilizimit të fondeve. Midis viteve 2001 dhe 2005, KE ka dhënë rreth 350 miliard € për rreth 128 projekte që merren me çështje të mbuluara nga UNCCD në rajonet e përmendura³¹. Ky financim është siguruar përmes burimeve të ndryshme (gjeografike dhe tematike).

UNCCD i vë theks të fortë proceseve pjesëmarrëse dhe krijimit të një mjedisi të përshtatshëm, i cili rrit veprimin në nivel lokal, ndaj ndërveprimet e BE-së me organizatat e shoqërisë civile mbi çështjet e lidhura me shkretëtirëzimin janë tashmë sistematike dhe të rregullta. Platforma Evropiane për Shkretëtirëzimin (eniD) është organizata ombrellë e OJQ-ve evropiane të përfshira në menaxhimin e qëndrueshëm të tokës.

Në vitin 2006, KE miratoi një grant të rëndësishëm për projektin "DryNet", i propozuar nga eniD dhe që synon pajisjen e rrjeteve të shoqërisë civile me njohuritë dhe vizibilitetin e duhur për t'iu adresuar çështjeve të varfërisë dhe degradimit në kontekstin e zhvillimit strategjik dhe UNCCD.

BE-ja është e bindur për urgjencën për të finalizuar një plan të tillë të përbashkët veprimi strategjik me objektiva të kufizuara në kohë, në mënyrë që të forcojnë angazhimin e të gjithë

³⁰ *Ibid.*

³¹ *Ibid.*

aktorëve drejt objektivave të UNCCD. Një mjet i tillë do të nxiste mobilizimin e burimeve për aktivitetet e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës.

Plani strategjik ofron një mundësi unike për të rigjallëruar Konventën dhe për të adresuar disa nga sfidat kryesore të UNCCD. Ai gjithashtu do të lejojë që UNCCD të përfitojë nga pikat e forta të tij, të kapë mundësitë e ofruara nga mjedisi i ri i politikave e financimit dhe të krijojë një terren të përbashkët të ri e të rigjallëruar për të gjitha palët e interesuara nën Konventë.

Energjia

Në tërësi, në BE, konsumi i energjisë në industri, transport dhe banim, është përgjegjës për rreth 80% të emetimeve të gazeve serrë dhe industrisë e energjisë janë përgjegjëse për më shumë 35% të emetimeve të dioksidit të karbonit (EEA, 2010).

Në këto kushte, dhe në një kohë që bota po përballet me sfida të fuqishme të energjisë, të tilla si pakësimi i rezervave fosile, probleme të sigurisë së energjisë, varësia e energjisë, kriza e energjisë bërthamore e kështu me radhë, përmirësimi i eficiencës së energjisë dhe nxitja e energjisë së rinovueshme janë ndër zgjidhjet për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

Energjia e rinovueshme sigurohet nga burime natyrore që rigjenerohen në një kohë të shkurtër. Burimet e energjisë së rinovueshme janë era, dielli, energjia e valës dhe gjeotermike. Sigurimi i energjisë nga këto burime nuk kontribuon në ndryshimin e klimës, pasi nuk sjell emetime të gazeve serrë në masë të tillë që është e dëmshme për mjedisin. Emetimet e dyoksidit të karbonit nga këto burime janë të papërfillshme krahasuar me burimet fosile, ndaj ato shpesh etiketohen 'karbon neutrale' (Nakata *et al*, 2011).

Sipas IEA (2010), në vitin 2008, 12.9% e furnizimit global të energjisë sigurohej nga burimet e rinovueshme, kryesisht biomasë dhe burime hidrike, dhe në masë më të vogël nga era, dielli, burimet gjeotermike, etj. Qymyri, nafta, gazi (burimet fosile) dhe energjia nukleare zënë 85% të konsumit total të energjisë. Këto burime janë përgjegjëse për rreth 60% të gjithë emetimeve globale të gazeve serrë (nga 80% që është përgjegjës totali i konsumit të energjisë, shih më lart).

Ndërsa, konsumi final bruto i energjisë së Vendeve Anëtare i takon 10.3% të rinovueshmeve dhe pjesa tjetër i takon burimeve konvencionale - atyre fosile (Eurostat, 2011). Pjesa e

elektricitetit nga burime të rinovueshme ishte 16.6% po atë vit, me një rritje të ngadalshme, por të qëndrueshme ndër vite.

Përdorimi më i madh i burimeve të energjisë së rinovueshme dhe asaj nukleare është një mënyrë për diversifikimin e energjisë. Diversifikimi vitet e fundit përbën prioritet për shumë vende dhe kjo nuk ka lidhje vetëm me shqetësimin për ndryshimin e klimës, por edhe për sigurinë e energjisë dhe çështje të tjera.

Gjithashtu, çkarbonizimi i shoqërisë është prioritet në agjendën botërore, ndaj një revolucion i të rinovueshmeve pritet të ndodhë në të ardhmen e afërt. Nuk mungojnë dhe projekte ambicioze dhe njëherazi spekulative, sipas të cilave brenda 2050-ës, energjia e rinovueshme do arrijë të mbulojë 77% të nevojave botërore të energjisë (IPCC 2011).

BE-ja mbështet një portofol të gjerë kërkimi që përfshin energjitë e rinovueshme (biokarburantët, diellore, fotovoltaike, erën, oqeanin, gjeotermale dhe hidro). Shumica e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit sot i drejtohen energjisë diellore. Plani strategjik për teknologjinë e energjisë është një ndër shtyllat e politikave të BE-së për energjinë dhe klimës [COM(2007) 723 dhe COM(2009) 519].

Politikat e BE-së për energjinë

Ideja e një strategjie evropiane për energji të gjelbër, u hodh për herë të parë më 1996, kur KE prezantoi letrën e saj të gjelbër: *“Energjia për të ardhmen: burimet e rinovueshme të energjisë”*³². Komisioni argumentonte se pa një rritje të masës së të rinovueshmeve në profilin energjetik evropian, BE-ja nuk do të qe në gjendje të përmbushte premtimet e saj ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Këto argumente u kthyen në objektiva, të cilat u pasqyruan në *“Direktivën mbi nxitjen e elektricitetit të prodhuar nga burime të rinovueshme energjie”*³³, e cila u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, në shtator 2001. Ndërsa, në Konferencën Evropiane për energjitë e rinovueshme që u mbajt në Berlin, në janar 2004, u theksua nevoja për të rritur me urgjencë pjesën e të rinovueshmeve në konsumin evropian të energjisë në mënyrë që të përballoheshin me eficiencë sfidat e ngrohjes së klimës dhe të

³² Green Paper – “Energy for the future: renewable sources of energy”, marrë nga <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:1996:0576:FIN:EN:PDF>

³³ Directive 2001/77/EC, marrë nga <http://eurlex.europa.eu/LexUri.Serv/LexUriServ.do?uri=OJ:2001:283:0033:0033EN:PDF>

përmirësohej siguria e energjisë në Evropë. BE-ja propozoi disa objektiva ambiciozë me qëllim arritjen e të paktën 20% të konsumit bruto të energjisë në kontinent, deri më 2020, nga të rinovueshmet. Ky objektiv madhor, përveç kontributit në pakësimin e emetimeve të CO₂ me 20%, do të mundësonte që BE-ja të mbetej aktori kryesor në zhvillimin e tregjeve globale të energjive të rinovueshme.

Në përputhje me rekomandimet e Konferencës së Berlinit, Parlamenti Evropian miratoi rezolutën e tij mbi ‘Konferencën ndërkombëtare për energjinë e rinovueshme’ në Bon, në qershor 2004. Në këtë të fundit, ai kërkoi Komisionit, Këshillit dhe Vendeve Anëtare të nxitonin me objektivat për rritjen e kontributit të energjive të rinovueshme, pasi këto masa do të ndihmonin BE-në të arrinte më shpejt objektivat e Kiotos.³⁴

Në mars 2006, KE paraqiti Letrën e Gjellbër “*Një strategji evropiane për energjinë e qëndrueshme, konkurruese dhe të sigurt*”. Në këtë letër u paraqit një rishikim strategjik i energjisë në BE, lidhur me sfidat dhe të ardhmen e politikave të energjisë në BE. Përsa i takon ndryshimit të klimës dhe sigurisë së energjisë, KE propozoi ‘qasjen e integruar’, e cila kombinonte programet e eficiencës së energjisë me energjinë konkurruese dhe eficiente, atë të rinovueshme. Kjo letër e gjellbër e KE, hapi *sui generis* debatin për zhvillimin e mëtejshëm të politikave të energjisë së gjellbër në BE dhe mundësinë e vendosjes së një objektivi ligjor detyrues për kontributin e të rinovueshme në konsumin final. Po kështu, për herë të parë objektivi për energjitë e rinovueshme u pa i ndërlidhur me problemet e ndryshimit të klimës dhe sigurisë së energjisë.

Në mbështetje të strategjisë së propozuar nga Komisioni, Këshilli Evropian i kërkoi Komisionit të përgatiste politikat e energjisë për Evropën. Ndërsa Parlamenti Evropian, në rezolutën e tij për Letrën e Gjellbër, i propozoi Komisionit të përgatiste për Këshillin Evropian të pranverës 2007 ‘objektivat sektorialë’ të detyrueshëm për energjinë e rinovueshme, me qëllim final arritjen e 25%-shit të energjisë nga burimet e rinovueshme, deri më 2020, sikurse dhe të projektohej rruga për të arritur objektivin prej 50% të energjisë së gjellbër brenda 2040-ës.³⁵

³⁴ European Parliament resolution on the International Conference for Renewable Energies, prill 2004, marrë nga <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P5-TA-2004-0276&language=EN>

Bazuar në vërejtjet dhe sugjerimet nga ana e Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian, Komisioni paraqiti në janar 2007 dokumentin “*Udhërrëfyese i energjisë së rinovueshme*”³⁶, si pjesë përbërëse të dokumentit “*Rishikim strategjik i energjisë evropiane*”. Në këtë udhërrëfyese, u pranua pamundësia për të arritur objektivin prej 12% brenda 2010-ës (vendosur më 1997), për shkak të punës së pamjaftueshme të Vendeve Anëtare. Si kundërpërgjigje, një objektiv i detyrueshëm ligjor prej 20% i të rinovueshmeve në konsumin bruto në kontinent brenda vitit 2020, u pa si i pëlqyeshëm dhe në nivelin e ambicieve të BE-së. Shpresohet që deri në vitin 2020, të paktën 10% e gjithë karburanteve të përdorura në Evropë do të vijë nga burime të rinovueshme dhe sipas Komisionit Evropian, këta biokarburantë duhet të emetojnë të paktën 60% më pak gaze serrë sesa karburantet fosile që zëvendësojnë. Përmbushja e këtyre objektivit konsiderohet gjithnjë i lidhur me pakësimin e gazeve serrë. Në dokumentin final të Politikave të Energjisë në Evropë (po të janarit 2007)³⁷, u kërkua që vendet anëtare të ngrinin plane kombëtare veprimi me qëllim që të arrinin objektivin e lartpërmendur në nivel kombëtar.

Pra, objektiv i prej 20 për qind i të rinovueshmeve në konsumin bruto në kontinent, brenda vitit 2020, ka evoluar nëpër stadi të ndryshme konsultimesh dhe debati në kuadrin institucional të BE, nga fillimisht indikativ, në ligjërish të detyrueshëm në Këshillin Evropian të pranverës 2007. Vendet anëtare e kanë adaptuar këtë objektiv, por ato përdorin mjete të ndryshme për ta arritur atë, sikurse janë disa mekanizma tregu.

Spektori i ndërtimit gjithashtu mund të japë një kontribut të konsiderueshëm në përgjigje të ndryshimit të klimës dhe ndryshimeve të tjera mjedisore dhe shoqërore. Direktiva e rishikuar “*Për performancën e energjinë në ndërtesa*”, shpreh ambicien e kalimit në gati energji zero në ndërtesat e Evropës të vitit 2021 dhe përforcon kërkesat për performancë të energjisë, pra do të vendosë standarde të reja për ndërtesat në Evropë.

Direktiva 2010/31/EU u miratua pas përvojës me zbatimin e Direktivës së parë (2002/91/EC) - ‘*Për performancën e energjisë të ndërtesave në Shtetet Anëtare*’, si dhe pas një propozimi nga

³⁵ European Parliament Resolution INI/2006/2113, 14 dhjetor 2006, marrë nga http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P6-TA-20060603&language=EN#def_1_13

³⁶ Renewable energy road map. ‘Renewable energies in the 21st century: building a more sustainable future’, 2007, marrë nga <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ.do?uri=COM:2006:0848:FIN:EN:PDF>

Komisioni në vitin 2008, bazuar në një vlerësim të detajuar të ndikimit të kësaj të fundit. Qëllimi i këtij rishikimi ishte të qartësonte dhe të thjeshtëzonte dispozita të caktuara, të shtrinte fushëveprimin e tyre, t'i bënte disa prej tyre më efektive, dhe të siguronte rolin drejtues të sektorit publik³⁸.

Sipas kësaj Direktive, Shtetet Anëtare duhet të krijojnë dhe të zbatojnë kërkesat minimale të performancës të energjisë në ndërtesat e reja dhe ekzistuese, të sigurojnë certifikimin e performancës së energjisë në ndërtesa dhe të kërkojnë kryerjen e inspektimeve të rregullta të kaldajave dhe sistemeve të kondicionimit në ndërtesa. Për më tepër, Direktiva u kërkon Shteteve Anëtare të sigurojnë që brenda vitit 2021 të gjitha ndërtesat e reja janë të ashtuquajtura 'ndërtesa me energji gati zero' (Naudé 2011).

Më 16 janar 2012, BE-ja miratoi Rregulloren e deleguar Nr. 244/2012 në plotësim të Direktivës 2010/31/EU, mbi performancën e energjisë së ndërtesave. Ndërsa, më 8 maj 2012, Komisioni Evropian organizoi një konferencë të aktorëve për mbështetje financiare për efikasitetin e energjisë me fokus ndërtesat. Qëllimi i konferencës ishte diskutimi i rolit të kuadrit rregullator dhe instrumenteve të financimit të BE-së e shteteve anëtare për të stimuluar mbështetjen financiare për eficiencën e energjisë³⁹.

Më 25 tetor 2012, u miratua Direktiva (2012/27/EU) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për eficiencën e energjisë, e cila synon të përshpejtojë përpjekjet e vendeve anëtare për të përdorur energjinë në mënyrë më eficiente, në të gjitha stadet e zinxhirit të energjisë, si dhe për të arritur objektivin 20% deri më 2020. Vendet anëtare kërkohet ta përafrojnë këtë Direktivë në sistemin e tyre të brendshëm, deri më qershor 2014.

Transporti

Transporti është përgjegjës për rreth një të katërtën e emetimeve të gazeve serrë të BE-së, duke qenë sektori i dytë më i madh i emetimit të gazeve serrë pas atij të energjisë. Transporti rrugor, i vetëm, kontribuon për rreth një të pestën e totalit të emetimeve të dioksidit të karbonit në BE, që është gazi kryesor serrë.

³⁷ Energy Policy for Europe, 2007, marrë nga

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ.do?uri=COM:2007:0001:FIN:EN:PDF>

³⁸ Marrë në http://ec.europa.eu/energy/efficiency/buildings/buildings_en.htm, shkarkuar më 29 gusht 2012

³⁹ *Ibid.*


Ndërsa emetimet nga sektorët e tjerë në përgjithësi janë në rënie, transporti mbetet ende sektor problematik. Sipas EEA (2010) emetimet nga transporti u rritën me 24% për periudhën 1990-2008 në BE-27, pa përfshirë emetimet nga transporti ndërkombëtar ajror dhe detar. Midis viteve 1995 dhe 2006, numri i makinave në BE-27 u rrit me 22%.

BE-ja ka politikat e veta për të reduktuar emetimet nga disa lloje transporti, të tilla si përfshirja e aviacionit në sistemin e tregtisë së emetimeve të BE-së (EU ETS) dhe vendosja e objektivave për emetimet e CO₂ nga makinat.

Më shumë se dy të tretat e emetimeve të gazeve të lidhura me transportin vijnë nga transporti rrugor. Megjithatë, burime të rëndësishme janë edhe aviacioni dhe sektori detar. Edhe këta sektorë janë duke përjetuar rritje të shpejtë të emetimeve, çka do të thotë se politikat për të reduktuar emetimet e gazeve janë të nevojshme për të gjithë gamën e transportit.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike emetimet e gazeve serrë sipas sektorit dhe mënyrës së transportit në vendet e BE, për vitin 2007, ku shihet se transporti është përgjegjës për rreth 15% të emetimeve të gazeve serrë nga gjithë burimet, ndërsa transporti rrugor është përgjegjës për rreth 40% të emetimeve të gazeve serrë nga transporti.

Figura 5: Emetimet e gazeve serrë sipas sektorit dhe mënyrës së transportit në vendet e BE, për vitin 2007



Burimi: European Commission, marrë më 16 korrik 2012 në http://ec.europa.eu/clima/policies/ets/index_en.htm

Ndërkohë që emetimet e gazeve serrë nga sektorë të tjerë, ndërmjet viteve 1990 dhe 2007, janë ulur me 15 për qind, emetimet nga transporti janë rritur me 36 për qind gjatë së njëjtës

periudhë. Kjo rritje ka ndodhur pavarësisht eficiencës së përmirësuar të automjeteve, për shkak të rritjes së sasisë së transportit personal dhe atij të mallrave. Meqenëse emetimet e gazeve serrë janë në rritje për format më të përhapura të transportit, BE-ja tani po zbaton një sërë politikash me qëllim uljen e emetimeve të sektorit në tërësi. Këto përfshijnë⁴⁰:

- përfshirjen e aviacionit në sistemin e tregtisë së emetimeve;
- përgatitjen e një strategjie për të reduktuar emetimet nga veturat dhe furgonët, duke përfshirë objektiva për emetimet nga automjetet e reja;
- zvogëlimin e intensitetit të gazit të karburanteve.

Nëse BE-ja synon vërtet të arrijë qëllimet e saj afatgjata, nevojiten të kryhen ulje të konsiderueshme të emetimeve të gazit nga transporti. Për këtë, Komisioni është duke kryer një studim për të hetuar llojet e politikave dhe teknologjive që janë të nevojshme për të arritur reduktimin e konsiderueshëm të emetimeve deri në vitin 2050.

Industria

Industrializimi konsiderohet si rruga për të arritur një shpërndarje të barabartë të të ardhurave në zona të ndryshme të botës. Dihet se industrializimi kontribuon në emetimet e gazeve serrë kryesisht nëpërmjet ndikimit tejet të madh në kërkesën për energji dhe përdorimin e saj, sikurse dhe nëpërmjet metodave të prodhimit me përdorim intensiv të karbonit.

Në një botë që përballet me çështjen e ndryshimit të klimës, industrializimi me karbon të ulët dhe rrugët e gjelbra të zhvillimit janë kërkesa imperative (Naudé 2011). Në këtë aspekt, ndryshimi i klimës shihet si një ndër sfidat më të mëdha që përballin politikat industriale. Me qëllim që industria (veçanërisht ajo prodhuese) të mbetet motor i rritjes dhe punësimit, si nga vendet e zhvilluara, ashtu dhe nga ato në zhvillim, duhen të aplikohen politika industriale që mbajnë parasysh edhe reduktimin e gazeve serrë. Ideja është që zhvillimi industrial dhe perspektivat e tij të mos ndikohen në mënyrë të ndërsjelltë nga ndryshimi i klimës, që zhvillimi industrial të bëhet pa përkeqësuar situatën e gazeve serrë dhe drejt një ekonomie me karbon të ulët.

Industria konsumon rreth 30 për qind të kërkesës për energji në botë dhe është përgjegjëse për gati 40 për qind të emetimeve të lidhura me energjinë. Industrinë më intensive nga pikëpamja e

⁴⁰ Faqja zyrtare e Komisionit Evropian, shkarkuar më 16 korrik 2012 në

karbonit janë ato të çelikut, hekurit, çimentos, aluminit, letrës, kimike dhe petrokimike. Megjithatë, zhvillimi industrial mundet edhe ta lehtësojë ndryshimin e klimës dhe përshtatjen ndaj saj duke krijuar mundësinë për transferimin e punësimit nga bujqësia për në industri, çka potencialisht mund të pakësojë presionin mbi tokën dhe pyjet, që sikurse është shpjeguar janë dy burime të rëndësishme të gazeve serrë (*Ibid.*).

Kalimi në një ekonomi me karbon të pakët kërkon inovacion teknologjik që realizohet duke nxitur proceset e kërkimit dhe zhvillimit. Politikat industriale për këtë qëllim mund të kenë efekte të ndryshme në afate kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata, të cilat duke iu përshtatur kërkesave të kohës do të avancojnë, nga përmirësimi i eficiencës së energjisë, në diversifikimin e burimeve të përdorueshme të energjisë, si dhe në teknologjitë e prodhimit me karbon të pakët.

Përveç inovacionit industrial, kalimi në një ekonomi me karbon të pakët kërkon bashkëpunim ndërkombëtar. Për këtë, aktorë të përshtatshëm dhe efektivë institucionalë, të tillë si Kombet e Bashkuara apo Bashkimi Evropian, mund të luajnë rol koordinues. BE-ja njihet për rolin e saj udhëheqës në vendosjen e objektivave për emetimet e gazeve serrë dhe në zhvillimin e aplikimit të teknologjive të energjive të rinovueshme, të tillë si mullinjtë me erë.

Në një kohë afatgjatë do të lindë nevoja për zhvillimin e teknologjive me karbon të ulët. Për këtë, politikat industriale priten të investojnë në mekanizma për largimin, ruajtjen dhe kapjen e karbonit. Sipas IEA (2010), në mënyrë që nivelet e CO₂ të arrijnë objektivin e vitit 2030 (450 ppm), kërkohet një investim në infrastrukturën e energjisë prej 10,5 miliard USD. Rreth 1,5 miliard nga këto, nevojiten për prodhimin industrial dhe të bio-karburantëve. Sikurse shihet, këta mekanizma janë të kushtueshëm dhe stimulimi i tyre do të kërkonte rritje të çmimit të karbonit; gjithsesi kjo nuk do të mjaftonte, por do të nevojiteshin edhe subvencione për kërkimin dhe zhvillimin (Naudé 2011). Aktualisht, shpenzimet për të nxitur ekonominë me karbon të pakët janë më të mëdha në fushën e teknologjive të avancuara të mjeteve, që shihen si teknologji që kursejnë energjinë. Politikat industriale po merren gjithashtu edhe me ‘rrjedhjen e karbonit’, e cila nënkupton që firmat dhe ndërmarrjet migrojnë në vende ku çmimet e karbonit janë më të ulëta.

Në një komunikatë nga Komisioni Evropian (European Commission 2010), drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetit të Rajoneve, lidhur me politikat e integruara industriale në epokën e globalizimit, theksohet se një sektor prodhues i gjallë dhe shumë konkurrues i BE-së, mund të sigurojë burime për sfidat shoqërore që përball sot BE-ja, të tilla si ndryshimi i klimës. Duke udhëhequr zhvillimin e standardeve evropiane ose ndërkombëtare për mallrat e reja të tregtueshme dhe teknologjitë e reja (të tilla si nanoteknologjia, makinat elektrike, teknologjitë shëndetësore, produktet me eficiencë energjike, të rinovueshmet dhe teknologji të tjera mjedisore), Evropa mund të krijojë një avantazh konkurrues për kompanitë e saj dhe të lehtësojë tregtinë. Standardet duhet të jenë të përshtatura për të ndihmuar në adresimin e politikave evropiane të tilla të mëdha si ndryshimi i klimës.

Komisioni nëpërmjet komunikatës shpreh synimin e tij që të promovojë kërkimin industrial, zhvillimin dhe inovacionin në teknologjitë e përparuara të prodhimit, me qëllim që të lehtësojë modernizimin e bazës industriale të BE-së, duke siguruar njëherazi përgjigje ndaj sfidave shoqërore si ndryshimi i klimës, eficienta e energjisë dhe mungesa e burimeve. Industria e BE-së duhet të përshpejtojë tranzicionin e saj drejt ekonomisë me karbon të pakët, me burime dhe energji eficiente. Luftimi i ndryshimeve klimatike dhe rritja e efikasitetit të burimeve mund të sjellin pakësim kostosh dhe pakësim të ndikimit mjedisor nga përdorimi i shtuar i burimeve dhe energjisë.

BE-ja ka publikuar një udhërrëfyes për ekonomi me karbon të pakët deri në vitin 2050, duke përfshirë piketa për vitin 2030, që nxjerr në pah rrugët për përmirësim teknologjik dhe ndryshime strukturore në sistemet industriale, të energjisë dhe transportit, që janë të rëndësishme për të nxitur inovacionin, rritjen dhe krijimin e vendeve të punës, dhe për të forcuar sigurinë e energjisë së BE-së.

Rrjedhja e karbonit dhe disavantazhe të tjera konkurruese që vijnë nga industria e BE-së duhet të shmangen për të parandaluar zhvendosjen e prodhimit dhe vendeve të punës jashtë Bashkimit Evropian. Në kontekstin e negociatave ndërkombëtare për klimën, BE-ja është aktualisht duke punuar për të përmirësuar shkallën dhe efektivitetin e tregjeve ndërkombëtare të karbonit dhe stimuluar rrjedhën e investimeve ndërkombëtare për kërkim, zhvillim dhe inovacion në teknologjitë me karbonit të pakët. Për më tepër, BE-ja është duke zhvilluar politika që mund të zvogëlojnë koston e strategjive afat-gjata të klimës dhe energjisë përmes

kapjes dhe ruajtjes së karbonit në shkallë të gjerë dhe projekte të tjera të reja të rinovueshme (European Commission 2010).

Konteksti ligjor dhe politik i mjedisit në nivel rajonal lidhur me ndryshimin e klimës

Mesdheu

Mesdheu është një rajon ekologjik unik përse i takon karakteristikave të tij natyrore, gjeografike dhe historike. Politikisht, Mesdheu është një grup vendesh, stabiliteti dhe prosperiteti i të cilëve varet ndjeshëm nga aftësia për të zbatuar politikat zhvillimore që marrin në konsideratë edhe aspektin mjedisor (The Blue Plan 2008)⁴¹. Ai është konsideruar të jetë një rajon ekologjik i vyer, por i brishtë, pasi zhvillimi i tij varet shumë nga mjedisi dhe cilësia e tij. Mesdheu është një nga zonat më kritike të biodiversitetit në botë. Deti i Mesdheut, i cili ka në brigjet e tij 24 vende, ku bën pjesë edhe Shqipëria, përmban 7% të specieve të njohura botërore të florës dhe faunës.

Figura 6: Hartë e Pellgut të Mesdheut



Burimi: Worldatlas, nxjerrë nga Interneti më 15 shkurt 2012, në <http://www.google.com/imgres?imgurl=http://www.worldatlas.com/aatlas/infopage/medsea.gif>

Disa të dhëna për rajonin e Mesdheut:

⁴¹ Marrë në <http://www.planbleu.org/planBleu/publications>, shkarkuar më 15 shkurt 2012.

- 7% të popullatës në botë
- 12% të produktit kombëtar bruto në vitin 2005
- 13% të tregtisë botërore në mallra në vitin 2005
- 31% të turizmit ndërkombëtar në vitin 2005
- 205 site të shpallura nga UNESCO si trashëgimi botërore
- 8% të emisioneve botërore të CO₂ në vitin 2005
- 5.7% të tokës së thatë në planet

Në Mesdhe kryhet 30% e transportit detar botëror dhe 25% e transportit detar të naftës.

Nga pikëpamja mjedisore, Mesdheu karakterizohet nga burime ujore të pakta dhe të shpërndara keq, nga thatësitat e verës dhe risku i përmbytjeve, si dhe nga rreziku i tërmetejeve e vullkaneve. Sikundër shprehet Brauch (2010), siguria mjedisore në rajonin e Mesdheut ndikohet nga ndryshimi mjedisor global. Përkeqësimi i situatës mjedisore, katastrofat natyrore dhe konfliktet etnike dhe fetare janë faktorë të migrimit ndërkombëtar që ndodh në të gjithë zonën e Mesdheut. Ky migrim ka ardhur në rritje në dekadat e fundit, ka prekur veçanërisht vendet veriore mesdhetare, anëtare të BE, sikurse janë: Italia, Greqia, Spanja, Portugalia. Faktor kyç në këto zhvillime migratore është hendeku në zhvillim midis vendeve mesdhetare te veriut dhe të jugut. Shumë vende të jugut të Mesdheut kanë karakteristika të ekonomisë rurale të zhvilluar dobët, e cila lidhet dhe me klimën dhe presionin që ushtrohet në shfrytëzimin e burimeve natyrore (European Commission 2002). Presioni i imigrimit për vendet e veriut të Mesdheut do të vazhdojë për sa kohë nuk është arritur një nivel zhvillimi i përshtatshëm në Mesdheun jugor.

Gjatë dekadave të fundit, ka një rritje të konsiderueshme të temperaturës së ajrit, paralelisht me një frekuencë të rritur të valëve të ngrohjes, të cilat janë më të gjata dhe më intensive. Ngrohja globale sjell përkeqësim të stresit nga të nxehtët. Nëse shoqërohet me lagështi, stresi nga të nxehtët përkeqësohet më tej. Një konsideratë analitike e kushteve të verës bregdetare, parashikon rritje në lagështinë relative, si dhe përkeqësim të ndotjes së ajrit. Në një pjesë të madhe të pellgut të Mesdheut, ka një rënie të reshjeve dhe numrit të ditëve me lagështi, paralelisht kjo me më shumë ngjarje të reshjeve ekstreme, që lidhen me intensitetin e ciklonit dhe shkallën e madhe të qarkullimit atmosferik.

Pellgu i Mesdheut ka një klimë unike të ndikuar nga një qarkullim i veçantë atmosferik i prekur fort nga një topografi komplekse e tokës, e cila luan një rol të rëndësishëm në drejtimin e rrjedhës së ajrit. Si rezultat, karakteristikat e tij të cilësisë së ajrit janë të lidhura me bashkëjetesën e ndotësve fizikë dhe antropogjenikë dhe modelet rajonalë klimatikë e të motit, transporti në masë të gjerë të ndotësve të ajrit, të aktivitetit të tepërt diellor për disa muaj. Për më tepër, grimcat e pluhurit shpesh përbëhen nga baktere dhe mund të jetë përgjegjëse për ndryshimin e vetive të grimcave, kryesisht në mjedisë me lagështi. Studimet tregojnë se episode të ndotjes së ajrit në pellgun e Mesdheut shoqërohen shpesh me anticiklone, që kanë efekte si të menjëhershme ashtu dhe afatgjata shëndetësore.

Popullsia në qytetet bregdetare të rajonit të Mesdheut është rritur midis viteve 1950 dhe 2000 nga 25 deri në 70 milion dhe është projektuar të rritet deri në 90 milion deri në vitin 2025. Në Evropën Jugore bregdetare popullsia është dyfishuar midis 1950 dhe 2000 nga 20 në 40 milion dhe pritet të stabilizohet në këtë nivel në vitin 2030, ndërkohë që është parashikuar të rritet në rajonin MENA nga 40 deri në 50 milion midis viteve 2000 dhe 2030. Kjo do të ndikojë më seriozisht deltat e lumenjve të mëdhenj, më veçanërisht Deltën e Nilit, si dhe rritje të nivelit të detit në Mesdheun Lindor, tendencë që vërehet qysh në monitorimet mjedisore të deritanishme.

Ndikimet e ndryshimit të klimës në sigurinë e Mesdheut dhe qasja evropiane

Ndikimet e ndryshimit të klimës në Mesdhe

Raporti i UNEP/MAP i vitit 2009, mbi Gjendjen e Mjedisit dhe Zhvillimin në Mesdhe, vuri në dukje se gjatë shekullit të 20^{të} dhe me një përshpejtim të dukshëm që nga viti 1970, Evropa Jug-Perëndimore (Gadishulli Iberik, Jugu i Francës) regjistroi një rritje të temperaturës prej pothuajse 2°C. Rritja e temperaturës është më e dukshme në dimër se në verë dhe për minimumin sesa për shifrat maksimale.

Sipas raportit përmbledhës të IPCC (2007a), nga 1900 deri në 2005 janë vërejtur tendencat në nivelet e reshjeve në rajone të mëdha dhe sasia e reshjeve ka rënë në Saheli, Afrikën Jugore mesdhetare dhe pjesë të Azisë Jugore. Ndërsa sipas raportit të UNEP/MAP (2009), reshjet janë pakësuar në Evropën Jugore. Në Mesdhe, disa rajone të Jugut kanë shënuar një rënie prej 20 për qind në reshjeve. Të dy raportet parashikojnë se në Evropën Jugore, ndryshimi i klimës pritet të përkeqësojë kushtet (temperatura të larta dhe thatësira) në një rajon tashmë të

pambrojtur ndaj ndryshueshmërisë klimatike dhe të pakësojë disponueshmërinë e ujit, potencialin hidroenergjetik, turizmin veror dhe produktivitetin e kulturave në përgjithësi.

Në shekullin e 21^{të}, për rajonin e Mesdheut sipas Paz *et al.* (2010), ekspertët e klimës parashikojnë rritje të temperaturës së ajrit nga 2,2°C deri në 5,1°C, rënie të reshjeve nga 4 deri 30 për qind, rritje të frekuencës dhe kohëzgjatjes së periudhave të thatësisë, ngjarje ekstreme më të shpeshta dhe më të dhunshme, të tilla si valët e nxehtësisë, thatësira apo përmbytje dhe rritje të nivelit të detit.

Sipas skenarëve të projektit *Acacia* (për ndryshimin e klimës në BE), reshjet në Evropën Jugore do të pakësohen deri në verën e vitit 2020 në pjesë të Spanjës qendrore nga 13-14 për qind dhe në pjesën veriore të Greqisë me të paktën 10 për qind. Deri në vitin 2050, pakësimi i projektuar i reshjeve të verës do të jetë në Greqi 14-20 për qind, në jug të Francës 13-15 për qind dhe përgjatë bregdetit spanjoll në Mesdhe 21-23 për qind. Deri në vitin 2080, pakësimi i reshjeve gjatë verës në Greqi parashikohet të jetë midis 18-27 për qind, në Francën jugore midis 17-20 për qind dhe në Spanjë midis 27-42 për qind (Brauch 2006). Numri, intensiteti dhe kohëzgjatja e ngjarjeve të motit ekstrem (valët e nxehtësisë, thatësitrat e verës, përmbytjet në dimër) do të rriten gjithashtu. Deri në vitin 2025, Plani Blu⁴² parashikon që ndryshimi i klimës të çojë në “një intensifikim ekstrem të ngjarjeve të motit”. Rreziku i thatësirave të rritura në këtë rajon gjatë tre dekadave të fundit, parashikohet të vijojë më tej deri në vitet 2050 dhe 2080.

Pra, Pellgu i Mesdheut, në shekullin e 21^{të} pritet të jetë një nga “zonat më të nxehta” të ndryshimit të klimës. Disa breza parashikimesh të ndryshimit të klimës kanë projektuar në vijimësi kushte më të ngrohta dhe më të thata në pellgun e Mesdheut. Verërat e Mesdheut priten të jenë shumë më të ngrohta e më të thata se sot dhe rritja e parashikuar e intensitetit dhe kohëzgjatjes së valës të të nxehtit, mund të paraqesë probleme të rënda shëndetësore, ndërkohë që temperaturat e larta mund të rrisin gjithashtu zonën e influencës së sëmundjeve të tilla si malaria (Paz *et al.* 2010). Një përmbledhje e ndikimeve të parashikuara të ndryshimit të klimës në rajonin e Mesdheut jepet më poshtë:

⁴² Plani Blu është zhvilluar në kuadrin e UNEP/ MAP (Plani i Veprimit të Mesdheut për Konventën e Barcelonës) dhe funksionon prej mëse 30 vjetësh për të realizuar një bashkëpunim mjedisor rajonal. Si një aktor i përfshirë në këtë bashkëpunim rajonal ai ka marrë përsipër të sinjalizojë vendimmarrësit dhe aktorë të tjerë për çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rreziqeve mjedisore në Mesdhe. Pjesë e këtij organizimi është edhe Shqipëria.

Ndikimet e parashikuara të ndryshimit të klimës në rajonin e Mesdheut

Pakësim i reshjeve vjetore	Rritje e kërkesës për ujë në bujqësi
Rendiment më i ulët në bimë	Më pak energji nga hidrocentralet
Risk më i lartë për ulje të biodiversitetit	Më pak turizëm veror
Risk më i lartë i shkretëtirëzimit	Më shumë sëmundje me prejardhje vektori
Më shumë zjarre pyjorë	Më shumë vdekje nga valët e të nxehtit

Burimi: EEA (2010) me ndryshime

Në pellgun e Mesdheut, mungesa e ujit është një problem mbizotërues. Me përparimin e ndryshimeve në kushtet klimatike, pritet që kërkesa për ujë të rritet në mënyrë dramatike për shkak të nevojës së zgjeruar për ujë të pijshëm, rritjes së kërkesës për ujë për ujitje dhe nevojës shtesë për ujë ftohës për termocentralet. Disponueshmëria e ujit do të ulet si rezultat i zvogëlimit të reshjeve, sidomos në sezonin e dimrit dhe rritjes së avullimit gjatë muajve tepër të nxehtë të verës.

Kërkesa për energji elektrike gjithashtu pritet të rritet për shkak të nevojës për të shtuar ajrin e kondicionuar në mjediset private e publike, si dhe nevojës për të përfutur ujë të pijshëm nëpërmjet desalinimit të ujit të detit dhe zgjerimit të trajtimit të ujërave të zeza.

Po kështu, prodhimi bujqësor në këtë rajon do të ndikohet negativisht nga ndryshimi i klimës, çka do të thotë më pak tokë bujqësore, potencial më i ulët prodhues dhe stinë më e shkurtër për rritjen. Këto zhvillime mund të ndikojnë më tej në sigurinë ushqimore të rajonit (Brauch 2010).

Ka shumë të ngjarë që vendet evropiane të kenë probleme imigrimi që lidhen jo me shkretëtirëzimin në Evropë, por atë në Afrikë. Afrika është kontinenti më i ndikueshëm nga ndryshimi i klimës, falë kushteve natyrore por edhe kapacitetit të pakët përshtatës. Ndaj, nga politikat e shkretëtirëzimit që do të zbatohen në jugun e Mesdheut (veriun e Afrikës) dhe në Afrikë më gjerë, do të varet në një masë të madhe çështja e sigurisë në Evropë.

Raporti i Vlerësimit i Grupit të II-të të Punës së IPCC të katërt (IPCC 2007c), dha vlerësimet e literaturës së rishikuar që kanë të bëjnë me Rajonin e Mesdheut në aspektin e ndikimeve fizike që janë planifikuar përkatësisht deri në vitet 2020, 2050 dhe 2100. Raporti sintezë (IPCC 2007a) arriti në përfundimin se në Evropën jugore, ndryshimi i klimës është parashikuar të përkeqësojë kushtet (temperatura të larta dhe thatësira) dhe të pakësojë disponueshmërinë e ujit, potencialin hidroenergjetik, turizmin veror dhe, në përgjithësi, prodhimin e kulturave.

Ndryshimi i klimës është parashikuar të rrisë rreziqet shëndetësore për shkak të valëve të të nxehtit dhe të frekuencës së zjarreve spontanë.

Konferenca e Shkencës së Klimës së Kopenhagenit, e marsit 2009⁴³, në raportin e saj përmbledhës arriti në përfundimin se:

“... emetimet e gazeve serrë dhe shumë aspekte të klimës po ndryshojnë pranë kufirin të sipërm të parashikimeve të IPCC. Shumë tregues kyç klimatikë tashmë janë duke lëvizur përtej modeleve të ndryshueshmërisë natyrale, në të cilin shoqëria bashkëkohore dhe ekonomia janë zhvilluar dhe lulëzojnë. Këta tregues përfshijnë temperaturat mesatare globale të sipërfaqes, rritjen e nivelit të deteve, temperaturën globale oqeanike, shkrirjen e akullit në detin Arktik, acidifikimin e oqeaneve dhe ngjarjet ekstreme klimatike. Me emetime të pa-pakësuara, shumë tendenca të klimës ka të ngjarë të përshpejtohen, duke çuar në një rrezik në rritje ndërrimesh klimatike të papritura ose të pakthyeshme.”

Karakteristikat më lart, e bëjnë imperative nevojën e zhvillimit të qëndrueshëm për zonën ekologjike të Mesdheut. Ndërkaq, sipas raportit të Planit Blu (2012), “tendencat e zhvillimeve aktuale në rajonin e Mesdheut janë ende larg nga çka do kërkohej për një zhvillim të vërtetë të qëndrueshëm, ndërsa situata mjedisore është një arsye e vazhdueshme për shqetësim”.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike në sistemin e njeriut

Në nivelin rajonal mesdhetar, studime të ndryshme të UNEP/MAP dhe Planit Blu kanë rishikuar shpesh ndikimet selektive, duke mos ndjekur kërkesat e vlerësimeve të IPCC. Raporti i seminarit rajonal të Planit Blu mbi ndryshimet klimatike në Mesdhe (2008) trajtoi ndikimin në mjedis dhe shëndetin e njeriut, veçanërisht në brigjet mesdhetare, për të cilat u mor në konsideratë rënia më drastike e nivelit të detit, rreziku i përhapjes së sëmundjeve infektive dhe ndikimet shëndetësore të valëve të të nxehtit, të tilla si ato të gushtit 2003, kur rreth 35,000 dhe 70,000 njerëz vdiqën në Evropën Qendrore dhe Jugore (UNEP/MAP 2009). Një tjetër fokus ishte në diskutimin mbi ndikimin në burimet natyrore, veçanërisht në burimet ujore, mbi rreziqet natyrore dhe pyjet, si dhe mbi aktivitetet antropogjene (peshkimit, turizmit, bujqësisë, nevojës për energji). Analiza e UNEP/MAP renditi midis ndikimeve të mëdha të ndryshimit të klimës disponueshmërinë e ujit, biodiversitetin dhe aktivitetet ekonomike, në të

⁴³ Synthesis report of the Climate Change Conference, mars 2009, shkarkuar më 15.05.2012, në <http://climatecongress.ku.dk/pdf/synthesisreport/>

cilin ata varen, si dhe implikimet e këtyre ndryshimeve të planifikuara mbi peshkimin, pyjet dhe shëndetin e njeriut.

Sikurse thamë më lart, ka dëshmi të rëndësishme që pellgu i Mesdheut, është duke përjetuar ndikimet e ndryshimeve klimatike. Dukuritë kryesore janë rritja e temperaturës (sidomos gjatë muajve të verës), rritja e frekuencës dhe intensitetit të valëve të të nxehtit, një reduktim i sasisë totale të reshjeve (paralelisht me rritjen e intensitetit të tyre) dhe zgjerim i thatësisë. Përveç kësaj, zona e Mesdheut po përballlet me presionin në rritje të popullsisë.

Të gjitha çështjet e mësipërme rrisin ndjeshmërinë e popullsisë ndaj ndikimeve të mundshme të ndryshimeve klimatike mbi sigurinë njerëzore (nëpërmjet rritjes së nivelit të detit, pakësimit të disponueshmërisë së ujit, rritjes së kripësisë e eutrofikimit të ujërave bregdetare, pakësimit të rendimentit të kulturave), si dhe ndikimin në shëndetin e njeriut nëpërmjet valëve të të nxehtit, zjarreve të papritur, sëmundjeve, ndotjes së ajrit, etj.

Ndryshimi i klimës globale ka ndikime të drejtpërdrejta në shëndetin e njeriut, duke përfshirë vdekshmërinë në rritje që lidhet me valët e të nxehtit. Vdekshmëria paraqet një sezonalitet me një kulminacion të përgjithshëm në dimër, por arrin kulminacione edhe në verë, që korrespondon me valët e të nxehtit (Paz *et al.* 2010).

Rritja e valëve të të nxehtit është një nga pasojat më të qarta të ndryshimeve klimatike. Vëzhgimet në qytete të pellgut të Mesdheut kanë treguar se valët e të nxehtit mund të kenë efekt shumë të fortë në vdekshmëri, ndërsa vdekshmëria rritet midis 1-4 për qind për çdo shkallë rritjeje të temperaturës. Më shumë në rrezik janë: të moshuarit, personat me sëmundjeve kronike paraprake, ata që kanë zënë shtratin, që jetojnë vetëm dhe të ekspozuarit shumë, si p.sh. ata të jetojnë drejtpërdrejt nën çatinë e një ndërtese.

Fëmijët janë më të prekshëm se të rriturit ndaj valëve të të nxehtit, pasi ata nuk i kanë zhvilluar plotësisht mekanizmat e rregullimit të temperaturës. Fëmijët shumë të vegjël janë në rrezik më të lartë vdekjeje, ndërsa fëmijët më të rritur kanë më tepër stres nga i nxehti, për shkak të kohës që kalojnë duke luajtur jashtë.

Ndryshimi i klimës mund të plotësojë disa efekte të dëmshme të rrezatimit diellor UV-B mbi shëndetin e njeriut. Për të njëjtën dozë UV, çdo rritje prej 1°C e temperaturës do të rezultonte në rritje të llogaritura të incidencës së kancerit të lëkurës me 3-6 për qind. Temperaturat e larta

dhe lagështia mund të rrisin efektet e dëmshme të rrezatimit UV-B mbi shëndetin e njeriut në pellgun e Mesdheut, duke përfshirë uljen e imunitetit ndaj sëmundjeve infektive dhe kancerit të lëkurës (Paz *et al.* 2010).

Aspekti i sigurisë i ndryshimit të klimës dhe qasja evropiane

Në letrën zbatuese të Strategjisë Evropiane të Sigurimit, në vitin 2008, të 27 vendet e Këshillit Evropian arritën në përfundimin se fatkeqësitë natyrore, degradimi i mjedisit dhe konkurrenca për burimet, përkeqësojnë konfliktin, sidomos në situata të varfërisë dhe rritjes së popullsisë (Brauch 2010). Pasojat janë humanitare, shëndetësore, politike, të sigurisë dhe migrim më i madh. Ky përcaktim bazohet në raportin e lartpërmendur të marsit 2008 të Përfaqësuesit të Lartë dhe Komisionit, i cili e përshkroi ndryshimin e klimën si një “shumëzues kërcënimi”. Këshilli Evropian vuri gjithashtu në dukje se ndryshimi i klimës mund të çojë në mosmarrëveshje mbi rrugët tregtare, zonat detare dhe burimet e pashfrytëzuara më parë.

Ndër shtyllat kryesore të politikës mjedisore të BE-së për Mesdheun, në kuadër të aktiviteteve të programit “Horizont 2020”⁴⁴ dhe që kanë lidhje indirekte me ndryshimin e klimës janë: a) projektet për të reduktuar burimet e ndotjeve më të konsiderueshme; b) masat për ndërtimin e kapaciteteve të administratave kombëtare mjedisore të vendeve fqinje; c) përdorimi i buxhetit kërkimor të Komisionit, për të zhvilluar dhe ndarë njohuritë për çështjet mjedisore. Sidoqoftë, programi Horizont 2020 për fazën e parë (2007-2013) *nuk i referohet as edhe një herë* ndryshimit të klimës në mënyrë specifike (Brauch 2010).

Ndërsa komunikata e Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian – Krijimi i një Strategjie Mjedisi për Mesdheun, e vitit 2006, *vetëm një herë* iu referua ndryshimeve klimatike në kuadër të kërkimit të vazhdueshëm dhe të kryer nën Programet e Kërkimit Kuadër 5 dhe 6, duke iu adresuar çështjeve të ujit (nën iniciativën e ujit të BE-së, komponenti i Mesdheut) dhe ndotjes aksidentale detare, kërkimeve detare e bregdetare dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike në ujëra (European Commission 2006b). Madje, kërcënimet mjedisore globale, të tilla si ndryshimi i klimës dhe humbja e biodiversitetit, janë përfshirë në këtë

⁴⁴ Horizont 2020 është programi i ri i BE-së për kërkimin dhe inovacionin, si dhe instrumenti financiar që zbaton iniciativën për Evropën 2020.

Komunikatë brenda një programi tematik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Gjatë Konferencës së tretë Ministrore Euro-Mesdhetare për Mjedisin, më 20 nëntor 2006, deklarata e Kajros iu referua *një herë* edhe ndryshimeve klimatike, duke përsëritur nismën e lartpërmendur të BE-së për krijimin e një strategjie të mjedisit për Mesdheun. Sipas deklaratës së Kajros, kjo nismë shpreh qasjen e Komisionit Evropian në lidhje me bashkëpunimin e tij mjedisor në rajon për vitet e ardhshme, nëpërmjet sektorësh të tillë si ndryshimi i klimës, shkretëtirëzimi dhe biodiversiteti.

Një përmbledhje literature e Drejtorisë së Përgjithshme për Marrëdhënie me Jashtë, mbi implikimet e ndryshimeve klimatike në sigurinë rajonale (Brauch 2010), mori në shqyrtim raportet e fundit, për gjashtë rajonet e përmendura në Raportin e Komisionit, nga të cilat rajoni MENA paraqiste interes të veçantë. Sipas kësaj përmbledhjeje, në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, ndikimet e ndryshimeve klimatike pritet të konvergojnë në procese social-ekonomike që do të çojnë në mungesë uji dhe ushqimi, duke rezultuar në rënie të mundësive të punësimit dhe rënie të potencialit ekonomik. Ndryshimi i klimës ka gjasa të përkeqësojë diferencat, veçanërisht ato midis shtresave sociale, nëpërmjet shpërndarjes së pabarabartë të pasurisë dhe qasjes në burime. Përmbledhja sheh një sfidë të ardhshme të sigurisë, kur kombinimi i klimës dhe tendencave social-ekonomike do të arrijnë kufijtë kritikë, duke katalizuar procese që çojnë në brishtësi të shtetit. Ngjarje krizash, të tilla si mungesa të papritura të ushqimit, mund të shkaktojnë trazira të dhunshme dhe nëse nuk trajtohen siç duhet, mund të destabilizojnë shtetet dhe të rritin mbështetjen publike për grupet ekstremiste që ofrojnë alternativa të tjera. Duke pasur parasysh rrymat gjeopolitike në MENA, kjo mund të ketë pasoja globale.

Kjo përmbledhje, argumentoi se dy burimet kryesore të pasurisë, të të ardhurave dhe të punësimit në rajonin MENA, që janë nafta dhe bujqësia, do të zvogëlohen. Ndryshimi i klimës ka të ngjarë të ulë prodhimin bujqësor për shkak të stresit të vapës dhe ujit të pakësuar në dispozicion për ujitje. Kontradiktat e pazgjidhura të ujit (Izrael, Palestinë, baseni i lumit Nil) dhe ndjeshmëria e lartë ndaj rritjes së çmimeve të ushqimit kanë rezultuar në konflikte të dhunshme në veri të Afrikës që nga viti 1970 deri në vitin 2008.

Ndërsa ndryshimi i klimës në Mesdhe, deri vonë nuk ka paraqitur ndonjë interes të madh për politikatat e mjedisit të BE-së, as edhe në kuadër të Partneritetin Euro-mesdhetar dhe Unionit për Mesdheun, diskutimi mbi implikimet e *sigurisë* të ndryshimit të klimës, që kanë të bëjnë me rajonin Euro-Mesdhetar, po bëhet gjithnjë e më shumë një shqetësim për Drejtorinë e Përgjithshme të Marrëdhënieve me Jashtë, e cila ka nisur procesin e udhërrëfyesit të BE-së mbi *ndikimet në siguri* të ndryshimeve klimatike.

Bazuar në një raport për rrezikun e sigurisë së ndryshimeve klimatike të WBGU që ishte lëshuar në Samitin e G-8^{ës} (WBGU 2008), qeveria gjermane propozoi një dokument strategjik të BE-së mbi ndikimet në siguri të ndryshimeve klimatike. Duke iu kthyer raportit të WBGU, në mars 2008, Komisioni Evropian përgatiti dhe paraqiti në Këshillin e Ministrave të BE-së dhe të Këshillit Evropian një raport mbi aspektin e sigurisë së ndryshimit të klimës. Nga një perspektivë ndërkombëtare e sigurisë me në qendër shtetin, raporti i WBGU argumentoi se: “Pa kundërveprim të vendosur, ndryshimi i klimës do të shterojë kapacitetet adaptuese të shumë shoqërive brenda dekadave të ardhshme. Kjo mund të rezultojë në destabilizim dhe dhunë, duke rrezikuar sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare në një shkallë të re”.

Raporti i mësipërm u referohet grupeve të mundshme të reja të konfliktit për shkak të nivelit të rritur të detit, stuhive dhe përmbytjeve, që mund të kërcënojnë qytetet bregdetare dhe rajonet industriale. Ndërsa WBGU i konsideron me pak gjasa luftërat ndër-shtetërore të nxitura nga klima, argumenton se ndryshimi i klimës mund të gjenerojë konflikte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe intensifikojë problemet ekzistuese, të tilla si dështimi i shtetit, përkeqësimi i rendit shoqëror dhe dhuna në rritje. Në rajonet më të prekura, kjo mund të çojë në procese destabilizuese, me përhapje strukturash konflikti. Këto zhvillime kërcënojnë të dëmtojnë sistemin e vendosur të qeverisjes globale, duke rrezikuar kështu stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare.

WBGU ka identifikuar katër grupe të konfliktit, dinamika e të cilëve mund të çojë në destabilizim social dhe në fund - në dhunë të cilat janë të shkaktuara nga klima. Ai gjithashtu përmendi gjashtë kërcënime kyçe për sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar që mund të lindin në qoftë se zbutja e ndryshimit të klimës dështon (WBGU 2008). Kërcënimet kryesore janë: rritja e numrit të shteteve të dobëta dhe të brishta, rreziqet për zhvillimin global ekonomik, për konflikte ndërkombëtare në rritje, për të drejtat e njeriut, si dhe për intensifikimin e migrimit.

Në këndvështrimin e WBGU-së, politika e klimës është gjithashtu një politikë parandaluese e sigurisë, pasi në rast se politika e klimës është e suksesshme në kufizimin e rritjes së temperaturave sipërfaqësore globale me mesatarisht jo më shumë se 2°C në raport me vlerën para-industriale, kërcënimi i induktuar nga klima për sigurinë ndërkombëtare ka të ngjarë të shmanget. Në të kundërtën, nëse përpjekjet lehtësuese dështojnë, sipas raportit të WBGU, rreziqet e sigurisë të nxitura nga klima do të fillojnë të manifestohen në rajone të ndryshme të botës rreth viteve 2025-2040. Prandaj, sfida kryesore është që të merren masa të përcaktuara të politikave të klimës brenda 10-15 viteve të ardhshme, në mënyrë që të shmangen shtrembërimet social-ekonomike dhe implikimet për sigurinë ndërkombëtare që përndryshe do të intensifikohen në dekadat e mëvonshme.

Ndër grupet e konfliktit të mësipërme të identifikuara nga WBGU, tre janë shumë të rëndësishme për rajonin Euro-Mesdhetar: a) degradimi i burimeve të ujërave të ëmbla i nxitur nga klima; b) rënia e prodhimit të ushqimit e shkaktuar nga klima; dhe c) migrimi i detyruar për shkak të mjedisit; ndërsa i katërti, d) rritja e katastrofave të stuhive dhe përmbytjeve të nxitura nga klima, ka prekur shumë vende të Evropës Perëndimore dhe Mesdheut Lindor, veçanërisht gjatë vjeshtës dhe dimrit (WBGU 2008).

Raporti mbi Zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Evropiane – Ofrimi i sigurisë në një botë në ndryshim, i dhjetorit të vitit 2008, me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së për Punët e Jashtme, Javier Solana vuri në dukje se pa përmendur termin klimë, strategjia evropiane e sigurisë së BE-së - Një Evropë e sigurt në një botë më të mirë, e miratuar në dhjetor 2003:

"Ka identifikuar tashmë implikimet e sigurisë së ndryshimeve klimatike. Pesë vjet më vonë, kjo çështje ka marrë një urgjencë të re. [...] Ndryshimi i klimës mund të çojë në mosmarrëveshje mbi rrugët tregtare, zonat detare dhe burimet e paarritura më parë. Ne kemi zgjeruar parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizës, por analizat dhe aftësitë e hershme paralajmëruese kanë nevojë të përmirësohen. BE-ja nuk mund ta bëjë këtë vetëm. Ne duhet të përshpejtojmë punën tonë me shumicën e vendeve në rrezik duke forcuar kapacitetin e tyre për të përballuar. Bashkëpunimi ndërkombëtar, me OKB-në dhe organizatat rajonale, do të jetë thelbësor."

Në një takim të Këshillit të Bashkimit Evropian mbi Diplomacinë e Klimës në BE, në vitin 2011, ndryshimi i klimës është njohur si një sfidë globale e mjedisit e zhvillimit dhe një kërcënim ndaj rritjes globale, prosperitetit dhe stabilitetit. BE-ja ka qenë në ballë të rritjes së

ndërgjegjësimit mbi implikimet e ndryshimeve klimatike me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare. Gjithsesi, zhvillimi i një kuadri global gjithëpërfshirës në të ardhmen duke angazhuar të gjitha ekonomitë e mëdha përmes veprimit shumëpalësh dhe kombëtar, në mënyrë që të kalohet në një ekonomi dhe shoqëri me karbon të pakët, të sigurt dhe të qëndrueshme, u konsiderua si thelbësore. Në takim u theksua domosdoshmëria që BE-ja të kontribuojë *tani*, në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet sistemike që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, para shpërthimit së krizës.

Këshilli theksoi gjithashtu nevojën për të rritur më tej përpjekjet e diplomacisë së klimës, për të adresuar ndryshimin e klimës në të gjitha nivelet politike dhe për të forcuar zërin e BE-së dhe thirrjen ndaj gjithë aktorëve të BE-së për të kontribuar në këtë drejtim, si dhe për të vazhduar dhe intensifikuar përpjekjet për të ndihmuar vendet në zhvillim, në përpjekjet institucionale të tyre dhe ngritjen e kapaciteteve për të adresuar ndryshimin e klimës. Lidhur me aspektin e sigurisë, Këshilli ka konfirmuar se “BE-ja do të vazhdojë të rrisë vetëdijen për rreziqet globale të sigurisë dhe natyrën shumëzuese-kërcënuese të ndryshimit të klimës, veçanërisht në rajonet e rrezikuara”.

Evoluimi i konceptit të sigurisë dhe nevoja për asistencë e bashkëpunim rajonal

Perspektiva e sigurisë ka ndryshuar nga një koncept sigurie me në qendër shtetin, që kishte mbizotëruar në analizën e marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë shekullit të 20^{të}, në një koncept në zhvillim të “sigurisë së komunitetit” në Evropë, me zgjerimin e BE-së nga 15 në 27 Shtete Anëtare (sot me 28). Ky ndryshim ndodhi përmes zgjerimit të konceptit të sigurisë nga ushtarak dhe politik - në siguri ekonomike, shoqërore dhe mjedisore, si dhe përmes thellimit nga kombëtare dhe ndërkombëtare - në siguri globale, si dhe përmes specifikimit të konceptit të sigurisë (siguri energjie, ujë, ushqimi, shëndeti dhe siguri klimatike) (Brauch 2010). Si rezultat, ka dalë një koncept i ri sigurie, me në qendër njeriun, i cili ndikon më seriozisht atë pjesë të botës që jeton në varfëri në Jug. Ndryshimi i klimës do të ndikojë më shumë vendet dhe njerëzit në Jug për shkak të një numri të lartë rreziqesh të rënda dhe intensive, një shkallë të lartë ndjeshmërie sociale që rezulton nga varfëria dhe mungesa e burimeve për masa përshtatëse dhe zbutëse, si dhe një kapacitet i pamjaftueshëm shtetëror për zbatim.

Një këqyrje e studimeve mbi implikimet e ndryshimeve klimatike në sigurinë rajonale, si pjesë e procesit udhërrëfyes të BE-së për ndryshimin e klimës dhe sigurinë ndërkombëtare, përmbledh rekomandimet në lidhje me ngritjen e vetëdijes, hulumtimet e mëtejshme, ndërtimin e kapaciteteve, prioritetet e politikave, rajonet prioritare dhe nevojën për asistencë ndërkombëtare për zhvillim, të nevojshme për t'iu adresuar kryesisht rajonit që do të preket më shumë gjatë këtij shekulli nga ndikimet fizike dhe shoqërore të ndryshimeve klimatike dhe që me shumë gjasa do të paraqesë gjithashtu rreziqe dhe shqetësime të sigurisë - rajonin e Mesdheut dhe më posaçërisht vendet MENA.

Bashkëpunimi në fushën e mjedisit është një fushë gjithnjë në rritje në kuadër të organizmave të Bashkimit Evropian (BE) dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Problemet mjedisore të Mesdheut trajtohen me prioritet në kuadër të Partneritetit Euro-Mesdhetar, i cili nisi me Procesin e Barcelonës më 1995. Konferenca e Barcelonës synoi nisjen e një procesi që do të çonte në krijimin e një zone të lirë tregtare midis Evropës dhe Mesdheut brenda vitit 2010. Prosesi i Barcelonës e ngriti bashkëpunimin mbi parimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, si pjesë e rëndësishme për të siguruar stabilitet, veçanërisht në marrëdhëniet midis dy palëve.

Problemet e thatësirave dhe shkretëtirëzimi janë më të theksuara në pjesën jugore të Mesdheut, kryesisht në vendet e veriut të Afrikës. Sidoqoftë, risku i thatësirave dhe problemeve ekonomike lidhur me to, është një rrezik i përhershëm i sigurisë së kufijve të BE-së. Partneriteti Euro-Mesdhetar sot përmban 44 anëtarë, ndër të cilat 28 vende anëtare të BE-së dhe 16 vende partnere ku bën pjesë edhe Shqipëria. Në vitin 2008, në vijim të Partneritetit Euro-Mesdhetar, u krijua Bashkimi për Mesdheun, i cili përmban 43 vende nga Evropa dhe Pellgu i Mesdheut. Qëllimi i këtij bashkimi që nxitja e stabilitetit dhe i mirëqenies kudo në rajonin e Mesdheut.

Ballkani Perëndimor- Politikat e ndryshimeve klimatike dhe perspektivat në kuadër të angazhimeve ndaj KKKBNK dhe anëtarësimit në EU

Ndryshimi i klimës në rajon

Ndërsa vendet e rajonit të Ballkanit po përpiqen për demokraci, zhvillim ekonomik dhe stabilitet, ata po përballen me sfida të reja të shkaktuara nga ndryshimi i klimës, në kushtet e

kufijve të rinj ndërkombëtarë dhe popullsive dinamike me identitete të forta etnike. Stabiliteti politik në rajon, i cili është në progres dhe efektiviteti i qeverisjes mund të ndikojnë në aftësinë e rajonit për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ndryshimit të klimës. Përkundër këtyre sfidave, megjithatë, vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia), kanë përjetuar të gjithë rritje të PBB në periudhën 1995-2009 dhe kanë përparuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Po kështu, shteti i ri i Kosovës (2008), po ndjek një rrugë konsolidimi si shtet dhe përparimi drejt proceseve integruese.

Dinamika e demografisë së Ballkanit është shumë e madhe; më shumë se 50 për qind e 4 milionë emigrantëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor janë duke jetuar në vende të tjera të Ballkanit, ose në Itali, Greqi apo Turqi. Një pjesë tjetër, prej 29 për qind jeton në vende të tjera të Evropës, ndërsa pjesa e mbetur prej 21 për qind, është e shpërndarë në të gjithë globin, kryesisht në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Australi (UNEP 2012).

Gjithashtu, më shumë se 1.5 milionë emigrantë jetojnë në Ballkanin Perëndimor, 52 për qind vijnë nga vendet e tjera të Ballkanit ose nga Italia, Greqia apo Turqia. Migrimi i brendshëm është gjithashtu një dukuri e shprehur në Ballkanin Perëndimor, pasi shumë njerëz lënë zonat rurale për të kërkuar mundësi të reja nëpër kryeqytete. Kështu, më shumë se 1.5 milionë emigrantë jetojnë në Ballkanin Perëndimor, 52 për qind vijnë nga vendet e tjera të Ballkanit apo nga Italia, Greqia apo Turqia. Migrimi i brendshëm është gjithashtu një dukuri e shprehur në Ballkanin Perëndimor, pasi shumë njerëz lënë zonat rurale për të kërkuar mundësi të reja nëpër kryeqytete. Kështu, popullsia e Tiranës është rritur nga 200.000 në gati 700 mijë banorë qysh nga fillimi i '90. Beogradi, Sarajeva dhe Shkupi kanë situata të ngjashme. Që prej vitit 1992, përqindja e popullsisë që jeton në zonat rurale ka rënë në çdo vend të Ballkanit Perëndimor. Të gjitha këto ndryshime demografike e zvogëlojnë kapacitetin përshtatës të rajonit (*Ibid.*).

Vendet e Ballkanit përjetojnë një gamë të gjerë klimatike, në krahasim me madhësinë e zonës së tyre gjeografike. Shqipëria ka një klimë mesdhetare me dimër të butë, të lagësht dhe të nxehtë, verë të thatë, sikurse dhe pjesa jugore e Malit të Zi, zonat bregdetare dhe ultësirat e Bosnjë-Hercegovinës. Klima në zonat e mbetura të Bosnjë-Hercegovinës shkon nga kontinentale e butë, në alpine. Veriu i Malit të Zi ka një klimë kontinentale dhe pjesët

qendrore e më pak veriore kanë disa karakteristika të klimës malore, por me ndikime të detit Mesdhe mbi temperaturën dhe reshjet. Shumica e Kroacisë ka një klimë të ngrohtë të moderuar, me shi, ndërsa klima e Serbisë ndryshon nga kontinentale e butë në shumë zona, në kontinentale në male, në subtropikale mesdhetare e kontinentale në jug-perëndim. Kosova në tërësi ka një klimë të lagësht kontinentale, me ndikime mesdhetare, e karakterizuar me verë të ngrohtë dhe dimër të ftohtë e me borë. Klima në Maqedoni ndryshon nga kontinentale-submesdhetare e moderuar, në kontinentale të nxehtë, kontinentale të ftohtë e në një sërë klimash nën-alpine (UNEP 2012).

Ballkani po ngrohet dhe është projektuar të vazhdojë në këtë tendencë në përgjithësi, në proporcion me rritjen e pritshme të temperaturave globale. Në mënyrë të ngjashme, rajoni ka më pak reshje dhe është projektuar të përjetojë rënie të mëtejshme të tyre, edhe pse modelet e reshjeve do të vazhdojnë të ndryshojnë sipas terrenit, lartësisë dhe afërsisë me detin. Gjithashtu, efekti i temperaturave të larta në avullim, së bashku me pakësimin e reshjeve, do ta bëjnë rajonin më të thatë.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe skenarët e zhvillimit në Ballkan

Në një seminar të organizuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe EEA, mbi mundësitë e zhvillimit të Ballkanit Perëndimor në kontekstin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe mungesës së ujit, që u zhvillua në Beograd, Serbi, më tetor 2011⁴⁵, u morën në konsideratë një gamë e gjerë forcash lëvizëse: sociale, teknologjike, ekonomike, mjedisore dhe politike, sikurse dhe gjithë ndikimet në nivel global, rajonal dhe vendor, lidhur me ndryshimin e klimës në rajon. Në këtë seminar u konkludua se forcat lëvizëse që kontribuojnë në rritjen e riskut janë arsimimi i dobët, vetëdija e ulët politike e publike, si dhe rritja e paqëndrueshme ekonomike. Rrjedhimisht, u identifikuan këto drejtime si thelbësore për të arritur të ardhmen e dëshiruar: edukimi dhe ndërgjegjësimi social, qeverisja e mirë, përmirësimi i mirëqenies së përgjithshme, stabiliteti politik, përdorimi i teknologjisë së gjelbër.

Aftësia e vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ndryshimeve klimatike - qoftë vetëm, ose së bashku - varet nga vulnerabiliteti (cenueshmëria) i tyre të

⁴⁵ Marrë nga <http://www.osce.org/eea/84373>, shkarkuar më shtator 2012.

përgjithshëm, i cili është një funksion i tre faktorëve - ekspozimit, ndjeshmërisë dhe kapacitetit për t'u përshtatur.

Ekspozimi ka të bëjë me risqet që lidhen me ndryshimet klimatike në të ardhmen, në krahasim me kushtet aktuale. Thatësira, për shembull, është një risk që vjen nga temperaturat e larta dhe reshjet e pakta. Rritja e temperaturave dhe prishja e regjimit të reshjeve janë ekspozimet më të rëndësishme të rajonit. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me thatësira dhe vërshime më të shpeshta dhe më të forta. Ekspozimi ndaj këtyre risqeve mund të ndikojë në shëndetin publik dhe biodiversitetin, si dhe në sektorët kyç të ekonomisë - burimet ujore, bujqësinë, pylltarinë, energjinë dhe turizmin. Të katër vendet me zona bregdetare - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi - gjithashtu përballen me risqe të mundshme që lidhen me rritjen e nivelit të detit. Ekspozimi i rajonit ndaj përmbytjeve më të shpeshta dhe intensive ka pasoja për ekonominë dhe mjedisin e vendeve, për të mos përmendur vuajtjet njerëzore. Përmbytjet në vitin 2010 në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Mal të Zi detyruan 20.000 njerëz të lenë shtëpitë e tyre dhe shkaktuan 450 milion USD dëme. Edhe në verën e vitit 2011, shirat e rëndë tronditën sistemin e ujërave të zeza në Prishtinë, dhe përmbytur qindra shtëpi dhe shkaktuar pothuajse 500 milionë USD dëme (UNEP 2012).

Ndjeshmëria konsideron shkallën në të cilën ekspozimi ndaj një risku shkakton dëm. Në një rajon bujqësor për shembull, ekspozimi ndaj thatësirës mund të ketë pasoja të mëdha. Ndjeshmëria e rajonit ndaj ekspozimit kundrejt thatësirës është e lartë dhe situata graviton në ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi burimet ujore. Në veçanti, bujqësia mund të përjetojë pakësim të prodhimit, me humbje periodike shumë të mëdha, sikurse dhe mbështetja në energjinë hidrike mund të bëhet më pak e besueshme. Bujqësia në Ballkanin Perëndimor ka një ndikim të rëndësishëm në *ndjeshmërinë* e rajonit ndaj ndryshimeve klimatike. Pothuajse gjysma e tokës në rajon përdoret për bujqësi, 19 për qind për kullota dhe 29 për qind është tokë e punueshme. Bujqësia kontribuon mesatarisht me 17 për qind të PBB-së të Ballkanit Perëndimor dhe një pjesë e madhe e popullsisë për punë është e angazhuar në bujqësi, i cili është dhe sektori punëdhënës më i rëndësishëm në rajon. Vendet e rajonit, në bazë të vlerësimit të faktorëve ekspozim-ndjeshmëri, janë shumë të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike (*Ibid.*). Nga një vlerësim që u është bërë vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është më e ndjeshmja ndaj ndryshimeve klimatike dhe Kroacia më pak e ndjeshmja (UNEP 2012).

Përshtatja është një strategji e menaxhimit të riskut që synon të përgjigjet ndaj efekteve të pashmangshme të ndryshimeve klimatike, si dhe për të rrisë elasticitetin - aftësinë për t'iu përgjigjur një ndryshimi të gjendjes së mjedisit, duke i rezistuar dëmit dhe duke u rikuperuar shpejt. Kapaciteti përshtatës nënkupton aftësinë e institucioneve sociale, ekonomike dhe politike për t'iu përgjigjur ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Ekosistemet me një kapacitet më të lartë për t'u përshtatur, janë më pak vulnerabël ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Për rajonet, vendet ose sektorët ekonomikë, kapaciteti për t'u përshtatur, në mënyrë të ngjashme përcakton shkallën e tyre të cenueshmërisë; vendet me një qeverisje të mirë dhe ekonomi të qëndrueshme janë të avantazhuar në kapacitetin e tyre përshtatës. Jo rastësisht, Kroacia ka kapacitetin më të lartë përshtatës nga pesë vendet e përfshira në indeks (Mali i Zi e Kosova nuk janë përfshirë në analizë). Maqedonia ka kapacitetin më të ulët përshtatës, ndërsa Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia renditen midis.

Në Shqipëri, burimet hidrike prodhojnë më shumë se 95 për qind të energjisë elektrike të vendit, por më 2007, ato përbënin vetëm 12 për qind të totalit të furnizimit të energjisë në vend. Në total, pjesa e kërkesës totale për energji, mbuluar nga energjia e rinovueshme, duke përfshirë atë hidrike, ra nga 42 për qind në vitin 2000, në 22 për qind në vitin 2007 (*Ibid.*). Rritja e pritshme e temperaturave mesatare vjetore dhe sezonale të ajrit dhe rënia e sasisë së reshjeve mesatare vjetore e sezonale në Shqipëri, në afatgjatë, ka të ngjarë të shkaktojë një reduktim prej 60 për qind në prodhimin e energjisë së rinovueshme. Pra, ndërsa energjia hidrike mund të ndikojë pozitivisht në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, mbështetja e vendit në këtë energji, mund të rrisë ndjeshmërinë e vendit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, duke shkaktuar një rreth vicioz.

Regjimi i reshjeve është gjithashtu i rëndësishëm për bujqësinë, e cila është ende shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare. Bujqësia punëson gati gjysmën e forcës së punës dhe gjeneron një pjesë të konsiderueshme të PBB-së kombëtare. Ndonëse sektorët në zhvillim si tregtia dhe shërbimet, po pakësojnë përqindjen e përgjithshme të bujqësisë në ekonominë shqiptare, kjo fushë pritet të vazhdojë të dominojë.

Plani i veprimit kuadër i Evropës Jug-Lindore për përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës

Të gjitha vendet e Ballkanit aspirojnë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe statusi i një vendi në lidhje me anëtarësimin në BE, është tregues i stabilitetit të tij. Kuadri për negociatat e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, i quajtur Procesi i Stabilizim-Asociimit ka tri qëllime: stabilizimin e vendeve dhe nxitjen e tranzicionit të tyre të shpejtë drejt ekonomisë së tregut, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe anëtarësimin përfundimtar në BE. Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia gëzojnë statusin e vendit kandidat, ndërsa Kroacia është bërë vend anëtar më 1 korrik 2013. Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova janë vende kandidatë potenciale, ndërsa Shqipëria më qershor 2014 fitoi statusin e vendit kandidat. Vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me shumë probleme të ngjashme në rrugën e stabilizimit - kontestime të vazhdueshëm kufijsh dhe enklava etnike, ekonomi gri, korrupsion, krim i organizuar dhe efekte të krizës ekonomike globale. Por, secili prej vendeve të Ballkanit Perëndimor gjithashtu ka rrethanat dhe sfidat e tij.

Katër nga shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë përfshirë plane përshtatjeje në komunikimet e tyre kombëtare ndaj KKKBNK. Këta plane përmbajnë deklarata të përgjithshme që shprehin synimin për të miratuar strategji më të hollësishme në lidhje me sfida të caktuara dhe janë tregues të drejtimit që një vend pritet të ndjekë. Gjithashtu, lidhur me pasojat e ndryshimeve klimatike, gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (përfshijtur Kosovën) janë anëtarë themelues të Qendrës së Menaxhimit të Thatësirës për Evropën Juglindore, misioni i së cilës është “të koordinojë dhe lehtësojë, vlerësimin, zhvillimin dhe aplikimin e mjeteve të menaxhimit të riskut të thatësirës dhe politikave në Evropën Juglindore, me qëllim përmirësimin e gatishmërisë ndaj thatësirës dhe reduktimin e ndikimeve të saj”⁴⁶.

Në kuadër të KKKBNK, Shqipëria synon në afat të shkurtër të përqendrohet në përmirësimin e sistemit të saj të monitorimit dhe sistemeve paralajmëruese për zonat bregdetare, bujqësinë dhe pylltarinë (shih më gjerësisht më poshtë në “Komunikimet kombëtare”). Planet më afatgjata parashikojnë pjesëmarrjen në Qendrën e Menaxhimit të Thatësirës për Evropën Juglindore, ndërtimin e një sërë strukturave të mbrojtjes bregdetare dhe zhvillimin e

⁴⁶ Marrë më shtator 2013, nga <http://www.dmcsee.org/>

strategjive të menaxhimit të tokës, si nivelimi dhe tarracimi, së bashku me masat për menaxhimin e ujit për bujqësinë.

Planet e përshtatjes të Ballkanit Perëndimor nuk shkojnë në nivelin e detajeve të programeve ose projekteve specifike përshtatëse, por sigurojnë një kornizë gjithëpërfshirëse, që vendet mund ta ndjekin për të zhvilluar vetveten. Ajo fillon me bazat - përf forcimin e sistemeve për vëzhgimin e klimës, monitorimin dhe parashikimin, përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe menaxhimin e bazës së të dhënave, rritjen e kapaciteteve për të punuar me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare dhe përmirësimin e disponueshmërisë dhe zbatueshmërisë së modelimit të klimës në rajon. Sipas UNDP (2012), planet gjithashtu identifikojnë përmirësimet në njohuri dhe kapacitetin e nevojshëm për të zvogëluar rreziqet, që lidhen me ndryshimet klimatike dhe për të inkorporuar konsiderata social-ekonomike në analizë.

Ndonëse Ballkani Perëndimor është ende në fazën e zhvillimit të institucioneve, në tërësi ka pasur progres të dukshëm. Gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (përfshijtur Kosovën) kanë marrë pjesë në projekte të financuara nga UNDP-GEF dhe për pasojë kanë rritur kapacitetin e tyre për të menaxhuar përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës. Përmes procesit të përputhjes me kërkesat e vlerësimit dhe raportimit të KKKBNK, këto vende kanë demonstruar tashmë ndërgjegjësim dhe njohuri në rritje lidhur me ndryshimin e klimës. Përveç kësaj, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor marrin pjesë në *Iniciativën Dinaric Arc* dhe *Balkans Environment Outlook (DABEO)*⁴⁷, një platformë për vlerësimin e integruar mjedisor.

Plani i veprimit kuadër i Evropës Jug-Lindore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike është një forum rajonal me një fillim premtues, por nuk ka autoritet institucional apo politik. Në këto kushte, modele të tjera të bashkëpunimit rajonal mund të jenë në gjendje të përfshijnë planin në një skemë më të fortë me partnerët ndërkombëtarë dhe mundësi financimi të konsiderueshme. Procesi i Stabilizim Asociimit në BE mund të jetë shembull i një qasjeje të organizimit rajonal të përshtatjes. Aktualisht, BE-ja financon nëpërmjet ECRAN⁴⁸ (zëvendësoi RENA-n në mars 2013), i cili ofron një mundësi për koordinimin e strategjive të

⁴⁷ DABEO është një proces raportimi nënrajonal; raporti DABEO është një vlerësim i integruar mjedisor, ekzaminim nënrajonal dhe sintezë e situatës mjedisore në malet e Ballkanit, që përfshin pjesë të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Greqisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë.

përshtatjes rajonale. Gjithashtu, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë tashmë të angazhuar në proceset dhe në strukturën e ECRAN-it, por çështja nëse ky organizim ka më shumë kuptim për periudhën e tranzicionit drejt anëtarësimit në BE sesa në afat të gjatë, vlen të merret në konsideratë.

Konventat Alpine dhe Karpate⁴⁹ ndonëse lidhen më shumë me Konventën mbi Diversitetin Biologjik sesa me KKKBNK, ofrojnë një platformë për bashkëpunim për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm për Ballkanin, model të cilin Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), si lojtar i pavarur, mund ta përdorë për zhvillimin e një Konvente për Ballkanin. Perspektiva e një konvente për Ballkanin Perëndimor (të Harqeve Dinarike), mundet megjithatë të sigurojë një platformë për strategjitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike rajonale dhe mund të jetë në gjendje të sjellë të gjitha marrëveshjet ekzistuese së bashku nën një strehë.

Sidoqoftë, çdo skemë e re projektuar për të koordinuar përshtatjen në Ballkanin Perëndimor do të bënte mirë të merrte në konsideratë grupin e organizatave, programeve, iniciativave dhe marrëveshjeve që aktualisht kontribuojnë në projektet dhe strategjitë e adaptimit në rajon. Ideja e të pasurit të një mekanizmi gjithëpërfshirës përshtatës rajonal mund të jetë tërheqëse, por në dritën e përpjekjeve të panumërta të bëra, qasja më e mirë e përgjithshme mund të vijë nga një njohje e kontributit që çdo komponent ofron për kauzën.

Përmbledhje

Secili prej vendeve të Ballkanit Perëndimor përballet ndër të tjera me sfidat e tij të stabilitetit politik dhe ekonomik, ndryshimet demografike dhe ndërtimin e institucioneve. Nga këto vende, Kroacia, me kapacitetin më të lartë adaptiv dhe ekspozimin e ndjeshmërinë më të ulët, është vendi më pak i riskuar nga ndryshimi i klimës në rajon, ndërsa ekspozimi dhe ndjeshmëria e lartë e Shqipërisë e renditin atë si më të riskuarën. Renditja përgjithësisht e ulët e kapacitetit përshtatës të rajonit pasqyron vështirësinë e këtyre sfidave dhe kohën relativisht të shkurtër që vendet kanë për të bërë progres. Planet individuale të përshtatjes të vendeve dhe plani i veprimtimit kuadër i Evropës Jug-Lindore ndaj ndryshimeve klimatike, janë fillime

⁴⁸ ECRAN: Environmental and Climate Regional Accession Network.

⁴⁹ Marrë më shtator 2013, nga

<http://www.unep.org/roe/ActiveintheCarpathians/tabid/54595/Default.aspx>

premtuese, dhe pjesëmarrja në *GEF*, *Harkun Dinarik*, *Balkans Environment Outlook* dhe procesin e Stabilizim-Asociimit të BE-së janë dëshmi e progresit.

E gjithë kjo veprimtari hedh themelet për punën edhe më të vështirë rajonale që shtrihet përpara. Duke qenë se burimet ujore në rajon kanë një ekspozim dhe ndjeshmëri të lartë ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatet e sektorit të bujqësisë dhe energjisë janë të lidhura ngushtë me sektorin e ujit, një strategji rajonale për menaxhimin e burimeve ujore duket të jetë çelësi për sukses i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkan. Me kaq shumë lumenj ndërkufitarë dhe basene liqenesh, vendet e rajonit kanë shansin më të mirë që të menaxhojnë burimet e tyre ujore në mënyrë bashkëpunuese, qoftë nëpërmjet një marrëveshjeje ekzistuese, nëpërmjet një të reje, apo disave dypalëshe.

Metodologjia

Çështja e ndryshimit të klimës i takon dekadave të fundit dhe gjatë kësaj kohe sa vjen e është bërë më shumë pjesë e diskutimeve dhe analizave të forumeve të shumta ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare. Si kundërpërgjigje për këtë proces, është formuluar një kuadër ligjor dhe institucional në të gjithë nivelet. Kjo ka ndodhur edhe në Shqipëri, ku çështja e ndryshimit të klimës, ndonëse nuk është ‘çështja mjedisore e ditës’, ka gjetur vendin e saj në aktet juridike, politikat, strategjitë, që udhëheqin punën e institucioneve shtetërore për të përmbushur objektivat kombëtarë për këtë çështje.

Kjo pjesë analizon evoluimin ligjor e institucional shqiptar në përgjigje të ndryshimit të klimës, në kuadër të procesit të integrimit në BE, parë në aspektin metodologjik. Për të realizuar këtë, është nevojitur ekzaminimi i llojeve të ndryshme të metodave dhe analizave, të cilat mund t’i përshtaten studimit të aspekteve juridike e politike të ndryshimit të klimës. Në zgjedhjen e një metodologjie të përshtatshme ose një përzierjeje të metodologjive të ndryshme, është marrë në konsideratë qëllimi i përgjithshëm i kërkimit, që është identifikimi i mangësive dhe shqyrtimi i mundësive.

Gjatë fazës së planifikimit të kërkimit, puna është përqendruar në kuadratin e kontekstit ligjor e të politikave, kontekstit teorik për analizimin e politikave për ndryshimin e klimës, si dhe metodat në aspektin më të ngushtë. Një mjet ka qenë analizimi i legjislacionit e politikave që lidhen njëherazi me ndryshimin e klimës dhe integrimin në BE. Për qëllime të këtij studimi, fushëprerja e legjislacionit e politikave të ndryshimit të klimës nga njëra anë, dhe integrimit

në BE nga ana tjetër, përfshin shumë disiplina, të tilla si: mjedisi, energjia, pylltaria, industria, transporti.

Planifikimi i kërkimit

Procesi i kërkimit në tërësi, mund të ndahet në dy faza të mëdha, përkatësisht planifikimi dhe zbatimi. Faza e planifikimit mund të ndahet më tej në nënfazat: përkufizimi i kërkimit dhe përzgjedhja e planit kërkimor (Hendrick *et al.* 1993).

Në literaturë, termi *planifikimi i kërkimit* përdoret në kuptimin e ngushtë, kuptim në të cilin barazon termin *metodë kërkimi*, në sensin e elementit kryesor të një strategjie kërkimi, ose në një kuptim më të gjerë (Punch 1998), si *një plan i përgjithshëm kërkimi*, duke përfshirë strategjinë, konceptet, pyetjen kush dhe çfarë do studiohet dhe mjetet për të mbledhur e analizuar të dhënat.

Në përputhje me sa më lart, janë formuluar pyetjet *çfarë, kush, ku* dhe *si*, duke ua përshtatur nevojave të kërkimit, i cili përqendrohet në ekzaminimin e kuadrit ligjor dhe institucional të politikave për ndryshimin e klimës në vend, në mënyrën si më poshtë:

- *Çfarë studiohet*: kuadri ligjor, përmbajtja e politikave, ndryshimi i klimës dhe ndikimet e tij në Botë, Mesdhe, Ballkan Perëndimor, Shqipëri; përgjigjja ndaj ndryshimit të klimës në të gjithë nivelet, skenarët e ndryshimeve klimatike, implikimet e ekonomisë, mjedisit, sigurisë, shëndetit; angazhimet e BE-së për ndryshimin e klimës, roli i saj në politikën globale të klimës, kërkesat për vendet anëtare dhe perspektivat për vendet në proces anëtarësimi, detyrimet e vendit tonë në këtë aspekt.
- *Kush/ cili(ët) studiohet(n)*: organizma, forume, nisma, rrjete institucionesh, qeveri, OJQ, aktorë, pjesëmarrës (stakeholders).
- *Ku studiohet*: në arenën ndërkombëtare, në Evropë, Komunitetin Evropian, Mesdhe, Ballkanin Perëndimor, Shqipëri, institucionet kombëtare.
- *Si studiohet*: metodat dhe teknikat që përdoren për të kryer studimin.


Elementët e mësipërm janë të ndërlidhur dhe si të tillë trajtohen gjatë zhvillimit të disertacionit, duke pasur parasysh qëllimin e kërkimit dhe mjetet bazë për të. Meqenëse një plan kërkimi përfshin *strategji kërkimi* dhe *teknika* për mbledhjen, analizimin e paraqitjen e të dhënave (Hendrick *et al.* 1993), le të vijojmë duke dhënë detaje për këto të fundit.

Strategjia e kërkimit

Metodat më të rëndësishme të analizës përfshijnë: analizimin e materialeve ligjorë, politikë, strategjikë, etj., nga burime dytësore, zhvillimin e analizës FDMK, analizën krahasuese, dy raste studimi, si dhe pjesëmarrjen e autorit në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe në trajnim të avancuar në fushën e përafrimit të legjislacionit mjedisor me *acquis-në* e BE-së.

Përgjithësisht kërkimi është cilësor, me elementë sasiorë. Sipas Punch (1998), kërkimi cilësor kërkon një situatë jetësore dhe një pamje gjithëpërfshirëse, ku mund të përzgjidhen disa tema dhe mund të bëhen shumë interpretime. Meqenëse çështja e ndryshimit të klimës trajtohet në mënyrë të integruar në politikat zhvillimore, edhe metodologjia e përdorur synon një qasje të integruar. Gjithashtu, strategjia kërkimore e zgjedhur për këtë punim, përmban parimin e trekëndorzimit të metodave, me qëllimin sikundër Denzin⁵⁰ (1978) shprehet, që të vilen përfitimet e secilës metodë, duke kompensuar edhe dobësitë e tyre.

Figura 7: Metodat në funksion të objektivit kërkimor (Burimi: Original)



Së pari, kryhet një *analizë dokumentesh*, përgjithësisht nga burime dytësore, e cila shërben si pikënisje për të realizuar një përmbledhje të situatës. Për këtë analizë, kur ka qenë e mundur, janë përzgjedhur burime vendase e të huaja, për të realizuar përplasjen e informacionit, me qëllim objektivitetin e tij. Së dyti, është kryer një analizë më specifike nga burime parësore

⁵⁰ Denzin N. është një ndër përkrahësit kryesorë të përdorimit të metodës së trekëndorzimit nga kërkuesit që punojnë me paradigme interpretuese, Marrë më nëntor 2012, në <http://www.strath.ac.uk/aer/materials/2designstrategiesineducationalresearch/unit5/triangulation/>

dhe dytësore, me qëllimin për të pasur akses në informacion më të hollësishëm, qoftë edhe të papublikuar (bëhet fjalë për situatën në Shqipëri). Në këtë analizim më të detajuar, është zbatuar edhe *vëzhgimi i pjesëmarrësit*, pra autorit, i cili jeton në Shqipëri, ku dhe punon si nëpunës publik. Në rastin e parë të studimit, autori ka shfrytëzuar informacione e të dhëna nga institucioni ku ai punon. Gjithashtu, janë kryer *komunikime personale* me zyrtarë nga Ministrinë e Mjedisit e të Integritimit Evropian të Shqipërisë, si dhe ekspertë shqiptarë e të huaj në kuadër të konferencave ndërkombëtare. Së treti, është përdorur metoda e *rastit të studimit*, duke synuar kalimin nga e përgjithshmja tek e veçanta dhe me qëllimin për të dhënë një kontribut konkret për aktorët dhe *stakeholder*-at. Qëllimi i një rasti studimi është që ‘duke paraqitur rastin dhe jo Botën’, të evidentojë dukurinë në studim, që nuk është lehtësisht e dallueshme në kontekstin e saj (Yin 1993). Sipas Punch (1998), një rast studimi është më tepër një strategji, sesa metodë dhe bazuar në klasifikimet sipas këtij autori, rasti i parë i studimit është i natyrës *instrumentale të veçantë* me elementë *parashikues*, ndërsa rasti i dytë i studimit është i natyrës *shpjeguese*.

Një element tjetër i strategjisë së kërkimit ka qenë përdorimi i analizës FDMK (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kufizimet, në anglisht SWOT), e cila synon të arrijë identifikimin e boshllëqeve dhe mundësive, nëpërmjet analizimit të faktorëve të brendshëm e të jashtëm, të dobishëm e të dëmshëm në arritjen e objektivave.

Metodat specifike për t’iu përgjigjur pyetjeve kërkimore

Së pari, le të flasim për *teknikat* e përdorura për mbledhjen e të dhënave. Kërkimi është mbështetur në të dhëna mbi legjislacionin, politikat, aktivitetet, pra kryesisht të dhëna cilësore. Por në studim ka edhe indikatorë, statistika, grafikë e të dhëna të tjera numerike, të cilët përbëjnë të dhëna sasiore.

Vëzhgimi i pjesëmarrësit mund të përdoret si një teknikë shpjeguese ose si një teknikë suplementare, madje edhe si teknika kryesore në një studim shpjegues. Në kushtet kur kërkimi në fjalë është kryesisht i natyrës shpjeguese, *vëzhgimi i pjesëmarrësit* është përdorur gjerësisht, sikurse ka ndodhur në rastin e studimit 2.

Pas mbledhjes së të dhënave, një pjesë e rëndësishme e kërkimit është analizimi i tyre dhe përkthimi në informacion të aplikuar. *Analiza e politikave* është një proces që përzgjedh dhe

rendit informacionin me qëllimin për të zbuluar lidhjet dhe për të siguruar shpjegime për vendimmarrësit, në mënyrë që ta kenë më të lehtë për të zgjedhur midis alternativave (Webber 1991). Procesi i analizimit të politikave ka fazat e tij si: përcaktimi i problemit, vendosja e kriterëve për vlerësim, identifikimi i politikave alternative, vlerësimi i këtyre politikave dhe zgjedhja mes tyre. Çështja e vendosjes së kriterëve të përshtatshme të vlerësimit, ka rëndësi për matur arritjen e ndonjë objekti. Në këtë kërkim, politikat e përzgjedhura lidhur me ndryshimin e klimës janë vlerësuar në kontekstin e fizibilitetit teknik, ekonomik e financiar dhe të operabilitetit administrativ, që nënkupton vlerësimin nëse kriteret e politikave përmbushin kërkesat për efektivitet, eficiencë, ligjshmëri, lehtësi administrative, etj. Një metodë tjetër e analizimit të të dhënave është *analiza FDMK* për të identifikuar kuadrin ligjor, politik e institucional kundër ndryshimit të klimës në Shqipëri. Këto metoda janë kombinuar me teknikat e shkrimit të memove (memo teorike e reflektive) dhe kodimit (zhvillim i koncepteve dhe zbulim i marrëdhënieve midis koncepteve e fenomeneve). Menaxhimi i të dhënave dhe paraqitja e tyre janë pjesë e rëndësishme e procesit të kërkimit. Paraqitja e tyre është bërë në tekstin e shkruar ose në anekse, në formë tabelash, grafikësh, skemash, etj.

Trekëndorçimi metodologjik është zbatuar si një mjet për të dhënë viston e vlefshmërisë së gjetjeve të kërkimit, me qëllim pakësimin e gjasave për keqkuptim. Në këtë metodë, parimi është që tre ose më shumë burime të konvergojnë në gjetje. Janë shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni: analizë e burimeve parësore (dokumente juridike, politikash, etj.), analizë FDMK, vëzhgimi i pjesëmarrësit, burime dytësore (libra, artikuj akademikë), raste studimore dhe komunikime personale.

Përsa i takon përgjigjes së pyetjeve kërkimore, kjo mund të bëhet duke përdorur metodologjitë që vijojnë: 1) mbledhje e të dhënave; 2) analizim i dokumenteve; 3) analizë FDMK; 4) analizë e kuadrit ligjor, politik e institucional për ndryshimin e klimës; 5) analizë krahasuese e kuadrit ligjor e politik me atë të BE-së; 6) analizë e boshllëqeve dhe identifikim i mundësive; 7) rekomandime politikash në nivel kombëtar.

Përmbledhje e metodave dhe kufizime të metodologjisë së përdorur

Më lart u dhanë orientime lidhur me çfarë, kush/ cili dhe ku do të studiohet, si dhe për faktin sesi do të kryhet analiza në tërësi dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore në veçanti. Për një

studim dhe kërkim më të detajuar, kryesisht me qëllim dhënien e rekomandimeve për përmirësim të kuadrit ligjor, politik e institucional lidhur me ndryshimin e klimës, është zgjedhur teknika e analizës së mangësive (boshllëqeve). Përmbledhtasi, gjatë fazave të ndryshme të kërkimit, do të ndërmerren hapat si më poshtë vijon:

Analiza e përmbajtjes së dokumenteve juridikë e politikë, me qëllimin:

- për të krijuar sfondin në të cilin kryhet kërkimi, krijuar bazën për krahasim e vendosje objektivash dhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e situatës, duke shfrytëzuar literaturën dhe konventën ndërkombëtare (KKKBNK), ligjin dhe *acquis-ë* e BE-së, informacione të detajuara e statistikore, raporte vlerësimi, etj.;
- për të krijuar një panoramë të bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal (evropian, mesdhetar, në Ballkanin Perëndimor) për parandalimin dhe lehtësimin e ndikimeve të ndryshimit të klimës, duke u përqendruar kryesisht në implikimet ekonomike e mjedisore të ndryshimit të klimës, duke shfrytëzuar informacionin nga forumet ndërkombëtare e rajonale të fushës dhe literaturën shkencore e politike;
- për të kryer një analizë FDMK të situatës në vend, në aspektin ligjor, politik, institucional, mjedisor, etj., duke shfletuar materiale juridike, politike, strategji e plane kombëtare, raporte vlerësimi (KE), duke shfrytëzuar të dhëna nga artikuj shkencorë, vjetarë statistikorë, botime zyrtare të institucioneve brenda ose jashtë vendit;
- për t'u thelluar në kërkime më shteruese, si nëpërmjet rasteve të studimit, qëllimi i përdorimit të të cilëve është që, nga konsideratat e përgjithshme të kalohet tek të përveçmet dhe të jepet një kontribut i prekshëm, me mundësi aplikimi në fushën e ndryshimit të klimës, duke shfrytëzuar përvojën e përparuar evropiane, bazën ligjore, kuadrin politik dhe institucional të Komunitetit Evropian.

Analiza FDMK

Analiza FDMK është një mjet i mirë për të përshkruar gjendjen në zonën e shqyrtuar dhe rrjedhimisht për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për çështjen në fjalë, në Shqipëri. Pjesa e analizës për fuqitë e dobësitë e FDMK është bërë në një mjedis statik, ku fuqitë përfshijnë karakteristikat statike pozitive, ndërsa dobësitë theksojnë karakteristikat statike negative. Bazuar në këta faktorë statikë pozitivë e negativë, shqyrtimi i forcave pozitive e

negative që vijnë nga mjedisi i jashtëm dinamik, çon në identifikimin e mundësive dhe kërcënimeve. Krahas faktit të pjesëmarrjes së vendit në konventa mjedisore ndërkombëtare, është shqyrtuar kuadri ligjor, politik e konceptual kombëtar për të luftuar ndryshimin e klimës. Gjithashtu, janë shqyrtuar aspekte të funksionimit të sistemit të administrimit publik e të politikave publike. Kriteri bazë në identifikimin e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve ka qenë përzgjedhja e faktorëve që ndikojnë në brishtësinë e çështjes së klimës në vend. Ky ka qenë kushti për filtrimin e informacionit të marrë nga dokumentet politikë e komunikimet personale.

Komunikime personale

Kjo mënyrë mbledhjeje e të dhënave është bërë kryesisht për arsye të trekëndorzimit të të dhënave për analizën FDMK, e cila kërkon mbështetjen jo vetëm në analizën e dokumenteve, por edhe në komunikimet personale me ekspertë të fushës(ave) në institucionet shqiptare ose ekspertë të huaj në konferenca ose trajnime ndërkombëtare, si dhe për procedurë rishikimi e vlerësimi për pjesët më kritike të informacionit.

Metodologjia e përdorur ka disa *kufizime*, të cilat autori i vlerëson si më poshtë:

Në trajtimin e ndryshimit të klimës si dukuri, ekzistojnë të *dy shkolla kryesore mendimi*: 1. Shumica e shkencëtarëve të klimës mendojnë se veprimtaria e njeriut, veçanërisht sa i takon konsumit të karburanteve fosile dhe çlirimit të gazeve serrë në atmosferë, po ndikon në rritjen dhe shtrirjen e efektit serrë, me pasoja në ndryshimin e klimës; 2. Një numër i konsiderueshëm shkencëtarësh dhe ekspertësh e kundërshtojnë këtë këndvështrim dhe mbështetin mendimin se temperatura e Tokës dhe klima mund të kenë ndryshuar për arsye natyrore, nga faktorë si dielli, aktiviteti vullkanik, etj. Ndër dy shkollat e mendimit, autori ka zgjedhur të parën, atë ‘zyrtaren’, e cila ka bashkuar qëndrimet e forumeve politike botërore, si ai i Kombeve të Bashkuara, që kanë themeluar Protokollin e Kiotos për të mbajtur nën kontroll emetimet e gazeve që shkaktojnë efektin serrë.

Po kështu, zgjedhja e përkufizimit të ndryshimit të klimës dhe këndvështrimit ndaj kësaj dukurie, është një çështje zgjedhjeje personale e autorit, e cila ka implikime për koherencë gjatë gjithë procesit kërkimor. Çdo zgjedhje tjetër, si në shkollë, ashtu edhe në përkufizim, mund të çonte në përfundime të tjera.

Tema ka karakter teorik, ndaj përzgjedhja e mirë e literaturës, burimeve të tjera referuese, metodologjisë dhe orientimi drejt vërtetimit të hipotezave dhe përgjigjes së plotë e të saktë të pyetjeve kërkimore, mund të përbëjnë kufizime të saj. Një kufizim në këtë aspekt është niveli modest i saktësisë së informacionit nga burimet zyrtare shqiptare, sikurse dhe pamjaftueshmëria e të dhënave e statistikave, me qëllim përdorimin e tyre për vlerësim krahasues dhe zbatimin në çdo rast të metodës së trekëndorzimit. Mund të përmenden si kufizime po kështu, niveli modest i monitorimit dhe raportimit mjedisor në Shqipëri, si dhe përditësimi i rrallë dhe joperiodik i informacionit mjedisor nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Sikurse është përmendur edhe më lart, studimi synon të arrijë në përfundime të vlefshme për ligjvënësit dhe politik-bërësit, si dhe të japë një material teorik dhe studimor të vlefshëm për ekspertët e fushës (legjislacion mjedisor dhe menaxhim të politikave mjedisore), por mbart kufizim kohor në aplikueshmëri, për shkak të vetë dinamikës së procesit integruar, në të cilin *progresi* është kryefjala.

PJESA II

ÇËSHITJA E NDRYSHIMIT TË KLIMËS PËR SHQIPËRINË, SI NJË PREJ SFIDAVE PËR INTEGRIMIN NË BASHKËSINË EVROPIANE - ANALIZË

Shqipëria

Një përmbledhje e shkurtër e natyrës dhe ekonomisë së vendit

Republika e Shqipërisë ndodhet në Evropën Juglindore, në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, ku laget nga deti Adriatik dhe deti Jon. Relievi i vendit është në tërësi malor, me zona malore dhe kodrinore që mbulojnë 77% të sipërfaqes së vendit dhe me një lartësi mesatare prej 708 metrash, që është sa dyfishi i mesatares evropiane (AMP 2010).

Klima në Shqipëri është tipike mesdhetare në perëndim, me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Ndërsa në pjesë të tjera, posaçërisht ato verilindore ka ndikime të klimës kontinentale dhe malore. Mesatarja vjetore e temperaturës luhet nga 11.3°C në zonat malore, deri në 21.8°C në zonat e ulëta dhe bregdetare. Mesatarja vjetore e reshjeve është rreth 1485mm/vit, por regjimi dhe shpërndarja e tyre varion së tepërmi. Pjesa juglindore e vendit ka sasi të pakta reshjesh, me një mesatare vjetore prej më pak se 600mm/vit (*Ibid.*). Muaji më i pasur me reshje është nëntori, ndërsa muajt më të varfër me reshje janë korrik-gusht. Në tërësi ka thatësi gjatë verës dhe lagështi të madhe në dimër.

Shqipëria është e pasur me burime ujore; rrjeti i saj gjeologjik ka një gjatësi totale prej 50,000km (*Ibid.*). Ka shumë lumenj, ujëra nëntokësorë dhe burime të llojeve të ndryshme. Lumenjtë, shumica e të cilëve derdhen në detin Adriatik, janë të rrëmbyer dhe kanë forcë të madhe erozioni. Ata përbëjnë një burim të rëndësishëm të energjisë elektrike në vend. Liqenet, përveç rëndësisë turistike, përdoren për qëllime vaditjeje dhe në disa raste për mbarështimin e peshkut. Ujërat nëntokësorë përbëjnë një pasuri natyrore shumë të rëndësishme, pasi janë burimi kryesor për ujë të pijshëm. Ata varen kryesisht nga reshjet, që janë faktori kryesor që ndikon në nivelin e tyre.

Pyjet zënë një pjesë të mirë të sipërfaqes së tokës (rreth 36%). Ata kanë funksion prodhues (ndërtim, industrinë e drurit, ngrohje) dhe mbrojtës (kundër erozionit, për të ruajtur biodiversitetin dhe për rekreacion). Pyjet natyrore përbëjnë rreth 91% të sipërfaqes, ndërsa ata të krijuar nga njeriu rreth 9% (AMP 2010). Në vitet 1951-1988 janë ripyllëzuar rreth 200,000ha, ndërsa janë përmirësuar rreth 497,000ha pyje. Kërcënimi më i madh i pyjeve në Shqipëri është zjarri. Nëpërmjet zjarreve (më së shumti të qëllimshme), janë shkatërruar mijëra hektarë pyje dhe kullota. Shqipëria është gjithashtu e pasur me një bimësi prej rreth 3.500 specimesh (Ceka 1999).

Figura 8: Harta e Shqipërisë



Burimi: Shqipëria.com, nxjerrë nga Interneti më 15 shkurt 2012, në <http://www.shqiperia.com/shqiperia/pozita.php>

Shqipëria është e pasur me burime natyrore që mund të sigurojnë energji të konsiderueshme, të tilla si nafta, gaz, qymyrguri, druri, si dhe energjia hidrike e burime të tjera të rinovueshme (*Ibid.*). Në vitin 1992, rreth 70% e prodhimit parësor të energjisë vinin nga nafta dhe qymyrguri.

Spektori i energjisë elektrike është më i rëndësishmi i energjisë, ndërsa energjia hidrike përbën 90% të energjisë elektrike të prodhuar (AMP 2010). Burimet hidrike mund të konsiderohen

burime energjie të pastër, pasi përgjithësisht e mbrojnë mjedisin. Megjithatë, kapaciteti i prodhimit nga hidrocentralet është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e vendit për energji gjatë gjithë vitit. Kjo ka çuar në periudha relativisht të gjata të mungesës së energjisë gjatë viteve të fundit. Për më tepër dihet varësia nga klima e prodhimit të energjisë hidrike. Dimra të thatë (në disa raste në vijimësi) kanë nxjerrë më tepër në pah cenueshmërinë ekonomike të vendit nga ndryshimi i klimës. Për pasojë të kësaj varësie, Shqipëria është kthyer në vend importues të elektricitetit neto. Për fat të keq, në Shqipëri ka probleme të trashëguara të prodhimit, shpërndarjes dhe përdorimit të burimeve të energjisë, për shkak të përdorimit një teknologjie jo shumë eficiente. Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike ka gjithashtu nevojë për modernizim dhe në sistem ka shumë lidhje dhe ndërhyrje të parregullta. Nivelet e eficiencës të energjisë janë gjithashtu të ulëta. Përveç rrjetit të amortizuar dhe abuzimeve me të, edhe ndërtesat janë të izoluara keq dhe me pajisje elektrike me rendiment të ulët të shfrytëzimit të energjisë.

Përdorimi i elektricitetit për frymë të popullsisë përse i përket mesatares është relativisht i ulët (1427 kWh konsum energjie elektrike në 2003 në krahasim me mbi 5000 kWh po atë vit në Itali). Megjithatë, kërkesa po shtohet me shpejtësi (1165 kWh më 2000) etj. Për të plotësuar mungesat e energjisë, veçanërisht në periudhën e dimrit, konsumatorët i janë drejtuar shfrytëzimit të pajisjeve ndihmëse (si gjeneratorët me naftë) për furnizimin e banesave të tyre ose aktiviteteve tregtare. Këto pajisje e shtojnë nivelin e ndotjes së ajrit në zonat urbane.

Po kështu, tregu shqiptar nuk ka arritur të plotësojë të gjitha nevojat për furnizim me hidrokarbure. Falë zhvillimit të sektorit të transportit dhe rritjes së kërkesës për naftë dhe benzinë, importet e karburanteve fosilë të lëngshëm kanë ardhur në rritje më vitet e fundit (AMP 2010).

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit, ndonëse kontributi i saj është ulur me kalimin e viteve. Politikat e zhvillimit bujqësor në të shkuarën ishin të orientuara drejt intensifikimit dhe ekspansionit në të njëjtën kohë. Toka bujqësore gati u 2.5-fishua në vitin 1989 krahasuar me vitin 1938, si pasojë e tharjes së moçaleve dhe e hapjes së tokave të reja bujqësore në zona kodrinore dhe malore. Megjithatë, popullsia u shtua me një ritëm më të madh, ndaj toka e punueshme për person u pakësua në masën 10% midis viteve 1950 dhe 1986 (Ceka 1999).

Në ditët tona, toka e punueshme është tërësisht e privatizuar dhe sektori i bujqësisë po pëson reforma të vazhdueshme. Në tërësi privatizimi i sektorit të bujqësisë u shoqërua me një rënie të prodhimit të bimëve dhe frutikuturës dhe rritje e prodhimeve të bulmetit e perimeve. Rritja e iniciativës së lirë në aktivitetin bujqësor ka patur ndikimin e saj në mjedis nëpërmjet erozionit të tokës (plugimit të shpateve dhe mbikullotjes), shpyllëzimit, kontrollit të dobët të sistemit të vaditjes, e për pasojë shpërdorimit të ujit. Copëzimi i tokave si rezultat i presioneve të urbanizimit dhe ndryshimeve në pronësinë e tokave, ka penguar modernizimin e sektorit. Nga ana tjetër, mbarështimi i varieteteve vendase, po vjen duke u pakësuar (AMP 2010).

Meqenëse krahasuar me dekadat e mëparshme, bujqësia si sektor ka pësuar rënie, është ulur dhe konsumimi i plehut inorganik dhe i pesticideve, si dhe përdorimi i ujit për vaditje. Sidoqoftë, gjatë 20 vjetëve të fundit ka lindur nevoja të kryhen investime të konsiderueshme në rrjetet e sistem-kanalizimeve të vaditjes dhe kullimit. Kështu, qysh nga viti 1994, kanë filluar programet për rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, të financuara nga Banka Botërore, krahas investimeve të vazhdueshme nga ana e buxhetit të shtetit.

Erozioni i tokës në Shqipëri është 100 deri në 1000 herë më i madh se në shumicën e vendeve evropiane (Buchroithner 2010). Ekzistojnë disa arsye natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu të kësaj dukurie. Së pari, vetë materiali dhe pjerrësia e terrenit që është kryesisht kodrinor dhe malor, e favorizojnë erozionin. Së dyti, karakteristikat e klimës janë të tilla që shpërndarja kohore e reshjeve është e çrregullt dhe intensiteti më së shumti i lartë. Zonat e mbuluara me bimësi përbëjnë vetëm gjysmën e së tërës, ndaj dhe efekti mbrojtës i bimësisë është i kufizuar. Ndërsa ndikimet e njeriut (antropogjenike) janë të shumta dhe një pjesë e tyre të shmangshme: dëmtimi i bimësisë, prerja e shkurreve dhe pyjeve, braktisja e përkohshme apo e përhershme e tokës, përdorimi i praktikave të papërshtatshme për shfrytëzimin dhe kultivimin e tokës. Erozioni ka prekur edhe bregdetin; ai mund të shihet në shumë pjesë të bregdetit shqiptar. I gjithë bregdeti nga Vlora në Gjirin e Ftelisit (Greqi) është thuarje i abraduar, me një intensitet erozioni 20-50 cm në vit (*Ibid.*).

Figura 9: Pishë e dëmtuar nga erozioni i bregut dhe kripa e ujit të detit me nivel të rritur, Plazhi i Shëngjinit, gusht 2008



Burimi: Instituti i Politikave Mjedisore, marrë më korrik 2012 nga:
http://www.iep-al.org/index.php?option=com_content&view=article&id=58&Itemid=66

Në vitin 2011, sipas të dhënave të INSTAT-it, pas censusit të fundit, për herë të parë popullsia në zonat qytetase i kaloi ato në zonat fshatare. Kjo tendencë në rritje e migracionit të popullsisë drejt qytetit, pritet të lejë pasojat e saj në sektorin e bujqësisë dhe në veçanti në tokën e punueshme, në aspektin e erozionit, uljes së produktivitetit dhe ç'është më e keqja, shkretëtirëzimit të saj.

Përsa i takon pyjeve, para vitit 1990, dëmtimi i tyre është bërë për shkak të hapjes së tokave të reja bujqësore. Prerja e pyjeve ka vijuar me një hap më të shpejtë në periudhën e tranzicionit, kryesisht si pasojë e prerjeve masive ilegale. Shkaqe të tjera kanë qenë dhe janë: zjarret (të qëllimshme ose nga pakujdesia), përdorimi i tokave pyjore për ndërtime ilegale, kontrabanda e masës drusore, ndotja e atmosferës dhe sëmundjet në pyje (Buchroithner 2010).

Para viteve '90, pjesa më e madhe e pyjeve të prerë përdorshin për industrinë e përpunimit të drurit. Sot struktura e përdorimit ka ndryshuar, me pjesën më të madhe të lëndës drusore të përdorur si lëndë djegëse për konsum shtëpiak.

Efekti kryesor në mjedis i aktiviteteve të pa ose të keq-administruara pyjore, është pakësimi i sipërfaqes së pyllëzuar me pasojë erozionin e tokës, që sterilizon zona të mëdha malore dhe dëmton cilësinë e ujit, duke shtuar ngarkesën e tij me sedimente. Humbja e sipërfaqes së mbuluar me dru, ndikon gjithashtu shumë negativisht në dëmtimin e biodiversitetit, duke zhdukur shumë habitate për një mori specimesh të botës bimore dhe shtazore.

Spektori i mjedisit

Territori i Shqipërisë ka qenë populluar qysh në kohët Paleolitike (2,6 Ma-10Ka), ndaj dhe ndikimi i njeriut në mjedis ka qenë shumë i zgjatur dhe për rrjedhim pasojat janë serioze (Buchroithner 2010).

Në të shkuarën moniste, problemet më të rëndësishme mjedisore kanë qenë ndotja industriale dhe bujqësore, zhvillimi i një bujqësie intensive pa kriter dhe mungesa e plotë e trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve bashkiake (Ceka 1999). Zhvillimi i industrisë së rëndë dhe përdorimi i teknologjive jomiqësore ndaj mjedisit, shkaktuan pasoja të rënda në ndotjen e ajrit, ujit, tokës, si dhe në shëndetin e popullsisë të zonave të prekura. Pasojat e zhvillimit të kësaj industrie dhe të bujqësisë intensive ndjehen dhe sot, duke u manifestuar me ndotje të tokës nga metalet e rënda dhe zhvillim të madh e të përhapur të erozionit të tokës.

Pra, faktorët kryesorë negativë që kanë ndikuar mjedisin shqiptar gjatë periudhës komuniste kanë qenë: përdorimi i teknologjive të vjetra në të gjithë degët e industrisë me një nivel të lartë ndotjeje; orientimi i gabuar i industrisë e bujqësisë, në disa raste vendosja e gabuar e objekteve industriale me pasoja të rënda për zona të caktuara; dhe mungesa e bazës ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e mjedisit. Por, sipas Buchroithner (2010), gjatë periudhës komuniste pati edhe disa faktorë zhvillimi që kanë ndikuar pozitivisht në mjedis: niveli i ulët i konsumit, niveli i ulët i transportit rrugor, përdorimi i materialeve ambalazhuese të riciklueshme, etj.

Në periudhën e tranzicionit politik dhe ekonomik, gjatë viteve '90, si pasojë e ndërprerjes së punës në shumicën e ndërmarrjeve industriale dhe përdorimit më të ulët të pesticideve në bujqësi, u vu re një ulje e ndotjes industriale. Po kështu, ndryshimet në strukturën e ekonomisë, si privatizimi, rritja e çmimit të energjisë, drurit, ujit dhe karburanteve, krijuan kushtet për mbrojtje më të mirë të mjedisit.

Nga ana tjetër, vendosja e një sistemi të ri politik në vend, në fillim të viteve '90, pruri zbatimin e reformave të ekonomisë së tregtisë së lirë, të cilat nga ana e tyre sollën shqetësime të reja mjedisore. Ndonëse ndotja industriale ra ndjeshëm për shkak të mbylljes së shumicës së industrive me teknologji të vjetër e u zhvilluan industri të reja, kryesisht të lehta dhe ushqimore, nuk pati ndonjë ndryshim të rëndësishëm në nivelin e ndotjes mjedisore. Një faktor i ri zhvillimi që filloi të kontribuonte gjithnjë e më shumë në ndotjen (veçanërisht atë të ajrit) ishte transporti rrugor. Edhe modelet e furnizimit me energji ndryshuan, duke kaluar nga qymyri dhe druri, tek nafta dhe gazi natyror. Zhvillimet e reja në sektorin e bujqësisë u pasuan nga një ulje e përdorimit të kimikateve, por nga ana tjetër, braktisja e tokës në zonat e thella, sikurse është përmendur dhe më lart, solli një rritje të erozionit të saj.

Situata e brishtë politike në vitet e para të tranzicionit, mungesa e një baze të plotë ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe mosfunksionimi i saj, çuan në dëmtimet masive të pyjeve nëpërmjet prerjeve ilegale apo zjarrvënieve, abuzimet me burimet natyrore si pyjet, kullotat, ujërat, minierat, dëmtimin e mjedisit urban për shkak të praktikave të ndërtimit ilegal dhe pa kushte higjienike, ndotjes së tokës kryesisht nga mungesa e një sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta bashkiake, etj. (Ceka 1999).

Në vitet që pasuan 1990, raporti i popullsisë urbane krahasuar me atë rurale erdhi duke u rritur në mënyrë të ndjeshme, çka solli rritjen e qyteteve, shoqëruar me probleme të ashpra mjedisore. Lëvizja e pakontrolluar e popullsisë shkaktoi degradim të vazhdueshëm të mjedisit urban dhe përkeqësim të kushteve higjienike. Po kështu, edhe fraksioni i mbetjeve urbane ndryshoi, në dëm të atyre organike dhe në favor të mbetjeve të pa-riciklueshme dhe vështirësisht të biodegradueshme (Buchroithner 2010).

Burimet e përtëritshme ujore në Shqipëri përdoren për qëllime urbane, industriale, bujqësore dhe prodhim energjie në HEC-e. Uji i pijshëm ende nuk sigurohet për të gjitha zonat e banuara

dhe gjatë gjithë kohës. Cilësia e tij, në disa raste dhe në varësi të sezonit nuk përmbush standardet evropiane (SNM 2007). Ka raste të cenimit të rëndë të cilësisë së ujit sipërfaqësor, veçanërisht kur ndodhet pranë burimeve të mëdha të ndotjes. Një tjetër dukuri negative e viteve të fundit është mbishfrytëzimi i burimeve ujore në zonat bregdetare.

Në Shqipëri sot rreth 10% e sipërfaqes së tokës gëzon statusin e zonës së mbrojtur. Krahasuar me rrjetin *Natura 2000* (i cili përfshin 18% të sipërfaqes së vendeve të BE-së), kjo sipërfaqe nuk është e mjaftueshme. Për më tepër, ka probleme të përputhshmërisë së këtyre zonave me habitatin natyror, sikundër dhe probleme të nivelit të mbrojtjes, që sipas SNM (2007) nuk është as i përshtatshëm dhe as i mjaftueshëm. Sipas po të njëjtit burim (zyrtar) rreth 19% e specieve bimore dhe shtazore janë sot të kërcënuara. Legjislacioni vendas për biodiversitetin mbron 308 specie bimësh dhe 338 lloje kafshësh (rreth 65% të specieve të rrezikuara).

Ndotja e zhurmës është kthyer sot në një problem të zakonshëm urban. Nivelet e lejuara të zhurmës gjatë ditës dhe natës kapërcehen në Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Burimet kryesore të zhurmës janë transporti, industria, biznesi dhe aktivitetet zbavitëse. Një tjetër ndotje, pasojë e iniciativës së lirë dhe zhvillimit pa kriter urban, është ajo vizive. Ndotjes vizive të bunkerëve dhe vendstrehimeve për raste agresioni ushtarak në kohë të monizmit, iu shtuan shtesat e objekteve dhe ndërtimet informale, pa arkitekturë dhe pa respektuar kushtet urbanistike, cenimi i sipërfaqeve pyjore, prishja e bukurisë së peizazhit, shfrytëzimi pa kriter i shtrateve të lumenjve, mbishfrytëzimi i bregdetit (shkëmbor dhe ranor), ndërtimet në vijën bregdetare, etj.

Monitorimi i mjedisit

Monitorimi i mjedisit është pjesë e rëndësishme e vlerësimit të gjendjes së mjedisit, zbatimit të strategjisë së tij, arritjes së rezultateve konkrete në përmirësimin e parametrave mjedisorë dhe përcaktimit të detyrave për të ardhmen. Në Shqipëri, gjendja e mjedisit vlerësohet nëpërmjet një sistemi monitorimi që përfshin disa institucione që janë përgjegjës për elementë të ndryshëm të mjedisit si ajri, uji, toka, etj., dhe treguesit e tyre. Mbi bazën e të dhënave të monitorimit, përgatitet raporti kombëtar i gjendjes së mjedisit, i cili shërben njëkohësisht dhe si udhërrëfyes për të ndërmarrë nisma ligjore me qëllim përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Sipas PKZ-MSA (2006), gjendja e mjedisit përcaktohet gjithashtu duke iu referuar:

1. Gjendjes së mjedisit kundrejt standardeve kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare;
2. Shkallës së ndikimit mjedisor të aktiviteteve të ndryshme;
3. Nivelit të shpenzimeve dhe efikasitetit të tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimit e degradimit mjedisor;
4. Shkallës së përputhjes së legjislacionit shqiptar dhe atij evropian në fushën e mjedisit;
5. Nivelit të zbatimit të këtij legjislacioni.

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1189, datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, Ministria e Mjedisit harton programin kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe bashkërendon punën për zbatimin e tij, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Në hartimin e këtij plani zhvillohet një proces konsultimi dhe bashkëpunimi me ministrinë, në fushën specifike që ato mbulojnë, për të përcaktuar të dhënat dhe treguesit që ajo do të grumbullojnë dhe përpunojnë për mjedisin. Gjithashtu, në këtë proces përfshihen dhe organet e qeverisjes vendore, të cilat përcaktojnë të dhënat e treguesit për mjedisin që ato kanë në administrim, sidomos për mjediset urbane, për administrimin e mbetjeve dhe ujërave, për pyjet e kullotat komunale, për shfrytëzimin e pasurive natyrore e minerare dhe për rregullimet në infrastrukturë. Programi kombëtar i monitorimit të mjedisit përcakton treguesit kryesorë të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ajër, në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore, në tokë, në det, në zonat bregdetare, në pyje e në larminë biologjike. Në programin kombëtar të monitorimit të mjedisit përfshihen dora-dorës tregues të rinj për monitorimin e mjedisit, në përputhje me treguesit e përdorur nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit janë:

1. Ministria e Mjedisit, e cila ngarkon strukturat në varësi si Drejtoritë e Shërbimit Pyjor dhe AKM-në, për monitorimin e disa treguesve. Ajo përgjigjet, gjithashtu, për regjistrimin dhe përpunimin e disa treguesve mjedisorë, në mbështetje të të dhënave të grumbulluara. Kjo ministri gjithashtu kryen, nëpërmjet AKM, inventarizimin e burimeve të ndotjes, përcakton karakteristikat e tyre dhe specifikon shpërndarjen sektoriale, organizon kontrollin e cilësisë së analizave të kryera për monitorimin e mjedisit, si dhe standardizimin e metodologjisë së tyre;

2. Ministria e Shëndetësisë, e cila monitoron disa tregues nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik dhe drejtorive rajonale të shëndetit publik;
3. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, e cila monitoron treguesit që kanë të bëjnë me administrimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe që monitoron disa tregues nëpërmjet Shërbimit Gjeologjik Shqiptar;
4. Ministria e Bujqësisë, e cila monitoron disa tregues nëpërmjet Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore;
5. Ministria e Mbrojtjes, e cila monitoron treguesit për ndërmarrjet dhe instalimet ushtarake brenda sistemit të saj;
6. Institucione monitoruese të specializuar, me të cilët lidhen kontrata, në bazë të procedurave të konkurrimit, të cilat kryejnë monitorimin e treguesve të dukurive natyrore e të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe të biodiversitetit;
7. Persona fizikë dhe juridikë, të cilët monitorojnë treguesit mjedisorë në nivel individual, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i lejes mjedisore.

Të gjitha rezultatet e monitorimit rakordohen nga institucionet monitoruese, duke shfrytëzuar kapacitetet e tyre monitoruese për tregues konkretë mjedisorë, rakordime që kryhen çdo vit. Për çdo tregues mjedisor, që matet apo llogaritet, cilësohet mënyra e përcaktimit, metoda e matjes, vendi i marrjes së mostrës, shpeshësia dhe njësia e matjes, mënyra e përpunimit dhe paraqitjes së të dhënave.

Të dhënat e mjedisit regjistrohen në regjistrat përkatës, në AKM dhe hidhen në bazën elektronike të të dhënave të mjedisit. Regjistrimi dhe hedhja e të dhënave në nivel qarku bëhet nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit. Institucionet monitoruese krijojnë bazën elektronike të të dhënave e të treguesve që monitorojnë, të cilat janë të hapura për publikun.

Ministria, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me të dhënat e siguruar nga monitorimi i mjedisit, përgatit dhe boton çdo vit raportin për gjendjen e mjedisit, të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave, si dhe përmbush detyrimet ndërkombëtare shtetërore për raportim të gjendjes së mjedisit. Ndërsa, Agjencitë Rajonale të Mjedisit përgatisin raportin e gjendjes së mjedisit në bazë qarku, i cili i paraqitet këshillit të qarkut e publikohet në formë elektronike.

Treguesit mjedisorë të gjendjes së mjedisit përfshijnë treguesit e dukurive natyrore dhe treguesit e cilësisë së mjedisit. Ndërsa treguesit e trysnisë përfshijnë treguesit mjedisorë të ndikimit në mjedis dhe treguesit e shkarkimeve të veprimtarive ndotëse. Më poshtë paraqiten treguesit mjedisorë të gjendjes së mjedisit, të cilët kanë lidhje me objektin e këtij studimi:

Tabela 4: Treguesit mjedisorë për dukurinë e ndryshimeve klimatike, precipitimet atmosferike dhe ajrin urban:

temperatura mesatare e ajrit	përmbajtja e lëndës së ngurtë, të pezullt në ajër
niveli i detit	përmbajtja e ozonit, O ₃ , në ajër
sasia e reshjeve atmosferike	përmbajtja e plumbit, Pb, në ajër
niveli i ujërave nëntokësore	përmbajtja e dyoksidit të squfurit SO ₂ , në ajër
përmbajtja e dyoksidit të squfurit, SO ₂	përmbajtja e oksideve të azotit, NO _x , në ajër
përmbajtja e oksideve të azotit, NO _x	përmbajtja e monoksidit të karbonit, CO në ajër
përmbajtja e plumbit, Pb	përmbajtja e hidrokarbureve në ajër

Burimi: VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009, me modifikime

Sipas strategjisë ndërsektoriale të mjedisit (SNM 2013-2020), një ndër objektivat e procesit të monitorimit mjedisor është rritja e numrit të stacioneve të monitorimit në përgjithësi dhe posaçërisht të monitorimit të ajrit urban në vitin 2020, krahasuar me situatën e deritanishme. Një tjetër objektiv është arritja e normave të shkarkimit në ajër dhe ujë të operatorëve të mëdhenj industrialë, sipas standardeve të përcaktuar në direktivat IPPC dhe LCP.

Elementët e zhvillimit që ndikojnë në gjendjen e mjedisit parë në aspektin juridik

Zhvillimi Urban

Në vitet që pasuan 1990, në Shqipëri, për shkak të migrimit të pakontrolluar të popullsisë, raporti i popullsisë urbane, krahasuar me atë rurale ka ardhur duke u rritur në mënyrë të ndjeshme, çka ka sjellë ndër vite një rritje konstante të mbipopullimit urban. Kjo dukuri, shoqëruar nga ndërtimet pa leje, sidomos në periferi të qyteteve, si dhe me mungesë të infrastrukturës së nevojshme, ka sjellë probleme të mprehta mjedisore.

Spektori i ndërtimit është zhvilluar shumë këto dy dekadat e fundit në Shqipëri. Ky aktivitet është përqendruar sikurse u përmend më lart, në zonat ekzistuese urbane, por edhe në zonat

bregdetare. Një numër i madh objektsh janë ndërtuar në zonën fushore bregdetare nëpër ngastra të vogla toke. Ky “bum ndërtimor” në tërësi është planifikuar dhe rregulluar në mënyrë të dobët. Një numër i madh ndërtimesh janë kryer në mënyrë informale dhe pa lejet e duhura.

Në kushte të tilla zhvillimi, si menaxhimi i gjendjes së mjedisit, ashtu dhe sigurimi i shërbimeve në infrastrukturën komunale për mbrojtjen e mjedisit, si p.sh. për grumbullimin e trajtimin e ujërave të mbetura dhe mbeturinave të ngurta, është tepër i vështirë në krahasim me rastin kur zhvillimi do të kryhej në mënyrë të përqendruar dhe të planifikuar (PKZ-MSA 2006). Sigurimi i shërbimeve në mbrojtje të mjedisit urban pengohet gjithashtu nga mungesa e mjeteve financiare brenda vetë sektorit publik.

Sipas SNM (2007) zhvillimi aktual urban shkakton përkeqësime të rëndësishme mjedisore të:

- Cilësisë së ajrit – çlirim i pluhurit nga ndërtimet, emetime nga gjeneratorët, nga pajisjet për ngrohjen e shtëpive, reduktim i hapësirave të gjelbra dhe emetime të rritura nga trafiku i shtuar;
- Sasisë së burimeve ujore – nxjerrja e ujit dhe shfrytëzimi i tij shpesh nuk bëhet siç duhet dhe nuk është në proporcion me popullatën. Po kështu, shkalla e humbjeve në rrjet në shumë nga sistemet e shpërndarjes vlerësohet deri në 75%;
- Cilësisë së ujit – ekziston një infrastrukturë e pamjaftueshme e grumbullimit të ujërave të zeza, ka rrjedhje nga kanalizimet e tyre dhe shumë pika shkarkimi komunikojnë me sistemet e kullimit të ujërave sipërfaqësore. Gjithashtu në përgjithësi ka mungesë të trajtimit të ujërave të zeza - ndonëse me ndihmë të huaj janë ndërtuar disa impiante për këtë qëllim. Mungesa e grumbullimit dhe trajtimit të përshtatshëm të ujërave të zeza nuk është në përputhje as me kërkesat ligjore Evropiane, as me ato kombëtare;
- Ndotjes së pamjes dhe zhurmës – zhvillimi i parregullt ka shpënë në krijimin e vendbanimeve të shpërndara, gjë që sjell një reduktim të dallimit midis zonave urbane dhe rurale, prej të sipërfaqeve pyjore, zhvlerësim të vlerave të peizazhit, ndotje të theksuar nga zhurma, ditën dhe natën.

Industria

Niveli i aktivitetit industrial, sikurse u përmend edhe më lart, në dy dekadat e fundit ka rënë në mënyrë të ndjeshme në krahasim me dekadat e mëparshme. Megjithatë, ndikimi në mjedis i pasojave të aktiviteteve të shkuara dhe i të rejave që janë krijuar, është i lartë në krahasim me rendimentin e prodhimit. Kështu për shembull, informacioni i paraqitur në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, tregon se shkarkimet e dioksidit të karbonit CO₂ për banor janë shumë më të ulëta se në shumicën e vendeve të industrializuara, por kontributi i shkarkimeve të CO₂ për PBB është shumë më i lartë sesa në vendet e industrializuara (AMP 2009).

Nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve, në minierat e kromit, bakrit dhe nikelit që ka Shqipëria, vijon që prej dekadash e me një teknologji të vjetruar dhe që ndikon së tepërmi në ndotjen e mjedisit. Për disa industri të mëdha janë marrë disa masa për të kufizuar ndotjen e mjedisit, si p.sh. trajtimi i ujërave të mbetura në rafinerinë e Ballshit dhe instalimi filtrave të pluhurit në fabrikën e çimentos së Elbasanit. Megjithatë rafineria e Ballshit, dhe në përgjithësi industria e naftës, mbeten joeficiente dhe të vjetëruara, duke sjellë nivele të larta të ndotjes së mjedisit (shkarkime në ajër, firo, rrjedhje dhe shkarkime në ujë) për njësi të prodhimit. Sipas AMP (2009), degët e industrisë që ndikojnë më shumë në ngrohjen globale në Shqipëri janë: prodhimi i kromit, hekurit, çelikut dhe çimentos.

Transporti

Transporti ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e mjedisit, kryesisht të zonave urbane, duke qenë një ndër burimet kryesore të ndotjes së ajrit dhe emetimit të gazeve serrë. Transporti në Shqipëri dominohet nga ai rrugor. Vëllimi i transportit hekurudhor në tërësi dhe për udhëtarët në veçanti, është i ulët. Po kështu, edhe vëllimi i trafikut ajror është i ulët në krahasim me shumicën e vendeve Evropiane.

Numri i automjeteve në përdorim është rritur ndjeshëm dhe pritet të vijojë tendenca në rritje (AMP 2009). Sidoqoftë, pronësia e mjeteve të transportit (57 mjete për 1000 banorë) në Shqipëri është e pakët në krahasim me shumicën e vendeve evropiane (Vendet e EEA: mbi 350 për 1000 në vitin 2000) (SKShM 2010). Po ashtu, numri i kilometrave për person është i ulët.

Megjithatë, transporti po shkakton ndikime serioze në zonat urbane. Në mënyrë të veçantë cilësia e ajrit në qendrat kryesore urbane, është mjaft e përkeqësuar dhe kjo shkaktohet kryesisht nga nivelet e larta të shkarkimeve për kilometër për shkak të:

- Cilësisë së dobët të karburanteve të përdorur – standardet e tanishme të karburantit për automjetet janë më pak të rrepta sesa standardet e BE, (megjithë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 147 datë 21.03.2007 i cili ka vendosur 1 janarin 2011, si datë limit të futjes së standarteve të plota evropiane për karburantet)
- Moshës mesatare relativisht të madhe të mjeteve të transportit (mbi 10 vjet) në krahasim me mesataren e vendeve të BE që është 7.1
- Përdorimi i motorëve pa konvertor katalitik, duke favorizuar rritjen e përmbajtjes së pluhurit dhe shkarkimeve të gazta gjatë djegies së karburantit
- Mirëmbajtjes jo të mirë të automjeteve – ndonëse janë futur sistemet e testimit të automjeteve, duhet theksuar se kontrolli i shkarkimeve të automjeteve nuk është sipas kërkesave evropiane dhe nuk zbatohet siç duhet Plani Kombëtar i Transportit Shqiptar, i vitit 2004
- Menaxhimit joefikas të trafikut, që shpie në dyndje dhe në kohë qëndrimi të gjatë
- Kushteve të këqija të rrugëve, që shpien në shpejtësi të ulët të automjeteve (çka ul rendimentin e lëndës djegëse dhe shton gazrat e çliruar për kilometër) dhe amortizim të shpejtë të tyre.

Me ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008 (i ndryshuar) për taksat kombëtare dhe vendore) ka ndryshuar mënyra e taksimit të mjeteve të përdorura. Aplikimi i taksës së re të qarkullimit si a) taksa fikse për litër mbi gazoilin dhe benzinën të prodhuar në vend apo të importuar; taksa fikse për llojin e karburantit (25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën); b) taksa e karbonit që përveçse për benzinën dhe gazoilin, aplikohet edhe në dy kategori të reja nënproduktesh naftë (vajgurin dhe lëndë djegëse), priten të kenë ndikim pozitiv në cilësinë e ajrit (për më hollësisht referoju Rastit të studimit 1).

Gjithashtu, me VKM Nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe dizel”, këto të fundit lejohen të tregtohen vetëm për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët e lëndëve djegëse, që plotësojnë kërkesat e standardit shqiptar. Ndërsa për të reduktuar sasinë e squfurit në lëndët djegëse për përdorim industrial, është miratuar VKM

“Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim termik e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor”.

Kuadri ligjor dhe institucional i mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri në perspektivën e anëtarësimit në BE

E drejta e brendshme e mjedisit

Legjislacioni mjedisor në Shqipëri është i ri në krahasim me atë të vendeve të tjera evropiane. Deri në fillim të viteve '70, ai përqendrohej në mbrojtjen e pyjeve dhe kontrollin e gjuetisë. Politikat e para mjedisore janë hartuar në kontekstin e Strategjisë së parë Kombëtare të Mjedisit (1993) dhe të Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin (1994). Këta përbëjnë dokumentet e para zyrtare të politikave mjedisore në Shqipëri, duke shtruar rrugën që qeveria të krijonte një kuadër ligjor, institucional dhe financiar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga viti 1993, deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998, mund të konsiderohet si periudha e parë e zhvillimit të së drejtës së mjedisit në Shqipëri. Ndërsa nga viti 1998 e në vijim, mund të konsiderohet periudha e dytë e zhvillimit të së drejtës së mjedisit, e cila ka si karakteristikë kryesore prirjen për përafrim legjislacioni me *aquis communautaire* të fushës (Petrela 2010).

Dihet se kushtetutat ravijëzojnë drejtimit e rregullimeve të ardhshme ligjore, që realizohen fillimisht me akte ligjore dhe më pas me akte nënligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e aprovuar me referendum në vitin 1998, e frymëzuar nga parimet e Agjendës 21⁵¹ dhe nga konventat ndërkombëtare mjedisore, si dokumenti bazë i drejtave themelore të njeriut, shpreh qëllimin “për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm” dhe “për shfrytëzim racional të burimeve natyrore ..., bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm” (Neni 59,1/d, dh), çka është në mbështetje të parimit të zhvillimit dhe përdorimit të burimeve natyrore, pa i dëmtuar mundësitë dhe nevojat e brezave të ardhshëm. Po kështu, Kushtetuta mbështet parimin e së drejtës së publikut për t’u informuar për çështjet mjedisore (Neni 56). Në këto kushte, Kushtetuta e RSh përbën një premisë të

⁵¹ Agjenda 21 është një plan veprimi i Kombeve të Bashkuara lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm që është produkt i UNCED, i mbajtur në Rio de Zhaneiro, Brazil, më 1992.

mirë përse i takon rolit që ka mjedisi për shoqërinë dhe shtetin tonë, si dhe një bazë të rëndësishme për rregullimet e mëtejshme ligjore në këtë fushë.

Një ligj tjetër qendror në legjislacionin shqiptar mjedisor është ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, i cili mishëron parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, parimin e parandalimit dhe marrjes së masave paraprake, parimin e qasjes së integruar, parimin “ndotësi paguan”, etj.

Nisur nga përmbajtja e neneve të Kushtetutës lidhur me mjedisin, mund të pohojmë se fryma e saj është në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike, që u kushtojnë rëndësi të veçantë disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, siç janë e drejta për informim e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshtatshëm për të jetuar, jo vetëm për brezat e sotëm, por edhe për ata të ardhshëm, duke iu përmbajtur kështu parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky qëndrim i mbajtur në Kushtetutë, është gjithashtu në përputhje me frymën e dokumenteve themelore evropiane në fushën mjedisore, ndër të cilat edhe Raporti Brundtland 20⁵², ku theksohet domosdoshmëria për ta ruajtur mjedisin, me qëllim që të shmanget dëmi, shpesh i pakthyeshëm ndaj brezave të ardhshëm. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Shqipërisë ka bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm parime të rëndësishme të së drejtës mjedisore ndërkombëtare dhe evropiane (Petrela 2010).

Pas vitit 1998, ka pasur një shtim të veprimtarisë ligjbërëse në fushën e mjedisit, duke marrë nxitje si nga Kushtetuta, ashtu dhe nga kërkesat e kohës. Nisur nga baza e re kushtetuese, mjaft nga ligjet e mëparshme mjedisore dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, janë rishikuar, përditësuar apo zëvendësuar me norma të reja juridike. Sikurse dhe në vendet e tjera, legjislacioni mjedisor shqiptar synon të vendosë një ekuilibër midis nevojës për zhvillim dhe mbrojtjes së mjedisit. Sidoqoftë, në legjislacionin shqiptar, procesi i reflektimit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit është ende në fazën fillestare (Muharremaj 2014).

⁵² Raport i publikuar nga Komisioni Brundtland, formalisht i njohur si Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin, me rastin e 20 vjetorit të misionit të parë Brundtland (1987), që pati si synim bashkimin e vendeve me qëllim ndjekjen së bashku të rrugës së zhvillimit të qëndrueshëm.

Po kështu, në kuadër të konsolidimit të profilit të tij ndërkombëtar si shtet demokratik dhe në zhvillim, si dhe në kuadër të marrëveshjes së stabilizim-asociimit me BE-në, Shqipërisë i ka lindur detyrimi i marrjes së përgjegjësive dhe angazhimeve ndërkombëtare në mbrojtje të mjedisit. Kjo shihet e konkretizuar në proceset e ratifikimit apo aderimit në konventa, traktate, marrëveshje dy apo shumëpalëshe, për çështje të ndryshme mjedisore në nivel evropian dhe botëror. Kjo vërehet edhe në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin evropian dhe përvojën evropiane (*acquis communautaire*).

Konventat kryesore ndërkombëtare mjedisore (përveç KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos) në të cilat Shqipëria bën pjesë, janë si më poshtë (Guri et. al 2010):

- Konventa e Arhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, aderuar me ligjin 8672, datë 26.10.2000
- Konventa e Vienës për mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe protokollit i Montrealit për substancat ozonholluese, aderuar me ligjin nr. 8463, datë 10.3.1999
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër shkretëtirëzimit, aderuar me ligjin Nr. 8556, datë 22.12.1999
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi biodiversitetin, ratifikuar më janar 1994
- Konventa e vitit 1979 mbi ndotjen atmosferike ndërkufitare në distanca të mëdha, aderuar me ligjin Nr. 9425, datë 6.10.2005
- Konventa e Barcelonës për mbrojtjen e bregdetit dhe mjedisit detar të Mesdheut, aderuar me ligjin Nr. 8690, datë 16.11.2000
- Konventa e Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm, aderuar me ligjin Nr. 9263, datë 29.07.2004
- Konventa e Bernës për mbrojtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjediseve natyrore në Evropë, aderuar me ligjin Nr. 8294, datë 2.3.1998
- Konventa e Bazelit për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, aderuar me ligjin Nr. 8216, datë 13.5.1997
- Konventa CITES për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër, aderuar me ligjin Nr. 9021, datë 2.3.1998

- Konventa ESPOO dhe protokollit i Kievit për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar
- Konventa e Bonit mbi mbrojtjen e kafshëve të egra shtegtare/ migruese

Këto konventa ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj nga Parlamenti i RSh, janë akte normative, që kanë fuqi në territorin e Shqipërisë dhe janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, mbështetur në nenet 5, 116, 117 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 5 të Kushtetutës thuhet se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Parja e këtij neni si i lidhur ngushtë me nenin 122 të Kushtetutës, sipas së cilit RSh njih dhe zbaton marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara prej saj dhe të botuara në Fletoren Zyrtare, duke u bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të saj, është një interpretim në mbështetje të idesë se formulimi i nenit 5 nuk është formal apo i përgjithshëm (Zaganjori 2004). Mënyra se si RSh ka bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik të saj traktatet ndërkombëtare, përfshirë ato mjedisore, në të cilat është palë, është nëpërmjet miratimit të ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, për aderimin apo ratifikimin e këtyre traktateve. Kështu RSh i ka bërë dispozitat e një sërë traktateve mjedisore të detyrueshme për zbatim në territorin e saj, nëpërmjet ratifikimit të tyre me ligj.

Le të ndalemi pak në Konventën e Arhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, e cila është bërë pjesë e të drejtës së brendshme të RSh, pas ratifikimit me ligjin nr. 8672, 26.10.2000. Sa i takon zbatimin të saj, u miratua Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Arhusit. Nëpërmjet saj parashikohet rritja e rolit aktiv të publikut, shoqërisë civile, OJQ-ve dhe biznesit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Sa i takon të drejtës së informimit, Kushtetuta parashikon në nenin 23 të saj, të drejtën e informimit për këdo, në përputhje me ligjin, për veprimtarinë e organeve shtetërore. Në nenin 48 sanksionohet se kushdo mund t’u drejtojë ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara me ligj. Ndërsa e drejta e informimit sa i takon informacionit mjedisor, parashikohet në nenin 56 të Kushtetutës të RSh.

Bazuar në dispozitat e ligjit, është miratuar edhe VKM nr. 16, datë 4.01.2012, “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”, e cila parashikon edhe pjesëmarrjen e publikut në

vendimmarrjen mjedisore. Kjo e fundit parashikohet në mënyrë më të plotë në VKM nr. 994, datë 2.07.2008, “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”, e ndryshuar me VKM nr. 247, datë 30.04.2014.

Shqipëria ka përafuar disa direktiva të BE-së për mjedisit, ndër të cilat të poshtëshënuarat rezultojnë të përshtatura në shkallën më të lartë:

- Direktiva 85/337/EEC mbi vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis, e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC;
- Direktiva 2003/35/EC për pjesëmarrjen e publikut;
- Direktiva 2003/4/EC për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor;
- Direktiva 2004/35/EC mbi përgjegjësinë mjedisore.

Më tepër informacion për përshtatjen me legjislacionin mjedisor të BE-së dhe shkallën e përafrimit gjendet në vijim, ndërsa një përmbledhje e akteve kryesore juridike mjedisore të miratuara gjatë periudhës 2005-2012, sikurse dhe e atyre për aderimin e Shqipërisë në konventat e instrumentet ndërkombëtarë gjendet në shtojcën 3.

Legjislacioni penal mjedisor

Hartimi i një kuadri të plotë ligjor, në përputhje me *acquis communautaire*, nuk garanton mbrojtjen e mjedisit, nëse nuk zbatohet rigorozisht. Sfidat për zbatimin e legjislacionit mjedisor janë të shumta dhe të shumëllojshme, për shkak të larmisë së fushave, teknikave, instrumenteve ekonomikë. Zbatimi i *acquis* mjedisore bëhet edhe më i vështirë, po të kemi në konsideratë ndjeshmërinë e publikut ndaj shumë çështjeve mjedisore që e cenojnë dhe për të cilat është i gatshëm të përdorë ankimimin administrativ dhe gjyqësor.

Legjislacioni shqiptar në fushën e mjedisit mund të grupohet në tre kategori (Petrela 2010):

1. legjislacioni kuadër (më tej referuar si horizontal), i cili përmban parimet bazë të një drejtimi të caktuar mjedisor, duke rregulluar kuadrin ligjor dhe institucional, por pa synuar të rregullojë plotësisht një sektor të caktuar;

2. legjislacioni sektorial, cili nënkupton mbulimin juridik të aspekteve të ndryshme të mjedisit dhe veprimtarisë njerëzore, si p.sh. ligji mbi tokën, pyjet, parqet kombëtare, jetën e egër, ujërat, etj.;
3. legjislacioni penal për mbrojtjen e mjedisit, i cili përcakton përgjegjësinë në raste konkrete të cenimit të mjedisit. Provimi i faktit se dikush është përgjegjës për një vepër penale shoqërohet me një dënim penal (gjobë ose burgim).

Meqenëse legjislacioni mjedisor kuadër dhe sektorial trajtohen gjerësisht më poshtë, le të ndalemi pak tek legjislacioni penal për mjedisin në Shqipëri.

Sipas legjislacionit shqiptar, në fushën e mjedisit ekzistojnë dy lloje shkeljesh penale: kundërvajtje dhe krim. E njëjta figurë e veprës penale mjedisore klasifikohet si krim, kur pasojat që shkaktohen për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin në tërësi, janë të rënda dhe zgjasin në kohë. Diapazoni i ndëshkimit sipas legjislacionit shqiptar për shkeljet penale mund të jetë gjobë ose burgim nga 3 muaj deri në prej 15 vjet⁵³. Për shkelje të lehta mjedisore, sikurse janë kundërvajtjet administrative, dënimet e parashikuara janë administrative dhe rregullohen nga legjislacioni përkatës mjedisor.

Kodi Penal shqiptar u kushton një kapitull të veçantë (Kreun IV) akteve të dënueshme ndaj mjedisit. Veprat e ndryshme penale kundër mjedisit parashikohen në nenet 201-207⁵⁴. Në vijim po paraqesim dhe po trajtojmë në mënyrë të përmblodhur nëntë veprat penale në fushën e mjedisit, që parashikon dhe ndëshkon legjislacioni shqiptar (Kodi Penal i RSh 1995):

- Neni 201, Ndotja e ajrit;
- Neni 202, Transporti i mbeturinave toksike;
- Neni 203, Ndotja e ujërave;
- Neni 204, Peshkimi i ndaluar;
- Neni 205, Prerja e paligjshme e pyjeve;
- Neni 206, Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë;
- Neni 206/a, Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor;
- Neni 206/b, Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor;
- Neni 207, Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve.

^{53, 54} Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995.

Këto vepra penale mjedisore të parashikuara nga Kodi Penal, duket se mbulojnë një spektër të gjerë problemesh mjedisore. Por, nëse krahasojmë përmbajtjen e neneve të Kodit Penal shqiptar me parashikimet e Direktivës 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit me anë të ligjit penal, shohim se veprimet apo mosveprimet me pasojë dëmtimin e mjedisit të parashikuara në direktivë, janë më të shumta dhe më të plota se figurat e veprave penale të parashikuara në legjislacionin tonë. Bie në sy fakti se në Kodin Penal shqiptar nuk parashikohet ndotja e tokës (REC 2012). Dispozita që e trajton tokën, por që lidhet kryesisht me shpërdorimin e saj, është Neni 199. Si shpërdorim cilësohet p.sh. rasti i ndërrimit të destinacionit të tokës bujqësore në industriale, pa ndjekur më parë procedurat e studimeve dhe lejeve përkatëse, ose ndërtimet e paligjshme në zonat bregdetare. Këto shpërdorime ndikojnë indirekt edhe në ndotjen e tokës, por nuk përbëjnë formën klasike të ndikimit të aktivitetit njerëzor mbi cilësinë e saj.

Gjithashtu, në Kodin Penal shqiptar mungojnë parashikime për shkelje të kryera në kuadër të: menaxhimit dhe transportit të mbetjeve, funksionimit të një impianti industrial në të cilin kryhet aktivitet i rrezikshëm, ose shkelje si: abuzimi me speciet e mbrojtura të florës dhe faunës, përkeqësimi i habitatit, përdorimi, prodhimi, tregtimi, etj. i substancave ozon-holluese dhe shkaktimi i zhurmës në shkelje të ligjit.

Këto mangësi mund të justifikohen pjesërisht për shkak të kohës së hartimit të Kodit Penal shqiptar në vitin 1995, ndërkohë që Direktiva i përket vitit 2008, dhe për shkak të faktit se shkelje të tjera të legjislacionit mjedisor shqiptar janë të natyrës administrative, duke u parashikuar në ligje sektoriale dhe duke u dënuar me sanksione administrative, që janë më të lehta sesa ato penale. Kështu, sipas Kodit Civil (Neni 624), personi që me faj ka cenuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar, apo dëmtuar atë, tërësisht apo pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Theksojmë se kjo dispozitë e ligjit është në mbështetje të parimit mjedisor “ndotësi paguan”.

Pavarësisht se i gjithë legjislacioni shqiptar, së bashku me strategjitë e planet e veprimit synojnë ngushtimin e hapësirave për abuzime në fushën e mjedisit, për fat të keq, shumë pak gjendet i zbatuar në praktikë. Një shembull shprehës është gjendja e rëndë e bilancit pyjor. Edhe pse neni 206/a i Kodit Penal të përmendur më lart, parashikon se shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, i fondit pyjor, etj., me zjarr, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe

me gjobë nga një milion në dy milionë lekë, në praktikë nuk rezulton që gjykatat të kenë dhënë dënime të tilla (Muharremaj 2014). Nëse shohim evidencat statistikore për çështjet penale, p.sh. të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për një periudhë një vjeçare (2014), nuk konstatohet asnjë çështje që të jetë ngritur për veprat penale të parashikuara në nenet 201-207, si të reja, ashtu dhe të mbartura⁵⁵.

Po kështu, ekzistenca e një kuadri ligjor në letër, nuk garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut në praktikë, qoftë edhe në aspektin mjedisor. Si kudo edhe në Shqipëri, janë komunitetet e varfra ato që u nënshtrohen më shumë pasojave të degradimit mjedisor, për arsye se atyre u ofrohet dhe mbrojtja më e pakët (*Ibid.*). Gjithashtu, sikurse në shumicën e vendeve në zhvillim, është mungesa e institucioneve mjaftueshmërisht të forta për të mbështetur zbatimin e ligjit dhe një sistem i dobët gjyqësor. Por gjyqësori duhet të jetë hallka e fundit, që fillon me qelizat e shoqërisë, vijon me institucionet shtetërore, OJQ-të, etj.

Në legjisllacionin shqiptar lipset të bëhet një përmirësim në drejtim të garantimit të mbrojtjes civile, administrative dhe penale të mjedisit, si dhe mbulimit tërësor dhe harmonik të spektrit të së drejtës mjedisore nga ky legjisllacion. Dënimet e parashikuara për disa vepra, si prerja e paligjshme e pyjeve, ndotja e ujit dhe ajrit, peshkimi i ndaluar, janë shumë të ulëta, duke u cilësuar si kundërvajtje penale (për sa kohë nuk janë shkaktuar dëme në njerëz), ndërkohë që dëmet që shkaktojnë mund të jenë të mëdha dhe me pasoja në kohë. Përgjegjësia penale, sikurse edhe në legjisllacionin evropian, nuk duhet të lidhet vetëm me pasojat aktuale në jetën dhe shëndetin e njerëzve, por edhe me dëmtimet e shtrira në kohë mbi jetën e njerëzve dhe ekosistemet natyrore.

Procesi i politikave dhe legjisllacionit mjedisor nën dritën e integrimit evropian

Në nëntor 2005, qeveria e shqiptare pranoi Sistemin e Integruar të Planifikimit (SIP) një grup parimesh operacionale për të siguruar që politikat e ndërmarra nga qeveria për planifikimin dhe zbatimin të ishin koherente, eficiente dhe të integruara. Dy janë shtyllat kryesore të SIP: 1) një planifikim strategjik afatmesëm dhe afatgjatë, i cili u materializua me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2008) dhe 2) një proces afatmesëm i buxhetit, i cili u materializua me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili është një proces

⁵⁵ Marrë në: www.gjykatatirana.gov.al, më shkurt 2015

planifikimi tre-vjeçar financiar për arritjen e objektivave të ndryshëm, si hapa të ndërmjetëm për arritjen e qëllimeve të SKZhI.

SKZhI dhe PBA synuan të përshtatin plotësisht këto procese planifikimi:

- Programin qeverisës 2009-2013;
- Integrimin në Bashkimin Evropian, në veçanti zbatimin e Marrëveshjes të Stabilizim Asociimit (MSA) nëpërmjet realizimit të standardeve për anëtarësim;
- Administrimin e investimeve publike, nën një grup të ri procedurash, aplikuar për herë të parë më 2007;
- Ndhimën e huaj dhe përdorimin e saj në mënyrë sa më efektive, bazuar në angazhimet e Deklaratës së Parisit mbi efikasitetin e ndihmës (SKZhI 2008).

Në kuadër të SKZhI, Këshilli i Ministrave miratoi nëpërmjet Vendimit nr. 847, datë 29.11.2007, Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit (SNM 2007). Më vonë, MMPAU hartoi Strategjinë e Re Ndërsektoriale të Mjedisit (SNM 2013-2020).

Më 12 qershor 2006, Shqipëria firmosi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Marrëveshjen e Përkohshme me BE. MSA-ja hyri në fuqi më 1 prill 2009 dhe është instrumenti që do të mundësojë integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kjo marrëveshje krijon strukturën e duhur për zbatimin e ligjit, si dhe mbështet reformat institucionale dhe ekonomike me qëllim rritjen e standardeve të jetesës për qytetarët e saj. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet që Shqipëria të realizojë standardet dhe të garantojë statusin e saj si vend kandidat dhe më pas anëtar në Bashkimin Evropian. Në nenin 108 të kësaj marrëveshjeje, parashtrohet që palët marrin përsipër të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin kundër degradimit mjedisor, me qëllim qëndrueshmërinë mjedisore. Ndërsa përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së është pjesë e planit kombëtar për zbatimin e MSA, të cilin qeveria shqiptare e ka përgatitur dhe vënë në zbatim, si një instrument politik, ekonomik, ligjor dhe institucional, njëherazi pjesë e rëndësishme e Planit Kombëtar Strategjik për Zhvillim dhe Integrim. Theksojmë se marrëveshjet me BE-në trajtohen si marrëveshje ndërkombëtare dhe juridiksioni i tyre territorial, procedurat për ratifikimin dhe zbatimin e tyre garantohen nga Kushtetuta e RSH, në nenet 116, 121 dhe 122 të saj.

Për të arritur asociimin dhe anëtarësimin e plotë në BE, vendit do t'i duhet ndër të tjera që gjatë kësaj dekade të përshtatë legjislacionin e Komunitetit Evropian në fushën e mjedisit. Mjedisi është një nga përbërësit me të rëndësishëm të legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe është pranuar se është një nga fushat më të vështira për të arritur përputhshmërinë (SKZHI 2008). Për disa nënfusha, veçanërisht për elementët e legjislacionit të KE-së që kërkojnë “investime të mëdha”, përputhja e plotë nuk do të mund të arrihet derisa Shqipëria të anëtarësohet dhe disa kohë më pas, sikurse ka ndodhur dhe po ndodh me Vendet e Reja Anëtare. Sidoqoftë, ndërkohë lipset një përparim i dukshëm edhe në këto nënfusha.

Pikat kryesore të programit të qeverisë për mjedisin

Programi i qeverisë shqiptare që mbulonte periudhën 2009-2012, parashtronte këta objektiva kryesorë për mjedisin, ruajtjen dhe përmirësimin e tij:

- Mbrojtjen e cilësisë së mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore
- Investime masive publike për menaxhimin e mbetjeve, për ujësjellës, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza
- Kthimin e Shqipërisë në fuqi energjetike në Ballkan dhe investime publike e partneritet publik privat në sistemin energjetik

Mbrojtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit, sipas programit të qeverisë do të mbështetej në disa instrumente bazë, një pjesë e të cilëve renditen më poshtë (SKShM 2010):

- përafrimi gradual i standardeve mjedisore me ato të Bashkimit Evropian dhe ngritja e sistemit të instrumenteve monitoruese, inspektuese dhe ndëshkuese
- zhvillimi i instrumenteve të ruajtjes dhe zhvillimit të zonave e sistemeve që konsiderohen me vlera mjedisore dhe rehabilitimi i zonave me ndotje të trashëguar, mbështetur nga fonde publike dhe private
- adoptimi i instrumenteve fiskale që nxisin një mënyrë sjelljeje me respekt ndaj standardeve mjedisore dhe/ose nxisin investime me efekte pozitive në mjedis
- puna për edukimin dhe sensibilizimin mjedisor masiv dhe për çdo kategori apo grup social.

Sipas programit të qeverisë, politikat dhe zhvillimet mjedisore do të mbështeteshin me fonde të konsiderueshme publike dhe private. Deri në fund të mandatit (2013), qeveria e Partisë Demokratike parashikonte dyfishim të fondeve publike për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, krahasuar me 2009. Nga një krahasim i të dhënave zyrtare të buxhetit të shtetit, vërehet se fondet e akorduara në vitin 2013, janë në fakt më të pakta sesa katër vjet më parë⁵⁶.

Në strategjinë ndër-sektoriale të mjedisit për periudhën 2013-2020, cilësohet se politikat mjedisore gjatë periudhës në fjalë do të përqendrohen në menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit, ndër të tjera nëpërmjet:

- përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe reduktimit të ndotjes së zhurmës në zonat urbane
- *përshatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimit të gazeve me efekt serrë*
- parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes nga impiantet industriale
- mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, shtimit të sipërfaqes së zonave të mbrojtura
- mbrojtjes dhe menaxhimit të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, pakësimit të ndikimeve të përmbytjeve dhe thatësirës
- zhvillimit të qëndrueshëm dhe multi-funksional të burimeve pyjore dhe kullosore me qëllim parandalimin e degradimit të tokës, mbrojtjen e biodiversitetit dhe përmbushjen e funksioneve ekonomike dhe sociale (SNM 2013-2020).

Përputhja e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian

Dokumenti kryesor politik për arritjen e përputhjes legjislative është Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit, miratuar me VKM Nr. 317, datë 13.05.2005. Shkalla e përputhjes së legjislacionit mjedisor vendas me atë të Komunitetit Evropian, vlerësohet deri më sot si e pjesshme dhe duhen kryer një numër i madh ndryshimesh legjislative për të arritur përputhjen. Qeveria shqiptare ka futur tashmë si akt normativ kërkesën që çdo ndryshim në legjislacionin vendas të jetë në përputhje me atë të BE-së. Ndër objektivat që synohen të arrihen gjatë periudhës 2013-2020 është dhe arritja e përshtatjes së plotë, pra më masën 100% të legjislacionit evropian.

⁵⁶ Marrë më www.minfin.gov.al, korrik 2014

Po kështu, nga shqyrtimi ligjor i kohëve të fundit nga projekti ELPA (legjislacioni dhe planifikimi mjedisor në Shqipëri), një projekt asistence i BE-së në Shqipëri, u arrit në përfundimin se legjislacioni mjedisor shqiptar:

- Është i gjerë për nga fusha e synimet, ndonëse nuk i mbulon të gjitha fushat e *acquis*
- Shfrytëzon shumë nga mjetet rregullatore në dispozicion
- Shfaq probleme strukturore – pjesërisht legjislacioni nuk është i qartë dhe në shumë raste rregullat që ai kërkon të imponojë nuk janë realiste ose të drejta.
- Ka një regjim komande dhe kontrolli që nuk është efikas për të garantuar zbatimin e tij

Sipas UNDP (2008), një pjesë e këtij legjislacionit mjedisor shqiptar është shumë e përgjithshme, nga ku lind dyshimi nëse i ka premisat për të ofruar një kuadër rregullator të qartë e me lehtësi zbatueshmërie.

Ndërsa, sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2013⁵⁷, vlerësohet se:

“Harmonizimi me *acquis*-në ka përparuar, por përpjekje të mëtejshme nevojiten urgjentisht për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit. [...] Përpjekje substanciale dhe vullnet politik janë të nevojshme për të zhvilluar një qasje më strategjike për vendin dhe për forcimin e kapaciteteve administrative dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional. Përgatitjet në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë në një fazë të hershme.”

Procesi i përshtatjes legjislative po vijon, por opinioni i përgjithshëm i ekspertëve është se po kryhet me hap të ngadaltë, duke pasur si shkak burimet njerëzore të kufizuara në institucionet përgjegjëse, njohuri dhe përvoja të pakta të fushës. Ndërrimet e shpeshta në staf dhe punësimi i zyrtarëve me përgatitje modeste, ndikojnë në ngadalësimin e procesit dhe cilësinë e tij (UNDP 2008).

Zbatimi i legjislacionit

Zbatimi me sukses i legjislacionit mjedisor varet nga një mori faktorësh, ndër të cilët më të rëndësishmit janë: cilësia e legjislacionit, përputhja me legjislacionin evropian, shkalla e

⁵⁷ Albania 2013 Progress Report COM(2013) 700 final}, sikurse është shkarkuar në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf, më 16 tetor 2013

respektimit të ligjit në vend, institucionet e ngritura për të siguruar zbatimin e tij, e kështu me radhë (SKShM 2010).

Siç është thënë më parë, ka mangësi në një numër disiplinash, si dhe probleme strukturore, që kanë të bëjnë me legjislacionin aktual shqiptar. Për më tepër, niveli i shpërndarjes së legjislacionit është relativisht i ulët, legjislacioni dhe standardet e reja nuk publikohen gjerësisht që të njihen nga të gjithë aktorët e mundshëm. Si pasojë, niveli i njohjes së ligjit është i pakët. Ky faktor, midis të tjerëve, ndikon në një nivel relativisht të ulët të respektimit të legjislacionit mjedisor.

Marrëveshjet mjedisore shumëpalëshe përbëjnë bazën për pjesën më të qenësishme të *acquis communautaire* të BE, ndaj zbatimi i këtyre marrëveshjeve ka rëndësi për vendet e reja anëtare të BE-së dhe është një sfidë për vendet që e synojnë këtë anëtarësim. Edhe Shqipëria pritet të bëhet palë dhe ratifikojë një numër të madh marrëveshjesh shumëpalëshe mjedisore globale dhe rajonale, si pjesë e përpjekjeve të tij për t'u bërë pjesë e familjes evropiane. Në Shqipëri është ngritur një sistem që parashikon konsultim midis agjencive qeveritare të përfshira në zbatimin e legjislacionit kombëtar, në funksion të marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe. Për fat të keq ky proces nuk po rezulton eficient (UNDP 2008). Veçanërisht kjo dukuri theksohet kur ka zona të paqarta përgjegjshmërie midis institucioneve. Mungesa e kapacitetit administrativ dhe institucional shpjegon edhe nivelin e ulët të zbatimit dhe përforcimit të marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe.

Ekziston një opinion i përgjithshëm se në Shqipëri ka një mungesë kapacitetesh njerëzore, gjë që gjen pasqyrimin e tij më të qartë në nivelin e zbatimit të marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe, por ndjehet edhe në përmbushjen e detyrimeve të tjera në këtë kuadër, si p.sh raportimi (*Ibid.*).

Drejtimet kryesore strategjike mjedisore në kuadër të procesit të integrimit

Prioritetet e vendit tonë në sektorin e mjedisit, në kontekstin e rrugës drejt anëtarësimit në BE, janë paraqitur në një numër dokumentesh strategjike. Ndër më të rëndësishmit përmendim: Strategjitë Ndërsektoriale të Mjedisit (2007 e më tej 2013-2020) dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin (2007-2013). Këta dokumente skicojnë disa drejtime kryesore strategjike që udhëheqin procesin e integrimit në BE, si më poshtë:

- Përvetësimi i standardeve juridike të Komunitetit Evropian - kjo është një kërkesë e procesit të pranimit dhe veprimet e nevojshme për të arritur këtë janë përcaktuar në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.
- Mbështetja financiare për infrastrukturën e mjedisit - investimet që duhen për arritjen e standardeve, sipas programit të qeverisë, parashikoheshin të ndihmoheshin nga Fondi Mjedisor, i cili do të krijohej në pjesën e dytë të mandatit të dytë të saj (2011-2013) dhe do të mbulonte nevojat e programit për mbrojtjen e mjedisit (SKShM 2010). Ishte parashikuar që Fondi Mjedisor t'i delegonte investimet në kompetencë të disa ministrive, duke përfshirë edhe aktivitete si administrimi i mbetjeve të ngurta, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, si dhe efikasiteti i përdorimit të energjisë. Në fakt, deri në fund të qeverisjes së Partisë Demokratike, ky fond nuk u krijua.

Fondi Mjedisor është krijuar në disa shtete Evropiane. Në shumicën e rasteve fondi është krijuar si një “pjesë më vete”, subjekti financiar i të cilit është themeluar me ligj dhe që administrohet nga një bord ekzekutiv, i përbërë nga Ministria dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Krijimi i një fondi mjedisor do të kërkonte ndryshime të rëndësishme buxhetore dhe një ndarje të përgjegjësisë ndërmjet disa ministrive. Nëpërmjet tij, duke e vendosur në një linjë me programin e qeverisë, do të kryheshin investime të nevojshme për arritjen e standardeve mjedisore, të tilla si përmirësimi i sistemit monitorues dhe përmirësimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit.

Përcaktimi dhe arritja e objektivave mjedisore kërkojnë një sistem monitorimi të plotë që të pasqyrojë elementët e ndotjes së ajrit, ujit, tokës, etj. Pa një sistem monitorimi nuk është e mundur të njihet situata, e jo më të vendosen objektiva dhe të kërkohej arritja e tyre. Duke u nisur nga fakti se niveli aktual i ndërgjegjësimit mjedisor në vend është i ulët, çka rezulton në sjellje indiferente ose dëmtuese nga ana e qytetarëve ndaj mjedisit, informimi nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe ndërgjegjësimi i opinionit, janë objektiva strategjike mjedisore në kuadër të procesit të integritimit, të cilët do ishte mirë të mbështeteshin nga një fond mjedisor.

Vlerësimet e raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë lidhur me ndryshimin e klimës

Çdo vit në vjeshtë, Komisioni Evropian boton një raport të progresit të të gjitha fushave: ekonomike, politike, sociale e juridike të vendeve evropiane, të cilat janë në proces të anëtarësimit në BE. Në raportet e progresit për Shqipërinë, zë vend edhe çështja e mjedisit dhe ndryshimit të klimës. Më poshtë jepet një përmbledhje e raporteve të katër viteve të fundit, sa i takon çështjeve në fjalë.

Në raportin e progresit 2010⁵⁸, vlerësohet se nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të rishikuar kuadrin ligjor ekzistues mjedisor, me qëllimin për ta përafuar atë plotësisht me *acquis*-në mjedisore të BE-së. Institucionet ekzistuese nuk janë tërësisht funksionale, ka boshllëqe dhe fragmentim të përgjegjësive, koordinimi ndërinstytucional mbetet i dobët. Për këto arsye nevojitet një reformim i mëtejshëm dhe konsolidim i marrëveshjeve institucionale ekzistuese, përveçse ngritje e institucioneve të reja. Legjislacioni horizontal mjedisor është i përafuar dobët me *acquis*-në. Në raport gjykohet se përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për finalizuar përaftrimin në fushën e vlerësimit të ndikimit në mjedis, duke përfshirë riparimin e të metave në përshtatje. Kapacitetet administrative dhe burimet teknike e financiare duhet të forcohen djeshëm në mënyrë që Shqipëria të jetë në gjendje të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha kërkesat e *acquis-së* së BE-së mbi ndryshimin e klimës. Në këtë moment (2010), Shqipëria vlerësohet se nuk është gati të marrë përsipër një kufi ligjorisht të detyrueshëm apo angazhim reduktimi të emetimit të gazeve serrë, sipas rregulloreve klimatike post-2012. Për monitorimin dhe raportimin e gazeve serrë mbetet ende shumë për të bërë. Shqipëria nuk ka marrë asnjë masë për të transpozuar dhe zbatuar sistemin e BE-së emetimeve tregtare (EU ETS).

Në raportin e progresit 2011⁵⁹, vlerësohet se Shqipëria ka bërë ca progres në fushën e legjislacionit horizontal. Është viti gjatë të cilit janë miratuar ligjet e reja “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe “Për vlerësimin e ndikimit mbi mjedis”. Gjatë vitit 2011, u miratua gjithashtu ligji “Për lejet e mjedisore”, por në raport ngrihet shqetësimi për sa i përket përputhjes me standardet evropiane. Ndërsa përshtatja e legjislacionit për vlerësimin strategjik mjedisor

⁵⁸ European Commission. Analytical Report 2010. COM(2010)680, sikurse është shkarkuar më 16 maj 2013, në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_rapport_2010_en.pdf

⁵⁹ European Commission. Albania 2011 Progress Report, sikurse është shkarkuar më 16 maj 2013, në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf

vlerësohet se nuk ka përparuar. Nuk ka pasur asnjë progres edhe për sa i takon cilësisë së ajrit, e cila është monitoruar në të gjitha qytetet kryesore, por metodat dhe pajisjet e dobëta vlerësohet se nuk japin të dhëna të qëndrueshme. Ndërkohë që vlerësohet se ka pasur ca progres në fushën e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut, për shkak të përshtatjes së Direktivës për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga impiantet e mëdha me djegie, proces i cili ka përparuar me miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e mjedisit. Progresi i Shqipërisë lidhur me zhvillimin e politikave të përgjithshme për ndryshimin e klimës, vlerësohet si i kufizuar. Shqipëria nuk ka një strategji kombëtare për të adresuar ndryshimin e klimës dhe sfidat për zbutje dhe adaptim. Në nivelin ndërkombëtar, Shqipëria nuk ka formuluar premtime për reduktimin e emetimeve gazeve serrë dhe vendi nuk i është bashkuar pozicionit të BE-së në sesionin e 16^{të} të Grupit të Punës Ad-Hoc për angazhimet e mëtejshme nën Protokollin e Kiotos dhe në sesionin e 14^{të} të Grupit të Punës Ad-Hoc mbi veprimin bashkëpunues nën KKKBNK. Sa i përket përgatitjes dhe miratimit të *acquis-ë* për ndryshimet klimatike, Shqipëria vlerësohet të jetë në fazë shumë të hershme. Nuk janë bërë hapa konkretë për të ndërmarrë gradualisht një objektiv pakësimi të gazeve serrë, me synim zbatimin e *acquis-ë*, sidomos ndaj Skemës së Tregtisë së Emetimeve të BE-së dhe për t'u bashkuar me 'ndarjen e përpjekjeve' të BE-së. Për më tepër, kërkohen përpjekje drejt konvergencës me Vendimin e Mekanizmit Monitorues të BE-së.

Në raportin e progresit të vitit 2012⁶⁰, vlerësohet se ka pasur ca progres në legjislacionin horizontal mjedisor. Megjithatë, ligjet për vlerësimin e ndikimit mbi mjedis dhe mbi lejet mjedisore ende nuk janë përafuar me *acquis-në*, madje përfshijnë devijime serioze. Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe aksesit i publikut ndaj informacionit janë përmirësuar. Në fushën e cilësisë së ajrit, pak progres është bërë për ratifikimin e protokolleve të caktuara të konventës mbi ndotjen ndërkufitare të ajrit me rreze të gjatë. Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe raportimi vlerësohen të jenë përmirësuar ca, por vetëm dy stacione të cilësisë së ajrit janë plotësisht funksionale. Një ligji i ri, për mbrojtjen e ajrit, si dhe planet e menaxhimit të ajrit për bashkitë kryesore, janë ende në pritje. Lidhur me ndryshimet klimatike, Shqipëria përsëri vlerësohet se nuk ka bërë përparim në zhvillimin e politikave të përgjithshme. Konsiderata të klimës po integrohen gjithnjë e më shumë në politikën e energjisë, por përpjekje të

⁶⁰ Enlargement strategy and progress reports 2012. Conclusions on Albania, sikurse është shkarkuar në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf, më 7 qershor 2013

konsiderueshme vlerësohen si të nevojshme në mënyrë që ndryshimi i klimës të integrohet plotësisht në të gjitha politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale. Gjithashtu, vlerësohet se Shqipëria duhet të konsiderojë marrjen e angazhimeve lehtësuese në përputhje me ato të BE-së dhe të shteteve të saj anëtare me qëllimin që marrëveshja e klimës post-2020 të arrihet deri në vitin 2015. Vlerësohet pjesëmarrja e rregullt e Shqipërisë në komponentin e klimës së Rrjetit Mjedisor Rajonal për Anëtarësim (RENA). Rekomandohet që përpjekjet të vazhdojnë për ngritjen e vetëdijes në të gjitha nivelet dhe për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë. Kapaciteti i kufizuar administrativ dhe bashkëpunimi i dobët ndër-institucional gjykohen si faktorë që vonojnë përgatitjen dhe zbatimin e një politike të klimës në përputhje me *acquis-në*. Struktura administrative mbi ndryshimin e klimës kërkon forcim të konsiderueshëm, në mënyrë që të demonstrojë kapacitet në bashkëpunim dhe koordinim.

Raporti i progresit 2013⁶¹, pohon se në fushën e legjislacionit horizontal, qeveria ka përgatitur një strategji të re ndërsektoriale të mjedisit për vitet 2013-2017. Po kështu, ligji për vlerësimin strategjik mjedisor, që synon përafrimin me direktivën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, u miratua në shkurt, por vlerësimet e ndikimit në mjedis nuk kryhen sistematikisht apo përpara se të nisen projekte të infrastrukturës. Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ligji për lejet mjedisore nuk janë në përputhje me Direktivën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Moszbatimi i legjislacionit mjedisor vazhdon të përbëjë një problem të madh. Po kështu qasja e publikut në informacion dhe pjesëmarrja në vendimmarrje nuk është siguruar siç duhet. Ende nuk është miratuar një projektligj mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe legjislacion zbatues për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe kërkesat për disa ndotës. Një ndryshim në ligjin për taksat kombëtare të miratuara në prill 2013, i cili zvogëlon taksat për makinat e përdorura, nuk është në përputhje me *acquis-në* për mbrojtjen e mjedisit. Nuk ka ende ndonjë program të besueshëm monitorimi të cilësisë së ajrit, përveçse në Tiranë. Sidoqoftë, plani i menaxhimit të ajrit për kryeqytetin ende nuk është miratuar. Sa i përket kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut, Shqipëria ka ratifikuar në shtator të vitit 2012, protokollin “Mbi përgatitjen, përgjigjen dhe bashkëpunimin kundrejt incidenteve të ndotjes nga substanca të rrezikshme dhe të dëmshme” (OPRC-HNS). Sa i takon ndryshimit të klimës, Shqipëria ka

⁶¹ Albania 2013 Progress Report COM(2013) 700 final}, sikurse është shkarkuar në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf, në tetor 2013

vijuar ta lidhë veten me pozitat e BE-së në kontekstin ndërkombëtar të klimës. Por ende mungon një politikë dhe strategji klime e gjerë dhe gjithëpërfshirëse dhe nuk është ndërmarrë ndonjë angazhim për zbutjen e klimës deri në vitin 2020. Shqipëria ka marrë pjesë rregullisht në komponentin e klimës të RENA-s.

Sa i përket afrimit me *acquis*-në e klimës, legjislacioni është miratuar në fushën e cilësisë së karburanteve. Gjithashtu vendi ka identifikuar 13 instalime të palëvizshme me qëllim implementimin e ardhshëm të sistemit të tregtisë së emetimeve. Përpjekje të konsiderueshme janë ende të nevojshme për të përmirësuar raportimin, monitorimin dhe kapacitetin e verifikimit. Kapaciteti i kufizuar administrativ dhe bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional vlerësohet se po vonojnë përgatitjen dhe zbatimin e politikës së klimës në përputhje me *acquis*-në. Kapaciteti i Ministrisë së Mjedisit për programimin dhe zbatimin në sektorin e mjedisit në tërësi, cilësohet si i dobët. Gjithashtu, vlerësohet se fondet e parashikuara në buxhet për sektorin e mjedisit, nuk janë të mjaftueshme dhe koordinimi ndërmjet ministrive dhe qeverisë lokale është i dobët. Përpjekje të mëtejshme konsiderohen të nevojshme për të forcuar zbatimin e ligjit, duke përfshirë trajnimin e gjykatësve, prokurorëve dhe policisë mbi çështjet e mjedisit.

Tabela 5: Përmbledhje e vlerësimeve për legjislacionin mjedisor dhe të klimës në raportet e progresit të Komisionit Evropian gjatë viteve 2010-2013

Viti	Përafrimi i legjislacionit në tërësi	Legjislacioni horizontal	Legjislacioni i ajrit	Ndryshimi i klimës	Kapacitetet administrative	Bashkëpunimi ndërinstitucional	Monitorimi dhe inspektimi	Zbatimi dhe përforcimi i ligjit në tërësi
2010	I ulët	Dobët i përafruar	Një nga shqetësimet më të mëdha mjedisore	Janë marrë disa masa, por nevojitet me shumë për përafrimin me <i>acquis</i>	Nevojiten përpjekje serioze	Mbetet i dobët	Pajisje dhe metoda të dobëta	I dobët
2011	Progres i vogël	Ka ca progres	Pa progres	Progres i limituar	Ka ca progres, por për përafrim ende të dobëta	Mbetet i dobët	Pajisje dhe metoda të dobëta	Ka nevojë për përmirësim në të gjithë sektorët
2012	Progres i vogël	Ka ca progres	Ka pak progres	Nuk ka progres të rëndësishëm	Nuk ka progres	Mbetet i dobët	Ka pak progres	Ka pak progres

2013	Ka ca progres	Ka ca progres	Nuk ka progres	Ka ca progres	Nuk ka progres	Mbetet i dobët	Ka pak progres	Ka pak progres
------	------------------	------------------	-------------------	------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------

Përmbledhje

Gjatë katër vjetëve, bazuar në raportet e progresit të KE-së janë bërë këto përparime që kanë lidhje me ndryshimin e klimës:

1. Është miratuar ligji Nr. 91/2013 për vlerësimin strategjik mjedisor, që synon përafrimin me direktivën evropiane përkatëse;
2. Qeveria ka përgatitur një strategji të re ndërsektoriale të mjedisit për vitet 2013-2017;
3. Vendi ka identifikuar 13 instalime të palëvizshme me qëllim implementimin e ardhshëm të sistemit të tregtisë së emetimeve;
4. Është ratifikuar në vitin 2012, Protokolle mbi përgatitjen, përgjigjen dhe bashkëpunimin kundrejt incidenteve të ndotjes nga substanca të rrezikshme dhe të dëmshme;
5. Vendi qysh nga viti 2012 e ka unifikuar pozicionimin e saj me atë të BE-së në kontekstin ndërkombëtar të klimës dhe ka marrë pjesë rregullisht në komponentin e klimës të RENAs e më pas të ECRAN-it.

Në tërësi progresi i Shqipërisë lidhur me zhvillimin e politikave të përgjithshme për ndryshimin e klimës vlerësohet si i kufizuar. Shqipëria duhet të konsiderojë ndërmarrjen e angazhimeve lehtësuese në përputhje me ato të BE-së dhe të shteteve të saj anëtare me qëllimin që marrëveshja e klimës pas 2020^{ës} të arrihet deri në vitin 2015. Vendi nuk ka ende një strategji kombëtare për të adresuar ndryshimin e klimës dhe sfidat për zbutje dhe adaptim. Harmonizimi me *acquis-në* ka përparuar, por përpjekje të mëtejshme nevojiten për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit. Burimet mbeten të kufizuara dhe investime të konsiderueshme janë të nevojshme. Duhet të inkurajohen edhe pjesëmarrja e publikut në nismat ligjore, si dhe konsultimi me të mbi investimet publike. Vetëdija e klimës në të gjithë nivelet mbetet e ulët dhe bashkëpunimi mes të gjithë aktorëve të përfshirë kërkon forcim të mëtejshëm. Përpjekje me të mëdha dhe vullnet politik janë të nevojshme për të zhvilluar një qasje më strategjike për vendin dhe për forcimin e kapaciteteve administrative dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në përputhje me Dokumentin e Gjelbër të BE-së “Një kornizë 2030 për klimën dhe politikën energjetike”, vendi duhet të fillojë të reflektojë mbi klimën dhe kuadrin e energjisë për vitin 2030.

Legjislacioni horizontal i mjedisit dhe shkalla e përafrimit të tij

Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit horizontal për të siguruar mbrojtjen e integruar të mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përbën një ndër detyrimet themelore të MSA-së. Në këtë të fundit, paralelisht me plotësimin e bazës ligjore, kërkohet edhe përcaktimi i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, aprovimit të lejes mjedisore, si dhe forcimi i strukturave dhe kapaciteteve vendase për zbatimin e legjislacionit horizontal. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të MSA-së kërkohet forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe vendore të përfshira në administrimin e mjedisit, burimeve natyrore dhe territorit, realizimi i një vendim-marrjeje mjedisore gjithëpërfshirëse (PKZ-MSA 2006). Forcimi i përfshirjes së publikut në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, rritja e aksesit të individëve dhe OJF-ve në informacionin mjedisor, si dhe pjesëmarrja e tyre në vendim-marrjen mjedisore janë po kështu pjesë integrale e detyrimeve të MSA.

Në PKZ-MSA, qeveria shqiptare është angazhuar që për periudhën 2010–2014 të disiplinojë zhvillimin ekonomik të vendit, duke përdorur në mënyrë më racionale burimet natyrore, duke mbrojtur vlerat natyrore të vendit dhe duke pakësuar ndotjen e mjedisit nga aktivitetet ekonomike. Ky plan përmban angazhime në fushën e reformës institucionale mjedisore dhe në nxitjen e iniciativave ekonomike miqësore me mjedisin.

Gjithashtu qeveria shqiptare angazhohet që të informojë publikun mbi gjendjen reale të mjedisit, të rishikojë të drejtat e publikut dhe të përmirësojë procedurat e ankimimit administrativ dhe gjyqësor për t’i dhënë akses më të lartë grupeve që kërkojnë mbrojtjen e mjedisit dhe ndëshkimin e ndotësve në rrugë administrative e gjyqësore (*Ibid.*).

Në fushën e legjislacionit horizontal të mjedisit, është synuar të punohet në drejtim të krijimit të një baze ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ngritjen e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor të tij, bazuar në detyrimet e përcaktuara në Direktivat përkatëse të BE-së dhe konventat ndërkombëtare.

Legjislacioni i vlerësimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim të mbrojtë mjedisin nga projektet e zhvillimit ekonomik të vendit. Detyrimin e zbatimit të këtij legjislacioni e kanë subjektet private dhe shtetërore që zbatojnë projekte të ndryshme zhvillimi.

Ndjekja e zbatimit të këtij legjislacioni në Shqipëri realizohet nga:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Agjencitë Rajonale të Mjedisit në Qarqe
- Inspektoriati i Mjedisit
- Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
- Agjencitë e Ujit dhe Baseneve
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor
- Njësitë e Qeverisjes Vendore

Kuadri ligjor ekzistues në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, përbëhet nga një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të cilat paraqiten përmbledhtas së bashku me direktivën evropiane që transpozojnë dhe shkallën e përafrimit në tabelën më poshtë:

Tabela 6: Legjislacioni horizontal shqiptar dhe shkalla e përafrimit të tij

Akti ligjor shqiptar	Direktiva që transpozon	Shkalla e përafrimit
<p>Ligj, Nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”</p> <p><i>Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Direktiva 2004/35/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004, “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar • Direktiva 85/337 EEC e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC “Për vlerësimin e efekteve që shkaktohen në mjedis nga aktivitetet private dhe publike” • Direktiva 90/313/EEC “Për të drejtën e 	<p>E plotë</p>

<p><i>të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.</i></p>	<p>informimit për mjedisin”</p> <ul style="list-style-type: none"> • Direktiva 91/692/EEC “Për standardizimin dhe racionalizimin e raporteve për zbatimin e direktivave që lidhen me mjedisin” • Direktiva 96/62/EC mbi cilësinë e ajrit • Direktiva 2008/1/EC “Për kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes” e ndryshuar • Direktiva 75/442/EEC “Për mbetjet” • Direktiva 91/689/EEC “Për mbetjet e rrezikshme” • Direktiva 92/43/EEC “Për mbrojtjen e habitateve natyrore dhe florës dhe faunës së egër” 	<p>E pjeshme</p>
<p>Ligj Nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet mjedisore”</p> <p><i>Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Direktiva 2001/80/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 tetorit 2001 “Mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga instalimet e mëdha me djegie” • Direktivën 1999/13/EC “Për komponimet organike volatile” • Direktivën 91/271/EEC “Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe për ambalazhimin e mbetjeve të tyre” 	<p>E plotë</p>
<p>Ligj Nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”</p> <p><i>Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:</i></p> <p><i>a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;</i></p> <p><i>b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Direktiva 85/337/KEE të Këshillit, datë 27 qershor 1985, “Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin”, të ndryshuar • Konventës të UNECE (<i>Espoo</i>) “Për vlerësimin e ndikimit në kontekstin ndërkufitar” • Konventa e Arhusit mbi të drejtën e informimit për mjedisin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje (1998) 	<p>E plotë</p>
<p>Ligj Nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”</p> <p><i>Ky ligj përcakton rregullat për:</i></p>	<p>Direktiva 2007/2/EC “Infrastruktura për informacionin hapësinor në Komunitetin Evropian” (<i>INSPIRE</i>)</p>	<p>E pjeshme</p>

<p>a) krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor; b) organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kombëtare të informacionit gjeohapësinor; c) përcaktimin e kushteve të përgjithshme që lidhen me mbledhjen, krijimin, përpunimin, etj., të informacionit gjeohapësinor; ç) detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve publike për informacionin gjeohapësinor.</p>		
<p>Ligj, Nr. 91, datë 28.02.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor” <i>Ky ligj ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis.</i></p>	<p>Direktiva 2001/42/EC “Për vlerësimin strategjik mjedisor” (SEA)</p>	<p>E plotë</p>
<p>Ligji Nr. 9700, datë 26. 03. 2007 “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare” <i>Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit, duke parandaluar ndikimet negative që mund të shkaktohen nga veprimtari që kryhen në territore ndërkufitare fqinje.</i></p>	<p>Konventën e UNECE (Espoos) “Për vlerësimin e ndikimit në kontestin ndërkufitar”</p>	<p>E plotë</p>
<p>VKM Nr. 13, datë 4.1.2013, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”</p>	<p>Direktiva 85/337/EEC Vlerësimi i ndikimit mbi mjedis (EIA)</p>	<p>E pjesëshme</p>
<p>VKM Nr. 13, datë 4.01.2013 , “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”</p>	<p>Direktiva 2011/92/EEC “Për vlerësimin e efekteve që shkaktohen në mjedis nga aktivitetet private dhe publike”</p>	<p>E plotë</p>
<p>VKM Nr. 1429, datë 29.01.2008 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin e veprimtarive dhe projekteve me ndikime të rëndësishme negative në mjedisin e vendeve fqinje”</p>	<p>Direktiva 85/337 EEC e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC mbi vlerësimin e ndikimit mbi mjedis nga aktivitetet private dhe publike, si dhe Konventës të UNECE (Espoos) “Për vlerësimin e ndikimit në kontekstin ndërkufitar”</p>	<p>E plotë</p>
<p>Udhëzim Nr., datë 3.11.2008 “Për</p>	<p>Direktiva 85/337 EEC e amenduar nga</p>	

formatin e njoftimit të shteteve fqinje për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkuftar”	Direktiva e Këshillit 97/11/EEC mbi vlerësimin e ndikimit mbi mjedis që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike, si dhe Konventës të UNECE (<i>Espoo</i> s) “Për vlerësimin e ndikimit në kontekstin ndërkuftar”	E plotë
Udhëzim Nr. 6, datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”	Direktiva 85/337 EEC e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC “Mbi vlerësimin e ndikimit mbi mjedis nga aktivitetet private dhe publike”	E plotë
Udhëzim Nr. 3, datë 19.11.2009 “Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”	Udhëzues për vlerësimin e VNM 2001, Fletorja Zyrtare e EC, 2001/ISBN 92-894-1336-0	E plotë

Burimi: PKZ-MSA; www.ligjet.org dhe procesverbali i mbledhjes së Komisionit për Integrimin Evropian, datë 06.06.2011⁶², me ndryshime.

Ndërsa, tabela 7 jep një vlerësim të shkallës së përafrimit të direktivave evropiane të legjislacionit horizontal mjedisor në një këndvështrim tjetër, pa përmendur aktet shqiptare.

Tabela 7: Shkalla e përafrimit të legjislacionit horizontal mjedisor evropian (deri më korrik 2012)

Akti ligjor horizontal	Përafrimi në përqindje									
	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
85/337/EEC <i>Vlerësimi i ndikimit mbi mjedis (EIA)</i>										100%
2001/42/EC <i>Vlerësimi strategjik mjedisor (SEA)</i>			36% ⁶³							
2003/4/EC <i>Akesi ndaj informacionit</i>										100%
2003/35/EC <i>Pjesëmarrja e publikut</i>										100%

⁶²http://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0CCEQFjAA&url=http%3A%2F%2Fwww.parlament.al%2Fweb%2Fpub%2Fintegrimi_06_06_2011

⁶³ Direktiva është transpozuar 100% me ligjin Nr. 91, datë 28.02.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”

Akti ligjor horizontal	Përafrimi në përqindje									
	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
2004/35/EC Mbi përgjegjësinë mjedisore										100%
2007/2/EC INSPIRE		16%								
2008/99/EC Krimi mjedisor	N/A									

Burimi: EU project implemented by Consortium led by Hulla & Co. Human Dynamics KG (EUROPEAID/128906/D/SER/Multi), me ndryshime.

Shihet se ecuria e përafrimit të legjislacionit horizontal mjedisor ka qenë në tërësi e mirë. Por ka dhe akte të tjera juridike të fushës që nuk transpozojnë akte komunitare, sikurse ka dhe direktiva evropiane për të cilat procesi i përafrimit nuk ka nisur ende. Shqipëria ende nuk ka bërë progres në drejtim të përafrimit të Direktivës 2008/99/ EC mbi krimin mjedisor.

Ndërkohë, ka progres të dukshëm në drejtim të përafrimit të Direktivës së vlerësimit të ndikimit mbi mjedis. Ligji i Ri “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i miratuar më korrik të vitit 2011 dhe i plotësuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 13, datë 4.1.2013, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, ka përafruar dispozitat e mbetura të Direktivës EIA, duke arritur statusin e përafrimit të plotë.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave “Mbi aksesin e publikut në informacionin mjedisor”, më janar 2012, është transpozuar plotësisht Direktiva 2003/4/EC, aksesin ndaj informacionit, (përfshirë pjesën e mbetur të neneve 3 deri 7). Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC) është transpozuar plotësisht po gjatë vitit 2012. Një pjesë e dispozitave të saj kanë qenë transpozuar me Ligjin e ri “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili ka hyrë në fuqi më qershor të vitit 2011.

Po gjatë 2012-ës, u miratuan instrumente juridike shtesë, duke përfshirë ligjin “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH” (i cili transponon në masë të madhe direktivën 2007/2/EC – INSPIRE, por që në tabelat 6 dhe 7 figuronte e përafruar në masë të

ulët). Ndërsa gjatë 2013-ës, u përafrua plotësisht Direktiva SEA nëpërmjet Ligjit Nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

Sa i takon *zbatimit*, është arritur progres i kufizuar për direktivat e sektorit horizontal. Lidhur me Direktivën EIA, ligji i ri “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” ka vendosur procedurën e shqyrtimit dhe grumbullimit për projekte jo të listuara, si edhe ka zvogëluar Shtojcën I të kapaciteteve të projektit. Siç është përcaktuar në ligjin e ri të VNM-së, vlerësimi i ndikimit në mjedis do të jetë i detyrueshëm për projekte të Shtojcës II. MM (ish MMPAU) e ka vlerësuar këtë Direktivë si të zbatuar plotësisht, megjithatë zbatimi i plotë i saj pritet të arrihet pas vitit 2013, pasi ndikohet nga VKM-ja e lartpërmendur, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, e cila hyri në fuqi gjatë 2013-ës.

Progres është bërë në drejtim të zbatimit të Direktivës së Aksesit ndaj Informacionit, me disa obligime zbatuese të arritura. Autoritetet kompetente kanë qenë të caktuara, të tilla si Ministria e Mjedisit (ish MMPAU), Autoriteti i Planifikimit dhe departamente të ministrive të tjera. Disa prej këtyre autoriteteve ishin caktuar paraprakisht me Ligjin për Planifikimin e Territorit.

Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” i qershorit 2011, përcakton se raportet e gjendjes së mjedisit duhet të publikohen çdo vit. Gjithashtu, më shumë progres është bërë në lidhje me informimin nëpërmjet mediave elektronike për popullsinë. Faqja ueb e MM përfshin legjislacionin më të rëndësishëm dhe informacione të tjera të dobishme, të tilla si informacione për lejet e mjedisit, strategji, raporte, etj., por për fat të keq nuk është e përditësuar rregullisht (të paktën për periudhën 2011-2013).

Nuk janë përpiluar ende rregullimet ligjore dhe administrative të plota, që sigurojnë vënien në dispozicion nga ana e autoriteteve publike të informacionit mjedisor ndaj çdo personi fizik apo juridik kundrejt kërkesës dhe duke shmangur ndonjë interes të mundshëm. Edhe pse MMPAU pretendonte të kishte të gjitha instrumentet e nevojshme për implementimin e plotë të një Direktive për Akses ndaj Informacionit, data për implementimin e plotë u shty deri në fund të vitit 2015 (EU project 2012).

Asnjë progres i rëndësishëm nuk është bërë në drejtim të *zbatimit* të Direktivës për Pjesëmarrjen e Publikut, edhe pse duhet theksuar se janë bërë disa shtyrje në planin e

implementimit, duke e shtyrë zbatimin e plotë nga viti 2011 për në vitin 2015. Autoritetet kompetente janë identifikuar, të tilla si Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë. Ato janë përgjegjëse për përgatitjen, rishikimin apo modifikimin e planeve të Shtojcës I, duke përfshirë edhe ato për mbetjet dhe mbeturinat e paketimit, për shkak të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”. Përveç kësaj, informacioni për publikun, përfshirë dhe të drejtën për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes jepet nga Drejtoria e Informacionit dhe Komunikimit të MM, agjencitë rajonale të mjedisit dhe Qendra e Informimit të Arhusit. MM ka caktuar vitin 2015 si afat të ri për zbatimin e plotë të Direktivës për Pjesëmarrjen e Publikut.

Legjislacioni në fushën e energjisë dhe industrisë

Kuadri ligjor shqiptar për sektorin e energjisë përfshin një numër të konsiderueshëm instrumentesh të ndryshme juridike, nga të cilat më të rëndësishmet janë:

- Ligji për burimet e energjisë së rinovueshme (Nr. 138, 2.05.2013);
- Ligji për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji (Nr. 68, 21.06.2012);
- Ligji për eficiencën e energjisë (Nr. 9372, 27 prill 2005);
- Ligji për sektorin e energjisë elektrike (Nr. 9072, maj 2003);
- Ligji për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa (Nr. 8937, shtator 2002);
- Ligji për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike" (Nr. 8987, tetor 2002);
- Ligji për policinë elektrike (Nr. 8637, korrik 2000);
- Ligji për energjinë elektrike (Nr. 7962, korrik 1995);
- Ligji për sektorin e rregullimit të energjisë elektrike (Nr. 7970, korrik 1995);
- VKM-ja për kodin e energjisë elektrike në ndërtesa (Nr. 38, janar 2003);
- VKM-ja për strategjinë e energjisë elektrike (Nr. 424, qershor 2003).

Politika afatgjatë e energjisë në Shqipëri paraqitet në Strategjitë Kombëtare të Energjisë (SKE) 2003-2006 dhe 2013-2020, që kanë si objektiv qendror rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, nëpërmjet optimizimit të furnizimit dhe efikasitetit të konsumit, ndërkohë që sigurohet edhe mbrojtja e mjedisit. Në Strategjia Kombëtare të Energjisë 2003-2006, paraqiten

skenarë energjetikë, që korrespondojnë me skenarët përkatës të Komunikimeve Kombëtare për Ndryshimin e Klimës (shih më poshtë); kështu skenari pasiv i SKE-së, korrespondon me skenarin bazë të KKKBNK-së, ndërsa skenari aktiv i SKE-së, korrespondon me skenarin e reduktimit të gazeve me efekt serrë të KKKBNK-së (SKE 2003). Vlen të përmendet se në SKE-në e re, janë vendosur objektivat kombëtare për kursimin e energjisë dhe rritjen e burimeve të energjisë së rinovueshme duke nisur nga viti 2015, të cilat pritet të sjellin një reduktim të gazeve serrë prej 4 milion tCO₂e. Po kështu, në këtë strategji është vendosur objektivi kombëtar për energjinë e rinovueshme: rritje prej 38% e konsumit të energjisë nga të rinovueshmet deri në 2020 dhe rritje prej 9% e eficiencës së energjisë deri në 2018 (SKE 2013).

Në një strategji për biznesin dhe investimet që pritet të miratohet dhe që mbulon periudhën 2013-2020, theksohet se bazuar në iniciativën evropiane të përdorimit eficient të burimeve, pjesë e strategjisë së Evropës për vitin 2020, Shqipëria do të synojë të jetë një vend ku burimet përdoren me eficiencë, duke u përqendruar në veprime që lidhen me ndryshimin e klimës dhe eficiencën e energjisë, teknologjinë me emetim të ulët karboni, rritjen e shkallës së riciklimit dhe përmirësimin e produkteve (SBI 2013).

Për të vënë në jetë objektivat më lart, është punuar edhe për përafrimin e legjislacionit të energjisë me *Acquis Communautaire*. Në këtë fushë, sikurse dhe në fushat e tjera të legjislacionit, ka pasur asistencë të huaj. Të dhënat në tabelën më poshtë, ku pasqyrohet shkalla e përputhjes së legjislacionit shqiptar bazë të energjisë me atë të Bashkimit Evropian, janë pikërisht pjesë e rezultateve të analizës për boshllëqet legislative të një projekti të financuar nën programin IPA 2008.

Tabela 8: Shkalla e përputhjes së legjislacionit shqiptar të energjisë me atë të BE-së

Akti ligjor shqiptar	Direktiva që transpozon	Shkalla e përafrimit
	Direktiva Nr. 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC	E pjesshme

Ligji Nr. 9072, datë 22.5.2003 Për sektorin e energjisë	Rregullorja (EC) Nr. 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009, mbi kushtet e aksesit në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr. 1228/2003	E papërafuar
	Rregullorja (EC) Nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009, mbi kushtet e aksesit në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr. 1775/2005	E pjeshme
Ligji Nr. 9946, datë 30.06.2008, Për sektorin e gazit natyror	Direktiva 2009/73/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 13 korrikut 2009, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/EC Rregullorja (EC) Nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009, mbi kushtet e aksesit në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr. 1775/2005	E pjeshme
Ligji Nr. 8450, datë 24.2.1999 për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre	Direktiva e Këshillit Nr. 2009/119/EC e 14 shtatorit 2009, që vendos detyrimin për Shtetet Anëtare që të mbajnë një rezervë minimale i naftës së papërpunuar dhe/ose produkteve të naftës	E papërafuar
Ligji Nr. 9876, datë 14.2.2008 për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburantëve dhe karburantëve të tjerë të rinovueshëm për transport	Direktiva Nr. 2009/28/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 23 prillit 2009, për nxitjen e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe që amendon dhe më tej shfuqizon Direktivën 2001/77/EC dhe 2003/30/EC	E papërafuar

Burimi: Ministria e Integritimit Evropian (2011). Programi IPA 2008 i BE-së. Mbështetje për MIE-SMEI II, me ndryshime

Nga tabela vihet re, se shkalla e përafrimit të legjislacionit shqiptar bazë të energjisë me atë të BE-së është e ulët. Në Shtojcën 2, paraqitet një listë e Acquis-ë së BE-së për energjinë që konsiderohet me rëndësi për përafrimin para-aderues të vendit tonë (MIE 2011).

Tani le t'i hedhim një sy legjislacionit të industrisë. Në vitet 2010 dhe 2011, industria minerare i është nënshtruar disa ndryshimeve ligjore të, të cilët kanë sjellë edhe një performancë më të mirë të sektorit, për sa i përket tre aspekteve mjedisore: a) zhvillimit të qëndrueshëm; b) respektimit të kërkesave mjedisore; c) përdorimit racional të burimeve minerare (SBI 2013). Ligji i ri për minierat është hartuar në mënyrë të tillë që të garantojnë zhvillimin e një procesi të qëndrueshëm minerar, në mbështetje të prioriteteve kryesore të zhvillimit dhe duke siguruar zbatimin e masave të mbrojtjes së mjedisit të tilla si: trajtimi i zonave të dëmtuara, rehabilitimi i mjedisit të zonave minerare, mbyllja e sigurt e minierave të shfrytëzuara, menaxhimi i mbetjeve ekzistuese dhe mbetjeve të krijuara, forcimi i mbikëqyrjes dhe monitorimi gjatë veprimtarisë minerare dhe pas shfrytëzimit, pakësimi i dëmeve mjedisore nga aplikimi i teknologjive të avancuara, promovimi i praktikave më të mira minerare për të minimizuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet mbi jetën e komunitetit dhe natyrës (*Ibid.*).

Për sa i takon industrisë së ndërtimit të impianteve industriale, legjislacioni për ngritjen e zonave industriale është gati dhe zonat e para industriale kanë filluar të zhvillohen. Po kështu, edhe procedurat e lejeve të ndërtimit janë rishikuar dhe është planifikuar një sistem reformimi i plotë. Zhvillimi i zonave ekonomike dhe parqeve industriale është vendosur të orientohet drejt procesit të vlerësimit strategjik të ndikimit mbi mjedisin, çka pritet të ndikojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

Janë marrë masa ligjore dhe për zhvillimin e industrisë ricikluese, e cila ka shumë hapësira zhvillimi, veçanërisht në fushën e metaleve, plastikës, letrës dhe xhamit. Zhvillimi i kësaj industrie, krahas potencialit ekonomik është një kontribuues për ruajtjen e mjedisit.

Më poshtë jepen aktet juridike kryesore në fushën e industrisë, të miratuara gjatë viteve të fundit:

- Ligj Nr. 8/2013, datë 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”;

- Ligj Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”;
- VKM Nr. 232, datë 23.03.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”;
- VKM Nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”;
- VKM Nr. 362, datë 29.04.2011 “Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”;
- VKM Nr. 347, datë 29.04.2011 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”;
- VKM Nr. 364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”;
- VKM Nr. 479, datë 29.06.2011 “Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë”;
- VKM Nr. 571, datë 27.06.2013 “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të lejuara minerare për të drejtat minerare të miratuara me marrëveshje koncesionare”;
- VKM Nr. 866, datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”.

Tabela 9: Shkalla e përafrimit të legjislacionit evropian për ndotjen industriale (deri më korrik 2012)

Akti ligjor kontrolli i ndotjes industriale	Përafrimi në përqindje									
	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
2010/75/EU IED	N/A									
2008/1/EC IPPC							67%			
96/82/EC Seveso		21%								

1999/13/EC Solventët VOCs	5%									
2004/42/EC Boja VOCs	4%									
2001/80/EC LCP									88%	
2000/76/EC Incenerimi mbetjeve										99%
EC/66/2010 Eco-etikimi	0%									
EC/76/2001 EMAS	0%									

Burimi: EU project implemented by Consortium led by Hulla & Co. Human Dynamics KG (EUROPEAID/128906/D/SER/Multi), me ndryshime.

Në tërësi është arritur progres i moderuar në drejtim përafritimit të legjislacionit evropian në sektorin e kontrollit të ndotjes industriale. Progres është arritur në drejtim të përafritimit të Direktivës IPPC, kjo falë kryesisht miratimit të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit “Mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Përafritimi i plotë i Direktivës IPPC pritet të ndodhë në vitin 2015.

Nuk ka pasur progres në drejtim të përafritimit të Direktivës Seveso, kryesisht për shkak të miratimit të vonuar të projekt-ligjit të ri “Për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha” që është planifikuar si instrumenti kryesor i përafritimit. Miratimi i këtij projektligji do të finalizojë përshtatjen ligjore të direktivës në fjalë.

Përafritimi i Direktivës së tretësve VOC dhe i Direktivës së Bojërave VOC janë në faza shumë të hershme. Vetëm disa përkufizime janë përshtatur nëpërmjet miratimit të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit “Mbi lejet mjedisore”. Koha e përshtatjes së plotë të tyre pritet të jetë viti 2015.

Ndërkohë, ka pasur progres të konsiderueshëm në drejtim të përafritimit të Direktivës LCP, edhe ky për shkak të miratimit të dy akteve ligjore të lartpërmendura, që transpozojnë shumicën e dispozitave. Deri më tani, nuk ka ndonjë projekt konkret ligjor dhe nuk është

përcaktuar ndonjë afat kohor. Afati për përshtatjen e plotë të Direktivës LCP nuk është vendosur ende.

Ka progres të rëndësishëm kundrejt përafrimit të Direktivës për Djegien e Mbeturinave për shkak të miratimit të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të shtatorit 2011 dhe urdhrorit “Për djegien e mbeturinave”, të marsit 2012. Kjo Direktivë është konsideruar nga MMPAU si e transpozuar plotësisht edhe pse një dispozitë nuk është transpozuar. Kjo dispozitë është e lidhur me dispozitat e Direktivës 96/61/EC (shfuqizuar në vitin 2008 nga Direktiva 2008/1/EC dhe e cila u shfuqizua në janar 2014 nga Direktiva 2010/75/EU -IPPC) dhe si e tillë ajo i përket një faze të mëvonshme.

Zbatimi në sektorin IPPC mbetet në faza shumë të hershme. Direktiva Seveso mbetet në fazë të hershme të zbatimit, ndonëse disa masa janë qenë planifikuar qysh për vitin 2012. Përcaktimi i autoriteteve kompetente, sikurse dhe masa të tjera të zbatimit do të sigurohen nëpërmjet ligjit “Për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha”, kur ky i fundit të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Brendshme, duhet të bashkëpunojnë për zbatimin e kësaj direktive. Afati për zbatimin e plotë të kësaj direktive është fundi i vitit 2015.

Direktiva për Tretësit VOC është në faza shumë të hershme të zbatimit, ndërsa zbatimi i Direktivës për Bojërat VOC nuk ka filluar ende. Ende nuk është caktuar një afat për zbatimin e plotë të Direktivave.

Sa i takon zbatimin të Direktivës LCP, konstatohet progres i kufizuar, kryesisht në lidhje me caktimin e autoriteteve kompetente, caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve dhe vënien në vend të një sistemi të inspektimit dhe zbatimit. Afati i zbatimit nuk është përcaktuar ende.

Zbatimi i Direktivës për Djegien e Mbeturinave ka përparuar mjaft nëpërmjet disa masave tashmë të ndërmarra. Megjithatë, data e parashikuar më herët për zbatimin e plotë (2011), tani është shtyrë me 5 vjet, deri në vitin 2016.

Rregullorja për Eko-etiketimin dhe Rregullorja EMAS janë në faza shumë të hershme të zbatimit. Në parim janë hedhur hapa, por rregulla të hollësishme nuk janë hartuar ende, madje as nuk është caktuar një datë për zbatimin e plotë të tyre.

Legjislacioni në fushën e pylltarisë lidhur me ndryshimin e klimës

Pyjet në Shqipëri zënë një pjesë të mirë të sipërfaqes së tokës (rreth 36%). Pyjet natyrore përbëjnë rreth 91% të sipërfaqes, ndërsa ata të krijuar nga njeriu rreth 9% (AMP 2010). Ata kanë funksion prodhues (ndërtim, industrinë e drurit, ngrohje) dhe mbrojtës (kundër erozionit, për të ruajtur biodiversitetin dhe për rekreacion). Para vitit 1990, prerja e pyjeve është bërë me qëllim hapjen e tokave të reja bujqësore. Ndërsa sot, kërcënimi më i madh i pyjeve në Shqipëri është zjarri. Njëpërmjet zjarreve (më së shumti të qëllimshme), janë shkatërruar mijëra hektarë pyje dhe kullota. Por, edhe prerja e pyjeve ka vijuar me hap të shpejtë, kryesisht në periudhën e tranzicionit, si pasojë e prerjeve masive ilegale. Ndërkohë që para viteve '90, pjesa më e madhe e pyjeve të prerë përdorshin për industrinë e përpunimit të drurit, sot struktura e përdorimit ka ndryshuar, me pjesën më të madhe të lëndës drusore të përdorur si lëndë djegëse për konsum shtëpiak. Shkaqe të tjera të pakësimit të sipërfaqeve pyjore kanë qenë dhe janë: përdorimi i tokave pyjore për ndërtime ilegale, kontrabanda e masës drusore, ndotja e atmosferës dhe sëmundjet në pyje (Buchroithner 2010).

Ndikimi kryesor në mjedis i aktiviteteve pyjore të pa-administruara ose të keq-administruara, është pakësimi i sipërfaqes së pyllëzuar me pasojë erozionin e tokës. Erozioni i tokës ka prekur kryesisht zonat malore, duke dëmtuar cilësinë e ujit dhe duke shtuar ngarkesën e tij me sedimente. Humbja e sipërfaqes së mbuluar me dru, ndikon gjithashtu në dëmtimin e biodiversitetit, duke zhdukur shumë habitate për një mori specimesh të botës bimore dhe shtazore.

Synimi i politikave të qeverisë në fushën e pyjeve shprehet ndër të tjera edhe në strategjinë ndër-sektoriale të mjedisit që mbulon periudhën 2013-2020. Në këtë dokument, shprehet qëllimi për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe kullosore, forcim ligjor dhe institucional. Objektiva të tjerë kryesorë afatmesëm janë:

- Sigurimi i një kuadri rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;
- Përafrimi i plotë i legjislacionit të BE-së në fushën e pyjeve, krahasuar me 50% përafrim në vitin 2011;
- Vendosja e sistemit të shërbimeve të ekosistemit dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike deri më 2020;

- Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve të djegura deri në vitin 2020;
- Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë-funksional të fondit pyjor;
- Rritja e efektivitetit ekonomik dhe eficiencës energjetike nëpërmjet përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve shtetërorë;
- Përmbyllja e procesit të transferimit të pyjeve tek organet e qeverisjes vendore dhe përfundimi i procesit të regjistrimit të pyjeve komunalë në AKKP (SNM 2013).

Në tabelën më poshtë jepet situata e përafrimit të legjislacionit bazë për pyjet, krahasuar me legjislacionin dhe *acquis*-në e BE-së:

Tabela 10: Shkalla e përafrimit të legjislacionit bazë të pyjeve me atë të BE-së

Akti ligjor shqiptar	Akti i BE-së që përafron	Shkalla e përafrimit
Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimet pyjore” i ndryshuar	<p>Vendimi i Këshillit të Ministrave 89/367/EEC për krijimin e komitetit të përhershëm të pyjeve</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave 96/653/EEC që autorizon lejet e përkohshme të tregtisë së materialeve riprodhuese pyjore</p> <p>Rregullorja e Këshillit nr. 1460/98 që amendon rregulloren Nr. 1170/93 që heq disa rregulla të detajuara për mbrojtjen nga zjarri</p> <p>Rregullorja e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian Nr. 2152/2003 për monitorimin dhe ndërveprimin e vendeve anëtare, fokusuar në pyjet</p> <p>Rregullorja e Komisionit Nr. 1737/2006 për heqjen e disa rregullave të detajuara për zbatimin e rregullores së Këshillit Nr. 2152/2003 për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimin mjedisor midis vendeve anëtare</p>	E pjesshme

Ligji Nr. 9693, datë 19.03.2007 ‘Për fondin kullisor’	Rregullorja Nr. 1257/99 Për klasifikimin e zonave malore Rregullorja 1698/2005 Për politikat e zhvillimit rural Rregullorja 796/2004 Për politikat e reja bujqësore Rregullorja Nr. 1259/99 Për bujqësinë dhe mjedisin Rregullorja Nr. 1782/2003 Masat për zhvillimin rural	E pjesshme
---	---	------------

Sikurse shihet, shkalla e përafrimit të legjislacionit bazë pyjor është e pjesshme, madje e vlerësuar me 50% për vitin 2011, nga vetë qeveria shqiptare.

Gjendja e mjedisit dhe kuadri ligjor lidhur me ngrohjen globale

Shqipëria shkarkon një sasi relativisht të ulët të gazeve serrë, sasi kjo e barazvlefshme me rreth 7619.9 Gg CO₂, në vit (SKShM 2010). Kjo sepse më shumë se 90% e energjisë elektrike në Shqipëri prodhohet nga burime hidrike, ndërsa industritë me intensitet të lartë energjie nuk operojnë më. Kategoritë që zënë peshën më të madhe të shkarkimeve të gazeve serrë në Shqipëri janë transporti (burimet e lëvizshme të ndotjes), bujqësia dhe mbetjet. Edhe pse Shqipëria nuk mban përgjegjësi kryesore për shkarkimin e gazeve serrë në nivel global, asaj do t’i duhet të përballet me shumicën e pasojave mjedisore, sociale dhe ekonomike të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Në mënyrë të ngjashme me vendet e tjera të botës, edhe Shqipëria do të preket së tepërmi nga këto ndryshime, me pasoja si rritja e temperaturave, ulja e reshjeve dhe rritja e nivelit të detit. Nëse kjo situatë nuk merret në konsideratë dhe nuk trajtohet për t’u zgjidhur, atëherë do të cenohet ecuria pozitive e vendit në drejtim të zhdukjes së varfërisë dhe të zhvillimit të vendit. Ndryshimi i klimës do të sjellë pasoja të ndryshme negative për burimet ujore, turizmin, ekosistemet, bujqësinë dhe zonat bregdetare.⁶⁴

⁶⁴ Faqja zyrtare e PNUD-it në Shqipëri, shkarkuar nga <http://www.ccalb.org/index.php?pg=details&id=7&cid=1>, më 18 mars 2012

Nga një studim i kryer nga Mandija et al. (2012), i cili përdor të dhëna meteorologjike për të përcaktuar tendencën e temperaturave në Shqipëri në katër dekadat e fundit (1973-2011), vihet re një rritje e lehtë e temperaturës mesatare, e temperaturave maksimale mujore dhe një rënie e temperaturave minimale mujore. Pra, vërehet një rritje e diferencave midis temperaturave në skaje. Një tjetër parametër i shqyrtuar në këtë studim është tejpashmëria e ajrit, i cili është një parametër që tregon gjendjen mjedisore (përqendrimet e gazeve serrë dhe aerosolëve) të ajrit. Tejpashmëria në katër dekadat e fundit ka pësuar rënie, çka tregon prishje të cilësisë së ajrit. Sidoqoftë, kur analizohet koeficienti i korrelacionit midis temperaturës dhe tejpashmërisë në dy intervale, para 1990 dhe pas 1990 (kur temperaturat kanë tendencë në rritje, për rrjedhojë tejpashmëria duhet të tentojë në ulje), vërehet se ky koeficient ndryshon (rënia e tejpashmërisë është më drastike në periudhën e dytë), çka i çon studiuesit në konfirmimin e faktit se ngrohja globale është një dukuri globale, më parë se të jetë lokale. Në qytetin e Tiranës, që është nga qytetet më të ndotura të dy dekadave të fundit, është vërejtur se temperatura mesatare vjetore për periudhën 1973-2011, është rritur me 1%, ndërsa tejpashmëria e ajrit është ulur me 76%. Konkluzioni nga ky studim është se ndikimet e ndryshimit të klimës kanë prekur dhe Shqipërinë dhe tendenca e këtyre ndikimeve është në rritje.

Këto ndikime mund të shihen nga të dhënat që Instituti i politikave mjedisore (një OJQ shqiptare e cila ka planifikuar të zbatojë disa projekte për prezantimin e fakteve të ndryshimeve klimatike dhe ndërmarrjen e veprimeve për t'i zbutur ato) ka publikuar në faqen e tij zyrtare. Kështu p.sh. më poshtë jepet një pamje e dy bunkerëve të ndërtuar nga regjimi komunist gjatë viteve 1970. Ata ishin ndërtuar disa metra larg bregut të detit. Por nga Figura 10 shihet sesi bunkerët tashmë ndodhen në ujë, pasi deti ka përparuar në brendësi të tokës⁶⁵.

Figura 10: Prova të rritjes së nivelit të detit në plazhin e Golemit, maj 2008⁶⁶



Burimi: Instituti i Politikave mjedisore, marrë më korrik 2012 nga:
http://www.iepal.org/index.php?option=com_content&view=article&id=58&Itemid=66

Më tej, le t'i hedhim një vështrim kuadrit ligjor dhe institucional shqiptar lidhur me ndryshimet klimatike.

Legjislacioni për ajrin, klimën dhe konteksti i politikave për ndryshimet klimatike

Cilësia e ajrit

Rezultatet e cilësisë së ajrit të monitoruar gjatë vitit 2006, tregonin se normat e cilësisë së ajrit për dy parametra Lëndët e Ngurta në Pezulli (LNP) dhe pjesëzat me diametër më pak se 10 μ (PM₁₀), nuk ishin arritur në shumicën e zonave urbane, ndërkohë që situata ndër-sektoriale e mjedisit vazhdonte të ishte normale nga pikëpamja e parametrave të tjerë të monitoruar (SO₂, NO₂, Ozoni dhe Pb), të cilat vazhdonin të mbeteshin brenda niveleve të lejuara nga normat (SKShM 2010). Ndërsa, sipas AMP (2009), si rezultat i projektit të monitorimit të cilësisë së

^{63, 66} Instituti i Politikave mjedisore, marrë më korrik 2012 nga:
http://www.iepal.org/index.php?option=com_content&view=article&id=58&Itemid=66

ajrit, gjatë vitit 2009, në pesë qytete kryesore të vendit, rezultoi se ndotësit e gaztë qenë brenda normave të lejuara të standardit shqiptar, por jo në çdo rast të standardit evropian. Në vitin 2012, sipas SNM (2013-2020), cilësia e ajrit në zonat urbane ka pasur përmirësim. Një pjesë e treguesve të cilësisë së ajrit (si SO₂, NO₂, CO dhe Pb) rezultojnë të jenë brenda normave të lejuara kombëtare dhe të BE-së. Megjithatë, me rritjen e transportit automobilistik, nisur nga tendenca në qytetet e Tiranës dhe më tej të Durrësit, treguesi NO₂ pritet të arrijë vlerën e lejuar brenda një harku kohor 3 deri në 5 vjet. Përsa i takon treguesve PM_{2,5} dhe PM₁₀ kanë një përputhshmëri të ulët (në masën 30%) me standardet e BE-së.

Një ndër problemet kryesore të cilësisë së ajrit në Shqipëri është ndotja nga LNP dhe PM₁₀. Ndotja nga PM₁₀ vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve, kryesisht të vjetër dhe me motor dizel, por edhe nga industria e ndërtimit. Në disa stacione monitorimi qytetas në vend, ndotja nga PM₁₀ i kalon normat shqiptare dhe ato evropiane, kurse ndotja nga LNP, i kalon afërsisht dy herë standardet shqiptare (*Ibid.*). Përqendrimet e lëndëve ndotëse janë më serioze në Tiranë dhe Elbasan, ku niveli i ndotësve kryesorë në disa pika të qyteteve është dy deri në pesë herë më i lartë se normat e lejuara.

Sipas një inventari të gazeve serrë të kryer në kuadër të Komunikimit të II-të Kombëtar në kuadër të KKKBNG (për të cilën do flitet pak më poshtë) kanë dalë këto të dhëna kryesore: totali shkarkimeve të gazeve serrë në vitin 2000, i shprehur në CO₂ ekuivalent ishte 7619.9 Gg. Sektori kryesor kontribuues në këto shkarkime është energjia me 44%, e ndjekur nga bujqësia me 27% dhe përdorimi i tokës e pylltaria me 22%. Pjesa e mbetur i takon mbetjeve, industrisë dhe përdorimit të solventëve dhe substancave të tjera kimike. Gazi që kontribuon më shumë në inventarin e gazeve serrë është CO₂ me 73% në vitin 2000.

Sikurse u përmend më lart, një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit në zonat urbane, është transporti rrugor i automjeteve. Industria kontribuon gjithashtu në shkallë të lartë në ndotjen lokale. Mënyra sesi është kryer deri tani planifikimi urban nuk i ka zgjidhur, madje i ka rënduar problemet e trafikut, ndërkohë që reduktimi i hapësirave të gjelbra në qytete, ka pakësuar përthithjen e dioksidit të karbonit.

Një objektiv i politikave afatgjata qeverisëse është ulja me 16% e emetimit të gazeve serrë deri në vitin 2020, krahasuar me skenarin bazë (viti 1990).

Legjislacioni për ajrin dhe shkalla e përafrimit të tij

Fusha e cilësisë së ajrit është një nga fushat prioritare në kuadër të MSA-së, detyrimet e së cilës përcaktohen qartë në nenet 70/3 dhe 108. Këto nene parashikojnë domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*, si dhe zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër degradimit mjedisor, me qëllim nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore. Në të synohet rritja e investimeve për mbrojtjen e mjedisit me qëllim përafrimin e standardeve tona mjedisore me ato të Komunitetit Evropian e në veçanti për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit në të gjitha qendrat urbane (PKZ-MSA 2006).

Gjatë periudhës 2002-2013, në nën-fushën e cilësisë së ajrit janë hartuar një numër aktesh ligjore dhe nën-ligjore që mbështeten në direktiva të ngjashme të BE-së dhe konventa të ndryshme ndërkombëtare. Shkalla e përafrimit të Direktivës Kuadër të Ajrit në aktet vendase është vlerësuar në masën 75%. Megjithë legjislacionin në fuqi dhe përpjekjet për zbatimin dhe përforcimin e tij, mbetet akoma për t'u bërë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit në disa zona urbane dhe industriale.

Sipas planeve strategjike të qeverisë, në të ardhmen, pritet të vazhdohet me hartimin e disa akteve të tjera që synojnë thellimin e mëtejshëm të përafrimit të direktivës kuadër të ajrit, të direktivave bija të saj, si dhe akte për aderime në konventa e protokolle të ndryshme për ajrin. Gjithashtu, pritet të vazhdojë puna për përsosjen e monitorimit të cilësisë së ajrit, duke përafruar metodologjitë, pajisjet e monitorimit dhe mënyrën e raportimit në EEA. SNM (2013-2020) konsideron si sfida për të ardhmen: adoptimin e plotë të legjislacionit të BE-së për cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimet në ajër, hartimin e planit kombëtar për cilësinë e ajrit, forcimin e sistemit kombëtar të monitorimit e shkarkimeve në ajër, forcimin e politikave të taksimit të automjeteve me synim përdorimin e automjeteve më miqësore me mjedisin.

Më poshtë jepen aktet juridike bazë në vendin tonë, lidhur me cilësinë e ajrit, direktivat e BE-së të cilat ato transpozojnë dhe shkalla e përafrimit me to.

Tabela 11: Legjislacioni i ajrit dhe shkalla e përafrimit të tij

Akti ligjor shqiptar	Direktiva që transponon	Shkalla e përafrimit
Ligj, Nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”	Direktiva nr 96/62/EC datë 27 shtator 1996 “Për cilësinë e ajrit”, e amenduar nga vendimi i komisionit 01/752/EEC;	E pjesshme (75%)

	OJL296 21.11.1996, p. 55-63. OJL p. 9.	
<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” Ligji Nr. 10266, datë 15.04.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” 	Direktiva nr 96/62/EC datë 27 shtator 1996 “Për cilësinë e ajrit”, e amenduar nga vendimi i komisionit 01/752/EEC; OJL296 21.11.1996, p. 55-63. OJL p. 9.	E pjeshme (75%)
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”	Direktiva nr 96/62/EC datë 27 shtator 1996 “Për cilësinë e ajrit”, e amenduar nga vendimi i komisionit 01/752/EEC; OJL296 21.11.1996, p. 55-63. OJL p. 9.	E pjeshme (75%)
VKM Nr. 803, datë 04.12.2003 “Për normat e cilësisë së ajrit”	Direktiva nr 96/62/EC datë 27 Shtator 1996 “Për cilësinë e ajrit”, e amenduar nga vendimi i komisionit 01/752/EEC; OJL296 21.11.1996, p. 55-63. OJL pages 9.	E pjeshme (75%)
VKM Nr. 248, datë 24.04.2003 “Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër”.	Konventa e UNECE “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe (CLRTAP) (Gjeneve, 1979)”	E pjeshme
VKM Nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe dizel”	Direktiva nr. 98/70/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 13 tetor 1998 “Lidhur me cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe dizel” që amendon direktivën e këshillit 93/12/EEC. OJL350, 28.12.1998.	E pjeshme
Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë të Mjedisit dhe Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 6527, datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazeve dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre”	Direktiva 70/220/EEC date 20 Mars 1970 “Për ndotjen nga mjetet e transportit”	E pjeshme

Burimi: PKZ-MSA, me ndryshime

Sipas një projekti të Bashkimit Evropian, shkalla e përafrimit të legjislacionit për cilësinë e ajrit deri më korrik 2012, është si më poshtë:

Tabela 12: Shkalla e përafrimit me legjislacionin evropian për ajrin (deri më korrik 2012)

Akti ligjor për cilësinë e ajrit	Përafrimi në përqindje									
	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
2008/50/EC Cilësia e ajrit të mjedisit të jashtëm			30%							

2004/107/EC Direktiva e 4t Bijë	22%									
2001/81/EC NEC (tavaneve kombëtare të emetimeve)	8%									
1999/32/EC Kaburantet e lëngshëm me përmbajtje squfuri	N/A									
94/63/EC VOC-të e naftës	N/A									
2009/126/EC VOC-të e naftës, stadi II	N/A									

Burimi: EU project implemented by Consortium led by Hulla & Co. Human Dynamics KG (EUROPEAID/128906/D/SER/Multi), me ndryshime.

Në tërësi shihet se shkalla e përafrimit të legjislacionit të ajrit është e pjesshme. Vihet re progres i moderuar në drejtim të përafrimit të Direktivave të cilësisë së ajrit të mjedisit të jashtëm (2008/50/EC), të 4-t Bijë (2004/107/EC) dhe NEC (2001/81/EC).

Lidhur me Direktivën e cilësisë së ajrit të mjedisit të jashtëm, nuk është arritur progresi i duhur në drejtim të përshtatjes së dispozitave të saj që lidhen me përkufizimet, agregimin dhe gjobat. Ndërkohë është miratuar ligji Nr. 28, datë 14.2.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të ndryshuar”, që përafron pjesën kryesore të kësaj Direktive dhe do të mundësojë përshtatjen e plotë të saj. Ky ligj ndikon edhe në shkallën e përafrimit të Direktivës së 4-t bijë, e cila pa këtë ligj ka një nivel përafrimi shumë të ulët, me vetëm dy përkufizime të përshtatura plotësisht.

Nuk ka pasur progres të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të Direktivës së tavaneve kombëtare të emetimeve, me përjashtim të dy përkufizimeve që janë transpozuar në ligjin e ri “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Ministria e Mjedisit ka pasur në plan të transpozonte shumicën e dispozitave të kësaj direktive me një VKM, e cila pritej të miratohej deri në fund të vitit 2013, por në fakt nuk ndodhi kështu.

Ligji “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” siguron bazën ligjore për rregulloren e ardhshme mbi tavanet e emetimeve, që do të transpozojë dispozitat e mbetura. Si kohë për përafrimin e plotë të Direktivës së taveve kombëtare të emetimeve është vendosur dhjetori 2015.

Zbatimi i direktivave në sektorin e cilësisë së ajrit mbetet ende në fazë të hershme. Detyrimi i vetëm që ka qenë i përmbushur plotësisht është sistemi i gjositjes, ndërsa organet kompetente nuk janë caktuar, përveç autoritetit të mbrojtjes ajrore. Zbatimi i Direktivës së 4-t bijë gjithashtu mbetet në një fazë të hershme. Disa nga autoritetet kompetente nuk janë caktuar ende. Sidoqoftë, miratimi i ligjit “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” do të mundësojë plane reale për vendosjen e sistemit për vlerësimin dhe përcaktimin e vendndodhjes dhe metodat referuese, ndaj dhe data për zbatimin e plotë të Direktivës së 4^t bijë është fundi i vitit 2014. Progres i moderuar është bërë në drejtim të zbatimit të Direktivës së tavanit kombëtar të emetimeve, kryesisht nëpërmjet ratifikimit të Protokollit të Göteborg-ut. Një program për reduktimin gradual të emetimeve, si dhe bazën e të dhënave është planifikuar të zhvillohet në kuadër të projektit INPAEL⁶⁷, ndërsa afati i zbatimit është dhjetori 2015.

Më poshtë, jepen akte juridike që miratojnë aderimin e Shqipërisë në traktate ndërkombëtare të cilësisë së ajrit dhe ngrohjes globale:

- Ligji Nr. 10062, datë 29.01.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të Konventës së vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”;
- Ligji Nr. 10063, datë 29.01.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 për qind të Konventës së vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”;
- Ligji Nr. 9425, datë 06.10.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe”;
- Ligji Nr. 9480, datë 16.2.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kopenhagenit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”;

⁶⁷ Projekti ‘Implementation of National Plan for Approximation of Environmental Legislation’

- Ligji Nr. 9484, datë 2.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Londrës të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”;
- Ligji Nr. 9485, datë 6.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Montrealit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”;
- Ligji Nr 9486, datë 6.3.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Pekinit të Protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Legjislacioni për ndryshimin e klimës dhe shkalla e përafrimit të tij

Në sektorin e ndryshimit të klimës, në tërësi ka pasur progres të pakët drejt përshtatjes së legjislacionit. Përafrimi i Direktivës për tregtinë e emetimeve është në fazë të hershme. Pesë nga përcaktimet e përdorura në këtë Direktivë janë transpozuar nëpërmjet ligjit “Për lejet mjedisore”, në korrik 2011 dhe ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” të qershorit 2011. Dispozitat e tjera të Direktivës (me përjashtim të Nenit 2 dhe një përkufizimi të Nenit 3) janë planifikuar të transpozohen në vitin 2015, përmes hartimit të një instrumenti të ri ligjor. Zbatimi i vendimeve për ‘ndarjen e përpjekjeve’ nuk ka filluar ende. Po kështu nuk ka pasur progres në drejtim të zbatimit të mëtejshëm të vendimit ‘për mekanizmin e monitorimit’. Koha e përcaktuar për përshtatjen e plotë të direktivës për tregtinë e emetimeve është dhjetori 2015, ndërsa zbatimi i plotë i saj është vlerësuar se do të arrihet më 2017.

Tabela 13: Shkalla e përafrimit me legjislacionin evropian për klimën (deri më korrik 2012)

Akte për ndryshimin e klimës	Përafrimi në përqindje									
	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
280/2004/EC Mekanizmi i monitorimit										
2003/87/EC Tregtia e emetimeve	5%									
406/2009/EC Ndarja e përpjekjeve										
2009/31/EC Magazinimi gjeologjik i CO ₂	N/A									

EC/842/2006 Gazet F											
EC/1005/2009 Substancat ozon holluese											
98/70/EC Cilësia e karburantit	N/A										
443/2009/EC Standartet e emetimeve për makinat e reja											
510/2011/EU Standartet e emetimeve për kamionët e rinj											
1999/94/EC Informimi i kosumatorit	0%										

Burimi: EU project implemented by Consortium led by Hulla & Co. Human Dynamics KG (EUROPEAID/128906/D/SER/Multi), me ndryshime.

Sa i takon rregullores për substancat ozon holluese, në përputhje me planin e menaxhimit të miratuar për Shqipërinë në korrik të vitit 2011, nuk është parashikuar të shfuqizohet Rregullorja Nr. 842 me legjislacion të ri gjatë periudhës 2014-2015. Gjithsesi, nëpërmjet legjislacionit, qeveria do të identifikojë autoritetet kompetente për trajnimin dhe certifikimin sipas kësaj rregulloreje. Masat e mëparshme zbatuese përfshijnë ndërmarrjen e hapave për të promovuar rikuperimin, riciklimin dhe asgjësimin e substancave të kontrolluara, duke krijuar një sistem të regjistrimit për laboratorët, krijimin e një sistemi të ndarjes së kuotave për prodhimin dhe importimin e substancave të kontrolluara, duke futur një sistem gjobitjeje. Zbatimi i plotë i kësaj rregulloreje është planifikuar për vitin 2016.

Lidhur me Direktivat për standardet e emetimeve të Rregullores së Re për makinat dhe standardet e emetimeve të Rregullores së Re për kamionët, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor është identifikuar si Autoriteti Kompetent për mbajtjen e informacionit për makinat e reja të pasagjerëve të regjistruara në Shqipëri. Autoritetet e tjera

kompetente do të caktohen pas miratimit të aktit ligjor që do të transpozojë këtë Direktivë. Zbatimi nuk ka filluar për Rregulloren e standardeve të shkarkimeve për makinat e reja dhe për Rregulloren e standardeve për kamionët e rinj, si dhe ende nuk është vendosur ndonjë afat për zbatimin e këtyre rregulloreve. Përcaktimi i autoriteteve kompetente, përgatitja e udhëzuesit mbi ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO₂, do të përcaktohet pas miratimit të ligjit të ri, i cili pritet të ndodhë më 2014. Koha e zbatimit të plotë të këtyre Direktivave është planifikuar të jetë dhjetori 2016.

Nuk është bërë progres në drejtim të përafrimit të Direktivës për informimin e konsumatorit. Zbatimi i Direktivës për informimin e konsumatorit nuk ka filluar ende, ndërsa ajo është planifikuar të zbatohet plotësisht deri në vitin 2016.

Progres i kufizuar është arritur për Rregulloret e gazeve F dhe Rregulloren e substancave ozon holluese, kryesisht nëpërmjet përgatitjes së planit të menaxhimit, ndërsa zbatimi i plotë për të dy rregulloret është planifikuar për vitin 2016.

Politikat për ndryshimin klimatik dhe cilësinë e ajrit

Në aspektin ligjor-institucional, Shqipëria ka hedhur disa hapa në drejtim të përgjigjes ndaj ndryshimit të klimës. Sikurse është përmendur më lart, Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), më janar 1994 dhe Protokollin e saj të Kiotos, më janar 2005, ku gëzon statusin si Palë e Shtojcës jo 1. Po kështu, në kuadër të zbatimit të Protokollit të Kiotos, janë nënshkruar protokolle bashkëpunimi midis Ministrisë së Mjedisit të RSH dhe ministrive homologe të vendeve perëndimore (si p.sh. Danimarka), marrëveshje këto për bashkëpunim, për zbatimin e Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (referuar Nenit 12 të Protokollit të Kiotos).

Institucioni përgjegjës në vend për ndryshimin klimatik dhe për KKKBNK dhe Protokollin e Kiotos, është MM, ku ka një sektor për ndryshimin e klimës, i cili është ngritur qysh më 1998. Ky sektor (program) është financuar kryesisht nga GEF/ UNDP. Sipas UNDP (2008), ky sektor, së bashku me përfaqësues ndërdisiplinorë dhe ndërinstitucionalë nga ministri të ndryshme, pjesë e një ekipi teknik, përveçse pikë qendrore operationale e KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos, kryen këto detyra kryesore:

- bën inventarin e gazeve serrë dhe skenarët afatgjatë të emetimeve
- vlerëson ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike dhe propozon masa përshtatëse ndaj tyre
- organizon veprimtari për të ndërgjegjësuar publikun mbi ndryshimet klimatike

Dokumentet kryesore politike në vend lidhur me çështjen e ndryshimit të klimës janë:

- Strategjia Kombëtare e Cilësisë së Ajrit (miratuar më 2014)
- Strategjia Ndër-sektoriale e Mjedisit (2013-2020)
- Strategjia Ndër-sektoriale e Mjedisit (2007)
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013
- Komunikimet Kombëtare
- Dokumenti i Politikave të Financimit të Karbonit në Shqipëri (2009) dhe plani i veprimit për zbatimin e tij

Sipas SKZHI, masat kundër ndryshimeve klimatike nënkuptojnë para së gjithash përmirësim të eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët. Nga kjo synohet të arrihet prodhim më i ulët energjie dhe nivel më i ulët i emetimeve nga prodhimi dhe konsumimi i saj. Mënyra e realizimit pasqyrohet në një program për zbatimin e standardeve për rritjen e eficiencës së energjisë dhe njëherazi ndërgjegjësimin e publikut për këtë çështje. Gjithashtu, Strategjia Ndër-sektoriale e Mjedisit (2007) parashikon disa masa për të zbutur ndryshimet klimatike që kanë të bëjnë kryesisht me:

- Pakësimin e nevojës për energji dhe nivelin e emetimit të gazeve serrë të shkaktuar nga prodhimi i energjisë dhe transporti;
- Rritjen e eficiencës së energjisë në ndërtimet e reja dhe pajisjet elektro-shtëpiake.

Këto masa mendohet të realizohen nëpërmjet ndryshimeve në bazat ligjore të energjisë, nëpërmjet vendosjes së mekanizmave me bazë tregu (si taksa e karbonit), nëpërmjet rishikimit të strategjisë të transportit, në këndvështrimin e përmirësimit të infrastrukturës së transportit dhe futjes së mjeteve me emetim të pakët të gazeve, si dhe rishikimit të strategjisë së sektorit të energjisë, me qëllim kryesor nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme në prodhimin e energjisë (SNM 2007).

Strategjia Ndër-sektoriale e Mjedisit (2013-2020) cilëson si sfida për të ardhmen: përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian në fushën e ndryshimeve klimatike, hartimin e politikave për reduktimin e gazeve serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit e zhvillimin e kapaciteteve administrative për ndryshimin e klimës. Gjithashtu, synohet të arrihet objektivi i uljes me 16% i emetimit të gazeve serrë deri më 2020, krahasuar me skenarin bazë (viti 1990).

Në dokumentet kryesorë strategjiko-politikë, identifikohen këta objektiva kryesorë në fushën e cilësisë së ajrit:

- Në PKZ-MSA (ndër prioritetet afatgjata për fushën e cilësisë së ajrit, lidhur me ngrohjen globale):
 - Reduktimi i ndotjes së ajrit në zonat urbane
 - Reduktimi i ndotjes nga rafineria e naftës në Ballsh
 - Përafrimi i vazhdueshëm i *acquis communautaire*
- Në Strategjinë Ndër-sektoriale të Mjedisit (SNM 2013-2020):
 - Arritja e përshtatjes së plotë me legjislacionin evropian
 - Rritja me 43% në vitin 2020, krahasuar me 28% në vitin 2011, i numrit të stacioneve të monitorimit të ajrit urban
 - Reduktimi i niveleve kombëtare të NO_x, të PM₁₀, të PM_{2,5} dhe ruajtja e niveleve të SO₂ brenda vitit 2020
 - Përputhshmëria e plotë e operatorëve të mëdhenj industrialë me normat e shkarkimeve në ajër, sipas direktivave IPPC dhe LCP

Për adresimin e prioritetëve afatgjata në PKZ-MSA parashikohen të ndërmerren iniciativa ligjore, si hartimi i planit kombëtar të veprimit për cilësinë e ajrit⁶⁸, akte të ndryshme juridike që përafrojnë ato komunitare, lidhur me ngritjen e sistemeve për njoftimin, identifikimin e ndotësve dhe kriteret e import-eksportit e transportimit të karburanteve.

Në strategjitë e lartpërmendura, masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike parashikojnë dhe fushata ndërgjegjësimi për uljen e sasisë së gazeve serrë. Këto fushata do synojnë nxitjen e

⁶⁸ Në bazë të Ligjit Nr. 10266, datë 15.4.2010, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8897, datë 16.5.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, parashikohet të hartohet Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit, me afat 5 vjeçar dhe jo më vonë se dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ndonëse kanë kaluar tre vjet (shtator 2013), ky plan kombëtar ende nuk është miratuar.

eficiencës së energjisë në sektorin e industrisë, nxitjen e izolimit termik të banesave, nxitjen e blerjes së pajisjeve shtëpiake që konsumojnë më pak energji, të përdorimit të sistemit me ngrohje diellore dhe përdorimit të ndriçimit ekonomik nëpër familje.

Sikurse pamë më lart, ndryshimit të klimës i adresohen si strategjitë kombëtare, ashtu dhe ato ndër-sektoriale, por dokumente kryesore politike për të janë Komunikimet Kombëtare për KKKBNK, si dhe dokumenti i politikave të financimit të karbonit në Shqipëri.


Komunikimet Kombëtare për KKKBNK

Sikurse është përmendur, Shqipëria e ka nënshkruar/ ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike më 1994, ndërsa Protokollin e Kiotos më 2005. Si një vend i Shtojcës Jo-1, Shqipëria ka detyrim për raportim çdo 4 vjet dhe për këtë sigurohet mbështetja teknike e financiare nga Kombet e Bashkuara.


Është detyrë e Komunikimeve Kombëtare që të përshkruajnë aktivitetet për të zbatuar Konventën, të cilat lidhen me të dhënat për shkarkimet e gazeve serrë, politikat kombëtare dhe praktikat më të mira, strategjitë kombëtare që adresojnë çështjet e shkarkimeve të gazeve serrë e përshtatjen ndaj ndikimeve të pritshme, si dhe bashkëpunimin për adaptim ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Procesi i Komunikimeve Kombëtare

Komunikimi i Parë Kombëtar – 2002




Komunikimi i Dytë Kombëtar – 2009



Komunikimi i Tretë Kombëtar – (në proces)

Nëpërmjet komunikimeve kombëtare është bërë një paraqitje skenarësh për të propozuar masa për zbutjen e ndryshimeve të pritshme klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre. Skenari bazë merr në konsideratë zhvillimin e sektorëve pa marrë parasysh ndikimin e ndryshimit të klimës. Skenari i zbutjes merr në konsideratë zbatimin e një sërë masash, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë me 48 për qind brenda vitit 2025, krahasuar me skenarin bazë. Paraqitur në mënyrë grafike, janë nivelet e emetimeve të gazeve serrë sipas të dy skenarëve:

Figura 11: Emetimet e gazeve serrë (në Gg CO₂ eq) sipas të dy skenarëve për periudhën 2010-2025



Burimi: EEA, marrë nga:

http://www.eea.europa.eu/soer/countries/al/soertopic_view?topic=climate%20change, shkarkuar më gusht 2012

Në komunikimet kombëtare merren në shqyrtim tri gaze me efekt serrë të drejtpërdrejtë (CO₂, CH₄ dhe NO₂) dhe gaze me efekt serrë jo të drejtpërdrejtë (CO, NO_x, SO_x dhe NMVOC). Qysh nga komunikimi i dytë janë marrë në shqyrtim edhe HFC-të, PFC-të dhe SF₆). Përmes studimeve të kryera gjatë procesit të hartimit të komunikimeve kombëtare, qeveria shqiptare arrin të vlerësojë nevojat e veta për teknologji jo të dëmshme për klimën. Vlerësimi i këtyre nevojave shërben si bazë referimi për të vlerësuar mundësinë e vendit për të reduktuar shkarkimin e gazeve serrë. Më tej, projektet e Mekanizmit për Zhvillim të Pastër (MZhp) arrijnë të vlerësojnë uljen e mundshme të shkarkimeve të certifikuar.

Në punën e saj për trajtimin e problemeve të ndryshimeve klimatike dhe në zbatimin e KKKBNK dhe Protokollit Kiotos, qeveria shqiptare asistohet nga programi i PNUD-it për

ndryshimet klimatike, i themeluar në vitin 1998. Objektivi kryesor i këtij programit është të ndërtojë dhe të zhvillojë kapacitete njerëzore dhe institucionale në nivel kombëtar për zbatimin e KKKBNK-së dhe të Protokollit të Kiotos në Shqipëri⁶⁹. Në veçanti, programi synon të krijojë një kuadër ligjor dhe institucional kombëtar, për të qenë në përputhje me kërkesat e KKKBNK-së dhe të Protokollit të Kiotos, të integrojë zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin në proceset e zhvillimit kombëtar, si dhe të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit publik, të komunikimit dhe informimit mbi problemet e ndryshimit të klimës tek të gjithë grupet e interesit në vend.

Programi i PNUD-it për ndryshimet klimatike përmban edhe objektiva specifike të tilla si ngritja e kapaciteteve adaptuese në zona dukshëm të prekura nga ndryshimet e klimës, sikurse janë deltat e lumenjve Drin e Mat. Kjo është hera e parë që në Shqipëri ndryshimet klimatike përfshihen si një pjesë integrale në programet për një zhvillim të qëndrueshëm në një zonë vulnerabël.⁷⁰

Dokumenti i politikave të financimit të karbonit

Ky dokument është përgatitur në vitin 2009 nga MM (ish MMPAU), Austrian Development Cooperation dhe PNUD-i. Qëllimi i “Dokumentit të politikave të financimit të karbonit” është që Shqipëria të zërë vend në Mekanizmin për Zhvillim të Pastër (MZhP) dhe në tregjet e ardhshme të karbonit në mënyrë konkurruese (DRFKSh 2009). Kujtojmë që pas miratimit të Protokollit të Kiotos në vitin 1998, MZhP u themelua si mekanizmi i parë i përshtatshëm, që përfshinte vendet pa detyrime për pakësimin e shkarkimit të gazeve serrë sipas KKKBNK, ose ndryshe vendeve që nuk bëjnë pjesë në Shtojcën 1. MZhP-ja është një nga instrumentet më të fuqishëm në tregun ndërkombëtar të karbonit. Që nga ajo kohë janë hartuar skema të reja dhe mekanizma të rinj për tregtinë e emetimeve, çka po çon drejt themelimit të një tregu të konsoliduar global të karbonit. Nga pikëpamja ekonomike, kjo prirje çon në maksimizimin e përfitimeve të mundshme dhe efikasitetit të mekanizmave fleksibël të karbonit ose siç njihen ndryshe, mekanizmat e balancimit të karbonit. Nga pikëpamja politike, këto zhvillime janë pjesë e strategjisë ndërkombëtare të ndryshimit të klimës.

⁶⁹ Faqja zyrtare e PNUD-it në Shqipëri, <http://www.ccalb.org/index.php?pg=details&id=7&cid=1>

⁷⁰ *Ibid.*

Pavarësisht nga mundësitë e saj, Shqipëria është mbrapa në pozicionimin e saj në tregjet e karbonit. Përveç një kuadri institucional të përshtatshëm për miratimin e MZhP-së, në Shqipëri, asnjë projekt nuk është regjistruar në rang ndërkombëtar si projekt MZhP-je. Megjithatë, qeverisë shqiptare do t'i duhet të përballlet me pengesa të ndryshme, për një pjesëmarrje efektive dhe frytdhënëse të aktorëve shqiptarë në MZhP dhe në tregjet e tjera të karbonit.

Në vitin 2005, u emërua në Shqipëri, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP), i cili iu komunikua zyrtarisht Sekretariatit të KKKBNK-së dhe Bordit Ekzekutiv të MZhP-së. Edhe detyrat e AKP-së (përveç komunikimeve kombëtare) do t'i mbështeste Programi i PNUD-it për Ndryshimet Klimatike.

Për të zyrtarizuar strukturën e AKP-së, janë miratuar katër akte nënligjore:

- Vendimi nr. 1553, datë 26.11.2008, për krijimin e AKP-së, hartimin e strukturës së tij, rolet përkatëse dhe tarifën e shërbimit për Letrën e Miratimit, si dhe emërimin e MM (ish MMPAU) “si një organ i specializuar për të shqyrtuar dhe miratuar projektet e Mekanizmit për Zhvillim të Pastër”;
- Urdhri nr. 24 i Ministrit të MMPAU, datë 10 shkurt 2009, i cili përcakton strukturën e Autoritetit dhe Sekretariatit të AKP-së dhe anëtarët e tyre;
- Urdhër Nr. 16 i Ministrit të MMPAU, datë 15.01.2010, “Për përbërjen e komitetit të autoritetit kombëtar të përcaktuar dhe sekretariatit të tij teknik”;
- Rregullorja e Ministrit të MMPAU nr. 1, datë 25.03.2009, “Mbi procedurat e rishikimit dhe miratimit të projekteve MZhP”, e cila përshkruan në detaje rolin e komitetit të AKP-së dhe të sekretariatit teknik, procedurat e rishikimit dhe miratimit të MZhP-së, aplikimin e kriterëve kombëtarë për zhvillim të qëndrueshëm, strukturën e formularëve zyrtarë për rishikim e vlerësim, dhe pagesën e tarifës.

Në dokumentin e politikave të financimit të karbonit përmendet fakti se ka edhe organizata të tjera qeveritare, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikës së mjedisit në përgjithësi dhe politikës së ndryshimeve klimatike e zbatimin e veprimtarive të projektit MZhP në veçanti, që janë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Gjithashtu, në Dokument shprehet opinioni se integrimi i politikave mjedisore dhe të energjisë të BE-së, në kuadrin ligjor shqiptar, duhet parë si një mundësi për zbatimin e projekteve të MZHP-së. Dihet se shumica e pjesëve të legjislacionit të BE-së lidhur me mjedisin dhe energjinë përbëjnë gjithashtu dhe zonat e zakonshme për zhvillimin e projekteve të MZHP-së. Shqipëria mund të vendosë që gjatë zbatimit të legjislacionit të BE-së në lidhje me mjedisin dhe energjinë të vendosë dhe integrimin e komponentit të MZHP-së. Gjithashtu në Dokument theksohet se ka rëndësi përmendja e faktit që Shqipëria do t'i vërë në zbatim projektet e MZHP-së në ato fusha ku legjislacioni i BE-së do të përshtatet me kuadrin e saj kombëtar, duke mos vënë në rrezik kërkesat shtesë të MZHP-së.

Si pjesë e veprimtarisë së saj ndërkombëtare në tregjet e karbonit, Shqipëria ka nënshkruar disa Memorandume Mirëkuptimi ose Marrëveshje, dypalëshe ose shumëpalëshe për zbatimin e projektit të MZHP-së me Italinë, Danimarkën, Fondin e Bio-karbonit të Bankës Botërore, KfW-në (Banka për Zhvillim e Gjermanisë) dhe për ngritjen e kapaciteteve me Ndihmën Austriake për Zhvillim (DRFKSh 2009).

Analiza FDMK

Analiza FDMK mund të bazohet në të dhënat juridike, politike, mjedisore, etj., dhe mund të zbatohet në nivele të ndryshme ndërkombëtare, rajonale, (në rastin tonë në nivel kombëtar). Analiza FDMK është gjithnjë një mjet i mirë në përshkrimin e situatës në një zonë të caktuar dhe në këtë mënyrë, në identifikimin e mangësive e mundësive në atë zonë (shih më lart pjesën metodologjike). Një analizë FDMK e përshtatshme, është konsistente në përmbajtjen e saj, bazuar në të dhëna dhe analiza të vlefshme, duke krahasuar pikët e forta e të dobëta me një standard. Pjesa e analizës për *fuqitë* e *dobësitë* bëhet në një mjedis *statik*, ku fuqitë përfshijnë karakteristikat pozitive statike, ndërsa dobësitë nënvizojnë karakteristikat negative. Mbi këta faktorë statikë pozitivë e negativë, shqyrtimi i forcave pozitive e negative të mjedisit të jashtëm (*dinamik*) çon në identifikimin e *mundësive* dhe *kërcënimeve*. Mbi bazën e faktorëve të analizuar mund të përpilohet një tabelë FDMK dhe mund të jepen drejtime strategjike për zonën e caktuar, të cilat duhet të jenë koherente e proaktive, duke iu përgjigjur mundësive dhe kërcënimeve të jashtme, si dhe fuqive e dobësive të brendshme.

Në përfundim të analizës së faktorëve të kryer gjatë pjesës së parë, me qëllimin realizimin e një pamjeje të qartë të fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve në vend, në fushën e legjislacionit dhe politikave të ndryshimit të klimës në vend, është përgatitur një tabelë si më poshtë:

Tabela 14: Analiza FDMK e legjislacionit dhe politikave për ndryshimin e klimës në Shqipëri

	Të dobishëm	Të dëmshëm
Të brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> ○ Aderimi në KKKBNK dhe PK ○ Komunikimet kombëtare ○ Strategji kombëtare për mjedisin dhe energjinë ○ Legjislacioni horizontal mjedisor ○ Legjislacioni kuadër për ndryshimin e klimës 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Shkalla e paplotë e përafrimit të legjislacionit ○ Mungesa e një strategjie për klimën ○ Koordinimi dhe zbatimi i programeve e projekteve ○ Koordinimi i pakët institucional ○ Kapaciteti i ulët teknik dhe administrativ ○ Mundësi të pakta financiare
Të jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> ○ Marrja e statusit të vendit kandidat në BE ○ Asistenca e huaj (BE, etj.) ○ Bashkëpunimi rajonal (Mesdhe, Ballkan Perëndimor) ○ Përfshirja në projekte me financim të huaj ○ Përfshirja në tregjet e karbonit 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ecuria e procesit të aderimit ○ Ndërvarja nga asistenca e huaj ○ Kriza ekonomike-financiare ○ Implikimet e ndryshimit të statusit në kuadër të KKKBNK

Pra, boshllëqet më të mëdha në vend, lidhen me dobësitë si më poshtë:

- Kuadër i paplotë ligjor dhe politik për çështjen e klimës;

- Mungesa e një koordinimi të përshtatshëm institucional dhe e kapaciteteve teknike e administrative për çështjen e klimës;
- Angazhim i pamjaftueshëm dhe mundësi të dobëta financiare për t'u përfshirë në projekte që lidhen me klimën.

Duke përdorur si pikënisje fuqitë e dobësitë dhe duke shtuar faktorët e jashtëm në analizë, mund të identifikohen këto 'dritare' mundësish:

- Krijimi i një kuadri të plotë ligjor në lidhje me ndryshimin e klimës;
- Përpilimi i një strategjie kombëtare për klimën;
- Koordinim më i mirë institucional për çështjen e klimës që nënkupton bashkëpunimin më të mirë të ministrive veprimtaria e të cilave ka lidhje me klimën;
- Rritje e kapaciteteve teknike dhe administrative në nivel qendror dhe vendor për sa i takon çështjes së klimës;
- Përfitimi politik, në know-how dhe burime financiare nga bashkëpunimi me jashtë, nga aderimi në struktura, asistenca e huaj.

PJESA III

DETYRIMET LIGJORE KLIMATIKE TË SHQIPËRISË NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË BE, PLUS DY RASTE STUDIMI - ANALIZË

Kërkesat e negociatave për zgjerim të BE-së – ndryshimet klimatike

Traktati i Pranimiit përbën, sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GjED), burimin parësor të ligjit komunitar. Forca detyruese e zgjerimit qëndron në nenin 1(3) të këtij Traktati, i cili i kërkon vendit të ri anëtar t'i bindet dispozitave përsa i takon të drejtave dhe detyrimeve të vendeve anëtare dhe fuqive e juridiksionit të institucioneve të BE-së, sikurse përcaktohet në traktatet e themelimit të tij. Shtojca II e Traktatit të Pranimiit përfshin për çdo kapitull të negociatave, një listë të akteve për t'u miratuar nga vendi i ri anëtar përpara pranimiit në BE. Neni 16 i shtojcës II është për *acquis*-në mjedisore dhe përmban dispozita për mbrojtjen e mjedisit në këto fusha (Massai 2011): menaxhimi i mbetjeve, cilësia e ujit, mbrojtja e natyrës, kontrolli i ndotjes industriale e menaxhimi i riskut, dhe mbrojtja nga rrezatimi.

E drejta e BE-së për mbrojtjen e mjedisit ka qenë një ndër kapitujt më të komplikuar të negociatave për zgjerim, veçanërisht për shkak të kompleksitetit të ligjit të BE-së në këtë fushë dhe angazhimit të madh politik të institucioneve evropiane. Politika mjedisore e Komunitetit bazohet në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera komunitare. Ekzistojnë rreth 300 ligje të BE-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Referuar të drejtës mjedisore të BE-së, një rol kyç luan GjED, vendimet e së cilës shërbejnë si burime dytësore të së drejtës së mjedisit. Kjo gjykatë luan një rol të rëndësishëm në garantimin e zbatimit praktik të së drejtës mjedisore evropiane. Për këtë, GjED ka lejuar përdorimin e dispozitave të Traktatit të KE për harmonizimin e legjislacioneve kombëtare, në mënyrë që të garantohet mbrojtja e mjedisit (Muharremaj 2014). Por përveç kësaj, GjED zotëron edhe mekanizmin e kontrollit gjyqësor të zbatimit të unifikuar të së drejtës mjedisore. Gjykatat kombëtare të vendeve anëtare janë ato që interpretojnë *acquis communautaire*

mjedisore në veprimtarinë e tyre të përditshme, së bashku me GjED, e cila shmang mundësinë e interpretimeve të paunifikuara nga ana e gjykatave kombëtare.

Vendeve kandidate u është kërkuar të përshtatin në legjislacionin e tyre kombëtar dhe zbatojnë rreth 200 akte juridike, që mbulojnë legjislacionin horizontal dhe fushat e tjera të mbrojtjes së mjedisit të përmendura më lart. Procesi i përafrimit u kërkon vendeve anëtare jo vetëm të ndryshojnë apo përshtatin legjislacionin kombëtar në përputhje me *acquis*-në, por edhe të sigurojnë garanci të mjaftueshme për të siguruar zbatimin dhe përforcimin efektiv të atij legjislacioni.

Acquis mjedisor në kohën e zgjerimit të BE-së të vitit 2004, përfshinte një numër të kufizuar të pjesëve të caktuara të legjislacionit, të perceptuara për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të ulur emetimet e gazeve me efekt serrë. Shteteve të reja Anëtare iu kërkuua të transpozonin në sistemet e tyre kombëtare disa akte legjislative me qëllimin për të kontribuar në politikën evropiane të klimës, si gjatë procesit të pranimit, edhe pas pranimit të tyre. Për më tepër, vendeve kandidate iu kërkuua të zhvillonin një strategji pranimi, e cila do të merrte gjithashtu parasysh integrimin e aspekteve që lidhen me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës në zhvillimin e politikave të fushave të tjera, të tilla si transporti, energjia, industria dhe bujqësia.

Ligjet kryesore të BE-së për energjinë, ajrin, ujin, mbetjet dhe ndotjen industriale, si dhe pak pjesë të legjislacionit horizontal, të tilla si direktivat mbi vlerësimin e ndikimit mbi mjedis dhe mbi aksesin e publikut ndaj informacionit mjedisor, përfaqësonin thelbin e *acquis-ë* mjedisore në lidhje me politikën e klimës, në kohën e negociatave për anëtarësim të dhjetë vendeve të reja anëtare të BE në vitin 2004 (Massai 2011).

Ndërsa lista e mëposhtme përfshin një set legjislacioni domethënës të BE-së kundër ndryshimeve klimatike (*Ibid.*):

- Direktiva e Këshillit 96/62/EC mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit të ambientit;
- Rekomandimet e Komisionit 1999/125/EC, 2000/303/EC dhe 2000/304/EC, mbi reduktimin e emetimeve të CO₂ nga makinat e pasagjerëve;

- Direktiva e Këshillit 1999/13/EC mbi kufizimin e emetimeve të komponentëve organike të paqëndrueshëm, për shkak të përdorimit të solventëve organikë në aktivitete të caktuara dhe instalime;
- Direktiva e Këshillit 1999/32/EC për reduktimin e përmbajtjes së squfurit në disa karburante të lëngshëm;
- Direktiva e Këshillit 2001/81/EC mbi tavanet kombëtare të emetimeve për disa ndotës atmosferikë;
- Direktiva e Këshillit 2001/100/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 7 dhjetorit 2001, që amendon Direktivën e Këshillit 70/220/EEC për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare mbi masat që duhen marrë kundër ndotjes së ajrit nga emetimet e mjeteve motorike;
- Direktiva e Këshillit 2002/3/EC në lidhje me ozonin në ajrin e ambientit;
- Direktiva 2001/1/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 janarit 2001 për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 70/220/EEC në lidhje me masat që duhen marrë kundër ndotjes së ajrit nga emetimet e mjeteve motorike;
- Direktiva e Këshillit 2001/80/EC mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdhenj të djegies;
- Direktiva 2003/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 3 marsit 2003 për ndryshimin e Direktivës 98/70/EC në lidhje me cilësinë e benzinës dhe naftës;
- Direktiva 2008/1/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (IPPC).

Negociatat mbi kapitullin e mjedisit për pranimet e vitit 2004, nuk përfshinë një seksion të veçantë mbi ndryshimin e klimës, siç ishte rasti për fusha të tjera, të tilla si ndotja e ajrit, uji, mbetjet, etj. Arsyeja se përse nuk u caktua një kapitull më vete për ndryshimin e klimës gjatë procesit të negociatave ishte se kur negociatat u mbyllën në nëntor të vitit 2002, pjesët e vetme të legjislacionit që kishin të bënin drejtpërdrejt me luftën kundër ngrohjes globale, qenë: 1. Vendimi i Këshillit 93/389/EEC i ndryshuar me Vendimin 99/296/EC për një mekanizëm monitorimi të CO₂ të Komunitetit dhe emetimeve të tjera të gazeve serrë; dhe 2. Vendimi i Këshillit 94/69/EEC lidhur me pjesëmarrjen në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës. Këta dy akte janë përfshirë në kapitullin mbi cilësinë e ajrit që

mbulon një gamë të gjerë të legjislacionit të Komunitetit, me një ndikim indirekt mbi nivelin e emetimeve të gazeve serrë në Evropë.

Negociatat e pranimit midis shteteve kandidate dhe institucioneve evropiane për kapituj të ndryshëm u mbyllën zyrtarisht në nëntor 2002. Natyrisht, disa dispozita janë miratuar nga Komuniteti Evropian pas kësaj date dhe disa ishin gjithashtu me rëndësi të veçantë, sidomos në lidhje me ndryshimin e klimës. Kjo ndodh kryesisht për shkak të faktit se ligji dhe politika e mjedisit e Komunitetit u zhvilluan në mënyrë të konsiderueshme në ato vite, në veçanti në fushën e ndryshimeve klimatike dhe energjisë së pastër, dhe për shkak të progresit të angazhimeve të ndërmarra në nivel ndërkombëtar.

Periudha midis 1 nëntorit 2002 dhe datës së pranimit 1 maj 2004, quhej periudhë e përkohshme. Negociatat e pranimit nuk mbulonin legjislacionin e BE-së të miratuar gjatë kësaj periudhe, madje ai as që ishte i përfshirë në Traktatin e Pranimit. Legjislacioni i Komunitetit i miratuar gjatë kësaj periudhe është bërë duke pasur parasysh një BE të zgjeruar me 25 vende dhe për këtë arsye përfshinte në disa raste, rregullime të veçanta për vendet hyrëse në formën e dispozitave, të amendamenteve apo neneve duke iu referuar detyrimeve të shteteve të reja anëtare, negociuar rast pas rasti nga përfaqësuesit e vendeve të përfshira në procesin legjislativ me BE. Një shembull i qartë është Direktiva 2003/87/EC (EATD-*Emmission Trading Directive*) e 13 tetorit 2003, e cila vendoste krijimin e një sistemi shpërblymje tregtar mbarë evropian (EU ETS): Neni 9 (1) i EATD u kërkonte Shteteve Anëtare të publikonin dhe të njoftonin Komisionin dhe vendet e tjera anëtare për planet kombëtare të alokimit deri më 31 mars 2004 (*Ibid.*). Për Shtetet e reja Anëtare, ky afat u shty deri më 1 maj 2004.

Në kohën e pranimit, vendeve u kërkohet pra, të zbatonin ndër të tjera, legjislacionin e mëposhtëm mbi ndryshimin e klimës të miratuar nga Komuniteti, gjatë periudhës së përkohshme:

- Vendimi i Këshillit 2002/358/EC i datës 25 prill 2002 në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e angazhimeve të përbashkëta në zbatim të saj;

- Direktiva e Këshillit 2003/87/EC për krijimin e një skeme për lejimet e tregtimit të emetimeve të gazeve serrë brenda Komunitetit (ETS BE);
- Direktiva 2003/30/EC për promovimin e përdorimit të biokarburantëve;
- Direktiva 2003/96/EC për tatimin e produkteve të energjisë dhe elektricitetit;
- Direktiva 2004/8/EC për promovimin e bashkëprodhimit të ngrohjes dhe energjisë elektrike.

Për më tepër, masa të veçanta të kufizuara në kohë dhe fushëveprim u miratuan midis Shteteve të reja Anëtare dhe Komisionit në lidhje me legjislacionin, për të cilin ishte hartuar një plan i qartë zbatimi. Për shembull, në respektim të Direktivës mbi parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (IPPC-96/61/EC), u akorduan periudha kalimtare për instalime të veçanta, sa i përket përshtatjes me ‘teknikat më të mira në dispozicion’ në Letoni dhe Poloni (deri më 2010) dhe Slloveni dhe Republikën Sllovake (deri më 2011), ndërsa afati i fundit për Shtetet e tjera Anëtare ishte viti 2007. Përveç kësaj, një periudhë tranzitore u është dhënë disa Shteteve të reja Anëtare për sa i përket Direktivës për impiantet e mëdha me djegie (LCP) (*Ibid.*).

Bisedimet mbi mundësinë e rënies dakord për pak rregullime kalimtare për shtetet kandidate, në lidhje me të Direktivën e tregtisë së emetimeve (EATD-2003/87/EC) u hapën para se kjo Direktivë të miratohej. EATD është një instrument i ri për politikën e klimës dhe zbatimi i tij kërkon shumë përpjekje, sidomos nga ato vende me një mungesë të kapaciteteve të nevojshme dhe burimeve në nivel qeveritar dhe ministror, si dhe në aspektin e ekspertizës teknike për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e emetimeve të gazeve serrë nga instalimet. Në veçanti, përgatitja dhe hartimi i planeve kombëtare të alokimit, përmes të cilëve shpërndahet ndihma e BE-së në instalimet kombëtare, kërkojnë ekspertizë dhe njohuri të konsiderueshme. Në takimin e dytë të Komitetit të Përkohshëm për ETS të BE-së, vendet kërkuan sqarime dhe kohë për të shqyrtuar propozimet e EATD, për shkak të mungesës së burimeve në dispozicion për të siguruar një zbatim korrekt të Direktivës. Duke pasur parasysh faktin se që nga viti 1990, kolapsi ekonomik në shumë vende anëtare ka kontribuar në pakësimin e emetimeve të gazeve serrë edhe më poshtë objektivave të caktuar në Protokollin e Kiotos, një reduktim i mëtejshëm që arrihet nëpërmjet sistemit të tregtimit të emetimeve, do t'i linte këto vende me një diferencë të vogël të rritjes lidhur me detyrimet për të reduktuar emetimet e gazeve në nivel evropian dhe ndërkombëtar në fazën e post-2012-ës. Në këtë

drejtim, në takimin e Komitetin të Përkohshëm, përfaqësuesit hungareze pohuan se vendeve hyrëse duhet t'u ishën lejuar rritje të emetimeve, të paktën kur hartoheshin planet e shpërndarjes kombëtare, sikurse u qenë lejuar disa vendeve të BE-së kur ishte negociuar marrëveshja e ndarjes së barrës në fillim të 1998-ës.

Sot, sfidat kryesore të zgjerimit në rajon në fushën e ndryshimeve klimatike, sipas *DG Enlargement* janë në këto fusha:

- Ligjore: legjislacioni kombëtar duhet të jetë i përafuar (deri në datën e pranimit) me mbi 200 akte ligjore të BE-së që mbulojnë mjedisin dhe ndryshimet klimatike;
- Administrative: institucionet kombëtare duhet të përshtaten dhe të forcohen për të qenë në gjendje të zbatojnë legjislacionit të BE-së;
- Financiare: investime të mëdha nevojiten për të siguruar modernizimin e institucioneve, teknologjisë dhe infrastrukturë në fushën e mjedisit dhe ndryshimit të klimës.

Një ndër prioritetet kryesore për vendet në proces anëtarësimi është veprimi për klimën. Në këtë fushë, çështjet më të rëndësishme janë: përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së për të rritur pjesën e konsumit të energjisë të prodhuar nga burime të rinovueshme, duke rritur eficiencën e energjisë, zhvillimin e teknologjive të kapjes dhe magazinimit të karbonit të emetuar nga termocentralet dhe instalimet e tjera të mëdha industriale; reduktimi i emetimeve të dioksidit të karbonit nga makina dhe furgonët e rinj, integrimi i klimës në politikat e tjera, etj.

BE-ja mbështet vendet që dëshirojnë të bashkohen në përpjekjet e tyre për të përmbushur standardet mjedisore dhe të ndryshimit të klimës të BE-së, nëpërmjet asistencës për shpjegimin e legjislacionit të ndryshimeve klimatike të BE-së, monitorimit të progresit për përafrimin dhe zbatimin e *acquis* së mjedisit dhe ndryshimit të klimës, nëpërmjet raporteve të progresit. Po kështu, BE mbështet edhe bashkëpunimin rajonal përmes programeve dhe instrumenteve RENA, TAIEX dhe ECRAN⁷¹. Ky i fundit është një program që ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin rajonal midis vendeve kandidate dhe kandidate potenciale të BE-së në fushat e mjedisit dhe veprimit për klimën. Programi synon t'i ndihmojë ata në rrugën e tyre drejt përshtatjes dhe zbatimit të politikave dhe instrumenteve mjedisore dhe klimatike të BE-

⁷¹ "EU enlargement factsheet", marrë më dhjetor 2013, nga <http://ec.europa.eu/enlargement>

së, të cilat përbëjnë parakushtet për pranimin në BE. Ndërsa instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) mbështet financiarisht investimet dhe forcimin e kapaciteteve administrative në të gjitha këto fusha kyçe.

Bazuar në dokumentin e strategjisë së zgjerimit të BE-së dhe sfidat kryesore për vitet 2013-2014, Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) mbështet reformat që çojnë në përmbushjen e kriterëve ekonomike. Nën WBIF, Komisioni Evropian, donatorët dypalësh dhe institucionet ndërkombëtare financiare po mbështesin 4 miliardë USD investime në vit në transport, energji, mjedis, ndryshimin e klimës, sektorin shoqëror, dhe sektorin privat e të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Detyrimet e Shqipërisë për ndryshimet klimatike në kuadër të anëtarësimit në BE

Tashmë që Shqipëria ka statusin e vendit kandidat dhe duke vijuar përgjatë periudhës së anëtarësimit, do të bisedohet me Komisionin për pjesë të ndryshme të legjislacionit të BE-së, që duhen transpozuar dhe zbatuar në nivel kombëtar. Politikat e BE-së për ndryshimet klimatike janë të përqendruara kryesisht në politikën mjedisore të BE-së dhe në politikën e energjisë së BE-së. Ligji mjedisor dhe i energjisë mjedisore të BE-së janë pjesë e *acquis communautaire* që Shqipëria duhet të integrojë në kuadrin e saj ligjor të brendshëm, pas pranimit të plotë (DRFKSh 2009).

Në bazë të dokumenteve ligjorë të para-aderimit, nuk ka asnjë referencë të drejtpërdrejtë për ndryshimet klimatike. Në Nenin nr. 108, MSA-ja përfshin vetëm një referencë të thjeshtë mbi çështjet mjedisore. Partneriteti Evropian, nëpërmjet të cilit BE-ja siguron udhëzime për autoritetet shqiptare mbi prioritetet e reformës, siguron detaje edhe lidhur me mjedisin duke nxjerrë në pah zonat kryesore prioritare mjedisore në vend, pa përmendur drejtpërsëdrejti masat e politikave ndaj ndryshimeve klimatike.

Siç dihet Shqipëria po përgatitet për t'u bërë anëtare e BE-së dhe vendi po ndihmohet në procesin e harmonizimit të legjislacionit të saj me legjislacionin e BE-së. Mos ndoshta BE-ja kërkon që vendet kandidatë dhe/ ose më pas anëtare të ndryshojnë statusin e tyre nga vende që nuk bëjnë pjesë në Shtojcën 1, në vende anëtare të Shtojcës 1 të Protokollit të Kiotos, si një para-kusht për anëtarësimin në BE? A nënkupton integrimi në BE faktin se projektet shqiptare nuk do përzgjidhen më si projekte MZHP-je por si projekte të Zbatimit të Përbashkët? A

mundet Shqipëria të përmbushë kërkesat e direktivës së BE-së për tregtimin e emetimeve duke ruajtur statusin e vendit jo anëtar në Shtojcën 1? Të gjitha këto dilema kanë marrë përgjigje në DRFKSh (2009): BE, si palë e Protokollit të Kiotos ka vënë në përdorim Nenin 4 të tij, që lejon grupe shtetesh të pranojnë një synim të përbashkët për shkarkimet. Sikurse kemi përmendur më lart, pesëmbëdhjetë Shtetet Anëtare nga të cilat përbëhej BE-ja në kohën kur u miratua Protokollin e Kiotos, u angazhuan të pakësonin shkarkimet e gazeve serrë me qëllim uljen me 8% gjatë viteve 2008-2012 krahasuar me nivelet e 1990-ës, gjatë periudhës së parë të angazhimit. Shtetet që u anëtarësuan në BE, pasi u nënshkrua marrëveshja e ndarjes së detyrimeve në vitin 2002, nuk u bënë pjesë e këtij angazhimi.

Shumica e vendeve të reja anëtare të BE-së janë shtete që përfshihen në Shtojcën 1, me objektiva për pakësimin e emetimeve. Por, vende si Malta dhe Qiproja u anëtarësuan në BE në 2004-ën duke mbajtur statusin e vendeve jo anëtare në Shtojcën 1, sipas KKKBNK-së dhe si pasojë pa objektiva specifike për pakësim për periudhën 2008-2012, siç parashikohet në Shtojcën B të Protokollit të Kiotos.

Të gjitha shtetet anëtare aktuale të BE-së kanë ndërmarrë angazhime ndërkombëtare nga viti 2012 e në vazhdim dhe do të hyjnë në bisedime për marrëveshjen e ndarjes së detyrimeve të brendshme. Ndërkohë, supozohet se anëtarësimi i Shqipërisë në BE nuk do të ndodhë deri në vitin 2017 (DRFKSh 2009). Si rrjedhojë, për momentin Shqipëria nuk ka arsye pse ta ndryshojë (në mënyrë të sforcuar) statusin e saj si shtet jo anëtar i Shtojcës 1, si kusht për anëtarësimin në BE. Gjithashtu, Shqipëria ka të njëjtin pozicion si shtetet e tjera që kërkojnë anëtarësimin në BE dhe që kanë statusin e vendit jo anëtar në Shtojcën 1, si Maqedonia, dhe Bosnja-Hercegovina.

Një tjetër çështje në lidhje me zbatimin e *acquis* të BE-së për ndryshimet klimatike është zbatimi i të ashtuquajturave direktiva të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve (ETS). ETS-ja është një mekanizëm evropian që ka si synim të mbështesë instrumentin që BE-ja dhe shtetet e saj anëtare kanë vënë në zbatim për të përmbushur objektivat e Kiotos. Sipas ETS-së, instalimet evropiane që bëjnë pjesë në listën e sektorëve të treguar në tekstin e direktivës (në përgjithësi impiante të mëdha në sektorë të tillë si prodhimi i energjisë, industrinë e ngrohjes, rafinerinë e naftës, furrat e koksifikimit, shkrirësit e mineraleve, çelikut, çimentos, xhamit, tjegullave, qeramikës, brumit të letrës dhe letrës) do të marrin çdo vit, një sasi të caktuar të

lejeve të emetimeve dhe një leje përfshin lejimin e shkarkimeve prej 1 ton ekuivalent CO₂. Çdo instalim duhet të dorëzojë në vit një numër lejesh që korrespondojnë me shkarkimet e prodhuara. Këto instalime, me shkarkime nën sasinë e përcaktuar të ndotjes mund t'ua shesin të drejtat e emetimit subjekteve me shkarkime të tepërta. Drejtuesit e instalimeve që nuk janë të aftë të dorëzojnë leje të mjaftueshme duhet të paguajnë gjobat financiare.

Edhe nëse Shqipëria, në momentin e pranimit në BE, nuk gëzon statusin e vendit anëtar në Shtojcën 1 dhe as të Shtojcës B të Protokollit të Kiotos, zbatimi i ETS-së do të jetë një detyrim si pjesë e integritetit të legjislacionit të BE-së. Nuk ka asnjë nen të veçantë në ETS që merret me domosdoshmërinë e të qenit shtet i Shtojcës 1 në përmbushjen e detyrimeve të direktivës së ETS-së. Mund të ndihmojë eksperiencia e Qipros dhe Maltës në këtë drejtim. Të dy vendet janë shembull i shteteve anëtare, të cilat përpos të qenit vende jo anëtare në Shtojcën 1 dhe të pa përfshira në Shtojcën B të Protokollit të Kiotos, kanë zbatuar në mënyrë të plotë direktivat e ETS-së dhe kanë vënë në zbatim dispozitat e saj në instalimet ndërkombëtare.

Mekanizmat e financimit të karbonit dhe lidhja e tyre me procesin e anëtarësimit në BE

Sikurse analizohet edhe në dokumentin rekomandues të financimit të karbonit (shih më lart), tregu i karbonit pritet të jetë në evoluim të vazhdueshëm në vitet e ardhshme, duke u pasuruar me mekanizma dhe skema të reja pjesëmarrjeje. Në këtë kuptim MZhP-ja do të jetë vetëm skema pioniere, madje ajo mund të pësojë edhe vetë ndryshime gjatë negociatave të Konferencës së Palëve dhe Takimeve të vendeve Palë në Protokollin e Kiotos, të cilat do të jenë pikënisja e proceseve të reja të zhvillimit të financimit të karbonit.

Burimet e risive dhe zhvillimeve në tregjet e karbonit mund të jenë: (i) reforma ose evoluimi i MZhP-së, ndryshe nga si njihet ose zbatohet në të tashmen; (ii) përfshirja e fushave dhe sektorëve të rinj në mekanizmat ekzistues ose krijimi i mekanizmave të rinj (për shembull, përfshirja e transportit ajror dhe detar në MZhP, ose në REDD nën KKKBNK e PK); (iii) Krijimi i mekanizmave të rinj që vijnë nga marrëveshje shumëpalëshe ekzistuese ose të reja (për shembull, Protokollin e Kiotos ose marrëveshje të tjera të reja); (iv) zhvillimi i standardeve të tregjeve vullnetare (Standardi Vullnetar i Karbonit - VCS - dhe të tjera); (v) Mundësi kuotash në skema për tregtinë e shkarkimeve në nivel rajonal ose kombëtar (SHBA, Kanada, Japoni, dhe të tjerë) (DRFKSh 2009).

Përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar të mjedisit dhe energjisë me atë të BE-së, mund të shihen si një mundësi edhe për zbatimin e projekteve të MZhP-së, pasi realisht shumica e pjesëve të legjislacionit të BE-së të këtyre fushave përbëjnë gjithashtu dhe zonat e zakonshme për zhvillimin e projekteve të MZhP-së. Shqipëria, gjatë zbatimit të legjislacionit të BE-së në lidhje me mjedisin dhe energjinë mund të vendosë integrimin e komponentit të MZhP-së në ato fusha ku legjislacioni i BE-së do të përshtatet me kuadrin e saj kombëtar, pa vënë në rrezik (sikurse përmendet edhe më lart) kërkesat shtesë të MZhP-së.

BE, si palë e Protokollit të Kiotos ka lejuar grupe shtetesh të pranojnë një synim të përbashkët për emetimet dhe të riafrojnë këtë synim në nivel ndërkombëtar (“Flluska” e BE-së). Shtetet që u anëtarësuan në BE pasi u nënshkrua marrëveshja e ndarjes së detyrimeve në vitin 2002, nuk janë pjesë e flluskës së BE-së. Kur BE-ja u angazhua në pakësimin e shkarkimeve të gazeve serrë me qëllim uljen me 8% gjatë viteve 2008-2012, krahasuar me nivelet e 1990-ës, gjatë periudhës së parë të angazhimit, ky objektivi mbulohej vetëm nga pesëmbëdhjetë Shtetet Anëtare, nga të cilat përbëhej BE-ja në kohën kur u miratua PK.

Që nga 2012 e në vazhdim, vendet e BE-së kanë angazhime ndërkombëtare dhe një marrëveshje të re për ndarjen e detyrimeve të brendshme. Sipas EEA (2013), projektimet për emetimet nga vendet anëtare tregojnë se totali i tyre do të bjerë më tej gjatë viteve 2012-2020 për EU-28. Emetimet e EU-së pritet të arrijnë një nivel më 2020-ën që është 21% poshtë nivelit të 1990-ës (përfshirë emetimet nga aviacioni ndërkombëtar). Pakësimet e projektuara pritet të arrihen në sektorët e mbuluar nga EU ETS (kryesisht furnizim me energji dhe industri), ku është përcaktuar një tavan emetimesh në nivel EU-je dhe në sektorët e tjerë të mbuluar nga objektivat e emetimeve kombëtare sipas Vendimit për Ndarjen e Përpjekjeve. Përtej vetë EU ETS-së, pakësimet më të mëdha priten nëpërmjet masave që mbështesin energjinë e rinovueshme, për të siguruar që plotësohen kërkesat e Direktivës së Energjisë së Rinovueshme dhe që zbatohet Direktiva e Emetimeve Industriale, e cila mbulon impiantet e mëdha me djegie.

Zbatimi i direktivave të Sistemit të Tregtisë së Emetimeve – ETS, është një tjetër çështje që lidhet me mekanizmat e financimit të karbonit dhe zbatimin e *acquis* të BE-së (shih më lart). Sipas ETS-së, instalimet evropiane që bëjnë pjesë në listën e sektorëve të cituar në tekstin e

direktivës, sikurse u përmend më lart, do të marrin çdo vit një leje që përfshin lejimin e shkarkimeve prej 1 ton ekuivalent CO₂.

Shqipëria, nëse në momentin e pranimit në BE, nuk e gëzon statusin e vendit anëtar në Shtojcën 1 dhe nuk është anëtare e Shtojcës B të Protokollit të Kiotos, do të jetë e detyruar të zbatojë ETS-së. Në fakt, vetë ETS nuk kërkon domosdoshmërinë e të qenit shtet i Shtojcës 1, në mënyrë që të përmbushen detyrimet e direktivës së ETS-së. Sipas ligjit aktual të BE-së, derisa Shqipëria të përfshihet në BE, ajo nuk ka arsye ta ndryshojë statusin e saj si shtet jo anëtar i Shtojcës 1, si kusht për anëtarësim. Megjithatë mund të ndodhë që BE-ja në një pikë të caktuar t'i detyrojë të gjitha vendet e saj anëtare të ndryshojnë statusin e tyre.

Ndërkohë që Shqipëria po përgatitet për t'u bërë anëtare e BE dhe vendi po merr ndihmë për harmonizimin e legjislacionit të vet me atë të BE-së, gjithashtu ende ka paqartësi lidhur me faktin nëse projektet shqiptare do të përzgjidhen si projekte MZhP-je, apo si projekte të Zbatimit të Përbashkët dhe nëse gjatë periudhës së para-aderimit ligji i BE-së e parandalon zbatimin e projekteve të MZhP-së (shih më lart “Detyrimet e Shqipërisë për ndryshimet klimatike”).

Një gjë është e qartë, që procesi i integritimit në BE nuk parandalon zbatimin e projekteve MZhP autorizimi i të cilave ka filluar gjatë fazës së para-aderimit dhe e çojnë periudhën e tyre të kuotave deri në atë fazë kur Shqipëria të jetë pjesë e BE-së. Këto projekte mund të vazhdojnë të prodhojnë kuota karboni në rast se shteti vazhdon të mbajë statusin e shtetit jo anëtar në Shtojcën 1. Ka vende si Qiproja që është vend anëtar i BE-së, me projekte të regjistruara të MZhP-së.

Pas anëtarësimit në BE dhe marrjes së detyrimeve për pakësimin e emetimeve në zonën e BE-së dhe ato ndërkombëtare, kuotat e projekteve të MZhP-së të regjistruara nën statusin e vendit jo anëtar në Shtojcën 1, nuk do të konsiderohen si kuota reduktimi të emetimeve të certifikuar (CER). Nga kjo perspektivë, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë bisedimeve aktuale ndërkombëtare mbi atë çka duhet të bëjë me projektet e MZhP-së kur ato nuk do të konsiderohen më si projekte me origjinë nga vendet jo anëtare në Shtojcën 1. Ky është një nga aspektet që ka gjasa të rregullohet nën një marrëveshje të re ndërkombëtare (DRFKSh 2009).

Pra, për të përmbledhur sa më lart, tregu i karbonit në Evropë ka skemat e tij, të tilla si MZhP, e cila pritet të evoluojë dhe pasurohet. Shqipëria mund të zhvillojë projektet e saj MZhP, të cilat nëse fillojnë në periudhën e para-aderimit, mund të vijojnë edhe pas anëtarësimit në BE. Zhvillimi i projekteve MZhP duhet të parashikohet gjatë procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar të mjedisit dhe energjisë me atë të BE-së. Në momentin e pranimit në BE, Shqipëria mund të jetë e detyruar të zbatojë skemën ETS, e cila së bashku me zbatimin e direktivave për energjinë e rinovueshme dhe emetimet industriale, kontribuojnë në pakësimin e emetimeve në nivel komuniteti evropian.

Rast studimi 1 - Përmirësimi i legjislacionit për taksën e karbonit në Shqipëri⁷²

Hyrje

Nëpërmjet këtij rasti studimi, autori ka për qëllim të japë kontribut konkret në përmirësimin e ligjit shqiptar mbi taksën e karbonit duke iu referuar ligjit të BE-së dhe *Acquis Communautaire*. Ky kontribut është menduar të bëhet duke pasur parasysh dy objektiva të rëndësishëm të vendit tonë sot: 1. Integrimin e Shqipërisë në BE; 2. Mbrojtjen e mjedisit përmes politikave të pakësimit të karbonit me synim ndryshimin e klimës.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Protokollin e Kiotos, në zbatim të Konventës Kuadër të Ndryshimet Klimatike, duke qenë pjesë e vendeve të Shtojcës jo-1. Megjithatë, si anëtar i protokollit ajo ka detyrimet e veta për të ndërmarrë masa për të zbutur shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe efektet e këtyre ndryshimeve. Politikat për të luftuar ndryshimin e klimës në vend përfshijnë masa legjislative që tentojnë të përafrojnë legjislacionin e brendshëm me atë të Komunitetit Evropian. Progresi në këtë drejtim është raportuar çdo vit pranë Komisionit Evropian dhe është pjesë e procesit të vlerësimit të bërë së fundmi mbi performancën e përgjithshme të vendit drejt anëtarësimit. Siç mund të shihet nga Raporti i Progresit për vitin 2013, performanca e Shqipërisë në drejtim të ndryshimit të klimës cilësohet si pamjaftueshme. Një arsye madhe për këtë performancë është përpjekja e paktë për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë në vend.

Administratat Doganore shpesh caktohen të zbatojnë politika për zbutjen e ndryshimeve klimatike, të tilla si taksat e importit të karbonit apo lehtësimi i tregtisë të teknologjisë së energjisë me karbon të ulët. Ky studim do të përqendrohet vetëm në taksat e karbonit që aplikohen mbi mallrat e importuara, ku Administrata Doganore Shqiptare është agjencia zbatuese.

⁷² Ky rast studimi është realizuar nën asistencën e Agjencisë së Mjedisit të Suedisë, në kuadër të një projekti të financuar nga Qeveria Suedeze, për përafrimin me legjislacionin mjedisor të BE-së, i cili ka zgjatur 18 muaj dhe ka përfshirë trajnime, vizita studimore dhe workshope, në Suedi dhe vende të tjera të BE-së.

Taksa e karbonit është një taksë që vihet mbi përmbajtjen e karbonit të një produkti energjie dhe është një formë e ‘vendosjes së çmimit’ të karbonit. Taksat e karbonit ofrojnë një mundësi kost-efektive për të reduktuar emetimet e gazeve serrë.

Në Evropë, një numër vendesh kanë imponuar taksat e energjisë bazuar pjesërisht në përmbajtjen e karbonit. Në vitin 2003, Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian miratoi Direktivën e Tatimit të Energjisë, Direktiva 2003/96/EC, që ristrukturon kuadrin e komunitetit për tatimin e produkteve të energjisë dhe të energjisë elektrike. Në vitin 2010, Komisioni Evropian vendosi zbatimin e një takse pan-evropiane minimale të ndotjes, blerë nën Sistemin e Tregtisë së Emetimeve të gazeve serrë të Bashkimit Evropian (EU-ETS).

Sipas ligjit shqiptar “Për taksat kombëtare” (nr. 9975, datë 28.07.2008), ndër taksat e ndryshme kombëtare në Shqipëri, ekziston edhe një taksë për karbonin. Si pasojë e ndryshimeve të ligjit, taksat e karbonit për produkte të ndryshme të energjisë, janë trefishuar në tre vjet dhe shumëllojshmëria e produkteve të naftës që taksohen është rritur. Gjithsesi, nga një krahasim i legjislacionit shqiptar me direktivën e BE-së për tatimin e produkteve të energjisë, mund të shihet se një numër i madh i produkteve të energjisë të parashikuara në këtë të fundit nuk janë të përfshira në ligjin shqiptar.

Analiza e situatës sjell rëndësinë e faktit që të merret në konsideratë ndryshimi i ligjit shqiptar për taksat kombëtare, në lidhje me taksimin e karbonit. Për këtë arsye, duhet të ndërmerret një analizë e rëndësisë së produkteve të lartpërmendura për tregun shqiptar, në mënyrë që të propozohen amendimet eventuale. Produktet e energjisë të përfshira dhe niveli i zbatueshëm i taksimit, duhet të rillogariten duke marrë parasysh përvojën e vendeve në rajon që kanë përafruar tashmë Direktivën 2003/96/EC dhe mundësinë për lirim të pjesëshëm, apo përjashtimin e produkteve të energjisë të përdorura për qëllime të veçanta, siç parashihet në Direktivë.

Taksa e karbonit dhe zbatimi i saj

Emetimet e gazeve serrë të nxitura nga njeriu, janë shkaku kryesor i ngrohjes globale dhe dioksidi i karbonit është më kryesori i gazeve antropogjenikë. Efekti fizik i CO₂ në atmosferë mund të matet si ndryshim në sistemin e bilancit energjetik të Tokës dhe Atmosferës. Në botë,

prodhohen çdo vit 27 miliard ton dioksid karboni nga aktiviteti njerëzor (USGS 2009). Karboni është i pranishëm në çdo lëndë djegëse hidrokarbure (qymyr, naftë dhe gaz natyror) dhe çlirohet si dioksidi karboni (CO₂) kur ato digjen. Përderisa emetimet e këtij gazi serrë të shkaktuara nga djegia e lëndëve djegëse fosile janë të lidhura ngushtë me përmbajtjen e karbonit të lëndëve djegëse përkatëse, taksa për këto emetime mund të mblidhet duke taksuar përmbajtjen e karbonit të lëndëve djegëse fosile në çdo moment të ciklit të prodhimit të karburantit.

Vendosja e taksave të karbonit është një nga politikat në dispozicion të qeverive për të zvogëluar emetimet e gazeve serrë. Një numër vendesh kanë zbatuar taksa karboni që janë të lidhura direkt me përmbajtjen e karbonit. Ndërsa në vendet e OECD-së, shumica e taksave mjedisore që lidhen me pasojat e emetimeve të gazeve serrë, janë të vendosura mbi produkte të energjisë dhe automjete motorike, në vend të emetimeve të CO₂ drejtpërdrejt.

Taksa e karbonit është një taksë e vënë mbi përmbajtjen e karbonit të lëndëve djegëse dhe është zbatuar në përgjigje të angazhimeve nën KKKBNK. Po kështu, nëpërmjet Protokollit të Kiotos që ka dalë në zbatim të kësaj konvente, emetimet e CO₂ janë rregulluar së bashku me ato të gazeve të tjera.

Nga këndvështrimi ekonomik, taksa e karbonit është një lloj takse Pigoviane. Taksa Pigoviane është një taksë që zbatohet në një aktivitet të tregut i cili gjeneron ndikime të jashtme negative dhe është menduar të korrigjojë rezultatin e tregut (Hepburn 2006). Në prani të ndikimeve të jashtme negative, kostoja sociale e aktivitetit të tregut nuk mbulohet nga kostoja private e aktivitetit. Në një rast të tillë, rezultati i tregut nuk është efikas dhe mund të çojë në mbikonsum të produktit. Një taksë Pigoviane e barabartë me ndikimin negativ të jashtëm, mendohet të korrigjojë rezultatin e tregut dhe ta kthejë atë sërish në efikasitet.

Kështu, taksat e karbonit ofrojnë një mënyrë potencialisht kost-efektive për të reduktuar emetimet e gazeve serrë. Ato ndihmojnë për të trajtuar problemin e emetuesve të gazeve serrë që nuk ballafaqohen me kostot e plota sociale të veprimeve të tyre. Taksat e karbonit janë model takse regresive, në faktin se ato ndikojnë në mënyrë disproporcionalisht pozitive grupet me të ardhura të ulëta.

Ka përdorues të mëdhenj të burimeve të karbonit për prodhimin e energjisë elektrike, të tilla si ShBA, Rusia dhe Kina, apo kompani të mëdha prodhuese, të cilat po i bëjnë rezistencë vendosjes së taksave të karbonit. Kundërshtitë për rritje të rregullimeve mjedisore të tilla si taksa e karbonit, shpesh përqendrohen në shqetësimet që firmat prodhuese mund të zhvendosen ose njerëzit mund të humbasin vendet e punës. Është argumentuar, megjithatë, se taksat e karbonit janë më të efektshme se rregulloret e drejtpërdrejta dhe madje mund të çojnë në rritje të punësimit.

Gjatë viteve '90, u propozua në nivel BE-je një taksë karboni (energjie), e cila dështoi për shkak të lobimit industrial (Pearce 2005). Në vitin 2010, Komisioni Evropian mori në konsideratë zbatimin e një takse minimale pan-evropiane mbi lejen e ndotjes, që blihej nën sistemin e tregtisë së emetimeve të gazeve serrë të Bashkimit Evropian (EU-ETS), në të cilin taksa e re e propozuar do të llogaritej në aspektin e përmbajtjes së karbonit dhe jo vëllimit, kështu që lëndët djegëse me përqendrim të larta të energjisë, pavarësisht përmbajtjes së tyre të lartë të karbonit, nuk do të kishin më të njëjtin çmim tradicionalisht të ulët. Sipas Komisionit Evropian, plani i ri do t'u ngarkonte firmave një taksë minimale për metrik ton të emetimeve të dioksidit të karbonit në një normë të sugjeruar prej € 4 deri në € 30 për ton të CO₂ (Kanter 2010).

Taksa e karbonit krahasuar me tregtinë e emetimeve (cap-and-trade)

Një politikë alternative për taksën e karbonit është vendosja e një 'kapaku' mbi emetimet e gazeve serrë. Niveleve të emetimeve të gazeve serrë u vihet tavan dhe lejet për të ndotur ndahen me ankand për ndotësit. Lejet nëpërmjet ankandit kanë avantazhe të konsiderueshme ekonomike pasi ngrenë të ardhura që mund të përdoren për të ulur taksat shtrembëruese (distortionary) dhe për të përmirësuar eficiencën e përgjithshme (Smith 2008). Për këto leje emetimi mund të caktohet një treg, në mënyrë që ndotësit të mund të tregtojnë disa ose të gjitha lejet e tyre me të tjerët (*cap-and-trade*). Rregullimi nëpërmjet tregtisë së emetimeve *cap-and-trade* mund të krahasohet me taksat e emetimeve apo taksat e tjera mjedisore.

Sipas Staudt et al. (2008), tregtia e emetimeve ose *cap-and-trade* është një qasje me bazë tregu që përdoret për të kontrolluar ndotjen, duke ofruar stimuj ekonomikë për të arritur pakësimin e emetimit të ndotësve. Një autoritet qendror (zakonisht një organ qeveritar) vendos

një kufi apo kapak mbi sasinë e një ndotësi që emetohet. Kufiri apo ‘kapaku’ u ndahet apo shitet firmave në formën e lejeve të emetimeve, të cilat përbëjnë të drejtën për të lëshuar apo shkarkuar një vëllim të caktuar të një ndotësi të caktuar. Firmat kërkohet të mbajnë një numër të lejeve (leje ose kredite karboni) ekuivalente me emetimet e tyre. Numri i përgjithshëm i lejeve nuk mund të kalojë ‘kapakun’, duke kufizuar emetimet e përgjithshme në atë nivel. Firmat që kanë nevojë për të rritur vëllimin e tyre të emetimeve, duhet të blejnë leje nga ata që kanë më pak nevojë (*Ibid.*). Transferimi i lejeve konsiderohet tregti. Në fakt, blerësi paguan një tarifë për ndotjen, kurse shitësi shpërblehet për të pasur emetime të reduktuara. Kështu, teorikisht, ata që zvogëlojnë emetimet do ta bëjnë këtë më lirë, duke arritur pakësimin e ndotjes me koston më të ulët për shoqërinë.

Tregtia e emetimeve të karbonit ka qenë vazhdimisht në rritje gjatë viteve të fundit. Sipas Bankës Botërore, 374 milion ton dioksid karboni ekuivalent (tCO₂e) janë shkëmbyer nëpërmjet projekteve në vitin 2005, 240% më shumë krahasuar me vitin 2004 (110 mtCO₂e) (IEA 2008). Konvertuar në dollarë, Banka Botërore ka vlerësuar se madhësia e tregut të karbonit ishte 11 miliardë USD në 2005, 30 miliardë dollarë në vitin 2006, dhe 64 miliardë në vitin 2007 (*Ibid.*).

Ka programe tregtare aktive për disa ndotës të ajrit. Për gazet serrë, programi më i madh është Skema e Tregtisë së Emetimeve të Bashkimit Evropian (European Union Trading Scheme), qëllimi i të cilit është të shmangë ndryshimet e rrezikshme klimatike. Në Shtetet e Bashkuara ekziston një treg kombëtar për të pakësuar shiun acid dhe disa tregje rajonale për oksidet e azotit (IPCC 2007b). Tregjet për ndotësit e tjerë priren të jenë më të vegjël dhe më të lokalizuar.

Një instrument hibrid tatimi i *cap-and-trade* dhe taksës së karbonit mund vendoste një çmim dysHEME dhe një çmim tavan për lejet e emetimit (Hepburn 2006). Një taksë karboni mund të përdoret në mënyrë konkurruese me *cap-and-trade*. Ajo rrit të ardhurat; nëse të ardhurat përdoren për të ulur taksat e tjera distortionary (shtrembëruese), kjo mund të përmirësojë eficiencën e taksës.

Të dyja taksat *cap-and-trade* dhe e karbonit u japin ndotësve një stimul financiar për të reduktuar emetimet e gazeve serrë. Taksat e karbonit japin siguri në lidhje me çmimet e emetimeve, ndërsa një skemë *cap-and-trade* ofron siguri në lidhje me sasinë e emetimeve. Në

një vlerësim të literaturës, Fisher et al. (1996) arriti në përfundimin se zgjedhja midis një sistemi kuote (kapaku) ndërkombëtar, apo taksave të karbonit ndërkombëtare, ka mbetur e paqartë. Lu et al. (2012) krahasoi instrumentet taksë karboni, tregti emetimesh dhe rregulloren komandë-dhe-kontroll në nivel industrial. U arrit në përfundimin se mekanizmat me bazë tregu do të vepronin më mirë sesa standardet e emetimit në arritjen e objektivave të emetimeve pa ndikuar në prodhimin industrial.

Ndryshe nga taksat e shkarkimeve dhe *cap-an-trade* të cilat janë rregullime të bazuara tek nxitja, rregullimet komandë-dhe-kontroll kanë forma të ndryshme dhe janë shumë më pak fleksibël. Një shembull i këtij rregullimi është një standard performance që përcakton një objektiv emetimi për çdo ndotës (që është fiks) dhe për këtë arsye barra e uljes së ndotjes nuk mund të zhvendoset në firmat që mund ta arrijnë atë më lirë. Si rezultat i kësaj, standardet e performancës nuk kanë të ngjarë të jenë aq kost-efektive sa tregtia e emetimeve *cap-and-trade*. Firmat do të ngarkohen me një kosto më të lartë për produkt dhe një pjesë e një kostoje të tillë të lartë do të kalojë tek konsumatori.

Ndryshimi i klimës dhe taksat e karbonit në Evropë

Ngrohja globale apo ndryshimi i klimës është e njohur gjerësisht nga shkencëtarët si një kërcënim potencialisht i rëndë mjedisor për Tokën. Politikat në kundërpërgjigje të ndryshimeve klimatike ndahen përgjithësisht në dy lloje, zbutëse (me synime tek shkaqet) dhe përshtatëse (me synime tek ndikimet).

Të dyja politikat, si e zbutjes, ashtu dhe e përshtatjes ndaj ndryshimit të klimës kanë implikime për administratat doganore. Politikat zbutëse merren me shkaqet e ndryshimit të klimës duke kërkuar reduktimin e emetimeve të gazeve serrë që shkaktojnë ndryshimin e klimës, ndërsa politikat e përshtatjes merren me ndikimet e ndryshimeve klimatike duke kërkuar të përshtatin shoqërinë njerëzore ndaj ndryshimeve klimatike dhe kështu të reduktojnë dëmet (Ireland 2010). Administratat doganore shpesh caktohen të zbatojnë politikat zbutëse të ndryshimeve klimatike në formën e procedurave kufitare ose detyrimit doganor, të tilla si tarifatat e importit të karbonit, lehtësimi i tregtisë të teknologjive së energjisë me karbon të ulët (veçanërisht nëpërmjet përdorimit të klasifikimit të mallit), dhe zbatimi i ligjit kundër parregullsive të tregtisë së lejeve të emetimeve.

Tarifat e importit të karbonit janë një politikë e zbutjes së klimës, agjencia administruese e të cilës janë shpesh doganat. Teorikisht, ekzistojnë dy lloje të përgjithshme të tarifave të importit të karbonit: taksat e produktit dhe taksat e procesit. Taksat e produktit përqendrohen në mallra të tilla si lëndët djegëse fosile apo gazet serrë me përdorime industriale (*Ibid.*). Ky rast studimi do të përqendrohet vetëm në taksat e produktit, në mënyrë më specifike në taksat e karbonit të produktit, pra mbi politikat lehtësuese, në të cilën administrata doganore shqiptare është agjencia zbatuese (në import).

Një numër vendesh kanë zbatuar taksa karboni ose taksa të energjisë, që janë të lidhura me përmbajtjen e karbonit. Në vendet e OECD-së, shumica e taksave që lidhen me mjedisin, me implikime për emetimet e gazeve serrë, janë të vëna më tepër mbi produkte energjie dhe mjete motorike, sesa mbi emetimet e drejtpërdrejta të CO₂. Në Evropë, vende të tilla si Danimarka, Finlanda, Gjermania, Irlanda, Italia, Holanda, Norvegjia, Sllovenia, Suedia, Zvicra dhe Britania e Madhe kanë vendosur taksa të energjisë ose taksa të energjisë bazuar pjesërisht në përmbajtjen e karbonit (Andersen 2010). Asnjë prej këtyre vendeve nuk ka qenë në gjendje të vendosë një taksë uniforme të karbonit për karburantet në të gjithë sektorët.

Le të marrim në konsideratë rastin e Suedisë, që është një vend *avant-garde* në nismat mjedisore. Në janar të vitit 1991, Suedia miratoi një taksë të CO₂ prej 250 SEK për ton (100 \$ ose 72 EUR) mbi përdorimin e naftës, qymyrit, gazit natyror, gazit të lëngshëm të naftës, benzinës, dhe karburantit për aviacion të përdorur në udhëtime kombëtare. Deri në vitin 2007, norma u ngrit gradualisht deri në 930 SEK (101 EUR) për ton të CO₂ (IEA 2008). Taksa e plotë u pagua në transport, ngrohje të hapësirës dhe prodhimin e energjisë elektrike dhe për ngrohje nga impiante jo të kombinuar. Përdorimi i kësaj takse shkaktoi një shtim të konsiderueshëm nga karburantet hidrokarbure në ata të biomasës. Kjo taksë e bëri ndotjen më të shtrenjtë dhe i bëri njerëzit të fokusoheshin në gjetjen e një zgjidhjeje më efektive për energjinë, sidomos për energjinë për ngrohje. Miratimi i taksës së karbonit është konsideruar si një ndër arsyet madhore që e çoi shoqërinë suedeze drejt zgjidhjeve miqësore ndaj klimës. Tani, në Suedi, biomasa përdoret gjerësisht, kryesisht mbeturinat nga pyjet dhe industritë pyjore.

Më 27 tetor 2003, Këshilli i Ministrave i BE-së miratoi Direktivën e taksimit të energjisë, Direktiva 2003/96/EC – që ristrukturon kuadrin komunitar për taksimin e produkteve të

energjisë dhe energjisë elektrike. Kjo Direktivë zgjeron fushëveprimin e sistemit të normës minimale të BE-së për produktet e energjisë, më parë i kufizuar në vajrat minerale, për të gjitha produktet e energjisë, duke përfshirë qymyrin, gazin natyror dhe elektricitetin. Kjo direktivë hyri në fuqi më 1 janar 2004 (European Commission 2013). Komisioni propozoi masat e duhura tranzitore për vendet për t'u anëtarësuar, të cilat u miratuan më pas nga Këshilli i Ministrave, në formën e dy direktivave, duke ndryshuar Direktivën 2003/96/EC. Këto janë Direktiva e Këshillit 2004/74/EC dhe Direktiva e Këshillit 2004/75/EC.

Komisioni Evropian paraqiti më 13 prill 2011, propozimin e tij për të rinovuar rregullat e vjetruara mbi tatimin e produkteve të energjisë në Bashkimin Evropian. Rregullat e reja synonin të ristrukturonin mënyrën se si tatoeshin produktet e energjisë, në mënyrë që të hiqnin pabarazitë aktuale dhe të merrnin parasysh si emetimet e CO₂ dhe përmbajtjen energjisë. Tatimet ekzistuese të energjisë do të ndaheshin në dy komponentë, që të marrë së bashku, do të përcaktonin normën e përgjithshme në të cilën një produkt tatoeshej. Komisioni dëshironte të promovonte eficiencën e energjisë dhe konsumin e produkteve më miqësore për mjedisin, për të shmangur shtrembërimet e konkurrencës në treg.

Propozimi i ri përcakton normën minimale për taksimin e komponentit CO₂ me 20 EUR për ton të CO₂ për të gjithë përdorimet e produkteve të energjisë (European Commission 2013). Ky komponent nuk zbatohet për energjinë elektrike. Norma e komponentit të energjisë varet nga fakti nëse produkti i energjisë përdoret si një lëndë djegëse motorike (rast në të cilin ajo është 9,6 EUR për GJ, që do të arrihet gradualisht deri në vitin 2018), ose si lëndë djegëse për ngrohje, ose si karburant motori i përdorur për qëllimet e përcaktuara në Nenin 8(2) të direktivës të taksimit të energjisë (rast në të cilin ajo është 0,15 EUR për GJ në vitin 2013). Ky komponent vlen edhe për energjinë elektrike (*Ibid.*).

Taksa e karbonit në Shqipëri

Sipas ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, ndërmjet taksave kombëtare në Shqipëri, ka edhe një taksë karboni. Përmes këtij ligji, përveç taksës së akcizës për karburantet (13 lekë, ose 0,10 EUR për kg), Shqipëria gjithashtu aplikon një taksë karboni për benzinën, gazoilin, qymyrin, solarin, mazutin, vajgurin dhe koxsin e naftës. Taksa vihet mbi importuesit për naftën e importuar dhe nënproduktet e naftës dhe mbledhet nga administrata doganore.

Nëpërmjet ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011, ka ndryshuar ligji i lartpërmendur (nr. 9975, datë 28.07.2008). Si pjesë e ndryshimeve, taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë/ litër për benzinën, 3 lekë/ litër për gazoil, 3 lek/kg për qymyrin, 3 lekë/ litër për solarin, 3 lekë/ litër për mazut, 3 lekë/ litër për mazutin dhe 3 lek / kg për koksin e naftës. Sikurse mund të shihet, taksat e karbonit janë trefishuar në tre vjet dhe shumëllojshmëria e produkteve të naftës për t'u taksuar është rritur.

Megjithatë, nëse të hedhim një vështrim të shpejtë në politikën e ndryshimit të klimës në vend lidhur me angazhimin e vendit dhe perspektivën evropiane, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e Kiotos duke zbatuar KKKBNK, duke qenë pjesë e vendeve të Shtojcës jo-1 (një kontribuues i vogël i emetimeve antropogjene të gazeve serrë). Gjithsesi, si anëtar i protokollit ajo ka detyrimet e veta për të ndërmarrë masa për të zbutur shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe efektet e saj si e tërë. Në këtë kuadër, struktura përkatëse në Ministrinë e Mjedisit, e asistuar nga UNDP-ja, ka përfunduar deri më tani dy Komunikime Kombëtare në lidhje me veprimtarinë e vendit kundrejt KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos. Këto komunikime shpallin rezultatet e punës së kryer dhe arritjes së objektivave në fushën e ndryshimeve klimatike. Monitorimi i ndotjes së ajrit, masat kundër industrive ndotëse apo sektorëve të tjerë që kontribuojnë në gazet serrë, janë disa nga pikat kryesore të raportimit.

Politikat për të luftuar ndryshimin e klimës përfshijnë gjithashtu edhe masat legislative, që në përgjithësi synojnë përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së. Progresi në këtë drejtim raportohet çdo vit në Komisionin Evropian dhe është pjesë e procesit të vlerësimit të këtij të fundit që bëhet për reformat e gjithanshme në drejtim të anëtarësimit. Çdo vit, në vjeshtë, shpallet një raport progresi për Shqipërinë, i cili shpreh mendimin në mes të tjerave edhe për reformën e mjedisit, duke përfshirë edhe ndryshimin e klimës.

Sikurse shihet në Raportin e fundit të Progresit (2013), performanca e Shqipërisë në drejtim të ndryshimit të klimës, e konsideruar në funksion të *acquis* dhe mekanizmave të KE-së, në tërësi është e dobët (shih më lart: “Procesi i politikave dhe legjislacionit mjedisor”). Një shkak i madh për këtë performancë të dobët është mungesa e punës për pakësimin e emetimeve të gazeve serrë. Arsyet për një situatë të tillë konsiderohet të jenë mungesa e burimeve financiare dhe teknike, sikurse dhe kapaciteti i ulët administrativ.

Kjo situatë kërkon pikë së pari angazhim dhe vullnet politik. Të gjitha aspektet e ndryshimit të klimës duhet të adresohen në mënyrë paralele, duke përqendruar përpjekjet në sektorët që janë më kërkues për burime. Përafrimi i legjislacionit në këtë drejtim mund të ndjekë të njëjtën logjikë. Shqipëria është rrugës drejt një procesi politik integruar. Në këtë drejtim, nuk ka asnjë alternativë përveçse që në kohën dhe me mënyrën e duhur t’i adresohet çështjes së ndryshimit të klimës. Dhe politika e taksës së karbonit mund të kontribuojë për këtë.

Nevoja për përafrim të mëtejshëm të legjislacionit të taksës së karbonit

Nga krahasimi i legjislacionit shqiptar me direktivën e BE-së për taksimin e produkteve të energjisë, mund të shihet se një numër i madh i produkteve të energjisë të parashikuara në këtë të fundit nuk janë përfshirë në ligjin shqiptar. Përshkrimi i këtyre produkteve sipas Krerëve të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave (në doganë) është dhënë më poshtë.

Tabela 15: Krerët Tariforë të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave (KTNK) të produkteve të energjisë të taksuara në Direktivën 2003/96/EC, por që mungojnë në ligjin shqiptar

KTNK	Përshkrimi
2701	Antracit, qymyr bituminoz
2702	Linjit
2704	Koks dhe gjysmë koks prej qymyrit
2705	Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi dhe gaze të tjera
2706	Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katrane të tjera minerale
2707	Vajra dhe produkte të tjera të distilimit në temperatura të larta të katranit të qymyrit
2708	Terpentine dhe koks terpentine, fituar nga katrani i qymyrit apo prej katraneve të tjera minerale
2709	Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze,

	bruto
2711	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera të gazta
2712	Vazeline, dyll parafine, dyll mikrokrystalin prej naftës, dyll i lëngshëm (i lëshuar), ozokerit, dyllë linjiti, dyllë torfe, dyllë të tjera minerale, dhe produkte të ngjashme fituar nga sinteza apo nga procese të tjera
2714	Bitum dhe asfalt, natyral; rreshpe bituminoze apo rreshpe naftë dhe rërë bituminoze; asfaltitet dhe gurët asfaltikë
2715	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumin natyral, në bitumin e naftës, në katranin mineral apo në terpeninën e katranit mineral
3403	Preparatet lubrifikuese (përfshirë vajin ftohës, përgatitjet për çlirimin e dadove dhe bulonave, preparatet anti—ndryshk apo anti—korrozionit dhe preparatet për lëvizjen nga format nga kallëpi, bazuar në lubrifikantet) dhe preparatet e një lloji të përdorura për trajtimin vajor apo lubrifikues të materialeve tekstile, lëkurëve, gëzofëve, apo materialeve të tjera, por përjashtohen preparatet që përmbajnë, si përbërës baze 70% apo më shumë ndaj peshës vaj naftë apo vajra efituara nga mineralet bituminoze
3811	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, preparatet kundër korrozionit dhe elemente të tjera të përgatitura shpesh, për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo për lëngje të tjera të përdorura për qëllime të njëjta si edhe vajrat minerale
3817	Alkilbenzenet e përziera dhe alkilnaftalenet e përziera, përveçse produktet e kreut 2707 apo 2902
3824	Lidhësit e përgatitur për format apo kallëpet apo zemrat në fonderi; produktet kimike dhe preparatet kimike të industrive kimike apo të lidhjeve (përfshirë ato që konsistojnë në përzierje të produkteve natyrale), të papërfshira dhe të paspecifikuara diku
4401	Druri si lëndë djegëse, në kërcunj, në kopaçe, në dege, në shkarpa apo në forma të ngjashme; druri në ashkla apo në copa; tallash dhe mbetje dhe kthime të drurit, nëse janë apo jo të aglomeruar në kërcunj, briketa, sfera apo në forma të ngjashme
4402	Qymyri i drurit (përfshirë qymyrin e lëvozhgave apo të arrave), nëse janë apo jo të aglomeruara

Burimi: Nomenklatura e kombinuar e mallrave 2013

Kjo analizë e situatës thekson rëndësinë e marrjes në konsideratë të ndryshimit të ligjit shqiptar “Për taksat kombëtare”, në lidhje me taksimin e karbonit. Ky ndryshim duhet të bëhet

pas ndërmarrjes së një analize të peshës që zënë në tregun shqiptar produktet e lartpërmendura.

Analiza e produkteve të energjisë që importohen në Shqipëri

Lidhur me çdo KTNK, sikurse përshkruhen në tabelën më lart, është bërë një kërkim në sistemin automatik të të dhënave të administratës doganore shqiptare, për sasinë e importuar të secilit prej tyre. Ky kërkim përfshin një periudhë tre vjeçare (2010, 2011 dhe 2012) në mënyrë që të ketë një pamje më të gjerë të situatës sesa do të ishte në një vit, si dhe të ketë një prognozë të tendencës së këtyre importeve.

Siç mund të shihet në tabelën 16, produktet më të rëndësishme të energjisë në litra janë KTNK-të: 2709 (vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, bruto) dhe 2711 (gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera të gazta). Për më tepër, produkti më i rëndësishëm i energjisë në ton është produkt i energjisë që ka KTNK 2701 (antracit, qymyr bituminoz).

Tabela 16: Importi sipas KTNK të produkteve të energjisë gjatë viteve 2010, 2011, 2012


KTNK	Sasitë gjatë viteve						
	2010		2011		2012		2012
	Në 1000 l	Në ton	Në 1000 l	Në ton	Në 1000 l	Në ton	
2701	0	64,190	0	90,277	0	99,507	50.67
2702	0	0	0	0	0	1	0.00
2704	0	14,363	0	14,746	0	14,583	7.43
2706	0	2	0	0	0	0	0.00
2707	0	23	0	61	5	144	0.07
2709	25,209	21,972	32,333	28,163	404	276	0.14
2711	138,449	77,876	140,575	76,619	132,509	72,214	36.77
2712	0	672	0	423	0	594	0.30
2714	0	5	0	3,526	0	79	0.04
2715	0	10,810	0	1,188	248	790	0.40
3403	164	150	129	122	169	155	0.08

3811	0	1,487	0	1,709	0	1,136	0.58
3817	0	7	0	4	0	2	0.00
3824	0	6,963	0	11,977	1	5,977	3.04
4401	0	284	0	169	0	925	0.47
4402	0	11	0	20	0	15	0.01
Total	0	198,814	0	229,006	0	196,398	100

Burimi: Baza e të dhënave të Doganës Shqiptare, 2013

Sasia e produktit të energjisë 2701 nga importi në Shqipëri, gjatë tre viteve të fundit ka treguar një rritje, siç tregohet në figurën 12. Lidhur me totalin e produkteve të energjisë nga importi, ai arrin një kulm në vitin 2011. Gjithsesi situata me importet si e tërë mund të konsiderohet e qëndrueshme.


Figura 12: Sasia e 2701 dhe totalit të produkteve të energjisë gjatë viteve në ton



Burimi: original

Në figurën 13 shihet se, sasia e dy KTNK-ve më të rëndësishme gjatë tre viteve, e matur në litra, është gati e qëndrueshme për produktin e energjisë 2711, ndërsa ka rënë në mënyrë dramatike në vitin 2012 për produktin e energjisë 2709.


Figura 13: Sasia e 2709 dhe 2711, matur në mijë litra gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012



Burimi: original

Sasia më e madhe në peshë e produktet të importuara të energjisë në Shqipëri për vitin 2012, është 2701 – “antracit, qymyr bituminoz”, i dyti më i madhi është 2711 – “gaze të naftës dhe hidrokarbure të tjera të gazta”.

Figura 14: Përqindja e totalit të KTNK për sasi të ton, në vitin 2012



Burimi: original

Përfundime

Qëllimi i këtij rasti studimi është dhënia e një kontributi konkret për përafrimin e legjislacionit të taksës së karbonit në Shqipëri, me Direktivën e Tatimit të Energjisë (2003/96/EC). Taksa e karbonit është një taksë që vihet mbi produktet e energjisë, duke ofruar një mënyrë efektive për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, të cilët ndikojnë në ndryshimin e klimës. Kjo taksë po aplikohet me sukses në shumë vende të zhvilluara në Evropë e në botë. Bashkimi Evropian nga viti 2003 e këtej, ka konsoliduar një bazë ligjore e politikash të avancuara për taksimin e produkteve të energjisë dhe karbonit që ato përmbajnë. Përveç taksën së karbonit, ka politika alternative që ofrojnë stimuj financiarë për të ulur emetimet e gazeve serrë, të tilla si tregtia e emetimeve dhe rregullimet komandë-dhe-kontroll. Aplikimi i mekanizmave me bazë tregu në tërësi, është konstatuar se vepron më mirë sesa vendosja e standardeve të emetimeve, duke mos ndikuar negativisht në prodhimin industrial.

Në Shqipëri aktualisht nuk ka një ligj të veçantë për taksimin e produkteve të energjisë dhe taksimi i karbonit është pjesë e ligjit për taksat kombëtare (nr. 10458, datë 21.07.2011). Ky ligj ka pësuar përmirësime dhe taksat e karbonit kanë ardhur në rritje, por referuar legjislacionit dhe *acquis*-ë së BE-së, taksat e karbonit dhe gama e produkteve të energjisë për t'u taksuar nevojitet të shtohen.

Nga një vëzhgim i bërë në sistemin e automatizuar të të dhënave në doganën shqiptare, si dhe nga analiza e produkteve të energjisë të përfshira në direktivën e BE-së për taksimin e produkteve të energjisë, por që mungojnë në ligjin shqiptar për tatimin e karbonit, mund të konkludohet se tre produkte energjie (KTNK 2710, 2709 dhe 2711) janë shumë të rëndësishme për tregun shqiptar në import. Gjithsesi, një analizë e plotë e tregut duhet të përfshijë gjithashtu prodhimin dhe eksportimin e KTNK-ve të tabelës 14, në dhe nga tregu shqiptar. Një bilanc neto i produkteve energjetike më të rëndësishme për tregun shqiptar mund të jetë një bazë e mirë për t'u marrë në konsideratë nga politikëbërësit, kur të propozojnë një amendament për ligjin ekzistues shqiptar për taksat kombëtare. Gjithsesi, në këtë proces, duhen marrë parasysh edhe faktorë të tjerë socialë, ekonomikë dhe politikë.

Përveç kësaj, përfshirja e produkteve të energjisë në ligjin shqiptar, mbështetur në legjislacionin e BE-së, niveli i tyre i mundshëm i taksimit dhe rilogaritja për produktet ekzistuese të energjisë, duhet të bëhen duke marrë në konsideratë:

1. Përvojën e vendeve të rajonit që tashmë e kanë përafruar Direktivën 2003/96/EC;
2. Mundësinë për përjashtim të pjesshëm apo ulje takse për produktet e energjisë të përdorura për qëllime të veçanta, sikurse parashikohet edhe në Direktivë.

Rast studimi 2 - Politikat për pakësimin e karbonit nëpërmjet pylltarisë – nevoja për ndryshime

Hyrje

Ky rast studimi shqyrton mundësitë e zbatimit të skemave për pakësimin e emetimeve të karbonit nga pyjet në Shqipëri, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, kontributin për lehtësimin e ndryshimit të klimës dhe përfitimet politiko-financiare nga përfshirja në iniciativa të BE-së. Rasti i studimit, përbëhet nga tri pjesë kryesore, të cilat parashtrajnë rolin e programeve REDD për menaxhimin e pyjeve, mundësitë dhe përfitimet e mundshme nga marrja pjesë në to, si dhe rekomandime për politikat pyjore në vend, në këtë kuadër.

Sipas SNM (2007), pyjet dhe kullotat mbulojnë rreth 1,5 milion hektarë ose 52% të sipërfaqes totale të Shqipërisë. Edhe pse statistikatat e kohëve të fundit tregojnë se kjo sipërfaqe është relativisht e qëndrueshme, prodhimtaria e saj është zvogëluar si pasojë e prerjeve mbi mundësinë e shfrytëzimit para vitit 1992, si dhe e prerjeve të paligjshme gjatë dy dekadave së fundit. Pyjet konsiderohen një burim i rëndësishëm i ekonomisë kombëtare dhe bazë për industrinë e drurit, industrinë e ndërtimit, prodhimin e energjisë dhe turizmin. Përsa i takon pronësisë së pyjeve, pushteti qendror ka 51% të fondit pyjor, bashkitë dhe komunat 46%, ndërsa ndërmarrjet private 3%.

Sipas të dhënave nga Banka Botërore (World Bank 2010), fondi pyjor në vitin 2010 ka pësuar rënie (76 milion m³, ndërkohë që në vitin 1990 vlerësohej me 81 milion m³). Gjatë periudhës 1991-2013, Shqipëria ka humbur për shkak të prerjeve ilegale, zjarrvënies të qëllimshme dhe mungesës së shërbimeve, më shumë se 74000 hektarë të fondit pyjor, me një mesatare prej 3750 ha/vit. Kjo nënkupton një mesatare shpyllëzimi prej 187.5%. Në DRFK (2009) vlerësohet se zonat e mundshme për pyllëzim janë përafërsisht 90,000 hektarë, ndër të cilat 40,000 hektarë janë toka të braktisura, të mbjella më parë me dru frutorë, ndërsa rreth 50,000 hektarë janë shkurre dhe kullota. Sipas po këtij dokumenti, në Shqipëri, vihet re një potencial i moderuar për implementimin e projekteve për pyllëzim dhe ripyllëzim.

Sipas Ministrisë së Mjedisit, gjatë dy dekadave të fundit janë numëruar rreth 1400 raste zjarresh në vit, të cilët kanë qenë përgjegjës për humbjen e 14500 ha pyje dhe kullota. Ka një raport të padrejtë midis prerjeve ilegale me ato legale, në kurriz të këtyre të fundit, i cili shkon 7 me 1 në vit. Prerjet ilegale dhe zjarrvëniet që ndodhin çdo vit, janë tregues të keqmenaxhimit dhe mungesës së kontrollit qeveritar mbi territorin pyjor në zonat kodrinore dhe malore.

Progres ka pasur në drejtim të privatizimit të fondit pyjor dhe kullësor. Në qershor 2008, qeveria shqiptare zyrtarizoi transferimin e të drejtave të tokës në 345 njësi të qeverisjes vendore. Deri tani, 60 për qind e pyjeve dhe kullotave janë transferuar nga shteti, në pronësi komunale, burime të cilat përdoren thuhet nga një milion njerëz. Transferimi i pronësisë së tokës dhe të drejtave të përdoruesit qeverisjes vendore, sipas PZhBN (2008) ka krijuar nxitje për të menaxhuar dhe mbrojtur burimet natyrore, të cilat kanë çuar në reduktim të erozionit, përmirësim të menaxhimit të ujit, ruajtje të biodiversitetit dhe mbrojtje të pyjeve, dhe kanë kontribuar në sedimentim më të pakët në kanalet ujitëse dhe digat e hidrocentraleve.

Po sipas PZhBN (2008), duke pasur parasysh sipërfaqet e mëdha të tokave të braktisura dhe të gërryera, Shqipëria ka një potencial të madh për sekuestrim të karbonit. Fondi Biocarbon i Bankës Botërore ka arritur një marrëveshje me qeverinë për të blerë reduktimet e emetimeve të siguruara nga këto aktivitete të sekuestrimit të karbonit. Sipas marrëveshjes, vendi do t'ia shesë reduktimin e emetimeve me një vlerë US \$ 11 milion Fondit Biocarbon të Bankës Botërore. Kjo do të tërheqë vëmendjen e investitorëve të tjerë për të ndihmuar Shqipërinë të pyllëzojë tokat e saj të degraduara, ndërsa në të njëjtën kohë do të jetë në gjendje të sekuestrojë karbon, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për komunitetet që janë pjesë e kësaj skeme, si dhe më gjerë.

Programet REDD

Shpyllëzimi konsiderohet si një nga shkaqet kryesore për ngritjen e temperaturës së tokës dhe një ndër faktorët kryesorë, që kontribuojnë në ndryshimin e klimës. Ndërsa ripyllëzimi, ose së paku mbajtja e paprekur e pyjeve, mund të ndihmojë në lehtësimin e ndryshimit të klimës. Në mënyrë që logjika e kundërt të funksionojë, duhen marrë masa të caktuara për të ruajtur të paprekur pyjet.

Plani i veprimit Bali, në Konferencën e Palëve, në seancën e saj të 13^{të} të shteteve, vendosi se një qasje gjithëpërfshirëse për të zbutur ndryshimet klimatike duhet të përfshijë:

"qasjet politike dhe stimujt pozitivë mbi çështjet që lidhen me reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve në vendet në zhvillim, si dhe çështjet e ruajtjes e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe rritjes së rezervave të karbonit pyjor në vendet në zhvillim".

Koncepti i parë i Reduktimit të Emetimeve nga Shpyllëzimi (në anglisht RED) u hodh në Konferencën e 11-të të shteteve, në Montreal (më 2005). RED nënkuptonte reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimi (bruto), ku qenë të përfshira vetëm ndryshimet e llojeve të tokës së mbuluar ‘pyjore’ në ‘jo-pyjore’. REDD nënkupton të njëjtën gjë si më sipër, plus degradimin e pyllit, ose kalimin në dendësi më të ulët të depozitës së karbonit brenda pyllit. Programi REDD mund të merret njëkohësisht si me ndryshimin e klimës e varfërinë rurale, ashtu dhe me ruajtjen e biodiversitetit dhe shërbimeve vitale të ekosistemit. Ndërsa REDD+ do të thotë të njëjtën gjë si më sipër, ku “plus” përfshin pyllëzimin, zbutjen e varfërisë, ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e menaxhimit të pyjeve. Kohët e fundit, “+” në REDD+ ka përfshirë edhe aktivitete që lidhen me ruajtjen dhe rritjen e stoqeve të karbonit, si ato që përfshijnë tokat-torfë, pavarësisht statusit të tyre pyjor.

Pra, programi REDD+, shkon përtej shpyllëzimeve dhe degradimit të pyjeve dhe përfshin rolin e ruajtjes, menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe rritjes së rezervave të karbonit pyjor. Ai është një përpjekje për të krijuar një vlerë financiare nga karboni i depozituar në pyje, duke ofruar stimuj për vendet në zhvillim, që të reduktojnë emetimet nga tokat e pyllëzuara dhe të investojnë për zhvillimin e qëndrueshëm në shtigje me karbon të ulët. Me fjalë të thjeshta, nën REDD+, disa vende u paguajnë vendeve të tjera për të reduktuar emetimet e tyre CO₂ nëpërmjet mbajtjes së pyjeve. Është parashikuar se flukset financiare për reduktime të emetimeve të gazeve serrë nga REDD+ mund të arrijnë deri në \$30 miliardë në vit (Schneider 2013). Kjo rrjedhë e konsiderueshme e fondeve mund të shpërblejë një reduktim domethënës të emetimeve të karbonit dhe mundet gjithashtu të mbështesë zhvillime të reja pro qëndrueshmërisë, të ndihmojë biodiversitetin dhe sigurojë shërbime vitale të ekosistemit.

Në Evropën Jug-lindore ka ende rezerva të mëdha pyjore, që mund të përdoren si objekt i projekteve REDD+. Duke ndihmuar zbutjen/përshtatjen ndaj risqeve të ndryshimit të klimës,

këto vende mund të përfitojnë financiarisht, si dhe në aspektin e imazhit të tyre kundrejt bashkësisë ndërkombëtare, duke siguruar në këtë mënyrë kapital financiar dhe politik.

Në Shqipëri, faktorët që ushtrojnë presion mjedisor në pyje janë: 1) prerjet ilegale të drurit, 2) sëmundjet dhe dëmtuesit, 3) struktura pyjore me cilësi të dobët, 4) përdorimi pamjaftueshëm i kapacitetit të tokës pyjore, 5) zbatimi i pamjaftueshëm i masave silvikulturore, 6) degradimi i tokës pyjore për shkak të nxjerrjes së gurëve dhe zhavorrit, dhe 7) zjarret në pyje (shpesh të qëllimshëm ose të shkaktuar nga aktivitete njerëzore dhe praktika bujqësore) (SNM 2007).

REDD+ mund të sigurojë një mjet edhe për të ndaluar këtë dukuri. Duhet thënë, megjithatë, se ka dy pengesa kryesore për zbatimin e programeve REDD+, nga njëra anë legjislacioni, nga ana tjetër, çështjet e pronësisë së tokës pyjore. Problemet më urgjente mjedisore në pyje janë shpyllëzimi dhe degradimi i tokës pyjore, të shkaktuar nga nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit, ndërtimet ilegale, dëmtuesit e sëmundjet, si dhe zjarret pyjore. Prerjet e paligjshme dhe mungesa e një strategjie rinovimi të pyjeve përkeqësojnë erozionin e tokës. Përdorimi i drurit për ngrohje, jo vetëm që vë në rrezik pakësimi burimet pyjore, por gjithashtu ka ndikim të rëndësishëm mjedisor, veçanërisht në cilësinë e ajrit.

Mënyrat e aplikimit të mekanizmave REDD

Një program për reduktimin e karbonit nëpërmjet pylltarisë përmban aktivitete që konsiderohen si të drejta për gjenerimin e reduktimit të emetimeve nën REDD. Këto mund të jenë aktivitete, që synojnë reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimet (RED), reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimet dhe degradimi (REDD), ose reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimet e degradimi dhe rritjen e rezervave të karbonit (REDD+). Këto aktivitete i referohen fluksit të karbonit midis tokës dhe atmosferës: reduktimi i emetimeve nga shpyllëzimet dhe degradimi (REDD) janë dy aktivitete që zvogëlojnë shtimin e karbonit në atmosferë. Rritja e rezervave të karbonit (“+” në REDD+) i referohet sekuestrimit ose largimit të karbonit nga atmosfera. Fushëveprimi i REDD+ në kuptimin e tij më të gjerë, megjithatë, përfshin edhe ruajtjen e karbonit (Schneider 2013). Stoqet janë të dallueshme nga emetimet, në faktin se ata nuk nënkuptojnë një ndryshim në përqendrimin e gazeve serrë në atmosferë dhe nuk njihen për këtë arsye si një aktivitet për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Zgjedhja e fushëveprimit ka ndikim mbi shkallën, koston relative dhe potencialin zbutës të një mekanizmi REDD. Ai gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në besueshmërinë e një marrëveshjeje politike dhe aftësinë e vendeve në zhvillim për të matur, raportuar dhe verifikuar mundësitë e konsideruara brenda fushëveprimit të një propozimi. Përveç kësaj, cilat vende mund të përfitojnë nga REDD, ndikohet edhe nga fushëveprimi që është rënë dakord.

Një mekanizëm REDD duhet të specifikojë se si është duke u matur reduktimi i emetimeve. Nivelet e referencës përfaqësojnë një skenar analize tregu, kundrejt të cilit reduktimet e shkarkimeve të ardhshme mund të maten dhe potencialisht të shpërblehen. Ata janë përdorur për të përcaktuar shtesën e një veprimtarie të caktuar, ose me fjalë të tjera, sa reduktime të emetimeve kanë ndodhur për shkak të zbatimit të një mekanizmi REDD, kundrejt faktit se si do të kishte ndodhur përndryshe. Ka dy lloje bazë të niveleve të referencës: historike dhe të projektuar. Nivelet e referencës historike përdorin normat e kaluara të shpyllëzimit si një alternativë për sjelljen në të ardhmen. Si shembull, nëse një vend shpyllëzoi 1 milion ha pyje që përmbajnë 1GtCO₂ çdo vit, midis viteve 1990 dhe 2005, atëherë baza e saj historike do të jetë 1GtCO₂ në vit (Schneider 2013).

Mënyra e dytë për të krijuar nivelet e referencës është që të përdoret një bazë e projektuar. Bazat e projektuara synojnë të parashikojnë se si normat e shpyllëzimit mund të ndryshojnë në të ardhmen dhe mund të përdorin një llojshmëri të metodave. Modelet ekonometrike mund të përdoren për të analizuar forcat themelore social-ekonomike apo strukturore që nxisin shpyllëzimin Schneider (2013).

Nivelet e referencave që përdorin një bazë të projektuar mund të krijojnë kritere që janë ose më të larta ose më të ulëta se nivelet historike, në varësi të qasjes dhe supozimeve që janë marrë për model. Është e vështirë, megjithatë, që lejitimet e emetimeve totale nën një model të projektuar të barazojnë emetimet aktuale globale nga shpyllëzimet (dhe degradimi). Niveli i ruajtjes së supozimeve brenda modeleve do të jetë një faktor kyç në përcaktimin e faktit se sa reduktimet e emetimeve do të gjenerohen nga nivelet e referencës të projektuara apo historike të rregulluara.

Shpërndarja e stimujve financiare

Fushështirja dhe niveli i referencës përcaktojnë se sa reduktime të emetimeve do të gjenerohen. E një rëndësie të barabartë është mënyra se si përfitimet në formën e stimujve

financiarë do të shpërndahen ose ndahen në vendet me pyje ekzistuese, që nuk mund të përfitojnë drejtpërsëdrejti nga një qasje e bazuar tek emetimet e REDD. Shumica e propozimeve mbështesin stimujt ose kompensimin direkt, në përputhje me vetë veprimet e një pale. Propozime të tjera sugjerojnë se përfitimet duhet t'u shkojnë palëve të ndryshme nga ato që gjenerojnë reduktime emetimesh nëpërmjet një mekanizmi shpërndarës. Zgjedhja se si shpërndahen përfitimet, ka potencialin për të ndikuar në masë të madhe në aftësinë e vendeve për të marrë pjesë në një mekanizëm REDD. Për t'iu adresuar shqetësimeve për barazi që dalin nga rrethanat e ndryshme kombëtare (zakonisht zhvillimore), disa propozime sugjerojnë që një shpërndarje mund t'i aplikohet bazës historike, për të lejuar të përfitojnë nga REDD emetuesit historikisht të ulët, të cilët mund të shpyllëzojnë më shumë në të ardhmen (Schneider 2013). Ky mekanizëm është diskutuar në modulin e nivelit të referencës.

Objektivi i mekanizmit të shpërndarjes është të shpërblejë vendet me mbulesë pyjore të lartë dhe norma të ulëta të shpyllëzimit (HFLD) për pyjet e tyre ekzistues ose stoqet e karbonit, duke shmangur rrjedhjet ndërkombëtare. Argumenti është që nëse vendet HFLD nuk shpërblehen për të mbrojtur rezervat e tyre aktuale, ata mund të kenë një nxitje për të rrëzuar pyjet e tyre për sipërmarrje më fitimprurëse. Shpërblimi sipas reduktimit të emetimeve kundrejt një baze globale, ofron stimuj për vendet HFLD, normat e shpyllëzimit të të cilëve janë nën këtë mesatare globale. Për të gjeneruar të ardhura për këto pagesa, vendet me shpyllëzim të lartë do të merrnin më pak nën një mekanizëm të tillë të shpërndarjes, pasi një pjesë e emetimeve të tyre do të llogaritej mbi bazën globale.

Një mënyrë e dytë për të rishpërndarë të hyrat përdor një mekanizëm ruajtës në formën e një tarife apo takse mbi reduktimin e emetimeve. Sipas këtyre mekanizmave, një përqindje e të ardhurave është mbajtur në një fond dhe pastaj u është paguar vendeve REDD në formën e pagesave të aksioneve.

Çelësi për të dyja këto qasje është se të ardhurat e nevojshme për të mbështetur vendet HFLD gjenerohen nga vetë mekanizmi. Disavantazh i mundshëm i këtyre qasjeve është efekti deformues që rishpërndarja mund të ketë në stimujt, për të reduktuar emetimet në vendet me shkallë të lartë të shpyllëzimit.

Një alternativë e mekanizmit të rishpërndarjes është të përdorë një mekanizëm tjetër financiar. Shumë propozime sugjerojnë një “fond stabilizimi”, që do të përdorë financime shtesë për të

adresuar shqetësimet për rrjedhje kapitali dhe pabarazi në vendet HFLD. Të ardhurat për një fond stabilizimi mund të vijnë nëpërmjet një llojshmërie burimesh, duke përfshirë fondet vullnetare apo mekanizmat inovativë financiarë, të tilla si ulja e tatimeve mbi lundrimin apo aviacionin.

Mekanizmat financiarë me bazë tregu

Burimet e financimit të diskutuara këtu i referohen në mënyrë eksplicite të hyrave që do të përdoren për të stimuluar reduktimin e emetimeve nën një mekanizëm REDD. Këto financa mund të grupohen në tre kategori kryesore: treg i drejtpërdrejtë, mekanizma të lidhur me tregun, ose financim vullnetar. Në një mekanizëm karboni me bazë tregu, reduktimet e certifikuar të emetimeve (në anglisht CERs) mund të përdoren nga kompanitë dhe qeveritë kombëtare për të përmbushur objektivat e reduktimit të emetimeve kombëtare në sistemin e tyre *cap-and-trade* (shih “Taksa e karbonit krahasuar me cap-and-trade”, në “Rastin e studimit 1”).

Një variant i një qasjeje me bazë tregu është krijimi i një tregu të dyfishtë, në të cilin kreditet REDD janë të lidhura me, por nuk janë të zëvendësueshme nga CER-et ekzistuese. Një qasje tregu e dyfishtë do të konsiderohej e matur, nëse reduktimet e emetimeve të krijuara nëpërmjet REDD do të ishin shtesë ose në vend të angazhimeve ekzistuese të Shtojcës 1. Në të dyja rastet, megjithatë, reduktimet e emetimeve mund të përdoren për të përmbushur objektivat e pajtueshmërisë. Një qasje e lidhur me tregun mund të gjenerojë financa përmes një llojshmërie mekanizmash. P.sh. një proces ankandi, do të gjeneronte të ardhura përmes ankandit të pagesave të emetimeve. Si në nivele kombëtare, ashtu dhe ndërkombëtare, procesi i ankandit mund të sillte të ardhura në sasi të madhe. Reduktimet e emetimeve përmes të ardhurave të ankandit mundet gjithashtu të përdreshin në drejtim të angazhimeve të Shtojcës 1.

Një fond vullnetar mund të veprojë në nivel kombëtar ose ndërkombëtar. Angazhimi i Ndihmës Zyrtare për Zhvillim (ODA), si në rastin e Norvegjisë me një shumë prej \$2,6 miliard, është një shembull i fondeve vullnetare (UNFCCC Ad-hoc w-g 2009). Në përgjithësi Palët e Shtojcës jo-1 bëjnë thirrje për kontribute të reja dhe shtesë nga vendet e zhvilluara. Por, reduktimet e emetimeve të krijuara nëpërmjet fondeve vullnetare, nuk mund të përdoren për objektiva të pajtueshmërisë.

Secili prej këtyre mekanizmave ka anët e tij të forta dhe të dobëta. Megjithatë, ka një konsensus në rritje, se një kombinim i këtyre mekanizmave financiarë do të ishte i nevojshëm për të përputhur fazat e ndryshme të zhvillimit me nevojat e ndryshme të popujve.

Politika Evropiane e REDD+

Instituti Evropian i Pyjeve (EFI) është një organizatë ndërkombëtare e themeluar nga vendet evropiane. Deri në pranverën e vitit 2013, Konventën për EFI-n e kishin ratifikuar 25 shtete evropiane, duke u bërë vende anëtare të Institutit⁷³. Në fund të vitit 2010, me financim nga Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare të tij, EFI themeloi Shërbimin REDD të BE-së, i cili financohet nga Komisioni Evropian, Franca, Irlanda, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar. Ai është një nga iniciativat e BE-së që merret me shkaqet themelore të shpyllëzimeve dhe degradimit të pyjeve dhe nxit menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në vendet në zhvillim. Objektivat e tij janë: të mbështesë vendet në zhvillim në përgatitjet e tyre për të zbatuar REDD+, të ndihmojë vendet në zhvillim të përmbushin objektivat e tyre për ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për REDD+, të informojë politikëbërjen e Komisionit Evropian dhe Shteteve Anëtare të BE-së për mbështetjen e REDD+ në vendet në zhvillim.

Shërbimi REDD i BE-së ka për qëllim të vendosë dialog afatgjatë me vendet në zhvillim, që marrin pjesë në iniciativat REDD+ dhe të sigurojë asistencë teknike për të mbështetur objektivat e vendeve REDD+. Ai e mbështet asistencën teknike në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional, monitorimin transparent, raportimin dhe proceset verifikuese. Shërbimi REDD i BE-së ofron analiza politike për të informuar vendimmarrjen dhe mbështet Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare të BE-së të formulojnë politikat dhe veprimet e tyre REDD+ (*Ibid.*).

Gjithashtu, BE-ja ka politika për të trajtuar përgjegjësinë e vet si konsumator ndaj prerjeve të paligjshme në vendet e treta dhe është e angazhuar të zhvillojë iniciativa specifike për të trajtuar ndikimin e konsumit dhe modeleve të prodhimit në BE-së në këtë drejtim. Plani i Veprimit të BE-së mbi zbatimin e ligjit të pyjeve, qeverisjen dhe tregtinë (Forest Law Enforcement Government and Trade - FLEGT), Marrëveshjet Vullnetare të Partneritetit me partnerët e tregtisë së lëndës drusore dhe Rregullorja Drusore e BE-së, sigurojnë një numër

masash për parandalimin e prodhimeve të paligjshme drusore, që hyjnë tregun e BE-së, për të përmirësuar furnizimin e ligjshëm të lëndës drusore dhe për të nxitur kërkesat e ligjshme për dru dhe produkte druri. BE-ja është e mendimit se zhvillimi i politikave për të kontrolluar kërkesat e përgjithshme për produkte, që mund të çojnë në shpyllëzim dhe degradim, duhet të shihen si një komponent integral dhe kyç i përpjekjeve ndërkombëtare për të reduktuar shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve⁷⁴.

Në një material të përgatitur nga Irlanda (në cilësinë e mbajtjes së Presidencës së radhës) dhe Komisionit Evropian, në emër të BE-së dhe vendeve të saj anëtare, dorëzuar në maj 2013, BE-ja shpreh qëllimin për të kontribuar në kompletimin e shpejtë dhe të suksesshëm të programeve ambicioze të punës REDD+ në agjendën e KKKBNK, për vitin 2013. BE-ja mbështet mendimin se në mënyrë që REDD+ të jetë një alternativë e besueshme për zbutjen, reduktimi i pritshëm i emetimeve falë tij duhet të ndjekë një trajektore të ngadalësuar dhe të përmbysur të emetimeve globale pyjore të gazeve serrë para vitit 2030⁷⁵.

Rekomandime jepen në materialin e cituar për qeveritë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe komunitetin e donatorëve, të cilët duhet të inkurajohen të sjellin së bashku konsiderata zbutjeje dhe adaptimi, në kontekstin e zhvillimit të strategjive kombëtare apo planeve të veprimit të REDD+, së bashku me konsiderata të tjera përkatëse të zhvillimit të qëndrueshëm, të tilla si sfidat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, zbutja e varfërisë, integriteti dhe qëndrueshmëria e mjedisit, lufta kundër shkretëtirëzimit dhe degradimit të tokës, ruajtja e biodiversitetit, si dhe reduktimi i rrezikut të fatkeqësive⁷⁶.

Lidhur me financimin, BE-ja mbështet mendimin se qeveritë e vendeve REDD+ mund të përmirësojnë mobilizimin e fondeve, duke integruar kombinimin e qasjeve të ndryshme dhe inovative financiare, duke përfshirë krijimin e fondeve kombëtare pyjore, portfolet

⁷³ Faqja zyrtare e European Forest Institute (EFI) marrë më 16 shtator 2013 në http://www.efi.int/portal/about_efi/

⁷⁴ Submission by Ireland and the European Commission on behalf of the European Union and its Member States,

Dublin, 27 May 2013, marrë më 16 shtator 2013, në

http://unfccc.int/files/cooperation_support/financial_mechanism/fast_start_finance/application/pdf/ie-05-29_-_fsf_report.pdf

⁷⁵ *Ibid.*

⁷⁶ *Ibid.*

kombëtare të investimit dhe/ ose zhvillimin e strategjive kombëtare për financimin e pyjeve, apo strategji ekuivalente, si dhe identifikimin e mundësive për financim në nivel kombëtar.

Zbatimi i REDD+

Shkaqet e shpyllëzimit e degradimit të pyjeve veprojnë në nivele të ndryshme: lokale, kombëtare dhe tregjet globale. Shkalla e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve vendas për shkak të kërkesës, mund të ndikohet kryesisht nga rrethanat kombëtare, duke përfshirë zbatimin e pamjaftueshëm të ligjit dhe kapacitetet institucionale (veçanërisht sa i përket qeverisjes dhe kohëzgjatjes së saj). Në këtë drejtim, shkaqet e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve duhet së pari të identifikohen dhe prioritarizohen në nivel kombëtar, në një mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse. Në të njëjtën kohë, duhet të identifikohen dhe trajtohen mënyrat për të reduktuar presionin mbi pyjet në vendet konsumatore.

Një mekanizëm global si REDD+, nga njëra anë duket si një version i zgjeruar i Mekanizmit për Zhvillim të Pastër, bazuar në tregtimin e karbonit përmes programeve kombëtare të vendeve në zhvillim dhe kërkesës për kredite karboni nga vendet e zhvilluara. Nga ana tjetër, REDD+ shërben mekanizëm për zbutjen dhe përshtatjen për vendet në zhvillim, që mundëson një transformim shumë më të gjerë drejt një 'ekonomie të gjelbër', bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës, duke ofruar një gamë mallrash dhe shërbimesh (Schneider 2013).

Vendet në zhvillim, në mënyrë që të marrin pjesë në një mekanizëm të tillë, nevojitet të zhvillojnë strategji kombëtare REDD+ për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike. Kjo fazë quhet 'faza përgatitore' dhe përfshin analizimin e faktorëve, përmirësimin e kornizës ligjore dhe ndërtimin e kapaciteteve për monitorimin e raportimin e përfitimeve të karbonit dhe jo të karbonit (*Ibid.*).

Shumica e vendeve në zhvillim të angazhuara në REDD+ po ndërmarrin aktivitete të fazës përgatitore. Disa vende në zhvillim po ndërmarrin gjithashtu masa stimuluese të bazuara në rezultate, që kontribuojnë në zbatimin e strategjisë kombëtare REDD+. Si Banka Botërore, ashtu dhe OKB kanë nisur iniciativa për të përgatitur vendet në zhvillim të marrin pjesë në mekanizma REDD+ nën KKKBNK, të cilat nuk janë miratuar ende.

Vendosja e një kuadri ligjor dhe institucional REDD+ siguron strukturën e duhur për bashkërendimin dhe zbatimin e aktiviteteve REDD+. Një strategji kombëtare REDD+ identifikon faktorët e shpyllëzimit dhe strategjinë për t'iu përgjigjur atyre, prioritarizon nevojat, kërkesat dhe përgjegjësitë për të arritur objektivat kombëtarë REDD+. Strategjia duhet t'u drejtohet faktorëve përtej sektorit pyjor dhe të bëjë thirrje për konsultime kombëtare, për të siguruar mbështetje të mjaftueshme për zbatimin e strategjisë. Pa mbështetjen e gjerë të aktorëve, strategji të tilla nuk pritet të japin rezultatet e dëshiruara.

Planet për të zhvilluar një sistem efektiv monitorimi, raportimi dhe verifikimi, që ofron informacion të besueshëm mbi zonat e shpyllëzuara dhe të degraduara, nivelet e tyre të karbonit, si dhe përfitimet e lidhura (jo të karbonit), të tilla si biodiversiteti, janë të nevojshme për një të mekanizëm REDD+ të bazuar në rezultatet.

Së fundi, sikurse është rënë dakord në negociatat e vazhdueshme të KKKBNK, çdo mekanizëm REDD+ duhet të zvogëlojë ose të ndalë kthimin e pyjeve natyrore në plantacione, të reduktojë humbjen e biodiversitetit, të respektojë të drejtat e njerëzve vendas, të krijojë struktura transparente dhe efektive të qeverisjes pyjore dhe të mundësojë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të palëve të interesuara. Këto aspekte janë të njohura si 'mbrojtëset e REDD+' dhe synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë së tij dhe reduktimin e rreziqeve ligjore, financiare dhe të reputacionit për donatorët, investitorët, institucionet shumëpalëshe, sektorin privat dhe shoqërinë civile. Në përgatitjen e strategjive kombëtare REDD+, vendet në zhvillim janë kërkuar të përshkruajnë se si ata kanë për qëllim të zbatojnë dhe monitorojnë masat mbrojtëse që përfshijnë në strategjitë e tyre.

Programi REDD+ për Shqipërinë

Për t'u bërë pjesë e një programi REDD+ nën KKKBNK është e nevojshme përzgjedhja e atyre pjesëve të pyjeve kombëtare, që janë të përshtatshme për një program REDD dhe specifikimi i llojit të pyllit, dendësisë së tij dhe aftësive për ruajtjen e karbonit. Pasi këto kushte të jenë plotësuar, Shqipëria mundet më tej të punojë në fushën e programit të saj. Idealisht, vendi duhet të kombinojë mbajtjen e statusit pyjor, me pyllëzimin e zonave të gjelbra të degraduara dhe menaxhimin e projekteve ekzistuese të klasifikimit. Kjo mund të

arrihet duke vënë parqet kombëtare nën programin REDD+ dhe duke kombinuar menaxhimin e pyjeve me detyrat e pyllëzimit.

Hapi i ardhshëm është përfshirja e popullatës lokale, pra specifikimi se si qytetarët lokalë mund të përfitojnë nga programi REDD, nëse të ardhurat REDD+ do të përcaktoheshin dhe realizoheshin në nivel-komune (zonë kadastrale) ose të paktën në nivel fshati. Sa i takon financimit, një mekanizëm me bazë tregu do të përshtatej më mirë, sidomos për shkak të afërisë së Shqipërisë me BE-në. Bashkimi Evropian ka objektiva specifike për emetimet e CO₂ dhe ofron mundësinë e kompensimit të disa prej emetimeve të saj me certifikata, në kuptimin e mekanizmit të zhvillimit të pastër, MZHP (shih “Protokolli i Kiotos”).

Në mënyrë që të ruajë pozicionin e saj ndërkombëtar në kuadër të qeverisjes klimatike globale, BE-së i duhet të vendosë oferta gjithnjë e më të larta mbi emetimet e CO₂, pavarësisht se praktikisht nuk ndodh gjithnjë kështu (madje çmimet e karbonit kanë rënë në 2012 dhe 2013-ën). Ndërsa vendos objektiva të lartë, Bashkimi Evropian do të ketë nevojë për më shumë projekte nën MZHP, që në të njëjtën kohë përmbushin kriteret e cilësisë të BE-së. Këto projekte financohen nga vendet ose kompanitë e BE-së me qëllim nxjerrjen e certifikatave për pakësimin e CO₂. Për këtë arsye, vendet apo kompanitë e BE-së do të jenë të gatshme të financojnë programet REDD+ në Shqipëri, me kusht që të ketë përmirësim në mbajtjen dhe menaxhimin e pyjeve, duke reduktuar kështu emetimet e CO₂. Nëse këto projekte planifikohen me kujdes në nivel lokal dhe të hyrat nga këto projekte mbahen në atë nivel, popullsia vetë do të ketë interes të zbatojë kushtet e programeve, që garantojnë suksesin e REDD+ në vend.

Sa për veprimet e ardhshme që mund të ndërmerren, një qasje tri hapëshe mund të ishte e suksesshme. Së pari, Shqipëria mund të japë një pasqyrë mbi pyjet e saj, mirëmbajtjen e tyre, planet e pyllëzimit, si dhe potencialet e saj (duke përfshirë menaxhimin). Së dyti, por paralelisht me të parin, Shqipëria duhet të ndjekë në mënyrë aktive interesin e BE-së në zbatimin ose të paktën financimin e programeve REDD+ në vend. Së treti, dhe përsëri paralelisht, Shqipëria duhet të fitojë ca shikueshmëri në bisedimet ndërkombëtare të klimës (nën KKKBNK).

Tani, mbështetur në dokumentet strategjike shqiptarë, le të shohim cilët janë objektivat politikë për pyjet.

Sipas SKZHI, mbrojtja e pyjeve përfshin: nxitjen e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave drejt konservimit natyror, mirëmbajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimit të ekoturizmit, rehabilitimin e pyjeve të degraduara, vazhdimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave tek njësitë e qeverisjes vendore, marrjen e masave për prerjet e paligjshme. Ndërsa mbrojtja e tokave përfshin ndër të tjera rritjen e nivelit të mbulimit me pyje në zonat e prekura, ndalimin e të gjitha nxjerrjeve të palicencuara të zhavorrit të lumenjve dhe vendosjen e kufizimeve të rrepta mbi gërmimet e licencuara.

Në SNM (2007), menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm e shumëfunksional i burimeve pyjore dhe kullimore konsiderohet një domosdoshmëri, sepse pyjet dhe kullotat përbëjnë një trashëgimi me vlera për Shqipërinë. Aty theksohet se kjo trashëgimi duhet të mbrohet dhe të qeveriset në mënyrë të tillë, që të mundësojë një zhvillim më të madh ekonomik në të ardhmen, pa prishur ekuilibrat biologjike natyrore dhe duke kontribuar në uljen e nivelit të varfërisë.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore, ndarja e drejtë e përfitimeve dhe dobive, që vijnë nga mbrojtja dhe përdorimi i tyre dhe rimëkëmbja e integritetit ekologjik të pyjeve e kullotave në vend, synohen të realizohen nëpërmjet zbrërimit të disa objektivave si më poshtë (*Ibid.*):

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i vazhdueshëm i pyjeve nëpërmjet pakësimit dhe ndërprerjes së prerjeve ilegale, rehabilitimit të ekosistemeve pyjore të dëmtuara, ripyllëzimit të sipërfaqeve të pa ripërtërira dhe pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura
- Organizimi i një kadastre pyjore moderne, si bazë për ruajtjen e tërësisë së fondit pyjor, e cila të dokumentojë pasurinë pyjore si sipërfaqe, vëllim, vlerë dhe pronësi
- Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve pyjore dhe kullimore nëpërmjet promovimit të funksioneve sociale e mbrojtëse dhe potencialit prodhues për prodhimet jo drusore

- Inkurajimi i aktiviteteve private nëpërmjet nxitjes së krijimit të njësive prodhuese në pyje, duke i dhënë në përdorim afatgjatë toka për aktivitet silvopastoral, si dhe toka të varfëruara e të eroduara për qëllime pyllëzimi
- Përmirësimi i kuadrit ligjor, në funksion të përfshirjes aktive në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave të përdoruesve vendorë dhe vazhdimi i transferimit të së drejtës së përdorimit/pronësisë të pyjeve dhe kullotave tek pushteti vendor, dhe
- Vazhdimi i reformës institucionale me qëllim krijimin e strukturave sa më efektive në qendër dhe në bazë, ndarja e funksioneve kontrolluese nga ato menaxhuese në pyje e kullota, rritja e efektivitetit të policisë së shërbimit pyjor, përsosja e strukturës së administratës pyjore.

Në maj të 2008, nën autoritetin e PNUD-it u përgatit një projekt për ngritjen e kapaciteteve për përfitim të financimeve të karbonit në Shqipëri (DRFK 2009). Qëllimi i këtij projekti ishte përgatitja e një studimi paraprak për sektorin e pyjeve në Shqipëri me qëllim rritjen e mundësive për të marrë pjesë në MZhP. Ky projekt konsideroi gjithashtu edhe mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të REDD+ në skemat e kuotave dhe në mekanizmat e tjerë të KKKBNK-së. Ai bëri një vlerësim të stokut të karbonit në biomasën në Shqipëri, që u vlerësua të jetë rreth 28 milion ton karbon dhe të përthithjes së përgjithshme neto në biomasë që vlerësohet të jetë 600 mijë ton C/në vit. Disa nga këto zona biomasore u konsideruan të kualifikueshme për aktivitetet e REDD+ dhe përfshirja e tyre varet nga mënyra se si përcaktohen këto aktivitete në kontekstin e KKKBNK-së. Kjo ndodh nëse në këtë zonë, menaxhimi i përmirësuar pyjor përfshihet si një mekanizëm që nxjerr kredi.

Si në shumë vende të tjera të Shtojcës Jo-1, shpresa është se në Shqipëri, aktivitetet e projektit MZhP mund të kontribuojnë në një mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në rastin e Shqipërisë, metoda e propozuar e vlerësimit të nivelit të këtij zhvillimi përdor një sistem pikësimi me pesha të caktuara për kriteret, sipas kontributit të tyre të supozuar të zhvillimit të qëndrueshëm (DRFK 2009). Kriteret dhe nënkriteret e përzgjedhura janë:

- Kriteret mjedisore
 - Kontributi në zbutjen e ndryshimeve klimatike

- Përfitime të tjera mjedisore p.sh. përmirësimi i cilësisë së ajrit, ujit, dhe tokës, mbrojtja e biodiversitetit, menaxhimi i pyjeve, etj
- Mënyra e shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe ruajtja e resurseve lokale
- Kriteret ekonomike
 - Kthimet financiare entitetit të projektit(eve)
 - Transferimi i teknologjisë së re, duke përfshirë teknologjinë e rinovueshme
 - Tërheqja e investimeve të huaja
- Kriteret shoqërore
 - Zbutja e varfërisë
 - Zhvillimi i kapaciteteve për aktorët e përfshirë
 - Pajtueshmëria me procedurën e përcaktuar për konsultim publik
 - Gjenerimi i punësimit
- Kriteret e politikës kombëtare
 - Kontributi ndaj pajtueshmërisë me politikat qeveritare dhe prioritetet në nivelet kombëtare / rajonale / sektoriale

Dy nga kriteret e mësipërme janë kritere përjashtuese, që do të thotë se një përgjigje negative në ndonjërin prej tyre, e përjashton projektin nga vlerësimi i mëtejshëm. Ata janë: kontributi për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe kontributi ndaj pajtueshmërisë me politikat qeveritare.

Këto potenciale mund të vihen më mirë në praktikë nëse pengesat që ndikojnë në investimet në sektorin e pyjeve trajtohen siç duhet. Një nga pengesat kryesore në sektorin e pyjeve në Shqipëri është konsideruar mungesa e ekspertizës dhe financimit nga komunat ose bashkitë, të cilat janë subjektet që kanë kompetencat kryesore mbi sektorin e pyjeve.

Masat që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e klimës në sektorin pyjor

1. Përmirësimi i kuadrit institucional dhe politikave pyjore

Realizimi i objektivit për përmirësimin e kuadrit institucional dhe të politikave pyjore mund të përfshijë veprimtaritë që vijojnë:

1.1 Përgatitja e një strategjie për mbrojtjen e klimës në sektorin pyjor

Kjo strategji duhet të përbëhet nga aktivitetet lehtësuese dhe kontributi përkatës hipotetik për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, lidhur me potencialin e tyre bio-fizik e teknik për sektorin e pyjeve, deri në vitin 2020. Aktivitetet lehtësuese që parashikohen më kost-efektive mund të planifikohen të zbatohen më parë.

Një strategji e mbrojtjes së klimës në sektorin pyjor duhet të ndërtohet mbi elementët e mëposhtëm:

- Identifikimi i portofolit të aktiviteteve lehtësuese dhe potencialit zbutës bio-fizik e teknik, të cilat plotësohen nga masat mbështetëse
- Përdorimi i një objekti të politikës kombëtare për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe përcaktimi i kontributit që mund të japë sektori pyjor
- Vendimi i informuar mbi faktin se si duhet të prioritarizohen aktivitetet zbutëse në sektorin pyjor, duke përfshirë shtigjet që do të ndiqen (plus një vlerësim kost-efektiviteti)
- Vlerësimi i kontributit të aktiviteteve lehtësuese dhe prioritetëve gjatë një horizonti kohor të paracaktuar

Kohëzgjatja e strategjisë së mbrojtjes së klimës duhet të jenë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sektorit pyjor dhe afatin e objektivave të reduktimit të emimit të gazeve serrë, vendosur në bazë të marrëveshjeve politike.

Mbështetur në strategjinë e klimës në sektorin pyjor, duhet të fuqizohet zhvillimi i mëtejshëm i politikave të qëndrueshmërisë klimatike, në përputhje me objektivat e reduktimit të emetimeve të gazeve serrë dhe arritjen e standardeve të cilësisë së BE-së kundrejt kompromiseve të arritura në Protokollin e Kiotos. Gjithashtu duhet të sigurohet trajtimi i integruar i ndryshimit të klimës në plane, programe dhe politika të planifikimit, ekzekutimit dhe monitorimit në nivele të ndryshme (në nivel vendor, rajonal dhe qendror), si dhe të zhvillohen strategji të ndryshme sektoriale kundër ndryshimeve klimatike, duke përfshirë masat zbutëse, kërkimin dhe trajnimin.

Për sa më lart, mund të shërbente krijimi i një Komiteti Ndërinstitucional Teknik për ndryshimin e klimës në sektorin e pyjeve, i cili do të përfshinte anëtarë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, nga ministrinë e tjera të lidhura me çështjen e ndryshimeve klimatike, si

dhe përfaqësues të qeverisjes vendore. Ky Komitet do të sigurojë koordinimin e veprimtarisë së administratave të ndryshme, në aspektin e politikave të ndryshmeve klimatike. Ai mund të ishte përgjegjës për:

- Zhvillimin e politikave dhe instrumenteve ligjore për kryerjen e aktiviteteve të lidhura me ndryshimet klimatike
- Sigurimin e natyrës zyrtare dhe dukshmërisë së Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike për sektorin e pylltarisë në vend
- Caktimin e anëtarëve brenda administratave të ndryshme të përfshira në monitorimin e zbatimit të ligjit dhe procedurave teknike në drejtim të ndryshimit të klimës
- Përpunimin e një manuali organizativ me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të secilit prej anëtarëve
- Forcimin dhe shtimin e aktiviteteve pyjore zbutëse ndaj ndryshimit të klimës brenda programeve dhe planeve që lidhen me tokën, energjinë, bujqësinë dhe turizmin
- Krijimin e një sistemi monitorimi cilësor dhe sasior për matjen e progresit dhe shkallës së realizimit të masave të miratuara
- Krijimin e një rrjeti konsulence të përhershme, duke përfshirë përfaqësues nga shoqëria civile (OJQ-të, pronarët e pyjeve private, etj) dhe nga shoqatat profesionale të pylltarisë

Progresi i aktiviteteve të ndryshme të përmendura më lart duhet të monitorohet, në mënyrë që të vlerësohet suksesi dhe përshtatshmëria e masave dhe të bëhen ndryshime aty ku duhet. Për këtë, duhet të mbikëqyren aspektet e mëposhtme:

- Manualët që përshkruajnë procedurat ndër-institucionale dhe të brendshme
- Objektivat e reduktimit të emetimeve në bazë vjetore
- Monitorimi, raportimi dhe verifikimi i sistemit dhe procedurave të krijuara për shkëmbimin e informacionit, rolet dhe përgjegjësitë brenda organeve të ndryshme.
- Rrjetet e identifikuara dhe përdorura për bashkëpunim

1.2 Pjesëmarrja e Shqipërisë në tregjet e karbonit

Sa i takon synimit të Shqipërisë për pjesëmarrjen në tregjet e karbonit, ajo duhet të jetë e dukshme dhe konkurruese dhe duhet të mbështetet në cilësinë e projekteve e seriozitetin e operatorëve të saj. Për të kapërcyer pengesat kryesore për përfshirjen e Shqipërisë në këto

tregje, kërkohet aftësi parashikuese dhe efikasitet lidhur me ndërtimin e aleancave, arritjen e marrëveshjeve dhe mobilizimin e burimeve financiare për zbatimin e financimit të karbonit. Në një fazë të dytë, do të nevojitet forcim i kapaciteteve teknike të punonjësve të projekteve, ngritje e aftësive të qëndrueshme menaxhuese për financimin e karbonit dhe mbështetje e këtyre aftësive nëpërmjet instrumenteve të informimit publik mbi tregun. Përveç kësaj, përfshirja e përfaqësuesve të tokave pyjore private dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, do të shtonte vlerën e projekteve dhe do të përmirësonte efektivitetin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara në planifikimin dhe zbatimin e politikave publike në kuadër të ndryshimeve klimatike.

Është e rëndësishme që Shqipëria të kërkojë që financimi dhe tregu i karbonit të ketë standarde dhe qëllime të larta dhe këto karakteristika të qëndrueshme (DRFK 2009):

- Të mos dëmtojë angazhimet e tanishme ose të ardhshme për reduktimin ose kufizimin e shkarkimeve në përputhje me instrumentet detyruese ligjore në nivel ndërkombëtar dhe të ofrojë mjete për të kontribuar me efikasitet për stabilizimin e gazeve serrë
- Të kontribuojë me efikasitet në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në rritjen e cilësisë së jetesës në vendin pritës të aktiviteteve, projekteve ose programeve të kuotave
- Të promovojë realisht transferimin dhe përshtatjen e teknologjive të padëmshme për klimën, në mënyrë që këto të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme në vendet pritëse
- Të promovojë barazi shoqërore dhe krahinore, duke ulur mundësinë për marginalizimin e zonave dhe të promovojë pjesëmarrjen efikase të gjithë popullsisë në përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike
- Të mobilizojë burimet financiare në mënyrë efikase, për të arritur zhvillim që pa dëmtuar klimën, të përmirësojë situatën e biznesit dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre menaxhuese në projektet për financimin e karbonit.

2. Intensifikimi i kërkimit dhe trajnimit lidhur me ndryshimet klimatike

Strategjitë e reja, politikat dhe procedurat e menaxhimit të ndryshimeve klimatike duhet të identifikohen, zhvillohen dhe zbatohen bazuar në traditën dhe njohuritë shkencore. Në mënyrë që të plotësohen angazhimet ndërkombëtare të monitorimit dhe raportimit, duhet të forcohen kapacitetet teknike dhe administrative. Së pari, është thelbësore të rritet ndërgjegjësimi mbi çështjet e ndryshimeve klimatike dhe të sigurohet qasje në informacion e palëve të interesuara.


Së dyti, lind nevoja e futjes së lëndëve arsimore dhe trajnuese që mund të përfshijnë zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të trajnimit për ndryshimin e klimës dhe aktivitetet pyjore.

Aktivitete të ndryshme të fokusuara në kërkimin dhe trajnimin për ndryshimin e klimës mund të ndahen në ndërtimin e kapaciteteve, kërkimin dhe arsimin.

2.1 Ndërtimi i kapaciteteve

Njohuri të reja, aftësi dhe ekspertizë janë të nevojshme për të mundësuar një vendimmarrje në kohë dhe të mirinformuar. Palët e interesuara duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të planifikuar, udhëhequr, menaxhuar dhe për të marrë pjesë në aktivitete. Rritja e aftësive dhe e të kuptuarit ndaj çështjes së ndryshimeve klimatike, në nivel individuale dhe organizativ, do të kërkojnë programe të reja për ndërtimin e kapaciteteve.

Figura 15: Aktivitetet e sugjeruara për ndërtimin e kapacitetit



2.2 Aktivitetet kërkimore

Përveç aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve, janë të nevojshme të dhëna dhe informacione të reja për të kryer vlerësime të ndryshimeve klimatike për pyjet dhe përshtatjen e zbutjen e lidhur me to. Aktivitetet e mëposhtme kërkimore rekomandohen të zbatohen për arritjen e qëllimeve ndaj ndryshimeve klimatike në kuadër të strategjisë:

Figura 16: Aktivitetet kërkimore të sugjeruara për mbrojtjen e klimës në sektorin e pyjeve



Le t'i shtjellojmë një nga një aktivitetet e sugjeruara:

Inventarët e gazeve serrë janë mjete kryesor për të përfaqësuar kontributin e secilit vend dhe çdo sektori për ndryshimin e klimës. Ata kontribuojnë gjithashtu për të krijuar, projektuar dhe vlerësuar të gjitha veprimet lehtësuese, programet dhe ligjet që lidhen me ndryshimin e klimës. Informacioni që merret nëpërmjet inventarëve bën të mundur identifikimin dhe përcaktimin e sasisë dhe burimeve kryesore të emetimeve e përthithjes dhe për këtë arsye, monitorimin e tendencave të emetimeve. Inventarët e gazeve serrë në Shqipëri janë ende në një fazë të hershme dhe sektori pyjor nuk është ende i përfshirë në inventarin kombëtar të gazeve serrë. Zhvillimi i një inventari për sektorin pyjor, jo vetëm që do të ndihmonte për të detajuar përmasat e emetimeve, por gjithashtu do të ndihmonte të përcaktohej masa e ndikimit të aktiviteteve zbutëse dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në vendimmarrje.

Skenarët e emetimeve përdoren për të përshkruar emetimet e ardhshme atmosferike të gazeve serrë. Në të njëjtën linjë me kryerjen e një inventarizimi të gazeve serrë, hulumtimi për

zhvillimin e detajuar të skenarëve të ndryshëm do të bëhej bazë reference jo vetëm për krahasimin e aktiviteteve të ndryshme zbutëse e potencialit të reduktimit të emetimeve, por edhe për kostot e përfitimet e tjera të lidhura me aktivitetet e reduktimit të emetimeve.

Në përputhje me zhvillimin e skenarëve të emetimeve, kërkimi duhet të kryhet në aspektin e ndikimeve direkte dhe indirekte të aktiviteteve për pakësimin e emetimeve. Ky kërkim duhet të përfshijë:

- Aspektet politike (p.sh. rregulloret mjedisore për përdorimin e pyjeve)
- Ndikimet sociale (p.sh. ndryshimi i mënyrës tradicionale të shfrytëzimit të pyjeve)
- Kostot ekonomike dhe përfitimet (p.sh. reduktimi i kërkesës për karburant)

Projektet pilot mund të jenë një mbështetje e mirë për vendimmarrjen dhe vlerësimin e aktiviteteve zbutëse. Ata mund të ofrojnë njohuri dhe parashikojnë përgjigje të mundshme në drejtim të:

- Projektimit dhe vlefshmërisë së metodologjive
- Rregullimit të kostove dhe përfitimeve
- Mundësive për të aplikuar aktivitete në rajone të ndryshme të vendit
- Analizës së pranueshmërisë sociale dhe përgjigjeve ekonomike

Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi rajonal do të mbështeste aktivitetet kërkimore të aplikuara në vend dhe bashkimi i studiuesve pyjorë do të sillte shkëmbimin e rezultateve dhe përvojave, si dhe zbatimin e tyre.

3. Financimi

Për të mbështetur pyllin dhe aktivitetet për zbutjen e klimës nevojiten burime financiare shtesë. Për të siguruar pronësinë e projekteve nga Shqipëria, sugjerohet krijimi i një Fondi Kombëtar Klimatik (FKK). dhe Këta lloj fondesh janë fonde të menaxhuara dhe zotëruara kombëtarisht, që ndihmojnë vendet për të mbledhur financa për klimën nga një shumëllojshmëri burimesh.

FKK është një mekanizëm që i mbështet vendet të orientojnë financat në drejtim të programeve dhe projekteve të klimës. Qëllimi kyç i FKK-ve është forcimi i pronësisë kombëtare të financave të klimës, i cili realizohet përmes:

- mbledhjes dhe shpërndarjes së fondeve për aktivitetet e ndryshimeve klimatike
- lehtësimin të përzierjes së burimeve publike, private, dypalëshe dhe shumëpalëshe
- koordinimin në mbarë vendin të aktiviteteve për ndryshimet klimatike

Në këtë mënyrë, Shqipëria do ta drejtojë realisht procesin dhe mund të bëjë përzgjedhje burimesh bazuar në rezultatin që aktivitetet japin në terren.

Burimet e financimit mund të kategorizohen si më poshtë:

3.1 Burimet e brendshme

- Nga buxheti i shtetit: një pjesë e kostos së masave do të duhet të mbulohen nga burimet buxhetore të departamenteve të ndryshme të ministrive dhe subjektet e përfshira.
- Nga sektori privat: sektori që kontribuon më shumë në ndotje mund të kompensojë për emetimet e gazeve serrë duke kontribuar në FKK. Ka shumë arsye pse zbutja me bazë pyllin mund të jetë interesante për sektorin privat. Megjithatë, në mënyrë që të mobilizohet në shkallën e kërkuar ky kapital në sektorin privat, është e rëndësishme që politikëbërësit të ofrojnë rrugët dhe formatet për sektorin privat, për të investuar dhe për t'u angazhuar në mbrojtjen, rehabilitimin dhe krijimin e pyjeve, të rrisin konkurrencën financiare dhe atraktivitetin e investimeve në pyje, me qëllim zbutjen e klimës, si dhe reduktojnë rreziqet eventuale të investimeve.

3.2 Burimet e huaja

Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat Shqipëria mund t'i studiojë si zgjidhje për financimin e aktiviteteve lehtësuese ndaj ndryshimit të klimës në kuadër të sektorit pyjor, të tilla si:

- Bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh me vendet e tjera
- Bashkëpunimi privat
- Fondet ndërkombëtare

Ka mundësi financimi për këto lloj projektsh nëpërmjet disa fondeve dhe programeve të granteve për projekte ekzistuese të sekustrimit të karbonit, si dhe disa fondeve apo OJQ-ve të cilat mbështesin projekte në shkallë të vogël për ruajtjen apo zhvillimin rural. Në varësi të treguesve të projektit, disa mundësi financimi jepen më poshtë:

- Fondi i Biokarbonit i Bankës Botërore (BIOCF)
- GEF - Programi i granteve të vogla: ndryshimet klimatike
- Fondi Gjerman për mbrojtjen e klimës

Burimet e tjera të financimit mund të jenë OJQ-të, fondacionet apo kompanitë, të cilat mund të kontaktohen me një koncept projekti të zhvilluar mirë. Përveç kësaj, aktivitete të tjera ndërkombëtare të bashkëpunimit mund të zhvillohen në Shqipëri jo vetëm për zbatimin e projekteve, por për ngritjen e kapaciteteve, trajnimin, etj.

3.3 Tregjet vullnetare

Shqipëria, si nënshkruese e Protokollit të Kiotos mund të përfshihet në aktivitete të MZhp dhe në skemat EU-ETS ose EU-Interregional. Pra, mundësitë për të në aspektin e tregjeve të karbonit konsistojnë në marrjen pjesë në një nga tregjet e vullnetare.

Analiza FDMK

Bazuar në analizën më lart, përpilojmë një matricë të fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve.

Tabela 17: Matrica FDMK për rastin e studimit 2

	Të dobishëm	Të dëmshëm
Të brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> ○ Aderimi në KKKBNK dhe PK ○ Komunikimet kombëtare ○ Projekti i PNUD për financimin e karbonit ○ Fond pyjor i konsiderueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Mungesa e një strategjie për mbrojtjen e klimës në sektorin pyjor ○ Mungesa e një Fondi Kombëtar Klimatik ○ Pakësimi i fondit pyjor ○ Potencial i moderuar natyror për REDD ○ Kapaciteti i ulët menaxhues për REDD ○ Nevoja për burime financiare
Të jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> ○ Marrja e statusit të vendit kandidat në BE ○ Asistenca e huaj (BE, etj.) ○ Sigurimi i financimit për karbonin nga fonde ndërkombëtare ○ Përfshirja në aktivitete MZhP ○ Përfshirja në skema EU-ETS dhe EU-Interregional 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Zgjatja e procesit të anëtarësimit në BE ○ Kriza ekonomike-financiare në Evropë ○ Kërkesat e cilësisë për projektet MZhP dhe REDD

Nga matrica vihet re se Fuqitë e Kërcënimit nga njëra anë dhe Dobësitë e Mundësitë nga ana tjetër, janë të balancuara, çka mund të interpretohet se ka shpresa për përfshirjen e Shqipërisë në programet për reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimet dhe degradimi dhe ato të financimit të karbonit.

Përfundime

Zbatimi i programeve REDD në Shqipëri është një mundësi shumë e mirë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe lehtësimin e ndryshimit të klimës. Përgatitja e një strategjie për mbrojtjen e klimës në sektorin pyjor dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në tregjet e karbonit janë dy masa pararendëse për zbatimin e programeve REDD. BE-ja në përmbushje të rolit të saj udhëheqës për çështjen e klimës në botë, është e gatshme të financojë programe për pakësimin e CO₂ dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të tilla si REDD dhe MZhP, me kusht që të përmbushin kriteret e saj të cilësisë. Ndaj, zbatimi në Shqipëri i projekteve me standarde të larta për ruajtjen dhe sekuestrimin e karbonit, përveç përfitimeve mjedisore, mund të sjellë të ardhura. Sidoqoftë, për të mundësuar aktivitetet zbutëse për ndryshimin e klimës, nevojitet krijimi i një fondi kombëtar klimatik në vend, i cili mund të shfrytëzojë burime financiare të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë tregjet vullnetare evropiane.

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Ky disertacion përqendrohet në çështjen e ndryshimit të klimës për Shqipërinë, trajtuar në aspektin e angazhimeve ligjore e politike që ky vend po ndërmerr dhe ato që pritet (apo është e udhës të ndërmarrë). Një pikënisje në kërkim është momenti i rëndësishëm politik në të cilin ndodhet Shqipëria (menjëherë pas marrjes së statusit të vendit kandidat të BE-së) dhe kërkesat e larta (si dhe mundësitë) që parashtron ky proces për Shqipërinë, në fushën e klimës dhe disiplinat që lidhen me të.

Kërkimi ka vërtetuar hipotezën se kuadri ligjor, politik e institucional në Shqipëri është i paplotë për t'iu përgjigjur çështjes së ndryshimit të klimës, sfidave që ajo paraqet dhe integritit në BE, se kapacitetet administrative, monitoruese dhe raportuese janë në nivele të ulëta dhe se përfshirja e publikut e ndërgjegjësimi mjedisor nuk arrijnë të kontribuojnë si duhet në vendimmarrjen mjedisore.

Konkluzionet më të rëndësishme, të përgjithshme dhe specifike, nën dritën e vlerës së shtuar të kërkimit, përmbledhen më poshtë.

Duke pasur parasysh *aspektet teorike të kërkimit*, çështja e ndryshimit të klimës ('ndryshimeve klimatike', në disa raste 'ngrohjes globale') është trajtuar në këndvështrimin politik, gjeopolitik, sociologjik dhe mjedisor. Qëllimi ka qenë rikuadratimi i këtij koncepti në kushtet e zhvillimeve më të reja në vend, rajon dhe në botë, për ta sjellë atë në fokus, në të mirë të mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe pozitës politike të Shqipërisë.

Duke kaluar në *aspektet empirike të kërkimit*, bazuar në *planifikimin e kërkimit* dhe në *strategjinë e kërkimit* (shih "Metodologjia") dhe në përmbushje të objektivave të vendosur (shih "Hyrje/ Qëllimi i studimit dhe objektivat") analiza është përqendruar në këto drejtime:

1. Sqarimi i natyrës së ndryshimit të klimës dhe ndikimit të saj në jetën shoqërore, politike, në ekonomi, në çështjet e sigurisë, në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien e tij. Përgjigjja ndaj ndikimeve të ndryshimit të klimës, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal, mundësitë për Shqipërinë në këtë kuadër;

2. Implikimet e ndryshimit të klimës në shoqërinë evropiane, përgjigjja ndaj këtyre ndikimeve. Roli i BE-së në çështjen e ndryshimit të klimës, legjislacioni dhe *acquis communautaire*, kërkesat ndaj vendeve anëtare dhe në proces aderimi, bashkëpunimi për zhvillim;

3. Kuadri ligjor, politik dhe institucional shqiptar lidhur me ndryshimin e klimës. Fushëprerja e arritjeve të legjislacionit dhe politikave të ndryshimit të klimës në Shqipëri me objektivat e integritimit në BE, e cila përfshin disiplina si: mjedisi, energjia, pylltaria, industria, transportit. Po kështu, shqyrtohet niveli i angazhimit politik të Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare për klimën dhe profili i saj ndërkombëtar;

4. Shqyrtimi i mundësive për aplikimin e skemave inovative evropiane me dobi për aksionin kundër ndryshimit të klimës, përfshirja e Shqipërisë në skemat e financimit të karbonit të BE-së, avantazhet nga këto skema dhe kushtet që duhet të plotësohen që kjo të realizohet.

Në tërësi, kërkimi është realizuar duke kryer analizën e përmbajtjes së dokumenteve ligjorë e politikë, nëpërmjet komunikimeve personale dhe duke përdorur analizën FDMK.

Përpara se të kalojmë në detaje për gjetjet kryesore të kësaj teme, le të ndalemi në *vlerën e shtuar të kërkimit*.

1. Bazuar në një analizë të thelluar të legjislacionit mjedisor shqiptar dhe atij kuadër për ndryshimin e klimës, krahasuar me atë të BE-së, vlerësohet gjendja dhe jepen rekomandime për përmirësimin e tij. Kjo analizë bëhet duke shfrytëzuar të dhëna nga burime zyrtare vendase dhe të huaja, me synim rritjen e saktësisë së informacionit që përpunohet;

2. Përdorimi i metodës së trekëndorëzimit dhe të analizimit të fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve në analizimin e kuadrit ligjor, politik dhe institucional të çështjes së ndryshimit të klimës në vend, ka çuar në konkluzione specifike për masa që duhet të ndërmerren për përmirësimin e këtij kuadri në Shqipëri;

3. Vendosja e Shqipërisë në kontekst rajonal, mesdhetar apo të Ballkanit Perëndimor, siguron një këndvështrim të ri gjeopolitik të çështjes së ndryshimit të klimës, duke krijuar premisat për të rekomanduar politika bashkëpunimi rajonal;

4. Përzgjedhja e dy rasteve të studimit, njëra në fushën e përafrimit të legjislacionit dhe tjetra në fushën e politikave që duhen ndërmarrë në një sektor me peshë për ndryshimin e klimës, bëhet me qëllimin për të dhënë një kontribut konkret në dy drejtime gati të pacekura.

Konkluzione të përgjithshme

Shkencëtarët dhe forumet ndërkombëtare (IPCC) kanë arritur në konsensusin se emetimi në atmosferë i gazeve serrë të nxitura nga njeriu, është shkaku kryesor i ngrohjes globale dhe se dioksidi i karbonit është më kryesori i gazeve antropogjenikë. Qysh nga fillimi i Revolucionit Industrial rreth dy shekuj më parë, përqendrimi i gazeve serrë ka ardhur në rritje, duke shkaktuar rritje të temperaturës së sipërfaqes të Tokës, ndryshime në modelet rajonale e sezonale të temperaturave, rënien e reshjeve, si dhe ndryshime në frekuencën e episodeve të motit. Disa ndikime të ndryshimit të klimës, si shkrirja e akujve, rritja e nivelit të detrave dhe rritja e aciditetit të oqeanëve, po shpalosen më gradualisht. Ndikimet e ndryshimit të klimës pritet të shoqërojnë zhvillimet ekonomike, demografike dhe mjedisore, që nga ana e tyre ndikojnë në ndryshimin e klimës, ndaj në shumë raste efektet e ndryshimit të klimës do të jenë të mbivendosur dhe të vështirë për t'u parashikuar.

Për të parandaluar pasojat më të rënda të ndryshimit të klimës, njerëzimi ka nevojë të kufizojë ngrohjen globale me rreth 2°C mbi temperaturën e para-industrializimit. Politikat për të pakësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe lehtësuar pasojat e ngrohjes globale po përqendrohet në disa drejtime, më kryesoret prej të cilave janë: reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, përmirësimi i eficiencës së sektorit të energjisë, përdorimi i biokaburanteve, përmirësimi i praktikave të përdorimit të tokës, mbrojtja e pyjeve dhe ripyllëzimi, zhvillimi i teknologjive që lehtësojnë pasojat e katastrofave të shkaktuara nga klima.

Ndryshimi i klimës pritet të ketë pasoja njerëzore dhe shoqërore të shumta, direkte dhe indirekte, që paraqesin shqetësime dhe risqe në aspektin e sigurisë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ndryshimi i klimës është një ndër rreziqet globale dhe me shkallë të gjerë për shëndetin e njeriut. Sfidat e reja për mirëqenien dhe mbijetesën që po përballon njerëzimi në shekullin e 21^{të}, natyrshëm çojnë në një zhvendosje nga koncepti i njëanshëm i sigurisë kombëtare, tek një qasje bashkëpunuese dhe shumëpalëshe e sigurisë. Madje konceptet e ripercptuara të sigurisë (ku ka ndikuar dhe ndryshimi i klimës), kanë rezultuar tashmë në një agjendë të re më “të butë” të sigurisë globale.

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (KKKBNK, 1994), synoi vendimmarrjen e përbashkët kundër rritjes së temperaturave mesatare globale dhe çdolloj ndikimi negativ të mundshëm të ndryshimit të klimës. Nën KKKBNK, vendet e

industrializuara detyrohen të ndihmojnë vendet në zhvillim, nëpërmjet financimit të strategjive për zbutjen dhe përshtatjen. Përveç OKB-së që është organizata ndërkombëtare kryesore që merret me çështjen e ndryshimit të klimës, ka edhe organizata të tjera të cilat japin kontributin e tyre në këtë fushë, të tilla si: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Banka Botërore, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Global Environmental Facility, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Për të forcuar përgjigjen globale ndaj ndryshimit të klimës, vendet anëtare të KKKBNK, nënshkruan më 1997, Protokollin e Kiotos (PK, 2005), në të cilin aderon edhe Shqipëria. KKKBNK dhe PK janë instrumentet kryesorë ligjorë ndërkombëtarë në fushën e politikave ndaj ndryshimit të klimës dhe ngrohjes globale. PK përcakton objektiva të detyrueshëm juridikisht kundrejt 37 vendeve të industrializuara, me qëllim pakësimin e emetimeve nga ana e tyre të gjashtë gazeve serrë. Ky protokoll ngriti gjithashtu disa mekanizma me bazë tregu, të tilla si Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (MZhP) dhe Zbatimi i Përbashkët, për të lejuar vendet e zhvilluara të përmbushin detyrimet e tyre sipas traktatit, duke investuar në vendet në zhvillim. Ekonomitë e vendeve që bëjnë pjesë në Shtojcën Jo-1 të Protokollit (ku bën pjesë edhe Shqipëria), nuk kanë kufizime në shkarkimin e gazeve serrë. Sidoqoftë, ato nxiten të zhvillojnë projekte për reduktimin e shkarkimeve të këtyre gazeve, duke prodhuar të ashtuquajturat “kredite karboni” ose “kuota karboni”, që më pas mund të shiten tek blerësit që bëjnë pjesë në Shtojcën 1.

Në takimet e fundit të vendeve anëtare në KKKBNK, Shqipëria ka mbështetur qëndrimin e BE-së dhe të komunitetit ndërkombëtar për zbutjen e ndryshimeve klimatike. BE-ja ka një strategji për t’iu përgjigjur ndryshimit të klimës dhe është duke zhvilluar një strategji për t’iu përshtatur ndikimeve të ndryshimeve klimatike, që nuk mund të parandalohen. Ndonëse BE-ja është përgjegjëse për më pak se 12% të emetimit global të gazeve serrë, ajo është zotuar të marrë rol udhëheqës në këtë fushë. Pavarësisht se nuk ka ndonjë legjislacion kuadër në nivel BE-je në fushën e bashkëpunimit për zhvillim ndërkombëtar për çështjen në fjalë, KE-ja dhe Shtetet Anëtare marrin pjesë aktive në këtë bashkëpunim. BE-ja është kontribuuesi më i madh i financimeve për klimën, që ndihmojnë vendet në zhvillim të përshtaten me efektet e ndryshimit të klimës dhe të zhvillohen duke mbajtur emetime të ulëta.

Madje, ndryshimi i klimës nuk trajtohet drejtpërdrejt si çështje as në Traktatin e Themelimit BE-së. Instrumenti më i rëndësishëm i BE-së kundrejt objektivit madhor të Kiotos është

Direktiva 2003/87/EC (EU ETS), e cila propozon një skemë për tregtimin e lejes së emetimeve të gazeve serrë brenda BE-së, me qëllim nxitjen e pakësimit të tyre. Përdorimi i një direktive që nga natyra është ‘ligj i butë’, në vend të një rregulloreje si instrument ligjor në fushën e emetimeve, rrit gradët e lirisë së vendeve anëtare dhe përmbush nevojën e ruajtjes së parimit të subsidiaritetit. Në këtë mënyrë, Vendet Anëtare bëjnë zgjidhjet e tyre në legjislacionin kombëtar, në mënyrë të veçantë për çështjen e ‘lejimeve’ (allowances) për të emetuar sasi të caktuara gazesh serrë (CO₂).

Përveç kuadrit për ndryshimin e klimës, BE-ja ka ngritur edhe instrumente të tjerë çështjesh mjedisore, përmes të cilave realizohet një integrim sektorial i ndryshimit të klimës. Kështu, BE-ja ndjek politikat e saj në disa fusha të rëndësishme për ndryshimin e klimës, të tilla si toka (thatësira, shkretëtirëzimi, degradimi i pyjeve), energjia (burimet e rinovueshme, eficienta e energjisë), transporti (ulja e emetimeve), industria (inovacioni teknologjik, ekonomia me karbon të ulët) dhe siguria globale.

Pellgu i Mesdheut, pritet të jetë një nga “zonat më të nxehta” të ndryshimit të klimës, ndërsa Afrika është kontinenti më i ndikueshëm nga ndryshimi i klimës. Për pasojë, ka shumë të ngjarë që shtetet evropiane të kenë probleme imigrimi që lidhen jo me thatësinë në Evropë, por atë në Afrikë. Ndaj, nga politikat e shkretëtirëzimit që do të zbatohen në jugun e Mesdheut (veriun e Afrikës), do të varet në masë të madhe çështja e sigurisë në Evropë. Implikimet e sigurisë të ndryshimit të klimës që kanë të bëjnë me rajonin Euro-Mesdhetar, po përbëjnë gjithnjë e më shumë një shqetësim për Komisionin Evropian, i cili ka zhvilluar një proces udhërrëfyes të BE-së mbi *ndikimet në siguri* të ndryshimeve klimatike. Problemet mjedisore të Mesdheut trajtohen me prioritet edhe në kuadër të Partneritetit Euro-Mesdhetar, i cili nisi me Procesin e Barcelonës më 1995 dhe sot përmban 28 vende anëtare të BE-së, si dhe 16 vende partnere, ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor gjithashtu po ngrohet, ka më pak reshje dhe është projektuar të vazhdojë këtë tendencë, në proporcion me rritjen e pritshme të temperaturave globale. Ndërkohë që vendet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparim drejt anëtarësimit në BE, stabiliteti i tyre politik është në konsolidim, çka mund të ndikojë në aftësinë e rajonit për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive ndikimit të ndryshimeve klimatike. Kjo aftësi e vendeve të Ballkanit Perëndimor, vetëm ose së bashku, varet nga ndjeshmëria e tyre e përgjithshme.

Sipas një studimi nga UNEP, ndër vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është më e ndjeshmja ndaj ndryshimeve klimatike. Katër vende të Ballkanit Perëndimor kanë përfshirë plane përshtatjeje në komunikimet e tyre kombëtare ndaj KKKBNK-së. Bazuar në komunikimet e saj kombëtare, në afat të shkurtër, Shqipëria synon të përqendrohet në përmirësimin e sistemit të saj të monitorimit dhe të sistemeve paralajmëruese për zonat bregdetare, bujqësinë dhe pylltarinë. Planet më afatgjata parashikojnë ndërtimin e strukturave të mbrojtjes bregdetare dhe zhvillimin e strategjive të menaxhimit të tokës, si nivelimi dhe tarracimi, së bashku me masat për menaxhimin e ujit për bujqësinë.

Gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (përfshijtur Kosovën) janë anëtarë themelues të Qendrës së Menaxhimit të Thatësirës për Evropën Juglindore dhe marrin pjesë në projekte të financuara nga UNDP GEF. Një strategji rajonale për *menaxhimin e burimeve ndërkufitare ujore* në mënyrë bashkëpunuese, mund të ishte një politikë e goditur për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor. Përveç kësaj, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kosova marrin pjesë në *Harqet Dinarike* dhe *Balkans Environment Outlook*, të cilat përbëjnë platforma bashkëpunimi dhe vlerësimi të integruar mjedisor. Konventat Alpine dhe Karpate ofrojnë gjithashtu platforma bashkëpunimi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), mund të jetë në gjendje të ndihmojë në zhvillimin e ndonjë Konvente, e cila mund të sigurojë një platformë për strategjitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike rajonale dhe mund të sillte të gjitha marrëveshjet ekzistuese së bashku, nën një kupolë. Sidoqoftë, çdo skemë e re e projektuar për të koordinuar përshtatjen në Ballkanin Perëndimor do të qe e udhës të merrte në konsideratë tërësinë e organizatave, programeve, iniciativave dhe marrëveshjeve që aktualisht kontribuojnë në projektet dhe strategjitë e adaptimit në rajon.

Çdo vit në vjeshtë, Komisioni Evropian boton një raport vlerësues të progresit në të gjithë fushat (ekonomike, politike, sociale e ligjore) të vendeve të cilat janë në proces të anëtarësimit në BE. Bazuar në raportet e progresit të KE-së për Shqipërinë, gjatë viteve 2009-2013, janë vënë re disa përparime lidhur me ndryshimin e klimës:

1. Është miratuar ligji për vlerësimin strategjik mjedisor, që synon përafrimin me direktivën evropiane përkatëse;
2. Është përgatitur një strategji e re ndërsektoriale e mjedisit për vitet 2013-2017;
3. Janë identifikuar 13 instalime të palëvizshme me qëllim implementimin e ardhshëm të sistemit të tregtisë së emetimeve;
4. Është ratifikuar protokollin mbi përgatitjen, përgjigjen dhe bashkëpunimin për incidentet e ndotjes me substanca të rrezikshme dhe të dëmshme;
5. Qysh nga viti 2012, Shqipëria e ka unifikuar pozicionin e saj me atë të BE-së në kontekstin ndërkombëtar të klimës dhe ka marrë pjesë rregullisht në komponentin e klimës të RENA-s dhe ECRAN-it.

Sidoqoftë, sipas raporteve të progresit të KE-së, ka akte të legjislacionit horizontal, si ligji për lejet mjedisore, që ende nuk është përafruar plotësisht me *acquis-në*, duke pasur kryesisht probleme në procesin e zbatimit. Ka pasur edhe raste të miratimit të akteve juridike që nuk janë në përputhje me *acquis-në* e BE-së, të tilla si: amendimi i ligjit për taksat kombëtare i miratuar në prill 2013, i cili zvogëlon taksat për makinat e përdorura. Në vlerësimin e KE-së, progresi i Shqipërisë në tërësi, lidhur me zhvillimin e politikave të përgjithshme për ndryshimin e klimës vlerësohet si i kufizuar. Ndonëse harmonizimi me *acquis-në* ka përparuar, nevojiten përpjekje të mëtejshme për harmonizimin e tij, si dhe për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit. Disa masa kryesore që duhet të ndërmarrë Shqipëria lidhur me çështjen e ndryshimit të klimës, në formën e angazhimeve lehtësuese në përputhje me ato të BE-së dhe të shteteve të saj anëtare, janë si më poshtë:

1. Të hartohet një strategji kombëtare për ndryshimin e klimës, duke përfshirë masat zbutëse dhe adaptuese;
2. Të inkurajohet pjesëmarrja e publikut në nismat ligjore, si dhe konsultimi me të mbi investimet publike;
3. Të rritet ndërgjegjësimi për çështjen e klimës në të gjithë nivelet, si dhe bashkëpunimi midis gjithë aktorëve të përfshirë;
4. Të zhvillohet një qasje më strategjike për vendin dhe të demonstrohet më shumë vullnet politik për çështjen e ndryshimit të klimës në arenën ndërkombëtare;
5. Të rriten përpjekjet për forcimin e kapaciteteve administrative dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Në Shqipërinë e pas viteve '90, si pasojë e ndërprerjes së prodhimit në shumicën e ndërmarrjeve industriale, u vu re një pakësim i ndotjes industriale. Po kështu, ndryshimet në strukturën e ekonomisë si: privatizimi, rritja e çmimit të energjisë elektrike, drurit, ujit dhe karburanteve, krijuan kushtet për një mbrojtje më të mirë të mjedisit. Nga ana tjetër, vendosja e një sistemi të ri politik në vend, u shoqërua me zbatimin e reformave të ekonomisë së tregtisë së lirë, të cilat sollën shqetësime të reja mjedisore. Braktisja e tokave bujqësore, dëmtimet masive të pyjeve dhe shtimi i transportit rrugor, ndikuan në rritjen e erozionit të tokës dhe nivelit të ndotjes së ajrit. Situata e brishtë politike në vitet e para të tranzicionit, mungesa e një baze të konsoliduar ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe mungesa e zbatimit të ligjit, çuan në shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore dhe dëmtimin e mjedisit urban.

Në vitin 1998, u miratua me referendum Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila përçon një frymë në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike, duke u kushtuar rëndësi të veçantë disa parimeve mjedisore, siç janë e drejta për informim e qytetarëve dhe angazhimi për një mjedis të përshtatshëm për të jetuar, jo vetëm për brezat e sotëm, por edhe ata të ardhshëm, duke mbështetur kështu parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Rrjedhimisht, Kushtetuta e Shqipërisë ka bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm parime të rëndësishme të së drejtës mjedisore ndërkombëtare dhe evropiane. Pas vitit 1998, u hartuan dhe aprovuan një sërë ligjesh mjedisore e aktesh të tjera nënligjore, si dhe u krijuan institucione të reja për mjedisin. Sidoqoftë, edhe hartimi i një kuadri të plotë ligjor, në përputhje me *acquis communautaire*, nuk garanton mbrojtjen e mjedisit, nëse nuk zbatohet rigorozisht. Pavarësisht se i gjithë legjislacioni shqiptar, së bashku me strategjitë e planet e veprimit synojnë ngushtimin e hapësirave për abuzime në fushën e mjedisit, shkalla e zbatimit është shumë e ulët. Këtë e demonstrojnë edhe evidencat statistikore për çështjet penale në fushën e mjedisit. Kjo ndodh për shkak se institucionet nuk janë mjaftueshmërisht të forta për të mbështetur zbatimin e ligjit, si dhe për shkak të një sistemi të dobët gjyqësor.

Aktualisht, në Shqipëri, gjendja e mjedisit vlerësohet nëpërmjet një sistemi monitorimi, që menaxhohet nga disa institucione përgjegjëse për elementë të ndryshëm të mjedisit si ajri, uji, toka dhe treguesit e tyre. Mbi bazën e të dhënave të monitorimit, përpilohet një herë në vit raporti kombëtar i gjendjes së mjedisit, i cili bën në njëfarë mënyre transparencën me publikun për gjendjen e tij. Sidoqoftë, përmirësimi në cilësi dhe sasi i monitorimit të mjedisit mbetet një

objektiv, përmbushja e të cilit është shumë e rëndësishme si për vlerësimin e parametrave mjedisorë nga ana jonë, ashtu dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të BE-së e më gjerë.

Monitorimi periodik i cilësisë së ajrit urban dhe respektimi i normave të shkarkimit në ajër të operatorëve të mëdhenj industrialë, sipas standardeve të përcaktuar në direktivat evropiane, janë objektiva të rëndësishëm për përgjigjen ndaj ndryshimit të klimës. Degët e industrisë që ndikojnë më shumë në ngrohjen globale në Shqipëri janë: prodhimi i kromit, hekurit, çelikut dhe çimentos. Për një pjesë të industrive të mëdha janë marrë disa masa për të kufizuar ndotjen e ajrit, si p.sh. instalimi i filtrave për pluhurin e çimentos. Transporti, i dominuar nga ai rrugor, ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit, kryesisht të zonave urbane dhe është një ndër burimet kryesore të gazeve serrë në vend. Ndonëse shkarkimet e dioksidit të karbonit për banor në Shqipëri janë shumë më të ulëta se në shumicën e vendeve të industrializuara, sasia e këtyre shkarkimeve në raport me PBB është shumë më e lartë sesa në ato vende.

Në rrugën e konsolidimit të profilit të tij ndërkombëtar si shtet demokratik dhe në kuadër të MSA-së me BE-në, Shqipërisë i ka lindur detyrimi i marrjes së përgjegjësive dhe angazhimeve ndërkombëtare edhe për mbrojtjen e mjedisit. Kjo shihet e konkretizuar edhe në proceset e ratifikimit apo aderimit në konventa, traktate, marrëveshje dy apo shumëpalëshe për çështje të ndryshme mjedisore në nivel evropian dhe botëror. Po kështu, kjo shihet edhe në procesin e përafrimit të legjislacionit mjedisor shqiptar me legjislacionin e BE-së dhe *acquis communautaire*.

Dokumenti kryesor politik për realizimin e përputhjes legjislative në vend është Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (2005). Shkalla e përgjithshme e përputhjes së legjislacionit mjedisor vendas me atë të Komunitetit Evropian, vlerësohet deri më sot si e pjesshme, pra duhen kryer një numër i madh ndryshimesh për të arritur përputhjen. Përveç nivelit të pjesshëm të përputhjes, legjislacioni mjedisor shqiptar nuk i mbulon të gjitha fushat e *acquis*, ka një regjim *komande e kontrolli*, që nuk është efikas për të garantuar zbatimin e tij dhe shfaq probleme strukturore, në disa raste duke mos qenë i qartë dhe në shumë raste duke kërkuar të imponojë rregulla që nuk janë të drejta ose realiste. Qeveria shqiptare ka futur tashmë si akt normativ kërkesën që çdo ndryshim në legjislacionin vendas të jetë në përputhje me atë të BE-së. Arritja e përshtatjes së plotë është dhe një ndër objektivat që synohen të arrihen gjatë periudhës 2013-2020.

Marrëveshjet mjedisore shumëpalëshe përbëjnë pjesën më të qenësishme të *acquis communautaire* të BE, ndaj zbatimi i këtyre marrëveshjeve ka rëndësi për vendet e reja anëtare të BE-së dhe përbën një sfidë për vendet që e synojnë këtë anëtarësi. Edhe Shqipëria, në përpjekje për t'u bërë pjesë e familjes evropiane, pritet të bëhet palë dhe ratifikojë një numër të madh marrëveshjesh shumëpalëshe mjedisore globale dhe rajonale. Angazhimi në marrëveshjet shumëpalëshe kërkon ngritjen e strukturave kombëtare të reja dhe forcimin e atyre ekzistuese, për kryerjen e koordinimit të përpjekjeve institucionale për zbatimin e tyre. Në konsiderimin e marrëveshjeve mjedisore shumëpalëshe, prioritet duhet t'u jepet sipas rëndësisë: 1) marrëveshjeve që janë të lidhura me objektivin e integritimit evropian dhe 2) marrëveshjeve që përbëjnë interes për të ashtuquajturat 'zona të nxehta' për ne ose rajonin. Me qëllim që të përmbushë objektivat për aderim e zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore, si dhe për përafrim legjislacioni, përveç angazhimit politik, nevojiten kapacitete teknike e administrative. Përvoja e vendeve të tjera me kushte dhe kapacitete të ngjashme, sugjeron që numri i njerëzve të përfshirë në menaxhimin mjedisor në institucion qendror (Ministrinë e Mjedisit) të shtohet ndjeshëm për pak vjet dhe të rriten kapacitetet e tyre. Një nivel më i lartë i zbatimit të ligjit mjedisor kërkon burime ekstra edhe për AKM, zyrat rajonale dhe Inspektoriatin e Mjedisit.

Programi i qeverisë shqiptare që mbulonte periudhën 2009-2012, e parashtronte si objektivi qendror mbrojtjen dhe rritjen e cilësisë së mjedisit, e cila do të mbështetej në përafrimin gradual të standardeve mjedisore me ato të BE-së dhe përmirësimin e sistemeve monitoruese, inspektuese dhe ndëshkuese. Deri në fund të mandatit (2013), qeveria e Partisë Demokratike parashikonte dyfishim të fondeve publike për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, gjë e cila nuk ndodhi. Dokumentet strategjike parashikonin mbështetje financiare për infrastrukturën e mjedisit – investime që duheshin për arritjen e standardeve mjedisore, të cilat parashikoheshin të mbështeteshin nga një Fond Mjedisor, i cili do të krijohej në pjesën e dytë të mandatit të dytë qeverisës demokrat. Në fakt, ky fond nuk u ngrit, sikurse u parashikua. Viti 2014, e gjeti Shqipërinë me një kuadër ligjor *horizontal* mjedisor të përbërë nga një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore dhe në tërësi të përafuar mirë. Por ka në këtë kuadër ka dhe akte të tjera juridike të fushës që nuk transpozojnë akte komunitare, sikurse ka edhe direktiva evropiane që i takojnë legjislacioni horizontal, për të cilat procesi i përafrimit nuk ka nisur ende. Kështu, nuk është bërë ende progres drejt përshtatjes së Direktivës mbi krimin mjedisor.

Në mënyrë të veçantë, sa i takon *zbatimit* të legjislacionit horizontal, është arritur progres i kufizuar, si p.sh. me Direktivat për vlerësimin strategjik mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut.

Në fushën e *energjisë*, janë vendosur objektiva kombëtarë për kursimin e energjisë dhe shtimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, duke nisur nga viti 2015, të cilat pritet të sjellin një reduktim të konsiderueshëm të gazeve serrë. Punë është bërë edhe për përafrimin e legjislacionit të energjisë me *Acquis Communautaire*, por shkalla e përafrimit është ende e ulët. Edhe *industrinë* minerare, ajo ricikluese dhe e ndërtimit të impianteve industriale u janë nënshtruar iniciativave apo ndryshimeve ligjore, që garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm, mbështetin masat mbrojtëse ndaj mjedisit dhe klimës. Në tërësi ka pasur progres të moderuar në drejtim të përshtatjes së direktivave evropiane të sektorit të industrisë, ndërsa zbatimi i tyre pritet të kryhet duke nisur nga viti 2015.

Përmbledhtasi, ka një sërë pengesash për arritjen e standardeve të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, që lidhen drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian:

- Niveli i shpenzimeve publike për infrastrukturën e mbrojtjes së mjedisit, është shumë i ulët për të arritur standardet evropiane në një të ardhme të parashikueshme;
- Niveli i shpenzimeve publike për të mbështetur elementët operativë të mbrojtjes së mjedisit (komunikimin, zbatimin dhe përforsimin e ligjit) është i pamjaftueshëm;
- Bashkëpunimi ndërinstytucional për çështjet e mjedisit është i dobët dhe shkakton ngërçe e vonesa në arritjen e objektivave;
- Bashkëpunimi midis qeverisjes qendrore dhe vendore, veçanërisht delegimi i kompetencave për menaxhim mjedisor tek kjo e fundit, lë për të dëshiruar;
- Ka mungesë kapacitetesh teknike e administrative dhe programesh specifike për zhvillimin e tyre;
- Shkalla e informimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor të publikut mbetet e ulët;
- Shkalla e përfshirjes së OJQ-ve dhe aktorëve të ndryshëm në vendimmarrjen mjedisore është e papërfillshme.

Për të shmangur disa nga këto pengesa do të ndihmonte adoptimi i lehtësirave fiskale për nxitjen e investimeve mjedisore. Nga pikëpamja e menaxhimit, në kuadër të procesit të

decentralizimit, *delegimi i kompetencave* në nivel rajonal e vendor është një objektiv i rëndësishëm. Për këtë, fillimisht nevojitet të fuqizohen zyrat rajonale të mjedisit. Në këtë mënyrë, ato do të luanin një rol më aktiv në mbrojtjen e burimeve natyrore, shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor, në nivel vendor, aty ku dhe problemet njihen më mirë dhe mund të zgjidhen më lehtë.

Gjithashtu, vendosja e modaliteteve të reja bashkëpunimit, të zyrtarizuara dhe të planifikuara, midis MM dhe ministrive të tjera, për çështjet e mjedisit, është me rëndësi të madhe. Bashkëpunimi ekzistues është kryesisht spontan dhe joformal dhe me pak gjasa për vijimësi, së paku për shkak ndërrimeve të shpeshta në personel. Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe Komisionin e Emergjencave Civile, ka rëndësi të veçantë, pasi lidhet me çështjen e sigurisë mjedisore kombëtare dhe njerëzore.

Pjesëmarrja e Organizatave Joqeveritare (OJQ) është faktor kyç në zhvillimin dhe zbatimin e politikave mjedisore nga ana e institucioneve qeveritare, duke mundësuar transparencën e procedurave dhe sigurimin e konsultimit publik në vendimmarrje. Nëpërmjet OJQ-ve kombëtare apo vendore, mund të përfshihen aktorë të nivelit ku gjenerohet problemi, në mënyrë që të zhvillohet një kuptim më i mirë i efektivitetit të zbatimit të një projekti të caktuar. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, jo vetëm u jep një dimension ‘zotërimi’ projekteve mjedisore, por ndikon dhe në shkallën e vizibilitetit të tyre.

Përshtatja e suksesshme e legjislacionit të BE-së, zbatimi dhe përforcimi i ligjit mjedisor në tërësi, kërkojnë ndërgjegjësim dhe një qasje të përgjithshme ndaj mjedisit, çka mund të bëhet e mundur edhe me përmirësim të komunikimit. Në këtë kuadër, vëmendje duhet t'u jepet masave për ofrimin e informacionit ndaj publikut, për rritjen e ndërgjegjësimin mbi kërkesat ligjore dhe promovimin e sjelljeve miqësore ndaj mjedisit. Masa me kosto relativisht të ulët për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, mund të kenë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në kushtet mjedisore. Sisteme të ndërgjegjësimit afatgjatë mund të realizohen nëpërmjet integritetit të temave mjedisore në programin shkollor dhe institucionet e arsimit të lartë.

Konkluzione specifike

Rasti i parë i studimit në disertacion i dedikohet përafrimit të legjislacionit shqiptar me Direktivën e Tatimit të Energjisë (2003/96/EC). Qëllimi i këtij rasti studimi është dhënia e një

kontributi konkret për vendosjen e një takse karboni mbi produktet e energjisë, duke ofruar një mënyrë efektive për reduktimin e emetimit të gazeve serrë, në përputhje dhe me standardet e BE-së. Kjo e fundit ka konsoliduar një bazë ligjore e politikash të avancuara për taksimin e produkteve të energjisë dhe karbonit që ato përmbajnë.

Në Shqipëri, taksimi i karbonit është pjesë e ligjit për taksat kombëtare, ligj i cili ka pësuar përmirësime dhe taksat e karbonit kanë ardhur në rritje, por referuar legjislacionit dhe *acquis-ë* së BE-së, këto taksa nevojitet të shtohen, si dhe të rritet gama e produkteve të energjisë që taksohen. Nga analiza e produkteve të energjisë të përfshira në Direktivën 2003/96/EC, por që mungojnë në ligjin shqiptar për taksimin e karbonit, si dhe nga analizimi i të dhënave të këtyre produkteve të energjisë në import, konkludohet për produktet më të rëndësishme për Shqipërinë për t'u përfshirë në ligjin përkatës. Një analizë më e plotë e tregut duhet të përfshijë gjithashtu prodhimin dhe eksportimin e produkteve të energjisë, që bëjnë pjesë në direktivë por që mungojnë në ligjin shqiptar, *në* dhe *nga* ky treg. Një bilanc neto i produkteve energjetike më të rëndësishme për tregun shqiptar mund të jetë një bazë e mirë për t'u marrë në konsideratë nga politikëbërësit kur të propozojnë një amendament për ligjin ekzistues shqiptar për taksat kombëtare. Megjithatë, në këtë proces, duhen marrë parasysh edhe faktorë të tjerë socialë, ekonomikë dhe politikë.

Përveç kësaj, përfshirja e produkteve të energjisë në ligjin shqiptar duke u mbështetur në legjislacionin e BE-së, niveli i tyre i mundshëm i taksimit dhe rrillogaritja për produktet ekzistuese të energjisë, duhet të bëhen duke marrë në konsideratë edhe përvojën e vendeve të rajonit, që tashmë e kanë përafëruar Direktivën 2003/96/EC, si dhe mundësinë për përjashtim të pjesshëm apo ulje takse për produktet e energjisë të përdorura për qëllime të veçanta, sikurse parashikohet edhe në Direktivë.

Përveç taksës së karbonit, ka politika alternative që ofrojnë stimuj financiarë për të ulur emetimet e gazeve serrë, të tilla si tregtia e emetimeve dhe rregullimet komandë-dhe-kontroll. Aplikimi i mekanizmave me bazë tregu në tërësi, është vlerësuar se vepron më mirë sesa vendosja e standardeve të emetimeve, duke mos ndikuar negativisht në prodhimin industrial.

Një pjesëmarrje e mundshme e Shqipërisë në tregjet e karbonit paraqet disa vështirësi, për kapërcimin e të cilave kërkohet aftësi parashikuese dhe efikasitet për mobilizimin e burimeve

financiare, ndërtimin e aleancave dhe arritjen e marrëveshjeve për financimin e karbonit. Pjesëmarrja në këto tregje duhet të jetë reale, e dukshme dhe konkurruese. Në një hap të dytë, nevojitet forcim i kapaciteteve teknike të zyrtarëve të projekteve, ngritje e aftësive të përgjithshme menaxhuese për financimin e karbonit dhe mbështetje e këtyre aftësive nëpërmjet instrumenteve të informimit publik. Përfshirja e përfaqësuesve privatë dhe shoqërisë civile në vendimmarrje është e nevojshme për të shtuar vlerën e projekteve dhe për të rritur efektivitetin e mekanizmave për pjesëmarrjen e palëve të interesuara në planifikimin dhe zbatimin e politikave në kuadër të ndryshimeve klimatike.

Në mënyrë që pjesëmarrja në tregjet e karbonit të jetë me dobi për Shqipërinë, duhet që ky treg të gëzojë këto karakteristika:

- Të ofrojë mjete për të kontribuar në stabilizimin e përqendrimeve të gazeve serrë në atmosferë;
- Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen e cilësisë së jetesës në Shqipëri;
- Të mos dëmtojë angazhimet e tanishme ose të ardhshme për reduktimin ose kufizimin e shkarkimeve në përputhje me instrumentet detyruese ligjore në nivel ndërkombëtar;
- Të promovojë barazi shoqërore dhe krahinore dhe pjesëmarrje efikase të gjithë popullsisë në përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike;
- Të mobilizojë burimet financiare në mënyrë efikase dhe të përmirësojë klimën e biznesit dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre menaxhuese për projektet e financimit të karbonit.

Politikat e BE-së për ndryshimet klimatike janë integruar kryesisht në politikat mjedisore dhe politikat e energjisë së saj. Legjislacionet e mjedisit dhe energjisë së BE-së janë gjithashtu pjesë e *acquis communautaire* që Shqipëria duhet të integrojë në kuadrin e brendshëm ligjor të saj, në kohën e pranimit të plotë. Integrimi i politikave të mjedisit dhe energjisë së BE-së në kuadrin legjislativ shqiptar, duhet të shihet edhe si një mundësi për të zbatuar projektet MZhP; Ndërsa në fushat, për të cilat është përshtatur tashmë kuadri kombëtar me legjislacionin e BE-së, Shqipëria mund t'i zbatojë këto projekte. Projektet MZhP, komisionet e të cilëve nisin në fazën e para-anëtarësimit, mund të vazhdojnë të gjenerojnë kredite karboni edhe kur vendi të jetë anëtarësuar në BE, me kusht që vendi të mbajë statusin e vendit të Shtojcës Jo-1. Në të

ardhmen, kur të ketë ka arritur një fazë të caktuar zhvillimi, Shqipërisë do t'i duhet të angazhohet për reduktimin e emetimeve kombëtare dhe ndoshta do ta lerë MZhP-në, për Zbatimin e Përbashkët dhe tregtinë e drejtpërdrejtë të emetimeve.

Një tjetër mekanizëm evropian i lidhur me ndryshimin e klimës është ETS, i cili ka për qëllim të mbështesë instrumentet e BE-së dhe shteteve të saj anëtare, për të përmbushur objektivat e Kiotos. Zbatimi i ETS-së do të jetë i detyrueshëm në momentin e anëtarësimit, si pjesë e integritit të *acquis communautaire*, edhe nëse Shqipëria nuk do të ketë statusin e Shtojcës 1 dhe as të Shtojcës B të Protokollit të Kiotos.

Rasti i dytë i studimit në disertacion u kushtohet politikave pyjore, të cilat konsiderohen të rëndësishme në çështjen e ndryshimit të klimës. Gjatë njëzet vjetëshit të fundit, Shqipëria ka humbur një pjesë të konsiderueshme të fondit pyjor për shkak të prerjeve ilegale, zjarrvënies të qëllimshme dhe mungesës së shërbimeve. Programet REDD për reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve, mund të merren njëkohësisht me ndryshimin e klimës, ruajtjen e biodiversitetit dhe ekonominë rurale. Ata synojnë të krijojnë një vlerë financiare nga karboni i depozituar në pyje, duke ofruar stimuj për vendet në zhvillim, që të reduktojnë emetimet e karbonit nga tokat e pyllëzuara dhe të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm. Së bashku me programet e MZhP nën KKKBNK, programet REDD, si *mekanizma me bazë tregu* që synojnë të arrijnë objektivat e CO₂, janë atraktive për BE-në dhe mund të gjenerojnë financa përmes një llojshmërie mekanizmesh. Në mënyrë që këto programe të vihen në jetë në Shqipëri, rekomandohet të merren një sërë masash, si vijon:

1. Përmirësimi i kuadrit institucional dhe politikave pyjore

Realizimi i këtij objektivi mund të përfshijë këto veprimtari kryesore:

- *Përgatitja e një strategjie për mbrojtjen e klimës në sektorin pyjor* që të përbëhet nga aktivitetet lehtësuese dhe kontributi përkatës hipotetik për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, deri në vitin 2020. Një strategji e tillë, duhet të përcaktojë kontributin që mund të japë sektori pyjor, bazuar në objektivin kombëtar politik për gazet serrë. Afatet kohore në strategjinë e mbrojtjes së klimës në sektorin pyjor duhet të jenë në përputhje me ato të strategjisë së zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe në sinkron me objektivat e reduktimit të gazeve serrë. Në tërësi, politikat e qëndrueshmërisë klimatike në sektorin pyjor duhet të

zhvillohen në përputhje me objektivat politikë kombëtarë dhe standardet e cilësisë së BE-së kundrejt angazhimeve në kuadër të Protokollit të Kiotos.

- *Krijimi i një Komiteti Ndër-institucional Teknik* për ndryshimin e klimës në sektorin e pyjeve, i cili do të përfshinte anëtarë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, nga ministrinë e tjera të lidhura me çështjen e ndryshimeve klimatike, si dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore. Ky komitet teknik do të siguronte koordinimin e veprimtarive të administratave të ndryshme, duke qenë përgjegjës për forcimin dhe shtimin e aktiviteteve pyjore zbutëse ndaj ndryshimit të klimës brenda programeve dhe planeve që lidhen me menaxhimin e tokës, konsumin e energjisë, bujqësinë dhe turizmin, etj.
- *Sigurimi i pjesëmarrjes së Shqipërisë në tregjet e karbonit* (për masat që nevojiten të ndërmerren në këtë kuadër, flitet më lart).

2. Intensifikimi i kërkimit dhe trajnimit lidhur me ndryshimet klimatike

Politikat, strategjitë dhe menaxhimi i ndryshimit të klimës në sektorin e pyjeve duhet të zhvillohen dhe zbatohen duke u bazuar në burimet tradicionale dhe njohuritë shkencore. Gjithashtu, ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe efektshmëria e aktiviteteve zbutëse duhet të monitorohen dhe rezultatet të raportohen në përputhje me angazhimet ndërkombëtare.

Për të përmbushur kërkesat më lart, mund të propozohen aktivitete të ndryshme kërkimore, për ngritjen e kapaciteteve dhe arsimin, të fokusuara në aspektet e ndryshimeve klimatike. Për një vendimmarrje në kohë dhe të mirinformuar, nevojiten njohuri të reja, aftësi dhe ekspertizë. Palët e interesuara duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të planifikuar, udhëhequr, menaxhuar dhe për të marrë pjesë në proceset përkatëse. Ngritja e kapaciteteve dhe të kuptuarit e pasojave negative të ndryshimeve klimatike në nivel individual dhe organizativ, kërkojnë programe të reja të trajnimit dhe të rritjes së aftësive. Përveç aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve, janë të nevojshme të dhëna dhe informacione të reja për të kryer vlerësime të ndryshimeve klimatike dhe aktiviteteve përshtatëse e zbutëse të lidhura me to. Aktivitetet e rekomanduara në këtë kuadër jepen përmbledhtas më poshtë:

- *Zhvillimi i skenarëve të ndryshëm të emetimeve të gazeve serrë dhe i një inventari të gazeve serrë për sektorin e pyjeve*

Zhvillimi i një inventari të gazeve serrë për sektorin pyjor, jo vetëm që do të ndihmonte për të detajuar përmasat e emetimeve, por do të ndihmonte të përcaktohej edhe masa e ndikimit të aktiviteteve zbutëse dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në vendimmarrje. Paralelisht me realizimin e një inventarizimi të gazeve serrë, aktivitetet kërkimore për një zhvillim të detajuar të skenarëve të ndryshëm, do të ishin me dobi jo vetëm për krahasimin e aktiviteteve të ndryshme zbutëse e potencialit të reduktimit të emetimeve, por edhe për kostot e përfitimet e tjera të lidhura me aktivitetet e reduktimit.

○ *Mbështetja e kërkimeve lidhur me aktivitetet për reduktimin e emetimeve*

Në përputhje me zhvillimin e skenarëve të emetimeve, duhet kryer kërkime për ndikimet e drejtpërdrejta dhe dytësore të aktiviteteve për reduktimin e emetimeve. Ky kërkim duhet të përfshijë: aspektet politike (p.sh. rregulloret mjedisore për përdorimin e pyjeve), ndikimet sociale (p.sh. ndryshimi i përdorimit tradicional të pyjeve), kostot ekonomike dhe përfitimet (p.sh. reduktimi i kërkesës për karburant). *Zbatimi i projekteve pilot* është një mundësi e mirë për vendimmarrjen, me qëllim vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve zbutëse. Ata mund të ofrojnë njohuri dhe parashikojnë përgjigje të mundshme në drejtim të projektimit dhe vlefshmërisë së metodologjive, rregullimit të kostove dhe përfitimeve, mundësive për të aplikuar aktivitetet në rajone të ndryshme të vendit.

3. Sigurimi i financimit

Për të mbështetur pylltarinë dhe aktivitetet për zbutjen e klimës në këtë sektor, nevojiten burime financiare shtesë. Me qëllim që të sigurohet zotërimi i projekteve nga Shqipëria, sugjerohet *krijimi i një Fondi Kombëtar Klimatik (FKK)* që të jetë i menaxhuar e zotëruar kombëtarisht dhe që supozohet të mbledhë financa për klimën nga një shumëllojshmëri burimesh. Në këtë mënyrë, Shqipëria do ta drejtojë realisht procesin dhe mund të bëjë përzgjedhje burimesh bazuar në rezultatin që aktivitetet japin në terren.

Burimet e financimit mund të jenë nga buxheti i shtetit, ose nga sektori privat (sektori që ndot më shumë, mund të kompensojë për emetimet duke kontribuar në FKK). Në mënyrë që të arrihet mobilizimi në nivelin e duhur i këtij kapitali në sektorin privat, është e rëndësishme që politikëbërësit të ofrojnë rrugët dhe formatet për këtë sektor, për të investuar dhe për t'u angazhuar në mbrojtjen, rehabilitimin dhe krijimin e pyjeve, për të rritur konkurrencën

financiare dhe atraktivitetin e investimeve në pyje, me qëllim zbutjen e ndryshimit të klimës, si dhe për të reduktuar rreziqet eventuale të investimeve.

Ekzistojnë *mekanizma të ndryshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar* dypalësh ose shumëpalësh, fonde ndërkombëtare, të cilat Shqipëria mund t'i shfrytëzojë për financimin e aktiviteteve lehtësuese ndaj ndryshimit të klimës në tërësi, si dhe në kuadër të sektorit pyjor. Disa mundësi financimi nëpërmjet programeve të granteve për projekte ekzistuese të sekuestrimit të karbonit dhe disa fondeve apo OJQ-ve të cilat mbështesin projektet në shkallë të vogël për ruajtjen apo zhvillimin rural, janë Fondi i Biokarbonit i Bankës Botërore (BIOCF), GEF - Programi i granteve të vogla për ndryshimet klimatike, Fondi Gjerman për mbrojtjen e klimës. Gjithashtu, programe të tjera ndërkombëtare të bashkëpunimit mund të shfrytëzohen nga ana jonë edhe për ngritjen e kapaciteteve teknike.

FUND

Lista e referencave

Literaturë

- Andersen, M. S. 2010. Europe's experience with carbon-energy taxation. *SAPIENS* 3 (2).
Marrë në: <http://sapiens.revues.org/1072> (Shkarkuar më maj 2013).
- Bourbon-Seclet, Ch. 2008. Legal aspects of climate change in Europe: Is the European Union Emission Trading Scheme greater than the sum of the parts? *Journal of International Banking and Regulation*.
- Brauch, H.G. (ed.) 1996. *Climate policy – scientific background, international regime building and conflicts, economic analyses like national problem identification and policy suggestions*. Heidelberg: Springer.
- Brauch, H.G. (ed.) 2010. *Climate change and Mediterranean security: international, national, environmental and human security impacts for the Euro-Mediterranean region during the 21st century*. European Institute of the Mediterranean.
- Buchroithner F. Manfred. 2010. *Remote sensing for environmental data in Albania: A strategy for integrated management*. NATO Science Series. The Netherlands: Kluwer Academic Publishers.
- Ceka, J. 1999. *Biomass assessment and utilization options for energy production in Albania*. Master of Science thesis, Department of Environmental Sciences and Policy, Central European University, Budapest.
- Cerda, E. and X. Labandeira. 2010. *Climate change policies: global challenges and future prospects*. Cheltenham: Edward Elgar Publishing Limited.
- Commission Europeene. 2010. *Changement climatique*. Office des publications.
- D'Amato, A. and Engel, K. (Ed.) 1997. *International Environmental Law Anthology*. Anderson Pub Co, pp 3-8.
- EEA. 2010. *The European environment. State and outlook 2010. Synthesis*. Copenhagen: European Environmental Agency.
- Fisher, B.S. *et al.* 1996 (PDF). An Economic assessment of policy instruments for combating climate change. In: J.P. Bruce et al. eds. *Climate Change 1995*. [Online] Marrë në: http://www.ipcc.ch/ipccreports/sar/wg_III/ipcc_sar_wg_III_full_report.pdf (Shkarkuar më maj 2013).

- French, D. and Rajamani L. 2013. Climate Change and International Environmental Law: Musings on a Journey to Somewhere. In: *Journal of Environmental Law* 25:3. Oxford University Press.
- Guri, S., Guri, M., dhe Koçi, K. 2010. *E drejta mjedisore: bazat e legjislacionit krahasimor mjedisor shqiptar e evropian*. Tiranë: Marin Barleti.
- Hendrick, T. E., Bickman, L., and Rog, D. J. 1993. *Applied research design: a practical guide*. Applied social research methods series, volume 32. London: Sage Publications.
- Hilson, Ch. 2013. It's All About Climate Change, Stupid! Exploring the Relationship Between Environmental Law and Climate Law. In: *Journal of Environmental Law* 25:3, Oxford University Press.
- Kramer, L. 2003. *EC Environmental Law*. Sweet & Maxwell. Fifth edition.
- Kulauzov, D. 2007. *Policies to combat desertification and climate change in the Southern-Mediterranean region in the context of the international development cooperation*. Doctor of Philosophy dissertation, Department of Environmental Sciences and Policy, Central European University, Budapest.
- Lazarus, J. R. 2004. *The making of environmental law*. Chicago: University of Chicago Press.
- Massai, L. 2011. *The Kyoto Protocol in the EU*. T.M.C. Asser Press.
- Muharremaj, E. 2014. *Ndikimi i të drejtës ndërkombëtare të mjedisit në legjislacionin shqiptar*. Disertacion doktore, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës, Tiranë.
- Nakata, T., Silva, D., Rodionov, M. 2011. Application of energy system models for designing a low carbon society. In: *Progress in energy and combustion Science*. Volume 37, Issue 4. Elsevier. pp. 462-502.
- NATO. 1999. *NATO handbook*. Brussels: NATO.
- Naudé, W. 2011. *Climate change and industrial policy*. Working paper No. 2011/03. Helsinki: Maastricht School of Management.
- Paz Sh., Xoplaki E., Gershunov A. 2010. *Impacts of Mediterranean Climate Change on Human Health*. Paphos, Cyprus: The Cyprus Institute. Energy, Environment and Water Research Center.
- Pearce, D. 2005. *The United Kingdom Climate Change Levy: A study in political economy*. Paris: OECD. [Online] Marrë në: [http://www.oalis.org/oalis/2004doc.nsf/LinkTo/NT00009492/\\$FILE/JT00179396.PDF](http://www.oalis.org/oalis/2004doc.nsf/LinkTo/NT00009492/$FILE/JT00179396.PDF) (Shkarkuar më maj 2013).

- Petrela, I. 2011. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian në mbrojtje të mjedisit. Në: *Revista shqiptare për botime ligjore*. Vol. 2 (2011).
- Pilifosova, O. 2000. *Where is adaptation going in the UNFCC' proceeding of SURVAS expert workshop on European vulnerability and adaptation to impacts of accelerated sea-level rise*. Hamburg.
- Punch, K. F. 1998. *Introduction to social research: quantitative and qualitative approaches*. London: Sage Publications.
- Regional Environmental Center (REC) (Ed.). 2012. *Mjedisi sot*. Tiranë. Nr. 134, pp.7-16.
- Robert, I. 2010. Implications for customs of climate change mitigation and adaptation policy options: a preliminary examination. In: *World Customs Journal*. Volume 4, No. 2.
- Shackleton, R. 2009. *Potential impact of climate change in the United States*. Washington D.C.: US Congressional Budget Office.
- Smith, S. 2008. *Environmentally related taxes and tradable permit systems in practice*. Paris: OECD. [Online] Marrë në: [http://www.oecd.org/olis/2007doc.nsf/LinkTo/NT00005FF2/\\$FILE/JT03247683.PDF](http://www.oecd.org/olis/2007doc.nsf/LinkTo/NT00005FF2/$FILE/JT03247683.PDF) (Shkarkuar më maj 2013).
- United Nations Development Programme. 2008. (PDF) *The Western Balkans Environmental Programme: review of policy integration and capacity development need assessment studies. Albania. Assessment of capacity building needs of national and local stakeholders*. [Online] Marrë në: http://westernbalkansenvironment.net/documents/review_of_policy.pdf (Shkarkuar më korrik 2013).
- UNEP. 2012. *Climate change in the West Balkans*. Zoë Enviroment Europe.
- United Nation-Sigma XI Scientific Expert Group on Climate Change. 2007. *Confronting climate change: Avoiding the unmanageable and managing the unavoidable*. United Nations Foundation.
- United States Geological Survey (USGS). 2009. *Volcanic Gases and Their Effects*. [Online] Marrë në: <http://volcanoes.usgs.gov/hazards/gas/> (Shkarkuar më prill 2013).
- Webber, D. J. 1991. *The distribution and use of policy knowledge in the policy process*. Knowledge and policy. Volume 4, Issue 4, pp. 6-36.
- Yin, R. K. 1993. Applications of case study research. *Applied social research methods series*. Volume 34. London: Sage Publications.
- Yujie L., Xinyuan Zh., Qingbin C. 2012. Effectiveness and equity implications of carbon policies in the United States construction industry. In: *Building and Environment*. Volume 49, pp. 259-269. Elsevier.

Zaganjori, Xh. 2004. *Vendi së drejtës ndërkombëtare në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*. Jeta Juridike. Nr. 2, Tiranë, fq. 32.

Burime parësore

Administrata Doganore Shqiptare. 2013. *Sistemi i brendshëm automatik i të dhënave*.

Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve (AMP). 2010. *Raport mbi gjendjen e mjedisit 2009*. Tiranë.

Albania Natural Resources Development Project (PZhBN). 2008. [Online] Marrë në:
<http://www.un-foodsecurity.org/node/638> (Shkarkuar më korrik 2013).

Climate Change and International Security, Paper from the High Representative and the European Commission to the European Council. 2008. [Online] Marrë në:
http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/reports/99387.pdf
(Shkarkuar më maj 2012).

Climate Change and Security: follow-up recommendations by EUHR Solana. 2008. [Online] Marrë në:
http://www.europa-eu-un.org/articles/en/article_8382_en.htm (Shkarkuar më 14 maj 2012).

Climate congress. 2009. *Synthesis report of the climate change conference*. [Online] Marrë në:
<http://climatecongress.ku.dk/pdf/synthesisreport/> (Shkarkuar më maj 2012).

COP17 final outcome (pa datë). Marrë në: <http://www.willstegerfoundation.org/climate-news/item/1388-cop17-final-outcome> (Shkarkuar më gusht 2012).

Denmark the official website (pa datë). Copenhagen climate COP15. Marrë në:
<http://www.denmark.dk/en/menu/Climate-Energy/COP15-Copenhagen-2009/cop15.htm>
(Shkarkuar më mars 2013).

Dokumenti Rekomandues për Financimin e Karbonit në Shqipëri (DRFKSh). 2009. Tiranë: MMPAU. [Online] Marrë në:
<http://www.ccalb.org/editorfiles/file/National%20Strategy%20for%20Carbon%20Finance%20-%20Albania.pdf> (Shkarkuar më qershor 2013).

European Commission. 2002. *Annual report 2001 on the EC development policy and the implementation of the external assistance*. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities.

_____. 2010. *Albania 2010 Progress Report*. [Online] Marrë në:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_rapport_2010_en.pdf (Shkarkuar më prill 2013).

_____. 2011. *Albania 2011 Progress Report*. [Online] Marrë në:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_rapport_2011_en.pdf
(Shkarkuar më prill 2013).

_____. 2012. *Albania 2012 Progress Report*. [Online] Marrë në:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf
(Shkarkuar më prill 2013).

_____. 2013. *Albania 2013 Progress Report*. [Online] Marrë në:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf
(Shkarkuar më prill 2013).

Federation of Small Businesses. 2011. *European Commission proposal for an EU-wide carbon tax*. [Online] Marrë në:
<http://www.fsb.org.uk/policy/images/european%20commission%20proposal%20for%20an%20eu-wide%20carbon%20tax.pdf> (Shkarkuar më prill 2013).

Hepburn, C. 2006. Regulating by prices, quantities or both: an update and an overview. *Oxford Review of Economic Policy* pp. 226–247. Marrë në:
<http://www.economics.ox.ac.uk/members/cameron.hepburn/Hepburn%20%282006,%20Oxrep%29%20Regulation%20by%20P%20or%20Q.pdf> (Shkarkuar më maj 2013).

IEA. 2008. *Energy Policies of IEA Countries – Sweden - 2008 Review*. International Energy Agency website. p. 150. [Online] Marrë në:
http://www.iea.org/publications/free_new_Desc.asp?PUBS_ID=2023 (Shkarkuar në maj 2013).

IEA. 2010. *World energy outlook*. IEA Press.

IPCC. 2007a. *Climate Change 2007: Synthesis Report*. Geneva: IPCC. This version: IPCC website. [Online] Marrë në: http://www.ipcc.ch/pdf/-assessment-report/ar4/syr/ar4_syr.pdf (Shkarkuar më maj 2013).

IPCC Working Group I. 2007b. *Climate change 2007: the physical science basis*. New York: Cambridge University Press.

IPCC Working Group II. 2007c. *Climate change 2007: Impacts, adaptation and vulnerability*. New York: Cambridge University Press.

IPCC. 2007d. *Projected climate change and its impacts*. (Core Writing Team, Pachauri, R.K and Reisinger, A. (ed.)). Print version: Geneva: IPCC. This version: IPCC website. [Online] Marrë në: http://www.ipcc.ch/publications_and_data/ar4/syr/en/spms3.html (Shkarkuar më maj 2013).

IPCC. 2011. *Special report on renewable energy sources, summary for policy makers*. [Online] Marrë në:
http://www.ipcc.ch/news_and_events/docs/ipcc33/SRREN_FD_SPM_final.pdf
(Shkarkuar më shkurt 2013).

- Kanter, J. 2010. Europe considers new taxes to promote 'clean' energy. *The New York Times* 22 June 2010. [Online] Marrë në: http://www.nytimes.com/2010/06/23/business/energy-environment/23carbon.html?_r=2&ref=cap_and_trade (Shkarkuar më maj 2013).
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. 1998. Tiranë.
- Kyoto Protocol to the United Nations Framework Convention on Climate Change*. 1997. United Nations.
- Mandija F., Bushati J., Zoga P. 2012. Statistical Distribution of Weather Pattern during latest four decades over Albanian territory. *Proceedings of the BALWOIS 2012 conference*, Ohrid, Macedonia.
- Ministria e Integritimit Evropian. 2011. *Programi IPA 2008 i BE-së. Mbështetje për MIE-SMEI II*.
- Nomenklatura e kombinuar e mallrave 2012*. [Online] Marrë në: http://www.instat.gov.al/media/166727/nomenklatura_e_kombinuar_e_mallrave_2012.pdf (Shkarkuar më shtator 2012).
- Schneider H. 2013. Deforestation: risk for the climate – chance for kosova? *Proceedings of conference: Effects of global risk in transition countries*, maj 2013, Pejë, Kosovë.
- Solana H. 2008. *Climate change and international security: Paper from the High Representative and the European Commission to the European Council* [Online]. Marrë në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/reports/99387.pdf (Shkarkuar më 14 maj 2012).
- Soros, G. 2008. *Comment on the global financial crisis*. Public Lecture. 11 nëntor 2008. Budapest. CEU. PERG Blog. [Online] Marrë në: <http://pergceu.blogspot.com/2008/11/george-soros-lecture-at-ceu.html> (Shkarkuar më qershor 2013).
- Statistikë e Gjyqësorit. Marrë në: www.gjykatatirana.gov.al (Shkarkuar më prill 2015).
- Steinmeier F. W. & Miliband D. 2008. *Europe has to face up to the security policy impact of climate change* [Online]. Marrë në: <http://www.auswaertiges-amt.de/EN/Infoservice/Presse/Interview/2008/080313-klimasicherheit.html> (Shkarkuar më maj 2012).
- Submission by Ireland and the European Commission on behalf of the European Union and its Member States*. 2013. [Online] Marrë në http://unfccc.int/files/cooperation_support/financial_mechanism/fast_start_finance/application/pdf/ie-05-29_-_fsf_report.pdf (Shkarkuar më shtator 2013).
- Treaty establishing the European Community as amended by subsequent treaties Rome*. 1957. Rome.

UNEP. 2009. *The State of the Environment and Development in the Mediterranean 2009*. [Online] Marrë në: http://www.unepmap.org/index.php?module=library&mode=pub&action=results&s_category=MAP%20Publications (Shkarkuar më 14 maj 2012).

UNFCCC. 1992. Geneva: UNEP's Information Unit for Conventions.

UNFCCC. 2009. Ad Hoc Working Group on Long-Term Cooperative Action Under The Convention, Sixth session, Bonn, 1–12 June 2009, [Online] Marrë në: <http://unfccc.int/resource/docs/2009/awglca6/eng/misc04a02.pdf> (Shkarkuar më shtator 2013).

WBGU. 2008. *World in transition: Climate change as security risk*. London Earthscan, [Online] Marrë në: http://www.wbgu.de/wbgu_jg2007-engl.html (Shkarkuar më korrik 2013).

World Bank. 2010. World Bank Indicators 2010. *Development Data Group*. [Online] Marrë në: <http://data.worldbank.org/country/albania> (Shkarkuar më korrik 2013).

Burime juridike

Directive of the European Parliament and of the Council 2001/77/EC of 27 September 2001 on the promotion of electricity produced from renewable energy sources in the internal electricity market.

European Commission. 1996. *Green Paper: Energy for the future: renewable sources of energy* COM(96) 576. [Online] Marrë në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:1996:0576:FIN:EN:PDF> (Shkarkuar më tetor 2012).

_____. 2000a. *EU policies and measures to reduce greenhouse gas emissions. Towards a European Climate Change Programme (ECCP)*. Communication COM (2000) 88. Brussels.

_____. 2000b. *Europe and space: turning to a new chapter*. Communication COM (2000) 597 final. Brussels.

_____. 2001a. *A sustainable Europe for a better world: A European Union strategy for sustainable development*. Communication COM (2001) 264 final. Brussels.

_____. 2001b. *Environment 2010: Our future, our choice – the Sixth Environment Action Programme of the European Community*. Communication COM (2001) 31 final. Brussels.

_____. 2006a. *Renewable energy road map. Renewable energies in the 21st century: building a more sustainable future*. Communication COM(2006) 848 final. [Online]

Marrë në: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ.do?uri=COM:2006:0848:FIN:EN:PDF> (Shkarkuar më shkurt 2013).

_____. 2006b. *Communication establishing an environment strategy for the Mediterranean*. [Online] Marrë në: http://europa.eu/legislation_summaries/environment/water_protection_management/l28182_en.htm (Shkarkuar më qershor 2012).

_____. 2007. *Energy Policy for Europe*. Communication COM(2007)1 final. Brussels. [Online] Marrë në: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ.do?uri=COM:2007:0001:FIN:EN:PDF> (Shkarkuar më qershor 2012).

_____. 2007. *European strategic energy technology plan towards a low carbon future*. Communication COM(2007)723 final. Brussels. [Online] Marrë në: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2007:0723:fin:en:pdf> (Shkarkuar më qershor 2012).

_____. 2009. *Investing in the Development of Low Carbon Technologies (SET-Plan) COM(2009)519*. Brussels. [Online] Marrë në: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2009:0519:FIN:EN:PDF> (Shkarkuar më qershor 2012).

_____. 2010. *An integrated industrial policy for the globalisation era-putting competitiveness and sustainability at centre stage*. Communication COM (2010) 614. Brussels.

European Council Directive 2003/96/EC restructuring the community framework for the taxation of energy products and electricity.

_____. *85/337/EEC on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment.*

_____. *96/61/EC concerning integrated pollution prevention and control (the IPPC Directive).*

_____. *96/62/EC on ambient air quality assessment and management.*

_____. *1999/32/EC related to a reduction in sulphur content of certain liquid fuels.*

_____. *2001/1/EC amending Council Directive 70/220/EEC on the approximation of the laws of the Member States on measures to be taken against air pollution by emissions from motor vehicles.*

_____. *2001/80/EC on the limitation of emissions of certain pollutants into the air from large combustion plants (the LCP Directive).*

_____. *2001/81/EC on national emission ceilings for certain atmospheric pollutants.*

- _____. *2001/100/EC amending Council Directive 70/220/EEC on the approximation of the laws of the Member States on measures to be taken against air pollution by emissions from motor vehicles.*
- _____. *2002/3/EC relating to ozone in ambient air.*
- _____. *2002/358/EC concerning the approval, on behalf of the European Community, of the Kyoto Protocol to the UNFCCC and the joint fulfillment of commitments thereunder.*
- _____. *2003/4/EC on public access to environmental information and repealing council directive 90/313/EEC.*
- _____. *2003/17/EC on amendment of the Directive 98/70/EC relating to the quality of petrol and diesel fuels and amending Council Directive 93/12/EEC.*
- _____. *2003/30/EC on the promotion of the use of biofuels or other renewable fuels for transport.*
- _____. *2003/87/EC establishing a scheme for greenhouse gas emission allowance within the Community and amending Council Directive 96/61/EC.*
- _____. *2003/96/EC restructuring the Community framework for the taxation of energy products and electricity.*
- _____. *2004/8/EC on the promotion of cogeneration based on a useful heat demand in the internal energy market.*
- _____. *2004/39/EC on markets in financial instruments amending Council Directives 85/611/EEC and 93/6/EEC, 2000/12/EC, and repealing Council Directive 93/22/EEC.*
- _____. *2004/101/EC amending Council Directive 2003/87/EC establishing a scheme for greenhouse gas emission allowance trading within the Community, in respect of the Kyoto Protocol's project mechanisms.*
- _____. *2006. Green Paper: A European Strategy for Sustainable, Competitive and Secure Energy SEC(2006) 317. [Online] Marrë në: http://europa.eu/documents/comm/green_papers/pdf/com2006_105_en.pdf (Shkarkuar më tetor 2012).*
- _____. *2008/99/EC (and of the Council) on the protection of the environment through criminal law.*
- _____. *2010/31/EU on the energy performance of building.*

European Parliament Resolution INI/2006/2113 Green Paper. *European strategy for sustainable, competitive and secure energy.* [Online] Marrë në: http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P6-TA-20060603&language=EN#def_1_13 (Shkarkuar më prill 2013).

- _____. *on the International Conference for Renewable Energies, 1 April 2004.* [Online] Marrë në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P5-TA-2004-0276&language=EN> (Shkarkuar më prill 2013).
- Ligj Nr. 7895, datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Qendra Shqiptare e Publikimeve Zyrtare 2004.*
- Ligji Nr. 9975, datë 28.7.2008 për taksat kombëtare, i ndryshuar. Qendra Shqiptare e Publikimeve Zyrtare. Fletorja zyrtare Nr. 128/2008.*
- Ligji Nr. 10280, datë 20.5.2010 mbi disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008, mbi taksat kombëtare, i ndryshuar. Qendra Shqiptare e Publikimeve Zyrtare. Fletorja zyrtare Nr. 73/2010.*
- Ligji Nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008: Për taksat kombëtare, i ndryshuar. Qendra Shqiptare e Publikimeve Zyrtare. Fletorja zyrtare Nr. 107/2011.*
- Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 për mbrojtjen e mjedisit. Qendra Shqiptare e Publikimeve Zyrtare. Fletorja zyrtare Nr. 148/2011.*
- Plani i integruar i MMPAU 2009. Tiranë.*
- Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asoiciimit (PKZ-MSA) 2006. Tiranë.*
- Strategjia Kombëtare e Cilësisë të Ajrit. 2014. Tiranë.*
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2003. Tiranë.*
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013. Tiranë.*
- Strategjia Kombëtare Shqiptare mbi Mbetjet (SKShM) 2010. Tiranë.*
- Strategjia Kombëtare për Biznesin dhe Investimet (SKBI) 2013. Tiranë.*
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2008. Tiranë.*
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM) 2007. Tiranë.*
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM) 2013-2020. Tiranë.*
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1189, datë 18.11.2009 për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.*

Burime nga Interneti

- CIEL. 2011. *Climate change and human rights: a primer* [Online]. Marrë në:
http://www.ciel.org/Publications/CC_HRE_23May11.pdf (Shkarkuar më 20 prill 2012).
- Drought Management Center for Southeastern Europe homepage (pa datë). Marrë në:
<http://www.dmcsee.org/> (Shkarkuar më shtator 2013).
- Eurostat (pa datë). Marrë në:
http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php/Development_aid_statistics (Shkarkuar më qershor 2012).
- Eurostat. 2011. *Sustainable renewable energy*. Marrë në:
http://www.eds-destatis.de/en/downloads/sif/sf_10_056.pdf (Shkarkuar më qershor 2012).
- European Commission Homepage (pa datë). *Climate policies*. Marrë në:
http://ec.europa.eu/clima/policies/brief/eu/index_en.htm (Shkarkuar më korrik 2012).
- _____ (pa datë). *Energy efficiency*. Marrë në:
http://ec.europa.eu/energy/efficiency/buildings/buildings_en.htm (Shkarkuar më gusht 2012).
- _____ (pa datë). *Taxation and customs union legislation*. Marrë në:
http://ec.europa.eu/taxation_customs/taxation/excise_duties/energy_products/legislation/index_en.htm (Shkarkuar më shkurt 2013).
- European Environmental Agency (pa datë). Soil protection critical for Europe. Marrë në:
<http://www.eea.europa.eu/highlights/soil-protection-critical-to-safeguard> (Shkarkuar më qershor 2012).
- European Forest Institute (EFI) homepage (pa datë). Marrë në:
http://www.efi.int/portal/about_efi/ (Shkarkuar më 16 shtator 2013).
- Euro-Mediterranean (pa datë). Marrë në: <http://en.wikipedia.org/wiki/Euro-Mediterranean> (Shkarkuar më mars 2013).
- Human development report (pa datë). Marrë në: <http://hdr.undp.org/en/content/human-development-report-20078> (Shkarkuar më korrik 2012).
- Environment news service (pa datë). Marrë në:
<http://www.ens-newswire.com/ens/dec2008/2008-12-12-02.asp> (Shkarkuar më maj 2012).
- OECD homepage (pa datë). Archives. Marrë në:
http://www.oecd.org/259okument/25/0,3746,en_36734052_36761863_36952473_1_1_1_1,00.html (Shkarkuar më prill 2012).

Plan Bleu homepage. 2012. Water and climate change. Which adaptation strategy for the Mediterranean? Marrë në: <http://www.planbleu.org/planBleu/publications> (Shkarkuar më qershor 2012).

Synthesis report of the Climate Change Conference. 2009. Marrë në: <http://climatecongress.ku.dk/pdf/synthesisreport/> (Shkarkuar më maj 2012)

UNEP homepage (pa datë). Active in the Carpathians. Marrë në: <http://www.unep.org/roe/ActiveintheCarpathians/tabid/54595/Default.aspx> (Shkarkuar më shtator 2013).

UNFCCC homepage (pa datë). Background on the UNFCCC: The international response to climate change. Marrë në: http://unfccc.int/essential_background/items/6031.php (Shkarkuar më mars 2012).

UNFCCC homepage (pa datë). NAPA priorities database. Marrë në: http://unfccc.int/cooperation_support/least_developed_countries_portal/napa_priorities_database/items/4583.php (Shkarkuar më mars 2012).

World Health Organization (pa datë). Global Environmental Change. Marrë në: <http://www.who.int/globalchange/environment/en/> (Shkarkuar më qershor 2012).

Shtojca 1

Gazet serrë që vijnë nga veprimtari njerëzore dhe emetimet e të cilëve kufizohen nga Protokoli i Kiotos:

Dioksidi i karbonit (CO₂)

Është gazi më i rëndësishëm serrë i emetuar nga veprimtaritë njerëzore në aspektin e sasisë. Ai emetohet nga djegia e karburanteve fosilë, drurit apo gjithë materialeve të tjerë që përmbajnë karbon. Një pjesë e tij thithet nga bimësia;

Metani (CH₄)

Ai vjen nga burimet natyrore dhe veprimtaritë e njeriut, si prodhimi i fosileve të djegshme, rritja e kulturave (si orizi) dhe menaxhimi i plehut organik.

Oksidin nitrik

Emetohet nga plehëruesit e tokës, djegia e karburanteve fosilë dhe prodhimi në industrinë kimike që përdor azot.

Tre tipe gazesh fluorhidrikë

Këta gaze gjejnë përdorim industrial. Hidrokarburet e fluoruara (HFC), hidrokarburet e perfluoruara (PFC) dhe hegzaflluoruret e squfurit (SF₆).

Shtojca 2

Acquis të BE-së për energjinë me rëndësi për përafrimin para-aderues

- ✓ Rregullorja e KE Nr. 714/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 13 korrikut 2009, mbi kushtet për qasje në rrjet, për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Rregullores së KE-së Nr. 1228/2003
- ✓ Rregullorja e KE Nr. 715/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 13 korrikut 2009, mbi kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe shfuqizimin e Rregullores së KE-së Nr. 1775/2005
- ✓ Raport nga Komisioni për Këshillin dhe Parlamentin Evropian mbi kërkesat e qëndrueshmërisë për përdorimin e burimeve të ngurta dhe të gazta të biomasës për energji elektrike, ngrohje dhe ftohje SEC (2010) 65, SEC (2010) 66
- ✓ Letra e gjelbër drejt një rrjeti të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë evropiane, SEC (2008) 2869
- ✓ Komunikim për kufizim të ndryshimit të klimës globale në 2 gradë Celsius - rruga përpara për vitin 2020 dhe më tej, SEC (2007) 7, SEC (2007) 8
- ✓ Komunikim nga Komisioni për Këshillin Evropian dhe Parlamentit Evropian - Politika e energjisë për Evropën , SEC (2007) 12
- ✓ Komunikim për të fituar betejën kundër ndryshimit të klimës globale, SEC (2005) 180
- ✓ Komunikim për udhërrëfyesin e energjisë së rinovueshme dhe energjive të ripërtërishme në shekullin e 21^{të}: ndërtimi i një të ardhmeje më të qëndrueshme, SEC (2006) 1719, SEC (2006) 1720 , SEC (2007) 12
- ✓ Komunikim për perspektivat e tregut të brendshëm për gazin dhe energjinë elektrike, SEC (2006) 1709 , SEC (2007) 12
- ✓ Komunikimi për veprimet e përbashkëta për rritjen dhe punësimin: programi i Lisbonës për komunitetin, SEC (2005) 981
- ✓ Komunikimi për politikat e BE-së dhe masat për të reduktuar emetimet e gazit: Drejt një programi evropian për ndryshimet klimatike (ECCP), COM (2000) 88
- ✓ Komunikimi për hetimin e pajtimit me nenin 17 të Rregullores së KE-së Nr. 1/2003 në sektorët evropianë të gazit dhe energjisë elektrike (Raporti Final) SEC (2006) 1724
- ✓ Komunikimi për efikasitetin e energjisë: dërgimi i objektivit prej 20%, COM (2008) 772

- ✓ Komunikimi mbi planin e veprimit të biomasës , SEC (2005) 1573
- ✓ Komunikimi për Strategjinë e BE-së për biokarburantet, SEC (2006) 142
- ✓ Komunikimi për planin e veprimit për eficiencën e energjisë: Të kuptuarit e potencialit, SEC (2006) 1173, SEC (2006) 1174, SEC (2006) 1175
- ✓ Komunikimi për analizën e opsioneve për të lëvizur përtej 20% të reduktimeve të emetimeve të gazit serrë dhe vlerësimin e rrezikut të rrjedhjeve të karbonit, SEC (2010)650
- ✓ Komunikimi për mbështetjen e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, SEC (2005) 1571
- ✓ Komunikimi për pjesën e energjisë së rinovueshme në raportin e Komisionit të BE-së në përputhje me nenin 3 të Direktivës 2001/77/EC, vlerësimi i efektit të instrumenteve legjislativë dhe të politikave të tjera të komunitetit për zhvillimin e kontributit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në BE dhe propozime për veprime konkrete, SEC (2004) 547
- ✓ Komunikimi për adresimin e sfidës së efikasitetit të energjisë, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, COM (2008) 241⁷⁷

⁷⁷ Burimi: Ministria e Integritit Evropian. (2011) Programi IPA 2008 i BE-së. Mbështetje për MIE-SMEI II. (me ndryshime).

Shtojca 3

Lista e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mjedisit, të miratuara në Shqipëri, gjatë periudhës 2005-2012⁷⁸,

Aktet 2005

- ✓ Vendim nr. 835, datë 28.12.2005 “Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjесimi”
- ✓ Vendim nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- ✓ Vendim nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park kombëtar”
- ✓ Vendim nr. 82, datë 2.11.2005 “Për shpalljen e Lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij “Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur”
- ✓ Vendim nr. 683, datë 2.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës e të zonës së lumit Buna, zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur, dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë”
- ✓ Vendim nr. 684, datë 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”

Aktet 2006

- ✓ Ligj nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- ✓ Ligj nr. 9548, datë 01.06.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Mbi Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve”, i Konventës së Arhus-it “Mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, si dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për problemet mjedisore””
- ✓ Ligj nr. 9486, datë 06.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat, që hollojnë shtresën e ozonit””.
- ✓ Ligj nr. 9485, datë 06.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Montrealit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat, që hollojnë shtresën e ozonit””

⁷⁸ me synim krijimin e një kuadri ligjor bashkëkohor dhe në përputhje me direktivat e BE-së.

Burimi: MMPAU, komunikim personal, mars 2013.

- ✓ Ligj nr. 9484, datë 02.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Londrës, aneksi II, të Protokollit të Montrealit, "Për substancat, që hollojnë shtresën e ozonit””.
- ✓ Ligj nr. 9480, datë 16.02.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kopenhagenit, të Protokollit të Montrealit, "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.
- ✓ Ligj nr. 9478, datë 16.02.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar””.
- ✓ Ligj nr. 9478, datë 16.02.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar””.
- ✓ Vendim nr. 394, datë 21.6.2006 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”
- ✓ Vendim nr. 860, datë 20.12.2006 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm”.
- ✓ Vendim nr. 124, datë 2.3.2006 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 337, datë 15.7.1999 të këshillit të ministrave “për krijimin e komisionit qeveritar për problemet ujore me vendet fqinje”, të ndryshuar””

Aktet 2007

- ✓ Ligj nr. 9700, datë 26.3.2007 “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkuftare”
- ✓ Ligj nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- ✓ Ligj nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar
- ✓ Ligj nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”
- ✓ Ligj nr. 9822, date 29.10.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare për ruajtjen e peshkut ton të Atlantikut (ICCAT)”
- ✓ Vendim nr. 49, datë 31.1.2007 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të Malit me gropa-Bizë-Martanesh "Peizazh i mbrojtur"
- ✓ Vendim nr. 147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe dizel”
- ✓ Vendim nr. 687, datë 19.10.2007 “Për shpalljen, me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta "Park kombëtar”
- ✓ Vendim nr. 847, datë 29.11.2007 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të mjedisit”

Aktet 2008

- ✓ Ligj nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”
- ✓ Ligj nr. 9996, datë 22.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor"
- ✓ Ligj nr. 9867, date 31.01.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër”
- ✓ Vendim nr. 22, date 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”
- ✓ VKM nr. 1124, date 30.07.2008 “Për certifikimin e specialisteve për VNM dhe auditim mjedisor”
- ✓ Vendim nr. 640, datë 21.5.2008 “Për shpalljen Park kombëtar të ekosistemit natyror Shebenik-Jablanicë”
- ✓ Vendim nr. 994, datë 2.7.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”
- ✓ Vendim nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”
- ✓ Vendim nr. 1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e kritereve për caktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor”
- ✓ Vendim nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”
- ✓ Vendim nr. 1553, datë 26.11.2008 “Për krijimin e autoritetit kombëtar të përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të protokollit të Kiotos”
- ✓ Vendim nr. 1631, datë 17.12.2008 “Për shpalljen “Park kombëtar” të ekosistemit natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar”

Akte 2009

- ✓ Ligj nr. 10120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”
- ✓ Ligj nr. 10062, datë 29.01.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Sofjes të vitit 1988 “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit ne Distance të Largët

- ✓ Ligj nr. 10063, datë 29.01.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Helsinkit të vitit 1985 “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare të paktën me 30%”, të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largët”
- ✓ Vendim nr. 547, datë 13.5.2009 “Për përcaktimin e procedurave dhe të vlerave të qirasë për sipërfaqet ujore, për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”
- ✓ Vendim nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”
- ✓ Vendim nr. 84, datë 27.1.2009 “Për caktimin e kritereve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit”
- ✓ Vendim nr. 108, datë 27.1.2009 “Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda, në pyje”
- ✓ Vendim nr. 241, datë 6.3.2009 “Për miratimin e listës së llojeve të huaja invazive dhe për përcaktimin e procedurave, për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit”

Aktet 2010

- ✓ Ligj nr. 10234, datë 18.2.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut”
- ✓ Ligji nr. 10277, datë 13.5.2010 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit "Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”
- ✓ Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”
- ✓ Vendim nr. 432, datë 28.4.2010 “Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune-Vain-Tale”
- ✓ Vendim nr. 519, datë 30.6.2010 “Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale”
- ✓ Vendim nr. 546, datë 7.7.2010 “Për miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie”
- ✓ Vendim nr. 553, datë 7.7.2010 “Për përcaktimin e sezonit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”
- ✓ Vendim nr. 587, datë 7.7.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.

- ✓ Vendim nr. 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
- ✓ Vendim nr. 825, datë 13.10.2010 “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.
- ✓ Vendim nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve”

Aktet 2011

- ✓ Ligj nr. 10 422, datë 26.5.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë", për financimin afatgjatë të programit bashkëpunues për monitorimin e vlerësimin e transmetimit në rreze të gjatë të ndotësve të ajrit në Evropë (EMEP)”
- ✓ Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili përfaqëson Direktivën 2004/35/EC Për përgjegjësinë mjedisore, me qëllim parandalimin dhe rehabilitimin e dëmtimit të Mjedisit e amenduar me Direktivën 2006/21/EC dhe Direktivën 2009/31/EC
- ✓ Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i cili transponon plotësisht Direktivën e 27 qershorit 1985 “Mbi vlerësimin e ndikimeve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin” amenduar nga Direktive 97/11/EC, Direktiva 2003/35/EC dhe Direktiva 2009/31/EC.
- ✓ Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i cili transponon plotësisht dispozitat e Direktivës nr. 1, datë 15 Janar 2008, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes të ndryshuar nga Direktiva 2009/31/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 mbi depozitimin gjeologjik të dyoksidit të karbonit
- ✓ Ligji “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, i cili transponon Direktivën e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian Nr. 2001/42/EC, datë 27 qershor 2001, “Për vlerësimin e pasojave në mjedis nga plane dhe programe të caktuara në mjedis”
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili transponon Direktivën kuadër të Mbetjeve 2008/98/EC.
- ✓ Ligj nr. 10476, datë 3.11.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distance të largët, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës”
- ✓ Vendim nr. 123, datë 17.2.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”

- ✓ Vendim nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- ✓ Vendim nr. 200, datë 2.3.2011 “Për miratimin e planit të veprimit për fushën e organizmave të modifikuar gjenetikiisht (OMGJ), 2011-2013”
- ✓ Vendim nr. 897, datë 21.12.2011 “Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes”

Aktet 2012

- ✓ Ligj nr. 64/2012 “Për peshkimin”
- ✓ Ligj nr. 112/2012 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shtesë të Nagoja-Kuala Lumpurit "Për përgjegjësi dhe dëmshpërblim të protokollit të Kartagjenës për biosigurinë" të Konventës së Biodiversitetit”
- ✓ Ligj nr. 113/2012 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e Nagojës “Për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i tyre” të konventës së Biodiversitetit “Për larminë biologjike”
- ✓ Ligj nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- ✓ Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- ✓ Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”
- ✓ Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”
- ✓ Vendim nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”
- ✓ Vendim Nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”
- ✓ Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”

Shtojca 4

Lista e vendeve pjesë e Shtojcës 1 në KKKBNK

	Australia		Litenshteini
	Austria		Lituania
	Bashkimi Evropian		Luksemburgu
	Belgjika		Malta
	Biellorusia		Mbretëria e Bashkuar
	Bullgaria		Monako
	Danimarka		Norvegjia
	Estonia		Polonia
	Federata Ruse		Portugalia
	Finlanda		Qiproja
	Franca		Republika Çeke
	Gjermania		Rumania
	Greqia		ShBA
	Holanda		Slovakia
	Hungaria		Slovenia
	Irlanda		Spanja
	Islanda		Suedia
	Italia		Turqia
	Japonia		Ukraina
	Kanadaja		Zelanda e Re
	Kroacia		Zvicra
	Letonia		

Burimi: Faqja zyrtare e KKKBNK, marrë nga

http://unfccc.int/parties_and_observers/parties/annex_i/items/2774.php, në gusht 2013